monumentet



DO NOT COPY

2005

DO NOT COPY

DO NOT COPY

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
TIRANË

monumentet

40
VJET
I.M.K.

2005

Redaksia:
Edlira ÇAUSHI - *Kryeredaktore*
Prof.Dr. Emin RIZA - *Sekretar kolegjiumi*
Prof.Dr. Valter SHTYLLA - *Anëtar*
Mustafa ARAPI
Reshat GEGA
Sulejman DASHI
Latif LAZIMI
Behar GJOKA - *Redaktor letrar dhe gjuhësor*

DO NOT COPY

© Copyright: Instituti i Monumenteve të Kulturës
Botim i Institutit të Monumenteve të Kulturës
I.M.K. - Rruga "Sami Frashëri", Nr. 33
Tiranë, 2005

Në kopertinë: *"Kisha e Shën Thanasit"*, Voskopojë
Foto: Alket ISLAMI

Shtypur në shtypshkronjën e Shtëpisë Botuese
"LILO"

PASQYRA E LËNDËS

Instituti i Monumenteve të Kulturës në 40 vjetorin e themelimit të tij 5

Koço ZHEGU *Qyteti i Lisit në kohën romake* 9

Emin RIZA *Vlerësimi i arkitekturës popullore në 40 vjet veprimtari të Institutit të Monumenteve të Kulturës* 25

Valter SHTYLLA *Portat e arta (Golden Gate) të Via Eganatias në Ballkan* 33

Sulejman DASHI *Restaurimi arkitektonik në Shqipëri (periudha tradicionale)* 41

Edlira ÇAUSHI *Kisha e Shën Thanasit, VOSKOPOJE* 49

Kristaq BALLI
Lorenc GLIOZHENI *Hartografia, Pîrî Reis dhe brigjet shqiptare në vitin 1520* 57

Shpresa PRIFTI *Banesa shkodrane me çardak deri rreth mesit te shek.XIX* 69

Mustafa ARAPI *Nikolla, biri i Onufrit dhe jo i Onufër Qipriotit* 87

Dr.Ark. Latif LAZIMI *Trashëgimia Kulturore në funksion të turizmit kulturor në bregdetinJonian* 97

Luan PËRZHITA *Rreth identifikimit të lumit Ardaksan* 103

Skënder MIHALÇKA *Afreskat në kishën e Shën Thanasit në Pecë viti 1525* 109

Adrian CENE
Andi SPAHIA
Gentian VOKOPOLA *Mbi restaurimin e pikturës murale në banesën e zekateve* 127

Frederik STAMATI *Një mbulesë ikone prej argjendi e vitit 1802. Konservimi dhe studimi i saj* 133

Ajet NALLBANI *Drejtoria Rajonale e Monumenteve të kulturës Berat në 40-vjetorin e krijimit* 139

Dr. Kristofor NASLAZI *Mbi veprimtarinë artistike ikonografike të piktorit të fundit të shek. XVII Murgut Simon I Ardenicës* 143

Emin RIZA *Propozim për përfshirje në listën e pasurive botërore, dorëzuar nga Shqipëria* 153

DO NOT COPY

CONTENTS

By **Koço ZHEGU** — *The town of Lissus in the toman period* 24

By **Emin RIZA** — *Valuation of Popular Architecture in the Institute of Cultural Monuments* 32

By **Valter SHTYLLA** — *The Golden Gate of the Via Egnatia in the Balkans* 39

By **Sulejman DASHI** — *Architectural Conservation in Albania (Traditional Period)* 48

By **Edlira ÇAUSHI** — *The church of Saint Athanas, in Voskopoja* 56

By **Kristaq BALLI**, **Lorenc GLIOZHENI** — *Piri Reis Cartography and the Albanian Coast* 66

By **Shpresa PRIFTI** — *Residences os Shkodra during the middle of 19th Century* 86

By **Mustafa ARAPI** — *Nikolas son of Onupher and not son of Onupher Cypriot* 96

By **Dr.Ark. Latif LAZIMI** — *The Cultural Heritage helps the Cultural turism in Ionian Seacoast* 101

By **Luan PËRZHITA** — *The identification of Ardaksan River* 107

By **Skënder MIHALÇKA** — *The Frescos of "Saint Thanas" church in Peca* 125

By **Adrian CENE**, **Andi SPAHIA**, **Gentian VOKOPOLA** — *The house of Zekat in Gjirokastra* 131

By **Frederik STAMATI** — *The Restoration os Hoxhara Treasure* 137

By **Ajet NALLBANI** — *The 40th Anniversary of the Institute of Cultural Monuments. (I.C.M.) the branch of Berat* 142

By **Dr. Kristofor NASLAZI** — *The Iconographic work of the painter Simon of Ardenica* 152

By **Emin RIZA** — *Proposal for the Inscription Submitted by Albania* 179

By **Bujar LESKAJ** *MINISTER OF TOURISM, CULTURE, YOUTH AND SPORTS*

Signature on behalf of the State Party 198

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Instituti i Monumenteve të Kulturës në 40 vjetorin e themelimit të tij

Themelimi i Institutit të Monumenteve të Kulturës në vitin 1965, mbi bazën e sektorit të Mbrojtjes dhe Restaurimit të monumenteve, pranë grupit të kulturës materiale të Institutit të Historisë dhe Gjuhësisë, shënoi një ngjarje kulturore për vendin.

Megjithëse me akte ligjore, sensibilizimi për monumentet në Shqipëri është krahasimisht i hershëm dhe i përket viteve 1922, me një qarkore për mbrojtjen e monumenteve më 1929, me dekret ligjin për "Monumentet Kombëtare", realisht vlerësimi i monumenteve në Shqipëri shfaqet pas Luftës së Dytë Botërore.

Prej vitit 1944 dhe deri më sot, në fushën e vlerësimit të monumenteve, mund të dallojmë dy periudha, atë deri në vitin 1965 dhe tjetrën pas saj, e cila lidhet me veprimtarinë e Institutit të Monumenteve të Kulturës.

Veprimtaritë për vlerësimin e monumenteve përfshijnë një gamë të gjerë aktiviteti që përfshijnë, gjurmimin, vënien në mbrojtje, kuadrin ligjor dhe tekniko-administrativ, studimin, restaurimin dhe propagandimin e monumenteve të të gjitha gjinive dhe periudhave, në truallin e Republikës së Shqipërisë.

Theksojmë se pas vitit 1944, në Shqipëri vlerësimi i monumenteve filloi të konsiderohej prekshëm, si veprimtari shumëplanëshe për përfshirjen e kësaj trashëgimie në jetën kulturore të vendit.

Në vitin 1948 miratohet dekreti "Mbi mbrojtjen e monumenteve të kulturës dhe sendeve natyrore të rralla". Ky ligj u zëvendësua prej atij të vitit 1971 dhe më pas atyre të viteve 1994 dhe 2004. Këto ligje kanë pasur përmirësime të vazhdueshme, duke synuar t'i përgjigjen problematikës komplekse të vlerësimit të monumenteve.

Në planin institucional fillesat e veprimtarisë në fushën e monumenteve lidhen me krijimin e një bërthamë të vogël për mirëmbajtjen e monumenteve pranë Institutit të shkencave. Në vitin 1955 krijohet Ateljeja e restaurimit, pranë Muzeut arkeologjik-etnografik. Në vitin 1962, atelie të tilla krijohen edhe në pesë qytete, duke rritur ndjeshëm veprimtarinë e mirëmbajtjes dhe konservimit të monumenteve.

Në vitin 1965 mbi bazën e sektorit të mbrojtjes dhe restaurimit të monumenteve, pranë grupit të kulturës materiale dhe ateljeve në qendër dhe rrethe, krijohet Instituti i Monumenteve të Kulturës. Ai kishte në përbërje të tij edhe mbarë rrjetin e ateljeve në rrethe. Vetë instituti u organizua mbi bazë sektorësh, sipas gjinive të monumenteve, krahas administratës.

Centralizimi profesional qe një parim i shëndoshë i veprimtarisë së institutit, i cili kishte përparësitë e dyfishta të zbatimit korrekt të kritereve të restaurimit, në mbarë monumentet dhe krijimit të kushteve për ngritjen profesionale të punonjësve të rinj të fushës. Ndarja e punonjësve shkencor, sipas kategorive të monumenteve gjatë gjurmimit dhe ndërhyrjeve restauruese, krijuan kushtet që restauratorët të ishin natyrshëm, njëherazi dhe historianë arkitekture dhe arti.

Me krijimin e Institutit të Monumenteve më 1965, lista e monumenteve ishte krahasimisht e vogël. Në të përfshiheshin monumente të vlerave madhore, kryesisht të gjinive të fortifikimeve dhe ndërtimeve të kultit, si dhe Qendrat historike të Beratit dhe Gjirokastrës, me një numër të madh banesash popullore.

DO NOT COPY

Në rrethanat e reja shtrohej detyrë parësore gjurmimi në gjithë vendin dhe vënia në mbrojtje e monumenteve me vlera, për t'u ruajtur për sot dhe për të ardhmen, në cilësinë e monumentit. Gjurmimi i monumenteve, përfshiu mbarë vlerat e trashigimisë së paluajtshme, pavarësisht prej gjinisë apo kohës së ndërtimit.

Kriteret e vënies në mbrojtje të monumenteve mund të përmblidhen në ato tipologjike, vlerave arkitekturore, shkollës së autenticitetit, gjendjes teknike, vendndodhjes, etj.

Lista e parë e monumenteve është ajo e vitit 1948 prej 107 veprash. Në vitin 1961 u vunë në mbrojtje dy qytetet – muze, të Beratit dhe Gjirokastrës, të cilët përfshinin një numër të madh banesash, ndërtime kulti dhe dy kalatë. Pas themelimit të Institutit të Monumenteve, gjurmimi në mbarë vendin për identifikimin e tyre u shfaq si prioritet. Grupe specialistësh, sipas fushave i ranë vendit, kryq e tërthor, duke identifikuar vlera, kryer dokumentacionin paraprak dhe paraqitur shembujt më të spikatur, për t'u shpallur monument në instancat përkatëse.

Në vitet 1974-1978 u krye gjurmimi i ndërtimeve popullore, kryesisht banesa në fshat dhe në qytet. Krahas u vu në mbrojtje qendrat historike të Korçës, Elbasanit, Shkodrës dhe Vlorës. Shpalljet e monumenteve kryheshin me lista të miratuara prej Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës, mbi bazën e propozimeve të bëra prej këshillit shkencor të I.M.K.

Në vitin 1988 në Shqipëri qenë shpallur në mbrojtje të shtetit, me cilësinë e monumentit, 1134 vepra dhe ansamble si pazari i Krujës, qendra antiko mesjetare e Apollonisë etj. Pas dokumentacionit paraprak, i cili hartohej gjatë gjurmimit të vlerave për t'u cilësuar monument, kryhej veprimtaria e rëndësishme e dokumentacionit grafik, fotografik dhe përshkrimor të monumenteve. Ky dokumentacion, hartuar sipas kriteresh të shëndosha metodike, sistemohej në arkivin e dokumentacionit shkencor të institutit. Kështu në vitin 1988 në arkivin e institutit ruheshin 127 480 negativë, bardhë e zi, të formateve të ndryshëm, 2300 dosje me material dokumentar, grafike dhe fotografike,etj.

Vënia në mbrojtje e vlerave më të spikatura historiko- kulturore, me cilësinë e monumentit, është e lidhur ngushtë me përkujdesjet për ruajtjen e këtyre vlerave, ndër të cilat vendin kryesor e zë restaurimi i tyre.

Veprimtaria restauruese në monumentet Shqiptare është mbështetur fuqimisht në dokumentimin themeltar të kësaj veprimtarie, "Kartën e Venecias", të vitit 1964. Parimet themelore të saj lidhen me ruajtjen maksimale të substancës origjinale, fazave të ndërtimit dhe teknikës tradicionale. Rindërtimet e pjesshme janë të pranueshme vetëm kur shfaqen si rruga e vetme për ruajtjen e pjesës origjinale të veprës. Restauratorët e rinj shqiptarë, të dalë ekskluzivisht prej shkollës shqiptare dhe të formuar profesionalisht nëpërmjet punës në këtë fushë, përballuan me arritje të prekshme problematikën e restaurimit të monumenteve.

Projektet e hartuara prej punonjësve shkencorë të I.M.K., zbatoheshin prej organizmash permanente, zbatuese në kuadrin e institutit, nëpër rrethe të ndryshme të vendit, nën mbikqyrjen e autorëve të tyre. Kjo praktikë, e cila përqëndronte në një organizim të vetëm projektimin dhe zbatimin e ndërhyrjeve restauruese, shfaqej me përparësi madhore në dobi të ruajtjes maksimale të autenticitetit të vlerave të monumenteve, që përbën synimin e çdo restaurimi të mirfillitë.

Ritmi i ndërhyrjeve restauruese, në mbarë gjinitë e monumenteve, nga viti në vit pësonte rritje. Kështu në vitin 1966 u restauruan 43 monumente, ndërsa në vitet 1987,1988 dhe 1989 u restauruan përkatësisht 221, 244 dhe 217 monumente. Shqipëria, shpejt, u rendit në vendet e para të hapësirës ballkanike dhe më gjerë, lidhur me përkujdesjet për vlersimin e monumenteve.

Restaurimi i monumenteve presupozon njohjen e thellë të monumentit për t'u restauruar dhe mbarë gjinisë prej restauratorit, i cili natyrshëm kthehet edhe në studiues të arkitekturës. Kjo e vërtetë shfaqet qartazi në veprimtarinë studimore – botuese të I.M.K. Pas botimit të parë të institutit në vitin 1967, veprimtaria botuese e tij pëson rritje të ndjeshme.

Ndër botimet e institutit, së pari shënojmë revistën shkencore gjashtë mujore "Monumentet", e cila i shtoi një fushë të re studimore shkencave albanologjike. Kjo revistë u përshëndet prej organizmash shkencore të huaja dhe personalitetesh të njohur

të fushës si kontribut jo vetëm për shkencën e vendit, por edhe për atë botërore. Krahas saj, një sërë monografish, mbi gjini të ndryshme monumentesh, qendrash historiko – kulturore dhe problematikash të restaurimit, filluan të botohen. Sukses i madh duhet mbajtur botimi "Historia e Arkitekturës Shqiptare" në vitin 1980. Një sërë albumesh dhe bibliografish, qenë ndihmesa të rëndësishme për thellimin e njohjes me monumentet si vlera të papërsëritshme historiko – kulturore.

Simpoziume kombëtare dhe ndërkombëtare, mbi monumentet shqiptare, dhanë ndihmesë për trajtimin e problematikës së këtyre vlerave dhe popullarizimit të tyre. Periudha e vendosjes së rendit demokratik në Shqipëri, paradoksalisht deri më sot nuk po jep përfundimet e pritura, lidhur me dendësimin e veprimtarisë për vlerësimin e monumenteve.

Prirjet pseudonovatore, pa provuar racionalizmin e tyre, kanë cënuar strukturat efikase për mbrojtjen e monumenteve dhe autoritetin profesional të institutit. Pikërisht, në këtë përvjetor të 40 të themelimit të institutit ka tregues të qartë të interesimit të prekshëm të shtetit shqiptar nëpërmjet Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për një kthesë rrënjësore në këtë fushë.

Kjo kthesë e domosdoshme për vitalizimin e monumenteve, si dëshmi e vlerave historiko – kulturore, lidhet para së gjithash me rritjen e autoritetit të I.M.K., i cili me fondet e duhura për restaurim, bazës për veprimtari të tjera bashkëplotësuese, do t'i vërë vlerat e trashëgimisë së paluajtshme në vendin e duhur të jetës sonë kulturore.

REDAKSIA

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Koço ZHEGU

Qyteti i Lisit në kohën romake

Njohja e periudhës së pushtimit romak, të qytetit Ilir të Lisit ka një rëndësi të veçantë për zhvillimin e historisë të qyteteve të Ilirisë bregdetare.

Nga zbulimet dhe gërmimet e deritanishme, janë arritur rezultate të shënuara në drejtim të përcaktimit etnik ilir si dhe zhvillimit të qytetit në periudhat e mëpastajme.

Në këtë artikull do të përpiqemi të argumentojmë të dhënat e deri tanishme në paraqitjen e tyre historiko arkeologjike për gjendjen e qytetit të Lisit në kohën e pushtimit romak.

TË DHËNAT HISTORIKE

Në historinë e shkruar të kohës antike, Lisi dhe Akrolisi përmenden së bashku, për herë të parë, nga historiani grek, Polibi në shek.II para Krishtit më vonë nga Tit Livi, historian romak i kohës së Augustit dhe nga Jul Qezari, etj.

Burimet historike nuk bëjnë fjalë për rrethanat edhe as për kohën e saktë të pushtimit të qytetit nga romakët. Në luftrat iliro-romake, që kishin për qëllim shmangien e operacioneve luftarake të fiseve ilire, që bëheshin për gjatë dhe në thellësi të tokës bregdetare të Adriatikut, nuk përmendet fare pushtimi i Lisit nga romakët.

Si qyteti i Lisit, ashtu edhe kështjella e tij Akrolisi përmenden, siç u tha më sipër, nga Polibi historian grek i shek.II. para kri. Ky autor në historinë e tij trajton gjerësisht luftrat iliro-romake, dhe ngjarjet e tjera që u zhvilluan në tokën ilire gjatë luftërave maqedonoromake, në vitet 264-146 para Kri. Polibi. Ai përmend gjithashtu se në vitin 213 para Kri.

Filipi i V i Maqedonisë donte të pushtonte Lisin me qëllim që të kishte një bazë detare të sigurt në bregun e Adriatikut, për ta përdorur në operacionet luftarake që synonte të kryente kundër Romës.Kur Filipi arriti në fushën para qytetit të Lisit u befasua me muret rrethuese të qytetit, dhe pozicionin gjeografik që kishte Akrolisi, kështjella mbrojtëse e tij. Në këtë rast ai u shpreh se ishte e pamundur që të pushtohej ky qytet, prandaj duhet parë ndonjë dredhi për t'i tërhequr ilirët jashtë mureve të rrethimit. Në këto rrethana Filipi me anën e një strategjie dredharake, shtiu në dorë se pari Akrolisin dhe më vonë me anën e luftimeve në fushë të hapur arriti që Lisi të dorëzohej menjëherë.

Në mbretërin e Gentit, Shkodra ishte kryeqytet i mbretrisë dhe Lisi radhitej një ndër qytetet më të fortifikuara në bregdetin lindor të Adriatikut.Të nisur nga fakti që Genti preu edhe monedha të veçanta, me emrin e lisit (LISITAN), pohojmë se ai ishte edhe një qytet autonom me një ekonomi shumë të zhvilluar.

Në këtë kohë mbreti Gent kishte mendime që me Perseun e Maqedonisë, të lidhte një marrëveshje kundër Romës. Bisedimet nuk patën ndonjë rezultat për arsye se Perseu nuk u përgjigjej kërkesave ekonomike të Gentit.

Ky autor, ndër të tjera, shkruan se Genti ishte i nxitur për luftë kundër romakëve dhe për këtë mblodhi në Lis të gjitha forcat e armatosura, rreth pesëdhjetmijë. Prej andej dërgoi të vëllanë me njëmijë këmbësorë dhe pesëdhjet kalore për të nënshtruar me anën e forcës ose të frikës, fisin e kandarëve. Genti vetë u nis kundër qytetit Basania, pesë milje larg nga Lisi. Basanasit ishin aleatë të romakëve, prandaj kur provoi Genti me anë të delegatëve t'i tërhiqte nga ana e tij, ata më parë pranuan të

rrethoheshin se sa të dorëzoheshin.Kur pretori Anici. Dëgjoi, Apoloni, se ç'po ngjiste në Iliri, përgatiti ushtrinë veçanërisht për të çliruar basanasit nga rrethimi. Këtë fushatë e penguan lajmet që mori se anijet e lehta të armikut po plaçkitnin bregdetin. Genti i nxitur prej Pantahaut kishte dërguar rreth tetëdhjet anije për të plaçkitur tokat e dyrrahasve dhe të apolloniatëve. Në këtë kohë flota romake qëndronte pranë bregdetit jo larg Apolonisë .Anici vrapoi këtu, i arriti shpejt plaçkitësit Ilirë, u përlesh me ta, i theu fare lehtë dhe disa nga anijet i zuri ndërsa të tjerat i shtrëngoi të kthehen përsëri në Iliri. Pastaj u kthye në lëmin e tij, pranë Genusit dhe shkoi për të ndihmuar basanasit. Genti i tmerruar nga arritja e shpejtë e pretorit romak, hoqi rrethimin dhe iku në Shkodër, aq i shpejtuar sa nuk mundi të merrte të gjithë ushtrinë me vehte. Atëherë një numur i madh ushtarësh, që do të mund të qëndronin n.q.s kryetari i tyre do t'u kishte qëndruar pranë,u dorëzuan të gjithë tek romakët.

Shembullin e këtyre e ndoqën edhe qytetet e tjera të kësaj krahine, të cilat u dorëzuan tek pretori romak, të tërhequr sidomos nga butësia,që ai tregoi kundrejt tyre. Pastaj pretori arriti në Shkodër e cila ishte pika më me rëndësi e luftës, sepse Genti e kishte zgjedhur këtë si fortesë të gjithë mbretërisë duke qenë vendi më i fortë i labeatëve, dhe i vështirë për t'u afëruar.

Pretori romak i nisur nga fakti se fillimi i kësaj fushate kishte shkuar mbarë besoi se dhe në marrjen e Shkodrës do ta ndihmonte fati dhe se një sulm i shpejtë dhe i befasishëm do të kishte efekt. Për këtë rreshtoi ushtrinë dhe ju afrua mureve të qytetit. Të rrethuarit po të kishin mbyllur portat dhe të kishin vendosur ushtarë për të ruajtur muret dhe kullat e portave, do të kishin prapsur romakët nga muret dhe do të kishin bërë të dështonin në sulmin e tyre. Por, ata dolën nga porta dhe, në fushë të hapur nisen luftën me romakët duke treguar më shumë guxim se sa qëndresë. Më në fund u thyen dhe në ikje e sipër u grumbulluan tek hyrja e ngushtë e portës, ku u vranë më shumë se dyqind vetë; atëherë kaq u hyri tmerri sa që Genti menjëherë dërgoi si delegatë te pretori dy nga krerët e fisit. Teutikun dhe Balin,për të kërkuar një vend të fshehtë për t'u këshilluar, por pa dobi; atë e gënjeu shpresa se i vëllai Karavanti do të vinte me shumë mijëra ushtarë, të mbledhur në ato vise ku ishte dërguar.Por me qenë se kjo nuk ndodhi, pas tri ditësh, u kthye në Shkodër, gjithnjë nëpër rrjedhën e lumit, dhe mbasi i çoi më parë pretorit fjalë për të kërkuar leje për t'u takuar dhe iu dha mundësia erdhi në lëmin e pre-torit. Pastaj bashkë me pretorin hynë nën vërejtje duke ja dorëzuar tribunit G.Kasit.

Anici mbasi shtiu në dorë Shkodrën, dha urdhër për të kapur miqtë e farefisin e mbretit. Përpara u nis për në Meteon, qytet i fisit të labeatëve, dhe solli në Shkodër tek lëmi, të shoqen e Gentit, Etlevën me të dy të bijtë Skerdilajdin dhe Pleuratin, si dhe të vëllanë Karavantin.

Anici mbasi shtiu në dorë Shkodrën,dha urdhër për të kapur miqtë e farefisin e mbretit. Përpara u nis për në Meteon, qytet i fisit të labeatëve,dhe solli në Shkodër tek lëmi, të shoqen e Gentit, Etlevën me dy bijtë Skerdilajdin dhe Pleuratin, si dhe të vëllanë Karavantin.

Anici mbasi lufta mori fund, brenda tridhjetë ditëve, dërgoi në Romë, si lajmëtarë të fitores Perpenen dhe pas pak ditësh vetë mbretin Gent, me të ëmën, të shoqen me fëmijët si dhe të vëllanë me krerë të tjerë të Ilirëve.

Pas rënies së mbretërisë së Gentit, Roma e ndau në tri njësi administrative territorin e tokave të fiseve Ilire, që përfshiheshin në shtetin Ardian. Në njësin e parë ushtarako-administrative, qyteti i Lisit ishte si qendër kryesore e saj. Këtu bënin pjesë krahinat në veri të lumit Mat e deri në kufirin jugor të labeatëve. Kjo ndarje kishte për qëllim në radhë të parë të përçante bashkimin e fiseve Ilire dhe të largonte rrezikun e organizimit të kryengritjeve të përbashkëta të këtyre fiseve, kundër romakëve. Këto fise Ilire janë konsideruar nga Polibi si "popull i prapë", prandaj edhe kundër tyre u morën masa administrative duke ua ndaluar të drejtën, që të mblidheshin në një kuvend të përbashkët.

Banorët e njerës njësi ndaloheshin të kishin marrëdhënie me njësinë tjetër, u ndalohej gjithashtu tregtija ndërmjet tyre,dhe prerja e lëndës së drurit për ndërtimin e anijeve. Para mijëvjeçarit të parë para Krishtit. Lisi përmendet si "municip", qendër e rëndësishme ushtarako-administrative romake.

Nga këta dy autorë, të paraqitur me radhë dhe

DO NOT COPY

në të gjithë tekstin ku bëhet fjalë në veçanti për qytetin e Lisit arrihet të plotësohet një pjesë e rëndësishme e historisë së këtij qyteti. Në mënyrë të tërthortë kuptohet pse ai gjatë luftës me Filipin e V të Maqedonisë, nuk u shkatërrua nga operacionet ushtarake,sepse luftimet u zhvilluan në fushë të hapur dhe jashtë qytetit. Lisi dorëzohet pa kushtete, nga ana tjetër mësohet se Filipi për arsye të ndryshme e lë qytetin pas një kohe të shkurtër.

TË DHËNA ARKEOLOGJIKE

Qyteti i Lisit, për periudhën romake ruan shumë gjurmë që tregojnë për një pushtim të një kulture të huaj e të dallueshme nga ajo fillestare Ilire,e cila zë fill nga një vendbanim para urban.

Periudha e dytë përfaqësohet më qartë në rindërtimin e sistemit të fortifikimit, të konceptuar sipas kërkesave të një strategjie të re që i përshtatet situatës së krijuar në konditat e vendosjes së një popullsie të huaj, pushtuese të vendit. Materiali tjetër i bollshëm arkeologjik, që predominon mbi atë vendas, tregon nga ana tjetër për marrëdheniet kulturore e tregtare të kolonëve me token e tyre te pertej detit, në perëndim të Adriatikut.

Sikurse përmendëm, qyteti i Lisit, administrohej për këtë periudhe nga një këshillë romake,i cili siguronte vendosjen e kolonëve edhe të reparteve ushtarake, si dhe mbrojtjen e tyre. Synimet e pushtuesve kanë qenë që të ndajnë popullsinë vendase nga kolonët romak gjë që tregon se romakët nuk u kishin besim dhe për të qenë të sigurtë e ndanë qytetin në dy zona të fortifikuara. Ata morën të gjitha masat që të ndryshonin rrënjësisht sistemin urbanistik të qytetit, duke e përshtatur atë brenda skemës së qytetit Ilir dhe njëkohësisht të fortifikimit të tij. Ata tani e dinin mirë se ndodheshin në një vend të huaj, në prani dhe të rrethuar nga popullsia vendase. Muret rrethues, më të hershëm të qytetit Ilir, u rindërtuan, në pjesët e rrëzuara, dhe zonat e banuara të qytetit, në këtë kohë u ndanë ndërmjet tyre me mure rrethues të fortifikuar me kulla të larta. Sipas programit të ri u krijuan katër zona të fortifikuara:

1) Akropoli në majë të kodrës.
2) Zona e qytetit.
3) Qyteti i poshtëm.
4) Zona e portit lumor.

Akropoli

Gjurmët e zbuluara në shumë vende tregojnë se në këtë kohë është rindërtuar edhe sistemi i fortifikimit mbrojtës i Akropolit, që siç thamë, ishte në majë të kodrës. Nga ky fortifikim, për t'u përmendur janë dy kulla mbrojtëse, të cilat janë ndërtuar që nga themeli me të njëjtën teknike. Njëra nga këto që ka formën drejtkëndore, është ndërtuar në përforcim të mbrojtjes së portës kryesore që ndodhet në mesin e gjatësisë të murit lindor, dhe tjetra ka formën gjysmërrethore, me një diametër rreth 12m. Te dy këto kulla, që konsiderohen si një përforcim i mëtejshëm i sistemit mbrojtës të Akropolit kanë si karakteristikë gdhendjen e blloqeve të gurëve në përgjithësi në forma trapezodiale me ballin e sheshtë dhe vendosjen e tyre në rreshta, thuajse horizontale. Gjurmë të kësaj teknike dallohen edhe në vende të tjera, aty ku janë meremetuar muret e rrëzuara të periudhës së parë Ilire.

Akropoli rindërtohet në përgjithësi mbi gjurmët e mureve Ilire dhe kishte tre hyrje me porta të mëdha, e mbrojtura me kulla të larta. Në Akropol mendohet të ishte vendosur, shtabi ushtarak.

Zona kodrinore

Në zonën kodrinore ishin vendosur kolonët romak, dhe pjesërisht reparte të ushtrisë. Kjo vërtetohet nga ambientet e shumta të zbuluara, ngjitur nga ana e brendshme e murit ndarës të qytetit. Zona fushore e rrethuar e qytetit u ishte lënë e lirë qytetarëve ilirë për të banuar dhe për të zhvilluar veprimtari të ndryshme tregtare.

Këto të dhëna tregojnë shumë qartë,se romakët nuk u vendosën në të gjithë qytetin, por në një pjesë të tij dhe nga ana tjetër del se ata nuk ishin të mirëpritur dhe aq më pak të sigurtë për të jetuar aty. Qëllimi kryesor i tyre ishte për të krijuar në këtë qytet një bazë dhe një urë kalimi, për të depërtuar në thellësi të tokës Ilire, në drejtim të Dardanisë dhe Maqedonisë.

Muri i brendshëm, që kishte për qëllim ndarjen e qytetit në dy zona të fortifikuara, fillon nga kthesa veriperëndimore e murit Ilir, ndërtuar në anën veriore, dhe përfundon në kthesën jugë-perëndimore të murit Ilir Jugor. Ky mur i ndërtuar, që nga themeli, është me një xokolaturë prej blloqesh

Do not copy

PO KOPJOHET

gurësh të daltuar me sipërfaqe afërsisht të sheshtë dhe forma në shumicë trapezodiale të çrregullta. Ata janë vendosur në muraturë pa llaç lidhës dhe në rreshta të valëzuar.

Në krahasim me bllogët e muraturës Ilire gurët në xokolaturën e murit të brendshëm kanë përmasa afërsisht të bararta dhe faqen e dukshme nuk e kanë të gufmuar. Xokolatura gjatë murit të brendshëm arrin si mbas pjerësisë së terrenit 3-4m. Pjesa e sipërme mbi zokolatur ka qenë e ndërtuar me tulla të pjekura e të vendosura me llaç balte.

Sikundër rezulton nga burimet, që përmendëm, deri në kohën kur dorëzohet Mbreti Gent tek romakët, Lisi ka vazhduar të jetë një qytet me një rëndësi të veçantë. Por duhet thënë se përderisa Genti nuk e përdori atë si një qendër të sigurtë për t'u mbrojtur kundër sulmeve të romakëve,por zgjodhi në këtë rast qytetin e fortifikuar të Shkodrës lë të kuptohet se Lisi në vazhdim duket se vihet nën mbrojtjen romake sikurse edhe qytete të tjerë Ilire.Në këtë gjendje duket se vazhdoi deri në gjysmën e shekullit të parë, para Kri. kohë në të cilën, siç njofton vetë Çezari, ai ngarkoi këshillin romak që kish në dorë qytetin e Lisit, të cilin ua kishte besuar më parë ai dhe ishte interesuar ta fortifikonte atë. Janë pikërisht gjurmët e qarta të këtyre fortifikimeve, të zbuluara kohët e fundit që tregojnë se qyteti i Lisit, në këtë kohë rifortifikon përsëri sistemin e fortifikimit në bazë të strategjisë së përparuar romake.

Nga ana e brendshme e murit ndarës, dhe ngjitur tij u zbuluan një sërë ambjentesh, me përmasa afërsisht të barabarta dhe forma drejtkëndore. Këto ambiente me nga një hyrje e një dritare secila, gjetën edhe në pjesën tjetër të murit Ilir, që nga kthesa ku zë fill muri i brendshëm e deri te porta e Burimit.S'ka dyshim që këto ambiente shërbenin si magazina për shërbime të ndryshme ushtarake .Në mesin e gjatësisë të murit të brendshëm u zbulua një portë e madhe që shërbente për komunikimin e zonës kodrinore me zonën e poshtëme të qytetit. Më poshtë në drejtimin jugor dolën edhe gjurmët e një hyrje shumë të vogël, e cila me sa duket, komunikonte me lagjen më jugore të zonës kodrinore me qytetin e poshtëm.

Porta e brendshme

Porta e brendshme është emërtuar, hyrja e re. Ajo është ndërtuar në kohën romake në mes të gjatësisë së murit të brendshëm dhe shërbente, siç thamë, për komunikimin ndërmjet dy zonave të banuara, atje ku ishin vendosur kolonë dhe zonës së poshtme ku banonin Ilirët.

Kjo portë është vendosur, afërsisht në vijë të drejtë, kundrejt portës së Gaviarit që i përket periudhës së parë Ilire. Gjurmët e para të portës së brendshme u diktuan, që në verën e vitit 1969, gjatë punimeve që u kryhen për nxjerrjen në dritë të trakteve të mureve rrethues të qytetit të Lisit. Nga kjo portë ishin akoma të dukshëm, mbi sipërfaqe të tokës, një numur bllogesh gurësh të gdhendur,dy prej të cilëve ishin të gdhendur dhe me shirita ,gjë që tregonte se ata ishin përgatitur për t'u vendosur në qoshe të murit. Gjurmet e sipërfaqshme tregonin për një ndërprerje dhe thyerje të drejtimit të murit të brendshëm. Të para së bashku gjurmët e gurëve të rrëzuar tregonin për konturet e një porte, me përmasa të përafërta me portat kryesore të qytetit. Muri ndarës, që zbret nga veriu, përfundon në një kullë mbrojtëse me formë drejtkëndore, kurse pjesa e murit që ngjitet sipër përfundon me vendin e shkallëve që shërbenin për t'u ngjitur tek bedenat e murit. Nga kjo vendosje është krijuar korridori i portës në mesin e të cilit u zbulua pragu i saj. Nga korridori kalohej në një oborr të fortifikuar dhe në të djathtë të tij hyhej në zonën e qytetit kodrinor. Porta e brendshme në tërësinë e saj paraqet një planimetri të veçantë nga portat e periudhës Ilire. Kjo portë, në përfundim të punimeve që u kryen për zbulimin e saj, doli shumë e dëmtuar dhe pothuaj në pjesën më të madhe e rrëzuar për shkak të rrëshqitjes së terrenit. Pjesa e sipërme e mureve të saj që ishte ndërtuar me tulla nuk ruhesh fare, gjë që tregon se tullat ishin marrë e përdorur për ndërtime të tjera në kohë të ndryshme.

Nga sa mund të vërehej nga rrëzimi i mureve, dhe zhvendosja e bllogeve të gurëve nga muratura del se rrëshqitja e tokës ka ndjekur pjerrësin e terrenit në dy drejtime, jugor e perëndimor. Gjithcka që trashëgohet nga kjo portë, i përket xokolaturës, të murit ndërtuar me bllogë gurësh të gdhendur, të cilët të gjithë u gjetën të rrëzuar ose të rrëshqitur deri në 2m, larg nga vendosja e tyre fillestare. Kjo portë si edhe gjithë portat e më të hershme, ishte e

përforcuar nga një kullë drejtkëndore të ndërtuar në krahun e majtë para hyrjes së saj.

Në brendësi të murit të brendshëm dhe në gjithë gjatësin e tij u zbuluan gjurmët e një sërë ambjentesh, që mendohet se u shërbenin reparteve ushtarake. Gjendja e tyre, në përfundim të gërmimeve arkeologjike pranë portës ishte shumë e dëmtuar. Pranë këtyre ambienteve u gjetën edhe gjurmët e shkallëve që shërbenin për ngjitjen e ushtarëve në bedenat mbrojtëse të murit të rrethimit. Këto ndarje, njëkthinëshe, kishin nga një hyrje dhe një dritare. Nën dyshemenë prej dheu të njërit prej këtyre ambientëve u gjetën gjurmët e një kanali të mbuluar me rrasa guri, i cili shërbente për nxjerrjen e ujërave të shirave, jashtë zonës së fortifikuar ku banonin romakët. Pragu i portës ishte i shkallëzuar dhe porta mbyllej me dy kanata druri.

Për punimet e restaurimit dhe ringritjen e mureve të xokolaturës së portës së brendshme paraqiten edhe më me hollësi në artikullin "Restaurimi i portës së brendshme në qytetin Ilir të Lisit". Botuar në nr 7-8, 1974 të revistës "Monumentet".

Gjurmë të tjera të merametimeve të mureve Ilire nga romakët u gjetën edhe tek porta e Gaviarit, në qoshen jugë-lindore të murit rrethues.

Në vërtetim të këtyre gjurmëve, pranë kësaj porte, u zbulua edhe një gur i mbishkruar, që bënte fjalë për ndërtime të kryera nga këshilli romake i qytetit, nën kujdesin e magjistarit ekzekutiv të tij, me shpenzimet e bashkësisë qytetare, përmendet gjithashtu edhe sasia e të hollave të shpenzuara për ndërtimet e kryera në këtë portë.

Për rindërtimin e sistemit të fortifikimit të qytetit të Lisit bën fjalë edhe vetë Çezari në veprën e tij "Lufta Civile", ku thotë se këshilli i qytetarëve, që kishte në dorë Lisin, të cilin ua kishte besuar më parë Çezari. Ishte i përkujdesur ta fortifikonin. Siç shihet këtu kemi një përputhje të burimeve historike, më të dhënat epigrafike kështu që përcaktimi kohor i fortifikimit të Lisit, në kohën romake, datuar në mesin e shek.I para Kri., është i sigurtë. Për një datim të tillë flet edhe vetë teknika e ndërtimit të murit ndarës, i cili është ndërtuar me teknikën e përzier, mur tulle të lidhura me llaç balte, i mbështetur në një xokolaturë, ndërtuar me blloqe gurësh të gdhendur të vendosur në muraturë të thatë.

Sipas të dhënave që u paraqitën, llogaritet që rindërtimi i sistemit të fortifikimit të Lisit, është bërë rreth 250 vjet pas fortifikimit të kohës Ilire. Tërthorazi arrihet në përfundimin se qyteti i Lisit deri në mesin e shek. te I para Kri. ka qenë i papushtuar nga romakët. Duke menduar se vendosja e kolonëve romakë dhe garnizonit ushtarak me banim të përhershëm, siç e tregojnë ambientet ushtarake të zbuluar pranë murit të brendshëm, del se qyteti i Lisit, pas dorëzimit të Gentit dhe deri në këtë kohë, rreth 100 vjet më pas ka qenë i lirë dhe në aleancë me Romën.

Në drejtim të zhvillimit ekonomik e kulturor të qytetit, periudha e pushtimit romak,duke filluar që nga gjysma e shek. I, duket se është periudha më e zhvilluar e tij. Kjo periudhë është përfaqesuar edhe në gjetjet e shumta që janë zbuluar në vend, si rezultat i gërmimeve arkeologjike dhe punimeve të restaurimeve të kryera për disa vjet me radhë.

Gjetjet e shumta të fragmenteve të qeramikës së pjekur zakonisht të enëve të përdorimit të përditshëm dhe në veçanti të amforave të mëdha,

Të cilat në shumicën e tyre janë të ardhura nga Italia dhe pjesërisht të prodhuara në vend. Këto tregojnë gjithashtu për marrëdhënie tregtare shumë të zhvilluara. Në shumë pjesë të buzëve dhe dorezave të amforave janë gjetur edhe shumë vula epigrafike apo monograme, që përcaktojnë punishtet e prodhimit të tyre.

Për qëndrimin apo tërheqjen e romakëve nga qyteti i Lisit, deri më sot nuk kemi ndonjë të dhënë të sigurtë, megjithatë gërmimet arkeologjike tregojne se sistemi i fortifikimit të qytetit të poshtëm, humbet tërësisht qëllimin mbrojtës dhe ndërtimet qytetare u gjetën të ndërtuara edhe jashtë këtyre mureve duke filluar që nga fillimi i shek.III dhe më pas. Për periudha të mëvonshme tregojnë gjithashtu edhe mbyllja e hapësirës së korridoreve të portave të periudhës Ilire dhe romake, në zonën kodrinore dhe qytetit të poshtëm, të cilat u gjetën të mbyllura me mure të zakonshëm të lidhura me llaç gëlqereje.

Nga pikëpamja e vendosjes së ndërtimeve jashtë mureve, në planin horizontal, ato tregojnë për ndryshime të rëndësishme në sistemin urbanistik të qytetit të Lisit. Në këtë kohë ai zhvillohet në terren jo më të kufizuara nga muret rrethuese, por mbi rrënojat e

DO NOT COPY

mbuluara të tyre. Këto ndërtesa të para në drejtimin vertikal, tregojnë për praninë e dy horizonteve të banimit që mbulojnë njëri tjetrin. Ky fakt vërteton nga ana tjetër, për rindërtime rrënjësore të qytetit të poshtëm të bëra në faza të ndryshme dhe të njëpasnjëshme.

Ndërtimet e para, jashtë mureve rrethuese kanë qenë të ndërtuara mbi një shtresë aluvionale,e cila presupozon një përmbytje dhe mbulim të një pjese të qytetit të poshtëm.Ky nivel banimi përfaqësohet më mirë nga gjurmët e një ndërtese që u gjet para dhe mbi kalldrëmin e hyrjes kryesore të qytetit Ilir, rreth 0,70m. lartësi mbi nivelin e kalldrëmit të rrugës. Ndërtesa e zbuluar këtu paraqitet një godinë me hajat përpara,ndërtuar me kollona të rrumbullakta prej guri. Disa metra më në perëndim të kësaj ndërtese u zbulua planimetria e një banjoje publike me hipokaust. Nga kjo banjo janë ruajtur muret perimetrale 0,50 m lartësi në të cilët ruhen gjurmët e oxhakëve, tulla me vrima nga ku kalonte flaka e ngrohjes së pareteve të mureve anësore të sallës kryesore. Nga zgjidhja e planimetrisë dhe teknika e ndërtimit të kësaj banjoje arrihet një datim i përafërt, rreth shek. III pas Kri. Kjo datë mendojmë se është edhe përfundimi i ndikimit të periudhës romake në qytetin e Lisit.

Nga sa u paraqit në këtë punim, arrihet në përfundimin se ngulitja e popullsisë romake në këtë qytet, ishte e përkohshme, për disa shekuj, dhe se popullsia vendase që jetonte e ndarë nga ajo romake, nuk u romanizua por vazhdoi të jetojë për shumë shekuj me radhë deri në ditët tona në trojet e veta.

DO NOT COPY

Bibliografia:

- Polibi. istoritë, L II. 12. Burime të zgjedhura historike. vëll. I 1965, f. 49.
- Tit Livi. Nga themelimi i Romës. LXIV.26.6. Burime të zgjedhura...
- Historia e Shqipërisë, I. Tiranë 1959.
- F.Prendi-Koço Zheku. Qyteti ilir i Lisit, origjina dhe sistemi i fortifikimit të tij. Studime Historike I 1971, f. 155-169.
- S.Islami. Lindja dhe zhvillimi i jetës qytetare në Iliri. Iliria II 1972, f. 12.
- F.Prendi-K.Zheku. Lisi në dritën e të dhënave të reja arkeologjike. Monumentet 2, 1971, f. 7-17.
- H.Ceka. Probleme të numizmatikës ilire. Tiranë 1965, f. 93-95.
- Koço Zheku. Lisi në shekuj. Tiranë 1988.
- C.J.Cezari. Lufta civile. L.III. 29.
- F.Prendi. Dy mbishkrime ndërtimi nga qyteti i Lisit. Iliria 1982.



Planimetria e mureve rrethues të Lisit

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Porta e Brendshme pas restaurimit



Ambientet ushtarake

DO NOT COPY



Porta e Brendshme



Koridori dhe praga i portës

DO NOT COPY



Mbishkrim që bën fjalë për rindërtimin e mureve rrethues



Mbishkrim që bën fjalë për mermetimin e portës së Gaviarit



Korridori i portës para restaurimit



Pamje gjatë zbulimit të portës së brendshme

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Pamje e ambienteve ushtarake pas restaurimit



Pjesë e një shtëpie banimi e kohës romake, zbuluar në zonën kodrinore



Kulla e rrumbullaktë në Akropol pas restaurimit





Amfora të gjetura tek porta e Brendshme

DO NOT COPY

DO NOT COPY





Vula mbi dorezat e amforave

DO NOT COPY





Vula mbi qaforet e amforave

DO NOT COPY

The town of Lissus in the toman period

The period of the Roman occupation of the Illyrian town of Lissus is of a great importance for the developing of coastal towns of Illyria.

In this article, analyzing the resources of the antic authors, confronting them even with the data gathered by the archeological excavations and the conservation work, is done a great effort to argument what was the role of this town in that period.

The antic historical resources where are mentioned the Illyrian-Roman war and the other events that happened in the Illyrian land in 264-146 B.C. did not mention in any case the occupation of the town of Lissus from the Romans.

As far as we understand from these resources, up to the time that the king of Illyrians Gent surrender to the Romans, Lissus continued to be a town of a great importance. It might be an important independent town pertaining to an alliance with the Romans. It remained in those conditions up to the half of the 1st century B.C. It was the time when Cesar charged the roman council that governed the town of Lissus, to fortify this town. It is because of these clear traces, discovered lately, that show that the town of Lissus in that time was refortified aiming to protect the colons and the military forces that were gathered in there. In that time inside this Illyrian town there was built a wall that separated the town in tow main parts, which were very well protected: The hilly part where were settled the army and the colons and the second zone that of the riverbank where was placed the rest of the population.

During the restoration of the walls of Lissus were discovered tow stones inscribed in the Latin language. They speak of the constructions done by the Roman Council of the town, under the protection of his executive majesty, L Gaviarit and Meges. There is explained that the work activity is paid with the expenses of the town community. As it is clearly seen the historical resources and the epigraphic data fit tightly together.

The time determination of the fortification of Lissus and at the same time, the settling of the Roman colons in the second half of the 1st century B.C. is verified completely.

According to these data the reconstruction of the fortification system of Lissus is done 250 years latter than that done from the Illyrians. We arrive to the conclusion that the town of Lissus, till the half of the 1st century B.C. was occupied by the Romans, on the other hand appears that this town, after Gent gave up, for about 100 years, Lissus has been an independent town in alliance with the Romans.

We have no data, if the Romans left Lissus or stayed there. The archeological excavations show that the fortification system looses its protective aim and the local population was out of the surrounding walls, staring from the beginning of the III century and after.

As far as we see in this article we come to the conclusion that the settling of the Roman colons in this town was not permanent, and the local population of this region was separated from them, also we verify that the Illyrians did not become Romans but continued to live in their land for many centuries up to nowadays.

Written by
Koco Zheku

DO NOT COPY

Emin RIZA

Vlerësimi i arkitekturës popullore në 40 vjet veprimtari të Institutit të Monumenteve të Kulturës

Arkitektura popullore, është krijimtari me vlera të veçanta historiko-kulturore, e cila në bashkësinë e trashëgimisë së paluajtshme, më vonë se të tjerat, u përfshi në përkujdesjet për vlerësimin e saj. Me termin vlerësim kuptojmë gjurmimin, vënien në mbrojtje, studimin dhe restaurimin e trashëgimisë kulturore. Arsyet për këtë dukuri mbarëevropiane, të themi të nenvleftësimit të arkitekturës popullore, besojmë se duhen kërkuar në moskuptimin e përbërësit historiko-dokumentar të këtyre vlerave i cili në këtë kategori madje shfaqet më qartazi se sa në gjini të tjera ndërtimesh. Edhe Shqipëria nuk bënte përjashtim nga koncepsioni i mësipërm, por duhet theksuar e vërteta se vendi ynë, nëpërmjet specialistëve të shquar si Gani Strazimiri krahasimisht shpejt, pas luftës së Dytë Botrore, u ndërgjegjësua për vlerat e arkitekturës popullore. Po të kemi parasysh rrethanat e prapambetjes relative të Shqipërisë, në shumë plane, tipologjinë e zhvilluar për kohën të kategorisë banesë tradicionale dhe vënien në mbrojtje shpejt të kësaj pasurie, atehere do të shpjegohej parësia e dukshme e trashëgimisë shqiptare në këtë fushë si në plan ballkanik ashtu dhe europian e më gjerë.

Kur themi se përkujdesjet për trashëgiminë në fushën e arkitekturës popullore në Shqipëri shfaqen pas luftës së Dytë Botërore, natyrisht kemi parasysh një proces i cili arrin kristalizimin, për t'u konsideruar fillesë e mirëfilltë, në shpalljen në mbrojtje nga ana shtetit, me cilësinë e qyteteve-muze, të dy kulmeve të krijimtarisë shqiptare dhe europiane në këtë fushë, Beratit dhe Gjirokastrës, më 2 qershor 1961. Kjo datë, e rëndësishme për vlerësimin e trashëgimisë sonë urbanistiko-arkitekturore, ka periudhën pararendëse dhe atë pasuese, madje duke përfshirë dhe atë para luftës së Dytë Botrore, vijnë në konsiderim kontributet e autorëve të huaj, që drejtpërdrejtë apo tërthorazi janë shprehur për arkitekturë popullore shqiptare dhe ato të etnografëve vendas. Ndër autorët e huaj përmendim Franc Nopçen, dhe Haberlarlandin. Duke respektuar veprën e tyre, pioniere në këtë fushë, për arsye të kuptueshme, kur ishte tepër herët për të qënë të kristalizuara kriteret metodike të studimit të kësaj fushe, veprat e tyre megjithë meritën madhore të përzgjedhjes së shembujve, vuajnë nga shumësia e tezave dhe hipotezave aprioristike, të cilat përshtohen ndjeshëm prej, të themi teorisë së importimit të dukurisë në lëmin e banesës. Lidhur me studiuesë të tjerë, duke filluar prej Çelebiut dhe deri te Georgu fon Hahni i madh, të dhënat, kryesisht dokumentare, duke qëmtuar me kujdes për t'u vendosur në kontekstin e duhur urbanistiko-arkitekturor. Etnografët vendas pas viteve 50 të shekullit të kaluar, gjatë ekspeditave etnografike në vëmendje patën, natyrshëm edhe krijimtarinë në fushën e banesës, si në fshat, ashtu edhe në qytet. Veprimtaria e tyre mund të cilësohet përzgjedhëse dhe dokumentuese. Themi përzgjedhëse sepse në numrin e madh të banesave tradicinale, etnografët u ndalën në shembujt më të arritur dhe njëherazi më impresionues. Ata i dokumentuan këto vlera grafikisht, me fotografim dhe disa herë me përshkrime. Ishte kjo një fillesë me vlera të mëdha për ta përfshirë edhe banesën popullore si objekt të kërkimit etnografik. Do të thonim, pamëdyshje se kërkimet në fushën e banesës shqiptare gjithë duke qenë, natyrshëm, pjesë e fushës së etnografisë dhe etnologjisë, kërkojnë urdhërueshëm studiues të fushës së arkitekturës. Kjo

kërkesë vjen prej së vërtetës se pavarësisht se krijimtaria në lëmin e banesës i përket asaj popullore, pra nuk është veprimtari projektuesish të shkolluar, apo gjithsesi, ashtu si ndërtimet e gjinive të tjera, p.sh ato të kultit, gjithashtu ka qenë prej shekujsh vepër e projektuesve të improvizuar, pra vepër ndërtimore apo arkitekturore. Si të tilla këto vepra studjohen sipas principeve të krijimit arkitekturor, duke konsideruar me seriozitet mënyrën e jetesës, e dhënë thellësisht etnografike, si motivuesen kryesore të kompozimit. Kjo e vërtetë u shpreh qartë në praktikën shqiptare të vlerësimit të banesës popullore me angazhimin sistematik në të të inxhinierëve të ndërtimit dhe më pas të arkitektëve. Ndërkohë, duhet të përmendim dy artikuj me vlerë, madje si një moment kthese metodike të Koço Zhekut, mbi banesat popullore në dy fshatra të rrethit të Tiranës, botuar në serialin "Etnografia shqiptare", të cilët sot e kësaj dite dëshmojnë për rrugë metodike të shëndoshë, e cila ishte vertet një gjetje krejtësisht vetjake.

Formimi i studjuesve shqiptar të fushës së arkitekturës popullore është kryer me rrethana të veçanta. Së pari, këta studiues u përfshin në fushën e restaurimit të këtyre vlerave, krahas procesit madhor të përzgjedhjes së tyre për t'u vënë në mbrojtje shtetërore. Për këtë proces ndihmesë të madhe dha përcaktimi i monumenteve të kategorisë së parë në Qendrën historike të Beratit. Kjo veprimtari përzgjedhëse, nga ana metodike, ishte një arritje e rëndësishme për kohën. Themi kështu sepse si kriter për përzgjedhjen e banesave për t'u mbrojtur në cilësinë e monumentit, u zgjodh së pari ai tipologjik, i ndjekur prej atyre të autenticitetit të vlerave arkitekturore dhe gjendjes teknike të banesave. Bazuar mbi këto kritere të shëndosha, gjatë veprimtarisë disavjeçare përzgjedhëse në fushën e banesave, për të qëmtuar vlerat që duhen vënë në mbrojtje në cilësinë e monumentit, këto parime u qartësuan me tej, sidomos pas njohjes me tipologjinë e banesës shqiptare në planin kombëtar dhe më gjerë, ballkanik dhe europian. Lista e parë e monumenteve e vitit 1948, e hartuar prej Institutit të Shkencave, përmblidhte 107 monumente të gjinive të ndryshme, pa patur në të asnjë banesë, shenjë e qartë e qëndrimit, të themi dyshues, ndaj vlerave madhore si dëshmi historike - kulturore të kësaj gjinie. Lista e parë e monumenteve, e cila vinte në mbrojtje shtetërore banesat me vlera të rëndësishme tipologjike dhe arkitekturore është ajo e vitit 1961, e cila i përket qytetit-muze të Beratit. Ritheksojmë se kriteret përzgjedhëse për banesat e Qendrës Historike të Beratit mbështetur kryesisht në atë tipologjik, vlerave arkitekturore dhe autenticitetit, qenë një ndihmesë themelore metodike për vazhdimin e kësaj veprimtarie. Lista e dytë e monumenteve, në gjininë e banesës shqiptare i përket vitit 1969. Me këtë listë përfshihen 25 banesa me vlera të rëndësishme tipologjiko-arkitekturore, në gjashtë qytete. Kjo listë konfirmoi tashmë qendrimin e pjekur shkencor mbi vlerat historike dhe dokumentare të gjinisë së banesave.

Në vitin 1965, themelohet Instituti i Monumenteve të Kulturës, mbi bazën e një sektori në përbërje të Grupit të Kulturës Materiale. Krijimi i këtij institucioni, të ngarkuar me gjurmimin, mbrojtjen, studimin dhe restaurimin e monumenteve, për të cilin pati merita madhore drejtori i parë i tij ark. Gani Strazimiri, qe një ngjarje e vërtetë kulturore. Tashmë, u krijuan kushte të favorshme për dëndësimin dhe thellimin e veprimtarisë dhe për vlerësimin e gjinisë së banesës popullore shqiptare. Vërtet në mënyrë të natyrshme, por do të thoshim edhe me një sens intuitiv largpamës, drejtuesi i Insitutit, bëri të vetën idenë, sa të drejtë aq edhe prodhimtare, të kordinimit të disiplinave të historisë së arkitekturës dhe restaurimit si bashkëplotësuese. Nëse i shtojmë këtij koncepti edhe ndarjen e bërë që në krye, nëpërmjet specialistëve të lartë sipas tre gjinive kyesore të monumenteve të arkitekturës në mbrojtëse, kulti dhe ndërtime popullore, mund të themi se u gjet një zgjidhje tepër racionale. Ngushtimi i fushës së veprimtarisë, u pasua me thellimin se u gjet një zgjidhje tepër logjike. Ngushtimi i fushës së veprimtarisë, u pasua me thellimin në të, duke dhënë kjo veprimtari përfundime të prekshme brenda një periudhe krahasimisht të shkurtër kohe. Punonjësit e fushës së ndërtimeve popullore, krahas atyre të ndërtimeve të kultit dhe fortifikimeve, pas krijimit të Insitutit të Monumenteve, dendësuan veprimtarinë për gjurmimin e vlerave ndërtimore për t'u vënë në mbrojtje.

Tashmë kjo veprimtari u konsiderua përparësi e vërtetë, për t'iu shmangur sa më parë rrezikut për dëmtimin apo shkatërrimin e banesave të vjetra,

DO NOT COPY

Do not copy

për nevoja të ndryshme jetësore. Deri në themelimin e Institutit të Monumenteve, në gjininë e banesave popullore, objekt gjurmimi qenë vetëm banesat qytetare, më pas, ashtu siç pritej veprimtaria gjurmuese përfshiu edhe banesat fshatare, përzgjedhja e të cilave mbështetej mbi kritere të njëjta metodike. Kështu, në listën e monumenteve te vitit 1973, për herë të parë në Shqipëri, krahas 79 banesave në qytete, vihen në mbrojtje edhe 40 banesa fshatare në rrethe të ndryshme të vendit. Që prej këtij viti në shpalljen e listave të mëvonshme të viteve 1977, 1979, 1980 dhe 1985, numrin më të madh të banesave të vëna në mbrojtje shtetërore e zënë banesat fshatare. Ndërmarjen e veprimtarisë sistematike për gjurmimin e ndërtimeve popullore qytetare dhe fshatare, në shumicën e madhe banesa, e përshpejtoi dukshëm vendimi i posaçëm i Këshillit të Ministrave Nr 229,

"Mbi gjurmimin dhe vënien në mbrojtje të ndërtimeve popullore". Sipas këtij vendimi u ngarkuan një sërë institucionesh, kryesisht Instituti i Monumenteve dhe Instituti i Kulturës Popullore, për gjurmimin e banesave popullore me vlera arkitekturore, historike dhe etnografike në mbarë vendin, në fshat dhe qytet. Meqenëse gjurmimi i qytetit kishte ecur mirë, kjo veprimtari u përqëndrua kryesisht në fshatrat e vendit. Grupe pune, me një inxhinier ndërtimi apo arkitekt në krye, duke pasur në përbërje dy skicografë dhe shpesh fotografin, i ranë vendit anë e kënd, duke kryer 35 ekspedita dhe duke grumbulluar një material dokumentar grafik, fotografik dhe përshkrimor. Grupet e gjurmimit mbulonin mbarë vendin, të ndarë sipas zonave etnografike, duke lehtësuar zbatimin e kriterit tipologjik.

Siç përmendëm, veprimtaria gjurmuese dhe përzgjedhëse e banesave për t'u cilësuar monumente kulture filloi me shpalljen e Qendrave Historike të Beratit dhe Gjirokastrës në mbrojtje shtetërore, në cilësinë e qyteteve muze. Pas kësaj ngjarje të rëndësishme kulturore, e cila e vendos Shqipërinë në radhët e para të vendeve europiane për sensibilizimin ndaj vlerave të arkitekturës popullore, pati një hapësirë kohore, të themi pushimi, lidhur me vënien në mbrojtje të qendrave historike apo ansambleve ndërtimore. Kjo veprimtari rifilloi në vitin 1973 me vënien në mbrojtje të qendrës historike të Korçës. Vënia në mbrojtje e këtyre vlerave, ishte e një rëndësie të veçantë për dy arsye. Së pari, koncepti i vlerave kulturore nuk lidhej vetëm me një faktor, atë të lashtësisë kohore, duke vënë në mbrojtje edhe një ansambël krahasimisht të vonë, kryesisht të gjysmës së dytë të shekullit XIX. Së dyti, vlerat urbanistiko-arkitekturore të zonës qëndrore të Korçës shfaqen si nga më të hershmet si në hapësirën shqiptare dhe atë ballkanike më gjerë. Në Korçë ndeshim të zbatuar rigorozisht planifikimin urbanistik me rrjetin e njohur rrugor të sistemimit kuadratik, dëshmi kjo me vlera të rëndësishme historiko-kulturore. Në këtë hapsirë, ashtu si në pjesët e tjera të qyetit, gjeti përhapje të gjerë banesa e tipit me qoshk, e cila qartazi shkëputej prej tipeve të banesës tradicionale shqiptare të mpleksura me ekonominë fshatare.

Në vitin 1976, vihet në mbrojtje Qendra historike e qytetit të Elbasanit, e cila përfshihet brenda mureve rrethues të kalasë së qytetit, një kastrum i periudhës romake, rindërtuar prej turqve në shekullin e XV në funksion të luftës shqiptaro-turke, në të cilën shqiptarët udhëhiqeshin prej Gjergj Kastriotit. Ansambli i banuar brenda kësaj fortese, është i ndikuar prej saj, duke shfaqur një shëmbull me vlera të veçanta.

Qendra historike e Shkodrës u vu në mbrojtje në vitin 1980. Ajo përfshin zonën tregtare të rrugës me emërtimin tradicional "Dugajet e reja" si edhe rrugen "Branko Kadia", në të cilën, gjithashtu mbisundonin mjediset e prodhimit artizanal dhe tregtimi në katin përdhes. Këtyre rrugëve iu bashkohet ajo"Luigj Gurakuqi", e cila është tipike për lagjet tradicionale të qytetit fushor të Shkodrës të shekujve XVIII- XIX.

Në vitin 1980 u vu në mbrojtje edhe ansambli i rrugës "Justin Godar " në qendër të qytetit te Vlorës, i cili ashtu si rruga e "Dugajeve të reja " në Shkodër i përkiste gjysmes së dyte të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX. Deri më sot, në sferën e qendrave historike, nuk ka pasur ndonjë hapësirë të re të vënë në mbrojtje. Qendrat e vëna në mbrojtje, gjithsej gjashtë të tilla, paraqesin qartë kuadrin urbanistiko-arkitekturor të qytetit shqiptar të shekujve XV- XX madje edhe më tej në kohë, siç e ndeshim në dëshmitë e Qendrave Historike të Gjirokastrës dhe Beratit.

Është për t'u shënuar se ndërsa në qytete, veprimtaria për vënien në mbrojtje të qendrave historike pati përfundime të prekshme, në fshat kjo veprimtari

DO NOT COPY

nuk gjeti shtrirje. Propozimi i vetëm i Institutit të Monumenteve për vënien në mbrojtje të fshatit Vuno, në zonën e emërtuar "Bregu i detit", të rrethit të Vlorës, nuk gjeti mbështetjen prej Ministrisë së ngarkuar me këtë kompetencë. Kjo e vërtetë paraqet një mangësi të ndjeshme në fushën e vlerësimit të trashëgimisë kulturore, dhe në atë urbanistiko-arkitekturore. Konceptet metodike të zbatuara në qendrat historike të vëna në mbrojtje, pas atyre të Beratit dhe Gjirokastrës, nuk paraqesin risi. Në të gjitha këto zona u zbatuan parimet e sanksionuara në Rregulloren për mbrojtjen dhe administrimin e qytetit muze të Beratit të vitit 1961. Ato përmblidhen në dy parime themelore, ndarjen e qendrës historike në zona - muze, e cila ruhet në tërësinë e saj urbanistiko-arkitekturore dhe mjedisore, pa ndryshime dhe në zonën e mbrojtur, në të cilën për arsye madhore të funksionimit të natyrshëm të jetesës, lejohen ndryshime dytësore, pa cënuar vlerat për të cilat ruhet qendra historike. Parimi i dytë, është ai i konsiderimit të mbarë ndërtimeve të përfshira në qendrën historike, të pa cilësuara monumente të kategorisë së parë, monumente të kategorisë së dyte. Këtyre të fundit u ruhet vetëm volumi dhe trajtimi i jashtëm arkitekturor.

Shpallja e monumenteve të veçantë, të gjinisë së ndërtimeve popullore, në shumicën dërrmuese banesa nuk mund të konsiderohet një veprimtari e cila mund të quhet e përfunduar pas një gjurmimi sado të imtë e mbarëvendor. Së pari, është thuajse e pamundur të qëmtohen mbarë shembujt që meritojnë të mbrohen, si për shkak të gjerësisë së shpërndarjes së dukurisë, ashtu edhe për shkak të kritereve për vënien në mbrojtje që mbështeten fuqishëm mbi studimet në këtë fushë të cilat vijnë gjithnjë në rritje dhe thellim. Së dyti, veprimtaria ndërtuese në fushën e krijimtarisë popullore në fushën e banesë, vërtet shkon drejt rënies së shpejt por pa u shuar krejtësisht. Tashmë, fushës së kategorisë banesë, po i shtohet me ritme tepër të larta fusha e ndërtimit të banesave individuale dhe kolektive prej arkitektësh të shkolluar. Natyrisht edhe në hapësirat e kësaj veprimtarie, duhen qëmtuar vlera me rëndësi tipologjike dhe vlera arkitekturore në vetvete. Kështu fusha e vënies në mbrojtje të vlerave arkitekturore, natyrshëm shfaqet si një proces i cili ecën paralel me veprimtarinë njërëzore, duke përfshirë edhe atë në gjininë e banesës. Vënia në mbrojtje e vlerave arkitekturore, me domethënie historiko-kulturore, është veprimtaria themelore e bashkësisë së përkujdesjeve për këtë trashëgimi, e cila emërtohet vlerësim. Vënia në mbrojtje e monumenteve do të ishte realisht e tillë në se ajo së pari, do të shoqërohej vijueshëm prej përkujdesjeve të kualifikuara që emërtohen restaurim, duke kuptuar me këtë veprimtari ruajtjen e vlerave origjinale të monumenteve. Në Shqipëri, kjo veprimtari, krahas asaj përzgjedhëse, apo më saktë, pak pas saj, e ka zanafillën në themelimin e Institutit të Shkencave, ndërsa institucionalizohet me krijimin e një ateljeje restaurimi në 1955. Kjo në 1962 pasohet me pesë të tjera në qytetet kryesore të vendit. Krijimi i Institutit të Monumenteve të Kulturës në 1965, shënojnë gjetjen e duhur në plan institucional për t'iu përgjigjur detyrave sa të gjera aq edhe komplekse, për vlerësimin e monumenteve në Shqipëri. Deri në themelimin e IMK ndërhyrjet mirëmbajtëse dhe restauruese në fushën e monumenteve, patën për objekt ata të gjinive të fortifikimit dhe kultit, ndërsa në gjininë e banesave, ashtu si dhe gjurmimi i tyre, shfaqen më vonë. Lidhur me kriteret e restaurimit të zbatuara në gjininë e ndërtimeve popullore, ato nuk paraqesin veçanti, por parimet e përgjithshme kanë shtrirje specifike në këtë kategori ndërtimore. Shkurtazi, në banesat e shpallura monument, janë zbatuar kriteret e ruajtjes maksimale të substancës origjinale të veprës, ruajtjes së mbarë fazave të ndërtimit, dhe vetëm rrallë, kur faza e mëvonshme fshihte vlera te rëndësishme, ajo është hequr. Rindërtimet pjesore janë pranuar vetëm kur ka qënë e vetmja mënyrë për të siguruar qëndrueshmërinë e veprës. Rikthimi i elementëve të banesës në gjendjen e parë është kryer sipas gjurmësh të prekshme dhe rrallë të dokumentuara qartësisht. Rindërtimet e pjesshme janë kryer me skemat dhe teknikat tradicionale, ashtu siç janë bërë përpjekje per të përdorur materiale të njëjtë, apo të ngjajshëm me origjinalet.

Duhet të theksjomë se këto parime kryesore janë zbatuar në monumentet e kategorisë së parë, në mbarë përbërësit e tyre kompozicionalë dhe teknikë, ndërsa në monumentet e kategorisë së dytë vetëm në pamjen e jashtme.

DO NOT COPY

Fillimet e ndërhyrjeve restauruese, në gjininë e arkitekturës popullore shfaqen në prag të krijimit të Institutit të Monumenteve të Kulturës, në 1965. Vepra e parë në të cilën u ndërhy për restaurim, qe ajo e Teqes së Sheh Dyrit, në Tiranë, më 1964. Në të vërtetë banesë e tipit me shtëpi zjarri përgjatë dy kateve, apo banesë tiranase, gjendja e saj kërkonte ndërhyrje restauruese. Projekti i saj iu ngarkua një restauratori të ri, ndërsa në të vertetë projekti u hartua nga grupi i këtyre restauratorëve nën drejtimin efektiv të drejtorit të Institutit Gani Strazimiri. Ky restaurim qe një përvojë e vertetë vetëformimi profesional, ashtu si ajo në mbarë gjinitë e monumenteve. Më pas ky shembull u pasua me restaurimin e baneses monument në kalanë e Krujës, të kthyer në muze etnografik, pazarit të vjetër të Krujës etj. Në punë dhe nëpërmjet saj u rrit dhe u formua profesionalisht brezi i restauratorëve të ndërtimeve popullore, i cili përfshinte kuadrot me formim universitar, kuadrot e mesme, si dhe mjeshtrat e ndërtimit të cilët ishin hallka realizuese, tepër e rëndësishme e zbatimit të projektit të restaurimit. Ndërhyrjet më të gjera restauruese, në fushën e banesave, u kryen në qytetet muze të Beratit dhe Gjirokastrës, ku ishin përqëndruar vlerat më të rëndësishme dhe më të shumta të kësaj pasurie kulturore. Krahas, ndërhyrje restauruese në monumentet e kategorisë së parë, në gjininë e banesave, u kryen në mbarë qytetet ku ato ruheshin. Rreth viteve 1970 filloi dhe veprimtaria restauruse në fushën e banesave fshatare, në mbarë vendin, natyrisht me të njëjtat parime metodike të ushtruara për vlerat e monumenteve të arkitekturës.

Gjinia e banesës popullore, pjesa kryesore e trashëgimisë në fushën e arkitekturës popullore, në kuadrin e pasurisë kulturore të palëvizshme, për arsye të funksionit të banimit, u bë shpejt kategoria e monumenteve që përthithi më shumë fonde restaurimi. Kështu gjatë hapësirës kohore të viteve 1965-1968, në banesat e cilësuara monumente të kategorive të para dhe të dyta, u ndërhy në 971 të tilla duke perthithur rreth 60% të fondeve të vëna në dispozicion për restaurim prej shtetit, të vetmit investitor deri në vitet 1990.

Skema organizative e njësimit të veprimtarisë studimore projektuese, me atë zbatuese në një institucion të vetëm, Institutin e Monumenteve të Kulturës me organizmat e tij në rrethe, ishte një zgjidhje lartësisht funksionale dhe njëherazi garantonte njësinë e procesit projektim-zbatim në monument.

Përzgjedhja e drejtë e monumenteve të gjinisë së ndërtimeve popullore, për ndërhyrje restauruese mbi bazën e njohjes së gjendjes së tyre, zbatimi rigoroz i parimeve të restaurimit dhe skema efikase e strukturave mbikqyrëse të gjendjes së monumenteve dhe zbatimit të ndërhyrjeve restauruese, dha përfundime vërtet të lakmueshme deri në vitet 1990. Shqipëria kishte zgjidhur me treguesë të lartë, problematikën e vërtet të vlerësimit të ndërtimeve popullore, do të thoshim në përputhje me vlerat madhore të kësaj trashëgimie, e cila për natyrën e saj është treguese e vertetsishme e mënyrës së jetesës së një kombi.

Për natyrën e tyre banesat popullore shfrytëzohen sipas funksionit fillestar të tyre, pra atij të banimit. Të ndërtuara përgjithësisht në shërbim të një mënyre jetese të tejkaluar, banesat-monument shfaqin kuptueshëm mospërputhje ndërmjet kërkesave të sotme të jetesës dhe formulimit të tyre. Nëse, në gjinitë të tjera si p.sh në atë të kultit, liturgjia thuajse e pandryshueshme kushtëzon një lloj statizmi funksional të veprave fetare, banesa ndikohet dukshëm prej ecurisë së jetesës, duke qenë ajo një kategori tejet evolutive. Natyrisht, në ruajtjen e skemave origjinale funksionale, banorët e këtyre monumenteve janë privuar prej mundësisë për ndryshime, por në përgjithësi është hasur në mirëkuptim, shenjë e kuptimit të vlerave të kësaj pasurie prej përdoruesve.

Kriteret e restaurimit të monumenteve të arkitekturës, përfshijnë mbarë gjinitë e kësaj kategorie kulturore-historike, por ato kanë shtrirje të ndryshme sipas gjinive. Në këtë këndvështrim, në gjininë e monumenteve, kriteri themelor i restaurimit, ruajtja e substancës origjinale, pra e formulimit kompozicional dhe teknikës origjinale, mbetet kriteri parësor, prej të cilit restauratorët janë udhëhequr vijueshëm. Është rasti për të qëndruar në një moment të rëndësishëm metodologjik, atë të bashkëndërdhënieve ndërmjet studiuesit të monumentit të arkitekturës, në rastin në shqyrtim të banesës, dhe restauratorit. Në realitetin shqiptar këto dy profesione paralele u njësuan në një të vetme, me përfundime vërtet të

POROTOPY

frutshme. Natyrshëm restauratori nuk mund të ndërhyjë në monument thjeshtë si riparues strukturash konstruktive. Pa përjashtuar edhe këtë synim, në radhë të parë duhet të njohë historikun e veprës në kohë, përkatësinë e saj tipologjike, teknikën e kohës së ndërtimit, apo të fazave të mëvonshme, etj. Prandaj restauratori ose duhet të bashkëpunojë ngushtas me historianin e arkitekturës, ose duhet që vetë ai të jetë njëherazi historian arkitekture dhe restaurator. Ndarja e restauratorëve shqiptarë, që në fillesat e veprimtarisë së tyre, sipas fushave, lehtësoi ndjeshëm, arritjen e formimit paralel profesional, historian arkitekturë i një gjinie dhe restaurator i saj. Shembulli i prekshëm shqiptar i kësaj zgjidhje, besojmë se është i një rëndësie që i kalon kufijtë e vendit. Faktikisht restauratorët shqiptarë, me përvojë, janë sot njëherazi historian të mirëfilltë arkitekture. Për t'u rikthyer tek çështja në shqyrtim ajo e parimeve të restaurimit të zbatuara në gjininë e banesës, dhe më saktë, me parimin e ruajtjes së substancës origjinale, do të thoshim se zbatimi i këtij parimi, parakupton studimin e monumentit, i cili në rastin shqiptar kryhet prej restauratorit. Ruajtja e substancës origjinale, lidhet në të vërtetë, se vepra ndërtimore ashtu si vepra e artit, është e papërsëritshme. Por, duhet pohuar se ky parim, gjithnjë duke u zbatuar, ka pasur edhe shmangie për arsyen madhore të funksionit të banimit të kësaj gjinie monumentesh, në një shkallë të lartë shfrytëzueshmërie në krahasim me gjini tjera monumentesh. Kriteri i ruajtjes së mbarë fazave të ndërtimit, si kontribute të periudhave të ndryshme në monument, ka gjetur zbatim të gjerë në gjininë e banesave. Vetëm në raste të rralla, kur monumenti paraqiste vlera të rëndësishme tipologjike, dhe strukturat e reja kanë qenë veshje, pa cënuar rëndë strukturat origjinale, është kaluar në fazën pararendëse. Këtu përmendim kryesisht mbylljen e hapësirave të hajateve dhe çardaqeve.

Rindërtimet e plota apo të pjesshme, janë konsideruar në kundërshtim me ruajtjen e vlerave të banesave monument. Vetëm në rastet kur mosrindërtimi i pjesshëm vinte në rrezik qëndrushmërinë e monumentit, këto ndërhyrje janë zbatuar. Ndërhyrjet restauruese në përgjithësi janë kryer sipas teknikave tradicionale, ndërsa materialet janë përzgjedhur në burimet origjinale ose të përafërta.

Një parim i zbatuar pothuaj përjashtimisht, në gjininë e banesave-monument është ai i ndërtimit të strukturave reversibël. Ky parim vjen në konsiderim për arsye të shfrytëzimit për banim të kësaj kategorie monumentesh. Me struktura reversibele, kuptohen ato të cilat nuk njësohen organikisht me struktura origjinale, por iu bashkëngjiten atyre, kryesisht për të krijuar hapësira më të vogla, brenda hapësirash të mëdha, mbyllje me parete të lehta të volumeve të hapura, veshje të ndryshme të strukturave origjinale, pa cënuar strukturat e tyre, etj.

Mbi bazën e këtyre kritereve, në mbarë vendin, në banesat qytetare dhe ato fshatare janë kryer ndërhyrje sistematike restauruese. Veçanrisht të dëndura kanë qenë ndërhyrjet gjatë viteve 1970-1990. Ato kanë përfshirë monumentet e kategorisë së parë në qytet dhe në fshat, si dhe monumentet e kategorisë së dytë në Qendrat historike të Beratit dhe Gjirokastrës. Lehtësitë financiare ndaj pronarëve të këtyre monumenteve, thuajse të gjithë në pronësi private, kanë qenë një faktor i rëndësishëm për ecurinë e mbarë të procesit të restaurimit të këtyre vlerave.

Një prej përbërsve të rëndësishëm të termit përbledhës vlerësim i monumentit është propogandimi i këtyre vlerave. Termi propagandim, ne konteksin e temës që trajtojme, shfaq perkujdesjet për popullarizimin e vlerave të banesave-monument, si për rrethin e ngushtë të specialistëve të fushës, ashtu edhe për masën e gjerë të qytetarëve. Ky propagandim me synim të dyfishtë për të paraqitur monumentet si dëshmi historiko-kulturore, pasohet prej ndërgjegjësimit në rritje të qytetarëve për këto vlera, duke lehtësuar në disa plane veprimtarinë përkujdesëse ndaj kësaj pasurie të papërsëritshme kulturore. Mjetet propaganduese për monumentet në përgjithësi dhe banesat-monument në veçanti përfshijnë botimet e llojeve të ndryshme shkencore dhe divulgative, veprimtari shkencore si sesione, konferenca apo simpoziume, njoftime nëpërmjet mjeteve të informacionit masiv të shtypit, apo atij pamor, etj. Ndër këto veprimtari vendin kryesor e zë veprimtaria botuese. Ashtu si mbarë veprimtaritë, që përfshihen në termin vlerësimin, edhe botimet në fushën e monumenteve në përgjithësi dhe gjinisë së banesave në veçanti, i kanë fillesat e mirëfillta

pas viteve 1965, me themelimin e Institutit të Monumenteve të Kulturës. Botimi i parë propagandistik për monumentet e arkitekturës i përket vitit 1967. Ai titullohet "Të njohim monumentet e Kulturës". Instituti i Monumenteve pati rritje dhe ngritje të shpejt profesionale, e cila u pasqyrua, më së miri, në fillimin e botimit të revistës shkencore "Monumente", dy here në vit. Unikale në mbarë Ballkanin ajo që dhe mbetet një arritje tepër e rëndësishme e fushës më të re të shkencave albanologjike, asaj të monumenteve shqiptare të kulturës. Ashtu si për gjinitë e tjera të monumenteve të arkitekturës, edhe për gjininë banesa popullore u hap një mundësi e re për të botuar trajtesa studimore të karaktereve të ndryshme, si dhe për të publikuar ndërhyrjet restauruese.

Krahas, Institutit i Monumenteve të Kulturës publikoi edhe një seri botimesh, në të cilën banesat zinin vend të rëndësishëm. Për vlerat e qytetit muze të Gjirokastrës (E. Riza) dhe Beratit (G. Strazimiri) janë botuar dy albume në gjuhën shqipe dhe të huaj. Disa monografi trajtojnë çështje të arkitekturës popullore, ndër to përmendim, "*Qyteti-muze i Gjirokastrës*" (E. Riza), "*Arkitektura fshatare e Shqipërisë veriore*"(P. Thomo), "*Korça, urbanistika dhe arkitektura*" (P. Thomo), "*Qyteti dhe banesa shqiptare e mesjetës së vonë*" (E. Riza), "*Banesa fshatare dhe familja e madhe*"(A. Muka) etj. Në fushën e restaurimit përmendim "*Restaurimi i banesës popullor*" (E. Riza). Vend të veçantë zë banesa shqiptare në botimin "*Historia e arkitekturës shqiptare*". Për t'u përmendur është punimi "Shqipëria", në botimin "Arkitektura tradicionale ballkanike".

Studiuesit shqiptarë, të banesës popullore, kanë marrë pjesë me referime në një varg konferencash shkencore kombëtare e ndërkombëtare.

Sot, në 40 vjetorin e themelimit të Institutit të Monumenteve të Kulturës, për t'i emërtuar realitetet me emrat e tyre, duhet të pohojmë se gjendja e trashëgimisë kulturore në gjininë e banesës popullore është thjeshtë e papranueshme ose e keqe. Ky cilësim shfaqet që me mos njohjen e gjendjes së këtyre vlerave dhe me ndërhyrjet thuajse të paqëna restauruese për këto vlera. Shkatërrimi i njësive restauruese të specializuar për zbatimin e punimeve, pranë institucioneve rajonale dhe praktikimi i të ashtuquajturave tendera, që goditja që iu dha sistemit vertet sa efikas aq edhe të specializuar të Institutit të Monumenteve me organizmat, pjesët e tij në rrethe. Mosdalja e akteve nënligjore për zbatimin e ligjit për Trashëgiminë kulturore, lidhur me financimin e ndërhyrjeve restauruese në banesat monument pronë privat, gjithashtu është një pengesë për moskryerjen e këtyre ndërhyrjeve.

Prirja e Drejorisë së Trashëgimisë e cila duhet të ndërhyjë kryesisht më politikat, apo orientimet kulturore, për të marrë funksionet e Institutit të Monumenteve, si emërimin e drejtuesve të Drejtorive Rajonale, apo caktimin e fondeve për to, kanë cënuar centralizimin profesional në fushën e monumenteve. Me këtë togfjalësh kuptojmë zbatimin e parimit të njohur se zbatimi i kritereve të restaurimit është, përjashtimisht, detyrë e forumeve të specializuara. Në këtë fushë duhet përshëndetur ngritja e Komisionit Kombëtar të Restaurimit, përbërja e të cilit duhet rishikuar për të rritur faktorin profesional të tij. Gjithashtu, Këshilli Shkencor i Institutit të Monumenteve, duhet që të rimarrë një varg funksionesh me të drejtë vendosëse, si forum më i specializuar i fushës. E drejtë e këtij forumi duhet të jetë dhe shpërndarja e fondeve të restaurimit në Drejtoritë Rajonale, si dhe përcaktimi i objekteve-monument për të restauruar çdo vit.

Rifillimi i veprimtarisë botuese dhe në radhë të parë i revistës serioze "Monumentet" është domosdoshmëri, krahas përpjekjeve për kualifikimin e kuadrit restaurator, dhe rritjen e përqindjes së tij në raport me adiminstratën e rritur pa kriter. Natyrisht këto sygjerime kanë lidhje me mbarë monumentet, por ato veçanërisht lidhen me ndërtimet popullore.

E ashtuquajtura, periudhë tranzicioni, si për nga zgjatja, ashtu edhe për nga dëmet, si në skemën organizative ashtu edhe në efikasitetin e veprimtarive komplementare, që thirren vlerësim i monumenteve, shpresojmë dhe bëjmë thirrje si profesionistë, që të mënjanohen përfundimisht për të rifilluar veprimtaritë me monumentet, ritheksojmë për të rifilluar atë veprimtari të filluar dyzet vjet më parë. Ajo pati suksese sepse qenë përgjithësisht specialistë e fushës që vendosnin, duke qenë ky çelësi i çdo suksesi të pritshëm.

POZITIV

Valuation of Popular Architecture in the Institute of Cultural Monuments

The interest for the popular Albanian architecture started with the foreign authors at the beginning of the XX century. The same interest was shown later from the native ethnographers and scholars of this cultural heritage.

They undertook the responsibility of tracing, conservation and studying of the Albanian civil residence. The selecting activity started in 1960, in the museum town of Berat on the typological criteria of the artistic values, authenticity and technical conditions.

The foundation of the Institute of Cultural Monuments marks an important moment for the valuation of Albanian cultural monuments especially in the field of popular architecture. Under protection were taken not only the monuments in the towns and villages but also the historical centers of Berat and Gjirokastra and those of Korça, Elbasan, Shkodra, and Vlora.

The conservative and protective activity of the values for the popular architecture started in 1960 and gets growing and become deeper after the foundation of the Institute of Cultural Monuments. The interventions, respecting the original values and the phases of construction, using the traditional techniques and materials, included all the monuments.

An important activity was undertaken during these 40 years even in the fields of propaganda and gender of popular residences. Included in the whole conservation and protection activities the first place belongs to the scientific and divulgate editions.

We can mention here the scientific articles in the scientific magazine "The Monuments" and the publishing of many monographs for these values.

EMIN RIZA

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Valter SHTYLLA

Portat e arta (Golden Gate) të Via Eganatias në Ballkan

Historia e rrugës antike, Via Egnatia, meriton të ndriçohet dhe botohet për shumë arsye. Trasimi topografik, mjaft komod, kalldremet solide, veprat e artit të shumta; si urat e gurit e drurit, muret mbajtës, kanalizimet etj, formulojnë historinë e teknikës së ndërtimit të saj. Ekspeditat e shumta ushtarake gjatë shekujve të ndryshëm përshkruajnë historinë militare të Via Egnatias. Veç këtyre kjo rrugë antike ka qënë mbartëse e kulturave të ndërsjellta. Ajo lidhte ndërmjet tyre qendra të botës antike Durrachium, Scampin, Lychindin, Heraklean, Edesen, Pellen, Tesalonikun, Neapoli (Kavallën) dhe Konstandinopojën, duke qenë kështu një rrugë kulturore e integrimit të traditave dhe e komunikimit human. Përveç tregueseve të mësiperm, që përbëjnë historinë komplekse te Via Egnatias, kjo rrugë antike sot tingëllon mjaft interesante në aktualitetin euro-ballkanik. Sot Via Egnatia përfaqësohet nga i ashtuquajturi "Korridori 8", që aq shumë u përfol në projekt ide, projekte teknike dhe përllogaritjeve të qeverive dhe organizmave projektuese nga Ballkani. Kjo nuk është një punë e humbur kot. Romakët, qëkur e ndërtuan në shekullin e dytë para eres sonë, e zgjodhën atë si varianti me i shkurtër dhe ekonomik ndërmjet Durrësit dhe Kostandinopojës nëpërmjet Selanikut. Duke kaluar nje terren të shkurtër malor në malet e Poliosit, gjatë luginës së Shkumbinit në Iliri dhe Qafët e Buta në Bukovë e Xhavato në segmentin Lychnid-Heraklea në Maqedoni. Nga pikëpamja fizike Via Egnatia përfaqësonte një aks rrugor, i cili veç lartësive të cituara më sipër, përshkohej në ultësira deri në Kostandinopojë, rrugë e shkurtër përgjithësisht fushore dhe që kalon nëpër qytete të rëndësishme të Shqipërisë, Maqedonisë, Greqisë dhe Turqisë.

Janë pikërisht këto përparësitë e kësaj rruge antike që e bëjnë atë të lakohet aq shumë në opinionet aktuale. Via historike Egnatia kalohet, nëpër katër territoret e mesipërme dhe, gjithë rrugët e tjera në veri e jug të saj, janë veçse degë të saj. Rigjenerimi i kësaj rruge, me të dy orientimet Maqedoni-Bullgari si dhe Maqedoni – Greqi – Turqi, përbën një faktor jetik për Shqipërinë. Në fazën e shfrytëzimit Shqipëria është tranzite e vlerave ekonomike-kulturore. Si të thuash, vendi ynë do ta ketë pozitën në mesin e sofrës ballkanike e në këtë rast shansi historik është dhe ai duhet shfrytëzuar. Komuniteti ndërkombëtar duhet të ndërgjegjsohet se jo rastësisht Iliria (Shqipëria) ka qënë shtrat i Via Egnatias të ndërtuar nga Romakët të cilët janë dalluar për trasime rrugësh apo ndërtime të arrira të çfarëdolloji.

Emergjenca të tilla, si faktori ekonomik, investimet e huaja dhe hapja e vendit drejt niveleve të larta të qytetërimit, nuk pranojnë zvarritje të problemeve kardinale të zhvillimit. Rrugët gjithmonë kanë shprehur zhvillimin e një vendi. Historikisht vendi ynë për vetë pozitën, i ka pasur gjithmonë ato. Sot kemi të drejtën e rigjallërimit të tyre edhe në ndonjë rast në ballafaqm ekskluzivitetesh prej të tjerëve. Rrugët lidhin popuj, zhvillojnë vendet ku kalojnë dhe ato duhen hartuar aq më tepër sot me pretendimet për një Europë Komunitare. Korridori 8 (pjesërisht dhe tërësisht Via Egnatia), rruga Durrës- Prizren, edhe ajo me origjinë antike, rruga tranversale Veri –Jugë nuk janë veç se shans i Shqipërisë.

Për ndërtimin e Via-Egnatias shprehet një gur miliar i zbuluar në 1974 në rrethinat e Selanikut. Në këtë gurë në latinisht dhe greqisht, lexohet emri i Prokonsullit të Maqedonisë, Knaesus Egnatius, biri i



Fig.1. Gur miljar i Egnatias - Selanik

Gajusit, sunduesit të Romës si dhe distanca prej 260 miljash ndërmjet Dyrrachiumit (Durresit) dhe Selanikut fig.1. Ky shënim me emrin e shtetarit më të lartë të Maqedonisë nën pushtetin e të cilit u ndërtua kjo rrugë, shpreh faktin historik se Via-Egnatia u ndërtua në periudhën republikane të Romës, ndërmjet viteve 146-143 para erës sonë, në fillimet e pro-konsullit të Egnatiusit në Maqedoni, emrin e të cilit mori vet rruga.

Via Egnatia në Ballkan ishte vazhdim i Via-Apias, së njohur të Gadishullit Italik të Apenineve, ndërtuar në vitin 312 p.e.s. nga censori Apius Klaudit, i ngarkuar me pasurinë shtetëror dhe punët publike. Via -Apia nga Roma zbriste drejt jugut deri në skelën e Brundisium (Brindizi) për t'u hedhur matanë Adriatikut në Dyrrachium. Ndërsa Egnatius e ndërtoi këtë aks romak, perandori Trajan (98-117) ndërtoi gjatë Via-Egnatias punime të tilla të rëndësishme saqë emri i këtij perandori konfrontohet me emrin e krijuesit të rrugës Egnatia. Via Egnatia si një rrugë antike, me vlera të njohura funksionale, përveçse ishte nje zgjidhje teknike optimale e pasur me elemente strukturore, ajo ka qenë trajtuar edhe si vepër monumentale. Në qytetet antike ku ajo kalonte, ishin të njohura Harqet e Triumfit me relieve dekorative, si dhe porta madhore. Nëpërmjet portave Via Egnatia hynte në qytetet e fortifikuara të asaj kohe. Portat e qyteteve antike, ku kjo rrugë duke çarë muret e fortifikuara, futej në qytet mes-përmes duke dalë nga faqja simetrike e fortifikimit, quheshin Porta e Artë (Golden Gate). Deri më sot Golden Gate të Via Egnatias në Ballkan sipas burimeve janë të hasura në Dyrrachion (Durrës), Scampis (Elbasan), Tesalonik (Selanik) dhe



Fig.2. Planimetria e kalasë së Durrësit



Fig.3. Gjurmët e Golden Gate - Durrës



Fig.4. Gjurmët e Golden Gate - Durrës

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig.4. Golden Gate - Durrës, 1914



Fig. 6. Golden Gate - Durrës, 1909

Konstandinopojë(Stamboll). Gjurmët e Portës së Artë në Kalanë e Durrësit dolën pas prishjes së shtëpisë së Pionierit karshi Inter Klubit. (Fig.2.) Ajo ndodhet në murin më të hershëm të kalasë, trakt muri i shek. II-IV të erës sonë, ndërtuar me tulla. Punimet e çlirimit të kryera në fund të vitit 2000 evidentuan konstruksionin e Portës së Artë të Durrësit. (Fig.3). Në asfaltin e rrugës doli gjurma e fillimit të qemerit të madh me tulla, në mbështetjen e djathtë të saj. Pas llogaritjeve, rezultoi se ky qemer kishte hapësirë drite rreth 9.6 m (fig.4). qemeri i majtë nuk ruhet, por gjurmët e tij mund të jenë nën lulishten pranë. Porta e Artë e hyrjes se Via Egnatias në Dyrrachium dhe në vetë gadishullin Ballkanik ka formë klasike (fig.5). Një hark i madh qëndror për kalimin e qerreve, me dy harqe simetrike me të vegjël anash për kalimin e këmbësorëve.

Në dekadën e fundit të shekullit XVII, studiuesi Coroneli jep një gravur të Durrësit, ku dallohet hyrja nga deti e qytetit të fortifikuar. Harku i portës ndodhet në pjesën e poshtme të një kulle katrore. Mbi harkun janë hapur dy dritare. Kjo kullë është ajo që shihet në fotot e viteve 1909-1914 (fig.6), në botimet për Durrësin. Mbështetur në krahasimin e niveleve ndërmjet gjurmës së thembrës së zbuluar të qemerit të madh dhe të thembrës së qemerit të hyrjes, se pas 1690 është e qartë, se pavarësisht se ndodhen në të njëjtin vend, Golden Gate i Via Egnatias nuk është porta e Jallis e skicës 1960 apo e fotove të fillimit të shekullit XX. Është e qartë se pas shkatërrimeve historike që ka pësuar qyteti i Durrësit, Golden Gate i Via Egnatias është dëmtuar ndoshta për shkaqe të uljes së tokës. Pas dëmtimit të saj, të paktën që prej shekullit XVII në të njëjtin vend të ish hyrjes monumentale romake, Golden Gate, me të njëjtin model është rindërtuar hyrja e re e qytetit nga ana e detit. Në vazhdim të Golden Gate si hyrja klasike e Via Egnatias së famshme, në periudhën Turke hyrja nga deti për në qytet është quajtur "Porta e Jallisë", me sa duket në gjuhën shqipe "Porta e xhadesë së rrugës", pasi turqit "Jallu" i thonë rrugës. Kjo dëshmon përsëri faktin se kemi të bëjmë me vepër monumentale të një vije-rruge, të njohur gjatë kohërave.

Porta të arta të Via Egnatias duhet të ketë pasur dhe në fazën më të hershme të kalasë së Elbasanit, shekulli i IV i e.s. Ne fortifikimin e Scampias (Elbasanit) (Fig. 7) Via Egnatia hynte në mesin e murit perëndimor, pranë muzeut të luftës dhe pasi përshkonte



Fig. 7. Golden Gate, në kalanë e Elbasanit. Hyrja perëndimore e kalasë

DO NOT COPY



Fig. 8. Gjurmët e kullës së daljes së Egnatias nga kalaja e Elbasanit



Fig. 9. Kulla e daljes së Via Egnatias nga kalaja e Elbasanit

qytetin dilte nga lindja. Nga Golden Gate i Scampit nuk ruhet asnjë këmbë, përveç fondamenteve arkeplogjike te nëndheshme. Siç vërehet nga gjurmët e kullave, në daljen e Via Egnatias, në Scampis hyrja e dalja e Via Egnatias kanë patur një strukturë tjetër, të paktën gjykuar nga faza mesjetare, pasi sqarimi i fazës antike kërkon gjurmimin arkeologjik. (fig. 8). Portat me qemere nga të dy anët mbroheshin me kulla gjysëmrrethore që dilnin jashtë mureve gjatësore. (fig.9)

Qyteti i Selanikut ka qenë një nga qendrat më të rëndësishme nga ku kalonte Via Egnatia në Ballkan. Bulevardi kryesor i tij mban emrin Via Egnatia. Sipas planimetrisë së fortifikimit, hyrja Golden Gate futej nga muri perëndimor, që mbyll dhe aneksin e sotëm " odhos Egnatia". Në Selanik, në mesin e këtij bulevardi ndodhet harku i triumfit i Galerios, nga vendasit u njohën me emrin Kamara, nën të cilin kalonte Via Egnatia. Galeri, ka qenë (fig. 11) ushtarak i lartë romak me origjinë ilire. Më 1 Mars 293 Galerio u bë një nga pjesëtarët e "tretrarkisë" (pushteti i të katërtve), i krijuar nga Diokleciani. Galerio nga Iliria ne periudhën 293 deri 305 u shpall cezar dhe më pas deri në 311 ai ishte "august perandor". Në vitet 297-298 Valerio arriti një fitore të bujshme mbi persianët. Kësaj fitoreje Galerio i kushtoi pikërisht Harkun e Triumfit në qendër të Selanikut. (fig. 12) Harku i Galerios është një konstruksion solid, me kompozim simetrik - qemer i madh me tulla me hapësirë drite 9.7m - me dy qemerë më të vegjël me hapësira 4.85m. Lartësia e harkut të madh arrin në 12.5 m. Në kamaren e Galerios këmbët e hargeve janë veshur me pllaka guri të bardha, ku janë gdhendur skena interesante nga jeta e këtij perandori romak me origjinë Ilire, përfshirë edhe skenën e fitores së tij mbi Persët. (fig. 13).



Fig. 10. Golden Gate në kalanë e Selanikut

Së fundi, pasi përshkon gjithë Ballkanin Via Egnatia arrin në Konstandinopojë(Stamboll) (fig 14.) duke hyrë në qytetin e fortifikuar, nëpërmjet Golden Gate të njohur në Jedikulen e Stambollit. Jedikule është një çitadelë e vogël në formë trapezi të çrregullt me 7 kulla në muret perimetrale, prandaj quhet edhe Jedikule (7 kullat), ndërtuar në vitet 1457-58 nga Sulltan Mehmeti II Fatih. Jedikule



Fig. 11. Skulpturë e Galerios, Selanik

DO NOT COPY

përfaqëson një shembull të arkitekturës ushtarake otomane të shekullit të XV. Gjatë këtij ndërtimi, Golden Gate është përfshirë brenda tij. Porta e art është një hark triumfi, i ndërtuar në vitin 390 nga perandori Teodosius I. Gjatë sundimit të perandorit Teodosius II, në vitet 408-450, u ndërtua muri rrethues i Konstandinopojës, i cili në sistemin difensiv të tij përfshiu edhe Portën e Artë. Në qendër të kompozimit të kësaj porte ndodhet Harku i Madh, i punuar me blloqe guri të gdhendur me finesë, me hapësirë drite 7,75m, anash të cilit janë 2 harqet e vegjël me hapësirë 5.7m. Pas hyrjes duken qartë gjurmët e kalldrëmit të Via Egnatias, i punuar me gure të mëdhenj pllloçak të lëmuar sipër. Portat e Arta (Golden Gate) të Via Egnatias në Ballkan e kategorizojnë këtë aks antik si një rrugë perandorake në antikitet dhe si një arterie mbretërore në mesjetë, kur për arsye të luftrave dhe pushtimeve të ndryshme ajo e humbi disi rëndësinë e saj, bile hera-herës edhe u pezullua.



Fig. 12. Harku (Kamara) i Galerios , Selanik

Për historinë e Via Egnatias është shkruar dhe folur shumë. Në kushtet e sotme të krijimit të shumë organizmave kulturore, kombëtare e nderkombëtare. Kjo vijë antike meriton status të veçantë si Pasuri e Kulturës Botërore, Itenerar Kulturor Ballkanik etj. Evidentimi i elementëve të kësaj vije antike, si dhe i qendrave dhe objekteve monumentale përgjatë saj përbëjnë një tematikë që duhet trajtuar, pasi përveç vlerave historiko-dokumentare, ato janë të lidhura organikisht me turizmin kulturor, të cilin ende nuk po e ndjejmë në masën e duhur.



Fig. 13. Galerio në një relief në harkun e Selanikut

DO NOT COPY



Fig. 14. Kalaja e Topkapisë me Golden Gate në Kostandinopojë



Fig. 17. Golden Gate në Jedikule në Kostandinopojë



Fig. 15. Planimetria e Çitadelës Jedikule në Kostandinopojë



Fig. 16. Golden Gate në Jedikule-Kostandinopojë

DO NOT COPY

The Golden Gate of the Via Egnatia in the Balkans

Via Egnatia is an ancient traverse that crossed a number of countries in the Balkans region and connected a number of highly civilized centers of the antique world such as: Dyrrachium, Scampa, Lychnid, Heraclea, Edessa, Pella, Thessaloniki, Neapolis and Constantinople. Thus aiding the spread of culture and tradition from one center to the other. Via Egnatia was a field (plain) road that passed through important cities of four different countries: Albania, Macedonia, Greece and Turkey.

It is precisely for these advantages that this antique road has been the center of many debates and discussions lately. The path, the construction choices and the objects erected along this ancient road, could be very helpful today as far as our countries are attempting to establish a better and more integrated economic, historical and cultural future.

This paper, while providing general information about Via Egnatia, focuses on the identification and details related to the Gates of Via Egnatia across the Balkans.

Via Egnatia made its entrance through the Gates into the fortified systems of the cities of the time. The gates of the antique cities were located along the fortified surrounding walls and they were called the Golden Gates. Golden Gates of Via Egnatia in the Balkans region can be found in a number of cities such as: Dyrrachion (Durres), Scampis (Elbasan), Thessaloniki and Constantinople (Istambul). In the paper, are provided details about the technical construction of these Gates, construction and reconstruction dates for each, names of the famous officials or kings who contributed to the erection of these gates and named them after a special historical event. Among these were Emperor August, Galerio, and Emperor Theodosius. Both of them erected Golden Gates, or Arches of Triumph, along Via Egnatia to celebrate their names and victories.

There is abundant literature and work concerning the history of Via Egnatia, especially owing to the existence and activity of numerous national and international cultural organizations. This ancient road has been awarded with a special status such as World Cultural Heritage, or Balkans Cultural Itinerary. Highlighting the elements of this antique road including the monumental centers and objects that can be found along it, is very important since this would provide not only historical and documentary values, but also a basis for the cultural tourism which, for the moment, is not being exploited to the extent it should.

Valter SHTYLLA

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Sulejman DASHI

Restaurimi arkitektonik në Shqipëri (periudha tradicionale)

Restaurimi i monumenteve të arkitekturës, deri në kristalizimin si shkencë, ka kaluar dy periudha të mëdha kohore. Periudhën empirike tradicionale dhe periudhën shkencore. Sot restaurimi pranohet si çasti metodologjik i njohjes së veprës monumentale, në qëndresën e saj strukturore (fizike) dhe në polaritetin e dyfishtë historik-estetik, që do të transmetohet në të ardhmen. Disiplina e restaurimit në Shqipëri i përmbahet këtij konceptimi dhe shfaqet si tërësi praktike dhe teorike e punës kërkimore-hulumtuese për gjurmimin, dokumentimin, mbrojtjten, ruajtjen dhe publikimin e trashëgimisë sonë kulturore. Anëtare e ICCROM-it (1962), vendi ynë aderon në Konventën ndërkombëtare mbi mbrojtjen e vlerave kulturore në rast konfliktesh të armatosura (1962) dhe ka pranuar dhe nënshkruar "Kartën ndërkombëtare për ruajtjen dhe restaurimin e monumenteve dhe të siteve" (1964). Në kongresin e Dytë ndërkombëtar të restaurimit, mbajtur në Venecie 1964, Shqipëria paraqet për herë të parë përvojën shqiptare me temën:

Qytete muze në Shqipëri- Qyteti i Beratit

Në trojet shqiptare trashëgimia në fushën e arkitekturës dokumentohet qysh nga neoliti me banesat prej druri (Maliq), me tumat në epokën e bronxit dhe me radhë në vendbanimet me mure rrethues 1200-1000 në fushat pjellore të vendit (Korçë) në jug, (Krujë) në Shqipëri të mesme, (Shkodër) në veri etj. Vendbanime të reja, ku kish nisur jeta qytetare e zhvilluar, (qysh nga periudha e parë e hekurit Bylis), me fizionomi të rendit skllavopronar dhe ekonomi të prodhimit zejtar e të këmbimit të mallrave, kishin përveç mureve rrethues edhe sistemet e fortifikimit për mbrojtjen e kufjve të qytetit me kështjella të vogla, por edhe ndërtime të tilla që ruanin e kontrollonin shtigjet (Persqop). Në vendbanimet më të hershme, muret rrethues realizoheshin me gurë të mëdhenj të papunuar ndërsa më pas, teknika kishte përparuar në përpunimin e blloqeve të gurëve me latim e në forma të rregullta gjeometrike (poligonale, kuadratike, në formë trapezi). Në këto qytete, përveç mureve rrethuese, të cilët qarkonin kodrat, vërehen edhe ndarje të brendshme. Këto veçonin brenda qytetit zona të caktuara si akropolin dhe qytetin e poshtëm. Në Apolloni shihen kuartallet, ku grupoheshin godinat shoqërore dhe ato për banim. Përgjithësisht godinat vendoseshin në terraca paralele; kurse një rrjet këndrejt rrugësh mundësonte lidhjen e zonave me njëra-tjetrën (Finiq). Godinat shoqërore shquheshin për shumëllojshmërinë funksionale dhe kërkesat stilistike e dekorative. Të tilla ishin tempujt, stadiumet, ujësjellsat, portikët, shëtitoret të shoqëruara me kohë edhe nga termet, nymfetë dhe rrjeti rrugor ndërqytetar me ura, argjinatura etj. Te banesat mbizotëronte tipi me oborr peristil. Një kategori e veçantë ishin varret monumentalë, si sarkofaget dhe ndërtimet sepulkrale të gdhendura në shkëmb (Selcë e poshtme).

Një pasuri e madhe arkitektonike ruhet nga periudha paleokristiane. Në veçanti dallohen bazilikat (Durrës, Amantie, Tiranë), baptisteret (Butrint), kishat (Lin).

Fortifikimet paraqesin evolucionin e teknikave të reja si atë të mureve e lidhur me llaç, por me kërdesa jo vetëm teknike, por edhe dekorative në përdorimin e qeramikes së ndërtimit. Shekujt VI-XIV dallojnë për nga formimi i qendrave të reja urbane, krahas atyre me vazhdimësi të pandërprerë. Përparon pro-

cesi i vendosjes së marrëdhënieve feudale drejt formimit të kombësive. Lulëzimi i ekonomisë feudale në shek. XI-XIV përbën një fazë të re në arkitekturë. Kështjellat nuk kanë vetëm funksione ushtarake, por edhe administrative. Arkitektura e fortifikimeve njeh daljet në formë erkeri dhe frëngjitë për balistat. Të tjerë përbërës janë oborret e fortifikuar (Berat). Periudha sjell formacionet e para shtetërore të shqiptarëve (fundi i shek.VII, principata e Arbërit dhe bashkimin e territoreve të mëdha politike të trojeve shqiptare nga Principata e Balshajve (Tivar-Prizren-Berat-Vlorë) shek. XIV. Arkitektura e kishave nxjerr në pah dallimet lindore të stileve bizantine nga ato romantiko-gotike të artit perëndimor. Piktura, skulptura dhe artet e aplikurara arrijnë nivele bashkëkohore të krahasueshme. Nga fundi i shek.XIV në mjedisin urban të Shqipërisë shfaqen tema të reja të arkitekturës, të sferës kulturore islame, si çesma, xhami, teqe, banjo, medrese. Qytetet zgjerohen jashtë kështjellave. Në qytetet e vjetra ngrihen varoshët por përveç tyre hedhin shtat edhe qytete të rinj (Tirana, Korça). Në pikëpamje ekonomike riorganizohet sistemi i esnafëve, i cili mori formë të plotë në shek. XVII-XVIII, duke krijuar kushte të favorshme për zhvillim më të shpejtë të jetës qytetare. Banesat popullore arrijnë të formohen në tipologji dhe në variante. Qytetet kanë bërthama social-kulturore e fetare, por edhe ekonomike-prodhuese siç ishin pazaret zejtar-tregtar (Krujë, Tiranë, Kavajë, bezistenet (Shkodër), banjat publike (Elbasan), bujtinat dhe hanet (Korçë), medresetë, ujësjellësat, çesmat, gjellëtoret dhe objekte të tjera për përdorim kolektiv, kullat monumentale të orës. Deri në fund të shek. XX shembuj të shumtë, që ruhen nga ky fond i traditës sonë, flasin edhe për një fenomen tjetër me rëndësi. Arti i ndërtimit, krahas përpjekjeve të mjeshtrave ndërtimtarë për të krijuar arkitekturë, njeh dhe restaurimin si pjesë të pandarë të këtij arti, si një gjini e veçantë krijuese. Kjo dukuri përgjithësohet sepse gjen pasqyrim në arkitekturën monumentale për të gjitha epokat historike. Ai dokumentohet nga burimet e shkruara, kronikat dhe sidomos në mbishkrimet e gdhendura apo të pikturuara, që përmbajnë vetë ndërtesat arkitekturore. Punimet restauruese në kohë dhe epoka të ndryshme, paraqesin lloje ndërhyrjesh, si mirëmbajtjen e thjeshtë merematuese, riparime pjesore apo totale, në stile e teknika të asaj kohe, plotësime, prishje dhe rindërtime prej fillimi etj. Vlen të dalë në pah fakti që restaurimi ishte vështruar si profesion i veçantë.[2] Shumë raste pohojnë se, për punimet restauruese në vepra madhore, janë përpjekur arkitektët e mjeshtrat më të mirë. Janë të njohura tashmë puna e kryearkitektit perandorak Sadefqar Mehmet Biçakçiut për restaurimin e xhamisë së madhe të Mekës dhe ato të restaurator Kasem Agës (1622) të pallatit mbretëror Top Kapi Saraj.[3]

Mbishkrimet e monumenteve tona përmbajnë të dhëna me rëndësi jo vetëm sepse kanë të gdhendura datat e themelimit, por edhe ato të ndërhyrjeve (osmaisht - "tamir") dhe vlerësime e konsiderata përgëzuese për dobinë dhe vlerën e punës restauruese të kryer. Nëpër mbishkrime vlerësimet quhen *riparime,* herë *merematime,* herë *rindërtime pjesore* apo *tërësore,* herë flasin për *"zmadhime"* nga kërkesat funksionale ose *"riprodhime identike"* në zbukurimet prej druri guri dhe në pikturat, por edhe më tepër vlerësimet estetike kalojnë deri në *"rimëkëmbje"*, *"ringjallje"* të monumenteve. Dukuria e parë është që restaurimi lind si degë e veçantë e arkitekturës dhe formohet si krijimtari në sferën e arteve plastike (pikturë, skulpturë, arkitekturë). Ai zhvillohet si proces krijues për nga mjetet e shprehjes artistike, nga qëllimi dhe mjeshtëritë specifike. Ato dokumentohen në të gjitha epokat historike. Për të dalluar restaurimin, nga një disiplinë e kodifikuar e epokës sonë, prej asaj të realizuar në të kaluarën historike kemi përdorur termin *"Restaurim tradicional"*, në ndonjë rast edhe *"empirik"*. Në literaturën tonë bashkëkohore përdoret termi "Faza ndërtimi" që nënkupton të njëjtën domethënie.[4] Monumentet e arkitekturës antike në qytetet e lashta ilire janë të pasura me ndërhyrje restauruese të llojeve *mirëmbajtës, plotësues, konsolidues riformulues, tjetërsues, rindërtues* si për shembull **Tempulli i Asklepit** (shek. IV p.e.r.) në qytetin e Butrintit. [5] Në stilin e *orderit dorik* ai ishte ndërtuar pranë teatrit të qytetit me ballorin (frontonin) kundrual portës së hyrjes të murit rrethues. Zgjidhja planimetrike e tempullit ishte *"prostil in antis"* i realizuar konstruktivisht në sistemin *tra-kollonë*. Muret qenë realizuar me blloqe gurësh të bardhë dhe shërbenin

DO NOT COPY

për të mbyllur e kufizuar hapësirën e naosit dhe të pronaosit. Kufizimi me masivin shkëmbor në anën veriore tregonte se tempulli nuk kish patur "*Opithodomos*", të ndërtuar posaçërisht sepse rolin e tij e luante shpella e burimit të ujit e ngjitur pranë tij nga kjo anë. Vetitë kurative të ujit kishin nxitur banorët butrintas t'i ndërtonin një tempull adhurimi Asklepit-Hyut të mjeksisë. Pamja ballore përbëhej nga dy kolona dhe dy ante mbi stilobat. Në shek. II e.r. tempulli ishte restauruar duke patur një zgjerim nga ana e teatrit aq sa lejonte muri i analemës dhe korridori i hyrjes në parodosin e teatrit. Tashmë ai njihej si **tempulli i Eskulapit**. Ruante në plan formën drejtkëndëshe, por ishte mbuluar me qemer cilindrik. Hyrja ishte sajuar në qendër të portës, e shoqëruar me dritare të harkuara në secilin krah. Ndryshe ishin kryer punimet restaruruese tek tempulli tjetër i Butrintit, i orderit jonik. Ndërhyrjet restauruese si zbukurimi me mozaikë i dyshemesë shek. I e.r. tregonte se si përdorej akoma edhe në shek.I e.r. Në rastin e parë ndërhyrja kishte qenë rindërtuese në stil e madhësi (**Tempulli i Eskulapit**), ndërsa ndërhyrja tjetër ishte, mirëmbajtëse dhe plotësuese e motivuar nga kërkesat funksionale (**Tempulli i Dodonës**).

Ndryshimet social-kulturore e religjioze, sollën edhe ato nevojën për restaurime (të justifikuara historikisht). Në formën e përshtatjeve të ndërtesave të vjetra pagane për faltore të krishtera, janë realizuar punime mbi to dhe duke përdorur materialet ndërtimore për të rindërtuar godinat sipas kërkesave të reja rituale. Këto punime i hasim në të gjitha qytetet antike të vendit tonë, si p.sh. ndërtimi i bazilikës paleokristiane fare pranë tempullit pagan në Amantie (Vlorë), përshtatja e një vile qytetare, të shtruar me mozaikë, për kishë në Tiranë, si dhe të tjera në Durrës, Bylis, Apoloni etj. Kjo e fundit ka tërhequr në veçanti vëmendjen tonë. Ajo është bërë objekt studimi nga shumë historianë arti dhe arkitektë; vendas dhe të huaj, të vjetër dhe të rinj, me përfundime të ndryshme dhe kundërshtuese.[6] Jemi ndalur posaçërisht në studimin e kryer nga dy shkencëtarë evropianë sepse ata nuk janë as specialistë restauratorë, por edhe sepse nuk kanë njohje të plotë të trashëgimit mesjetar kulturor të vendit tonë. Një panoramë përmbledhëse e historisë së këtij monumenti, sipas tyre mund të përmblidhej në pak fjalë. Kisha qendrore kushtuar Shën Mërisë në manastirin homonim në Apoloni është themeluar në vitet 80 të shek.XI, prej arkitektëve normanë dhe benediktinëve të Apulisë gjatë fushatave luftarake të Robert Guiskajit (1081- 1083) kundër perandorit bizantin Aleks Komneit. Pasi e kishin humbur luftën ata ishin larguar por kishin lënë në Apolonë, gurëgdhendësit e tyre. Këta gurëgdhendës, që sipas tij ishin shumë të aftë për punë dhe që qëndruan në Apoloni kishin ndërtuar muret prej guri të gdhendur në stilin *Norman* si dhe kupolën e ndërtesës në stilin *bizantin*. Më pas gurëgdhendës të tjerë kishin ardhur përsëri pas rreth 20 vjetësh. Këtë radhë me Bohemundin (1107–1108) dhe i kishin shtuar kishës një hekzonarteks në stil *perëndimor*, të ngjashëm me një të tillë të ngritur në Konversano të Italisë jugore dhe në kishën e San Benedetos (rreth 1110). Ndryshe mendojnë restaruratorët.[7] Nga punimet gjurmuese, përpjekjet, analogjitë me monumente të tjera të së njëjtës sferë kulturore dhe veçanërisht nga specifikat që ofron metodologjia e restarurimit, u saktësua kronologjia e jetës së gjatë të ndërtesës. Rezultoi, që gurët masivë e të gdhendur bukur, të përdorur për ngritjen e mureve, as nuk ishin sjellë nga jashtë e as ishin latuar në shek.XI nga gurëgdhendës normanë, por ishin bllokët antike të teatrit të Apolonisë dhe të përdorura disa shekuj përpara se të dukeshin benediktinët e Apulisë në këto troje. Aq më pak do të ishte vepër e tyre kupola me kluasonazh në një stil, për ata i panjohur tradicionalisht. Hekzonarteksi vërtet ishte një restaurim, pra ndërhyrje i një faze të vonë, por ndërtimi i tij i takonte shek. XIV (1328-1350) nga mjeshtër të Ateliesë së Durrësit, të njohur për atë periudhë me një përhapje të gjerë ndërtimesh të këtij lloji, jo vetëm në Shqipëri por edhe në bregdetin Dalmat e deri në vise të tjera të Evropës qendrore. Restaurime që ruajnë vlerë metodike edhe për kohën tonë shihen mirë në manastirin e Shën Klarës, dhe veçanërisht në kishën e Shnandoit (**Shën Antonit**) në Muzhlin e Skënderbeut në Kep të Rodonit. Kjo ndërtesë përfaqëson sot njërin nga shembujt e mbetur nga arkitektura romanike-gotike në Shqipëri. Për temën që na intereson ajo ka një histori të pasur. Studimet e kërkojnë themelimin e saj si faltore e një abacie benediktine e cila në shek. XIV ishte në përdorim nga etërit françeskanë, që e

POSTSCRIPT

kanë në juridiksion edhe tani. Ippen, i cili ka vizituar këtë manastir (konvent) një shekull më parë pohon se tradita vendase ja atribuonte ndërtimin e manastirit motrës së Skënderbeut si një konvent për murgeshat e Santa Klarës (Klarissa). Ky emër nënvizon ai, edhe pse nuk përdorej shumë në trevat e tjera shqiptare këtu ishte tepër i përhapur ndër vajzat dhe gratë. Rreth vitit 1720 manastiri ishte zgjeruar së tepërmi, pastaj ishte braktisur (1733) dhe me 1758 françeskanët e kishin marrë përsëri për ta bërë seli peskopale për peshkopin e Lezhës, Bariçiç (1826-1839).

Në vitin 1852 një tërmet i fuqishëm kishte shkatërruar një pjesë të madhe të manastirit, por edhe pjesë të kishës, si *nefet anësore* dhe *qemerin apsidal.* Kisha kishte qenë e afreskuar së paku tri herë dhe prekur me ndërhyrje konsoliduese, plotësuese dhe modifikuese të cilat do t'i publikojmë me përfundimin e punimeve që kemi nisur për këtë monument.[8] Mbi rrënojat e një bazilike të vjetër paleokristiane ndërmjet viteve (1471- 1481), brenda mureve të kalasë së Durrësit, është ndërtuar një xhami. Nga tradita xhamia njihet si **Xhamia e Fatihut**. Studimet tona përcaktojnë si kohë ndërtimi vitet kur Durrësi ju muar venecianëve nga otomanët të udhëhequr nga komandanti i njohur i kohës Ahmet Gjedik Pasha. Dy fakte përbëjnë interes për t'u cituar në këtë punim. Së pari, në xhami është përdorur teknika e *kluasonazhit* për bazamentin e minares bashkëngjitur murit, gjithashtu me kluasonazh të kishës. Kjo teknikë u ruajt për formimin hapësinor të faltores islame dhe është përdorur rëndom në ndërtimin e xhamive të tjera, para dhe pas saj në Shqipëri.[9] Një tjetër fakt është modeli i minares që klasifikohet në stilin klasik osman dhe përdoret pastaj me përparësi nga mjeshtrat shqiptarë në ndërtimin e xhamive të tyre në shekujt e tjerë. Ndryshe nga **Xhamia e Fatihut**, që u ndërtua në vendin e një kishe të vjetër, ku restaurimi pati karakter transformues funksional dhe aspak në drejtim të teknikës tradicionale, është ndërtuar disa vite më vonë një xhami e stilit klasik osman në qytetin e Korçës. Xhamia ruhet sot në modelin fillestar ashtu siç e kishte porositur Iliaz bej Mirahori, një dijetar i lartë i perandorisë osmane, kur u rikthye në atdhe në vitin 901 të hexhires. Në portën e hyrjes së xhamisë ndodhet një mbishkrim që tregon shkurtimisht ndërtimin e kësaj vepre dhe punimet e herëpashershme që janë ndërmarrë për ta ruajtur atë. Teksti i mbishkrimit thotë që:

Themeluesi i kësaj vepre të dobishme e të mirë, Mirahor Iliaz beu e ndërtoi në vitin 901 (1494). Më 980 Mehmet beu plot gëzim e mbuloi me plumb (kubenë). Më 1249 H (1833) Dervish Islam beu kreu restaurimin e parë. Më 1285 H (1868) Salibeu e bëri shumë mirë restaurimin e dytë. Le të kujtohen shpirtnat e tyne me lutje të mirë 1289 H (1872-73).

Dinamika e restaurimeve dhe kronologjia është e qartë, akoma më tepër se ne i njohim të gjitha aspektet operuese në këtë monument. Njohim pamjen fillestare që ka edhe sot pas ndërhyrjes sonë në vitet 1980, që patën karakter ruajtës të monumentit origjinal. Njohim edhe pamjen e monumentit në aspektin që kish marrë nga restaturimi i vitit 1285 H (1868) e cila ruhej mjaft mirë deri në vitin 1961. Tërmeti i vitit 1961 i dëmtoi ndërtesës së Mirahorit vetëm minaren elegante, kurse nga restaurimet e fundit i rrënoi plotësisht sofanë e xhamisë të shtuar nga Sali beu, kullën e sahatit të ngritur nga shoqatat esnafore të Korçës, teqenë e vjetër Sünbuli dhe disa godina të tjera aksesorë të kullës (kompleksi arkitekturor). Punimet restauruese të vitit 1868 duhet të ishin përfunduar për rreth 4 vjet aq sa është ndryshimi i datës së mbishkrimit 1289 H (1872-73) dhe që në fakt nuk kishin ndryshuar pamjen origjinale të xhamisë në tipologji planimetrike, vëllimore, por ishin kryer për të vetëm shtesa e hajatit. Modelimi artistik ishte realizuar me shijet e kohës dhe frymën e përgjithshme stilistike të qytetit të Korçës, në atë periudhë. Po të mos kish ndodhur tërmeti projekti ynë nuk do ta eleminonte atë, prandaj cilësimi si shumë i mirë që i atribuan atij populli dhe intlektualët e kohës gjen përgëzime edhe tani. Plotësimi i xhamisë me minare edhe pse nuk është realizuar akoma është plotësisht i mundur dhe i dobishëm, sepse kemi një dokumentacion të plotë të saj, madje banorët përreth i kishin ruajtur gurët e rrëzuar deri vonë. Një rindërtim hipotetik i kryer nga komuniteti mysliman, pa miratimin e Institutit të Monumenteve dhe siç ka ndodhur në Berat me minarenë e xhamisë së Hysen Pashës në lagjen Murat Çelepie do të ishte i papranueshëm. Ndërtesat fetare e publike në shekujt e fundit të mesjetës shqiptare flasin akoma më qartë për restaurimet tradicionale, sepse në të shumtën

Do not copy

PO NOT COPY

e rasteve përmbajnë institucionet mbishkrimore (një embrion i procesit të dokumentimit dhe publikimit të ndërhyrjeve restauruese). Xhamia mbretërore e Përmetit (e djegur gjatë Luftës së Dytë Botërore ka të ruajtuar në muzeun e qytetit mermerin e gdhendur mbishkrimor. Për këtë faltore kemi gjetur edhe një përshkrim të publikuar rreth viteve '40 . Autori i shkrimit tregon se xhamia ishte themeluar nga Sulltan Bajaziti II në vitin 900 të hexhires (1494) dhe se ishte trajtuar me përkujdesje restauruese tri herë: në kohën e Sulltan Hamidit në vitin e fundit të mbretërimit 1202-203 H (1774-89) pastaj në vitin 1306 H (1887-88) dhe së fundi në kohën e Mehmet Reshatit 1327-1336 H (1909-1918). Të dhënat e këtij shkrimi përputhen me atë të hulumtuara nga Vexhi Buharaja i cili pasi kish zbuluar mbishkrimin ka deshifriruar datat dhe kryer përkthimin, në gjuhën shqipe. Tekstin do ta japim të plotë:

Khani i khaneve të bujarisë Sulltan Hamidi palla e tij e mprehtë vendos rregullin në shtatë ngastrat (e botës). Kjo nuk është e vetmja nga veprat e tij të bukura (Ai) ka patur gjithmonë dashuri për vendin e vet. Për kaq kohë pat mbetur në gjendje të shkatërruar dhe të keqe, krejt një çerdhe kukuvajkash ishte çdo tip i saj, ku vetëm ato faleshin e luteshin ato luteshin e faleshin Brenda saj, kurse sot në Mihrabin e saj qëndron si imam kryeshejti. Tashti në të vërtetë roli i veçantë i atij perandori plot virtyte Silahdari që ka qënë gjithmonë bujar (me këtë rast) Themeluesi i Parë Bajezit Veliu, ai mbret i zgjedhur arriti shkallën e lartë të kryeshejtit. E ringjalli (Silahdari) dhe i dha shkëlqimin këtij tempulli. Po e ringjalli inisiativa dhe vullneti i zotërisë së tij. Jahja Silahdari me emër Me gjashtë shkronjat myxhevher (me pika) u tregua viti i rindërtimit O. Hatib Kjo faltore është altari i botës, një xhami me madhështi të shenjtë viti 1201 H (1786-1787) .

Nga disa pamje të paraluftës, që kemi për xhamitë e hershme duket se kemi të bëjmë me një tip të veçantë për nga stili. Nuk mund të pohojmë që ky ka qenë modeli fillestar, pa kryer më parë gjurmime e gërmime në vëndin e ndodhjes. Minareja ka shumë të dhëna që të jetë origjinale, sepse po të ish rindërtim do të përmendej pa dyshim në mbishkrim. Edhe në këtë rast nisma restaururese ishte diktuar nga gjendja e rrënuar, por sidomos nga braktisja e besimtarëve. Jahja Silahdari që ka patur gjithmonë dashuri për vendin e vet u motivua nga ky qëllim i lartë. Edhe më tepër mund të themi se ai realizoi këtë restaurim si një akt ringjalljeje që e ka të theksuar në mbishkrim dy herë. Duhet shtuar se në teoritë moderne të restauarimit janë shfaqur me kohë porosi metodologjike, si thënie e Anonit *që monumentin para se ta prekim duhet ta shohim me rreptësinë e historianit, me pasionin e artistit dhe me dashurinë e atdhetarit.* A nuk përmblidhen së bashku këto tre parametra në personin e Silahdarit Jahja?

Emri i tij shkruhet me emër në mbishkrim, krahas Sulltanit ai ruan meritën historike të themelimit të veprës dhe pastaj me punën e tij i shtyrë nga dashuria për vendlindjen i jep një shkëlqim të ri këtij tempulli. Siç shihet, në restaurimet tradicionale mprehtësia shkencore nuk mungon dhe nuk është aspekti teknik ai që udhëheq, por është uniteti ndërmjet moralit dhe botëkuptimit motivacioni që ngjit ndërhyrjen restauruese dhe ndikon pastaj kërkesën për një realizim teknik sa më të frytshëm dhe kurdoherë me kërkesë estetike.

Shembuj të shumtë paraqiten edhe në monumente të tjera që kemi gjurmuar, por do të përmendim tri ndërtesa që kanë patur restaurime në kohët e vjetra dhe janë prekur me ndërhyrje restauruese dhe nga instituti ynë.

Xhamia e madhe apo mbretërore, e qytetit të Beratit, përmban një mbishkrim të shkruar osmanisht, pjesërisht persisht dhe disa vargje arabisht të shkruar me bojë në frizin e mafilit. Aty thuhet se veziri i madh dhe serdari i tij Mehmet Rushiti, pasi erdhën në Berat, panë se xhamia e Sulltan Bajazitit ishte në rrezik shembjeje. Ata vendosën që ta rimëkëmbin. Mehmet Emini (myhyrdari) u caktua të mbikqyrte punimet. Kërkimet tona i përcaktuan ato gjatë ndërhyrjes ruajtëse. Ndër më të rëndësishmet ishin zbukurimet me gdhendje, të nikës së mihrabit, piktorët dekorativë në brendi, ribërja e tavanit me kupola druri të pikturuara dhe të tjera mafili prej druri të skalitur me korniza të profilizuara në madhësi jo të vogla. Ky është mafili më i madh në sipërfaqe të shfrytëzueshme që kemi pasur deri tani në xhamitë e Shqipërisë. Në krejt gjatësinë e tij ishte shkruar historiku i veprës në 29 pano me nga dy vargje secila.

Vargjet janë tetërrokëshe të dyzuara. Panote 15, 16, 20, 21 janë shkruar persisht; shkronjat janë të karakterit *thuluth* dhe kanë patur retushime në fillim të këtij shekulli, që në ndonjë rast kanë shkaktuar

gabime gjuhësore (Për këtë lloj ishte përdorur metoda e nxjerrjes më parë e shablloneve dhe, më pas ishin tonuar disa nga vargjet e dëmtuara, me një ndryshim fare të pakët në ngjyrë nga origjinalet), shumë nga të cilat nuk ishin prekur (ndërhyrje restauruese e pëlqyeshme në llojin e vet).

Mbishkrimi përfundonte me datën 1248 H (1832-833), që nënkupton përfundimin e punës restauruese. Monumenti ishte trajtuar edhe në ballinat e jashtme, ku vihet re një përpjekje e mjeshtrave për të riprodhuar me anë të suvatimit e bojatisjes aspektin piktorik të mureve të vjetra, me plastikë dekorative dhënë nga kontrasti i tullave në rreshta që kornizojnë gurët e latuar, me shirita pikturuar me ngjyrë të bardhë në sfondin gri të çelur të suvasë.

Pranë kësaj xhamie ndodhet Teqeja Halveti e sheh Hasanit, e cila bën pjesë në kompleksin ndërtimor së bashku me konakët e teqesë dhe medresenë (sot e shembur). Teqeja tani njihet si vepër e Sundimtarit të Beratit **Ahmet Kurt Pashës**. Shkurtimisht të dhënat, që merren nga leximi i shtatë mbishkrimeve brenda e jashtë janë: Teqenë e Sheh Hasanit e ngriti Ahmet Kurt pashai si një faltore të dashurisë mistike në vitin 1196 H (1782). Ky kishte qenë arkitekt i faltores së re, por edhe i të gjitha zbukurimeve e pajisjeve të brendisë, të përfunduara një vit më vonë. Me të mbaruar vepra, mbishkrimi vë në dukje se, *"Kjo faltore e shenjtë dhe e stolisur (tani që) kishte përfunduar, po ta shihte piktori kinez tavanin e saj si Saturni, ai do të prishej në fytyrë dhe do i shfaqej në ballë ngjyra e paaftësisë"*. A do të ish çudi, të thuhet më tej që kjo vepër i shton shkëlqimin botës. Në një tjetër pasazh vihet sërish në dukje që *Ahmeti ishte arkitekti që e zbukuroi këtë ndërtesë, se ai derdhi floririn* (këtu duhet kuptuar veshja me patinë prej fletësh ari e krejt tavanit të gdhendur të teqesë) *dhe bëri t`i çelej fytyra këtij vendbanimi të Zotit viti 1197 H.*

Një aspiratë atdhedashëse, e lartë për të zbukuruar qytetin e tij të lindjes, e kishte frymëzuar edhe sundimtarin e Tiranës, Haxhi Et`hem beun, një pinjoll i familjes së Bargjinëve, themelues të qytetit të Tiranës. Ai mori përsipër të përfundonte punimet në xhaminë e nisur nga i ati, që mbeti e papërfunduar në të gjallë të tij. Haxhi Et`hemi ndoqi për plotësimin e faltores sistemin me kupolë mbi trompat anësore e tambur poligonal, por i shtoi në dy krahë portikë me harkada dhe një minare të hollë dhe të lartë nga krahu i djathtë i hyrjes. Pasi kreu punimet e arkitekturës ai mblodhi piktorë që e zbukuruan jashtë e brenda me motive floreale dhe peizazhe imagjinare mbi Stambollin, ashtu të mahnitshme siç mund të kompozoheshin në fantazinë popullore. Njëri nga peizazhet paraqet në krah të një xhamie edhe një kullë sahati që të bën të mendohesh se Haxhi Et`hemi kishte projektuar ndërtimin e një ore monumentale për qytetin e tij, ashtu siç kishin vepruar edhe dijetarë të tjerë në qytetet Elbasan, Shkodër, Gjirokastër, Durrës, Berat, Kaninë etj. Me të vërtete ai e porostiti ngritjen e sahatit, që nisi dhe u përfundua nga populli i Tiranës pas vdekjes së tij. Me këto restaurime dhe plotësime Haxhi Et`hem beu dha një model arkitektonik, përfaqësues të arkitekturës së xhamive shqiptare, e përdorur më pas si model për xhamitë e reja në Peqin, një tjetër si ajo në Tiranë (xhamia e Stërmasit në pazarin e vjetër dhe në mjaft ndërhyrje restauruese nëpër xhamitë e vendit).

Gjatë këtij shekulli dy restaurime të tjera të repertorit tradicional janë ndryshimi i kullës së sahatit në katet e sipërme për kërkesën funksionale të orës se re me fusha shikimi dhe e trupit të minares në pjesën mbi sherif të këputur gjatë luftës. (është restauruar mjeshtërisht nga mjeshtri popullor dibran Adem Mata 1945). Një tjetër restaurim i llojit rindërtues me tendencë për të përsëritur modelin fillestar ishte kryer nga specialistët vendas edhe në xhaminë e vjetër të Sulejman Pashës në Tiranë, rreth vitit 1848, që u dogj në prag të mbarimit të *Luftës së Dytë Botërore.*

Historia e pasur e ndërhyrjeve restauruese në monumentin e qendrës së kryeqytetit është përjetësuar në mbishkrimet e saj; në njërin prej tyre thuhet:

Mirëbërësi, bujari dhe miniera e mirësisë, Molla beu me qëllim të mirë filloi këtë vepër mirësie. Ai hodhi themelet dhe mbaroi cepat e kubesë, por nuk mund të bënte zbukurimet jashtë e brenda, duke bërë bismilah dhe duke shtuar një njësi dhashë datën e vdekjes së tij sipas mënyrës myxhevher. Në prehjen e parajsës flutoroi si zog shpirti i tij Lavdi zotit, tashti biri i tij Haxhi Et'hem i pajisur me dituri dhe njeri me pozitë të lartë arriti të bëjë pikturimin. Ai arriti të plotësojë minarenë, bëri pikturimet dhe ndërtoi tavanin e portikut dhe tashti në këtë xhami këndohet ezani në të pesë kohët.

DO NOT COPY

Për vitin e themelimit të ndërtesës dhe atë të mbarimit Sejdiu e detyroi pendën që të shkruajë për secilën nga një varg. Kjo xhami me pikturime të çuditshme, me kube të lartë e që të fladit shpirtin e zbukuroi këtë qytet sikur të ishte Shën Sofia e Stambollit viti 1236 H (1820).

Shembujt e shumtë të ndërhyrjes restauruese tradicionale që janë në faltoret e godinat e tjera shoqërore si në banesat, urat e kështjellat si dëshmi jetike të popullit tonë, hasen herë të përmendura me shkrime, herë të dalluara me metodat gjurmuese e krahasuese, por të pranuara në përgjithësi si vlera të epokave pararendëse. Kjo bën që përvoja e pasur e restaurimit tradicional të vihet në themel të shkencës shqiptare të restaurimit të monumenteve.

DO NOT COPY

Shënime

1. Gani Strazimiri. Le citta' museo nella R.p. d'Albania-La citta di Berati. Il monumento per l'uomo. Atti del II Congresso Internazionale del Restauro. Bologna 1971. ff. 703-712.
2. Mustafa Cezar. Principles and regulations of construction and restoration duringa the ottoman period in Fifth international congress of Turkish art. Budapest 1978f. 205
3. Ramadan Sokoli. Mehmet Sadefqari. Perla 1996/3 f. 66.
4. Emin Riza. Mbrojtja dhe restaurimi i monumenteve në Shqipëri, Tiranë 1997. f. 59, cit. çdo fazë ndërtimore e monumentit paraqet kontribute të epokave të ndryshme, të cilat si të tilla duhen respektuar. Shih edhe: Gjergj Frashëri. Restaurimi i monumenteve të arkitekturës (çështje të metodës e metodologjisë). Drita 6 Mars. 1983, 18 Mars 1982. Aleksandër Meksi. Burim për edukimin patriotik e kultural të popullit. Mjeshtrat dhe arkitektura popullore. Tiranë 1977. f. 3-8.
5. Guri Pani. Arkitektura e dy tempujve në Butrint dhe punimet restauruese në to. Monumentet 1988. Nr 1. f. 23-36.
6. Gjergj Frashëri. Y. a-t-ilune architectue albanaise au moyen. Les letters albanaises Tiranë 1983/2 f.154-187.
7. Është fjala për punimin . Hajde und Helmut Buschkauze. Die Mairen Kieche von Apollonia in Albaien:Wien 1976.
8. Ippen Th. Alte Kirchen und Kircheruinen in Albanien Wien 1900.
9. Sulejman Dashi. Një xhami e vjetër në Berat. Monumentet 15-16, 1978, f. 101-108. Shih edhe Gj. Frashëri, S. Dashi. Fillimet e artit islamik në qytetin e Beratit. Monumentet. 1988/1. Tiranë f. 97-131.
10. Në shumë xhami monumentale të fondit tonë janë kryer kohët e fundit punime restauruese. Ato janë frut i bashkëpunimit shkecor të Institutit të Monumenteve me fondacionet bamirëse islamike të përfaqësuara nga komuniteti musliman shqiptar. Në ndonjë rast ndërhyrjet rindërtuese me gjuhë stilistike të huajtura nga jashtë dhe jo me frymën e pasur tradicionale janë të pamotivuara shkencërisht.

DO NOT COPY

Architectural Conservation in Albania (Traditional Period)

The discipline of cultural monumental restoration up to the moment of crystallization as a science has past two great periods: the empiric and traditional period and the scientific one.

The inherited architectural works and applicative art in Albania concerning all the historic periods are now traced and documented but not yet conserved and restored.

In the international plan the monumental restoration is accepted as a methodological moment of the getting familiar with the monumental work in its physical existence (structural) and in its double polarity historic and esthetic one which will be transmitted in the future.

The restorative discipline in Albania consists in this concept and appears as a practical and theoretical terrene for the searching, tracing and documentation of protecting, conservation and publishing of cultural heritage values.

During the tracing process we have done are noticed many restorative interventions in architectural works that are frequently mentioned like that in the dative inscriptions they have.

The restorative work in the first stage that is named "traditional or empiric restoration" consists in simple interventions, partly reconstructions, sometimes extensions and functional additions, and in some cases identical reproductions.

During the late middle age period the discipline of restoration become institutional and the professions of restorator become differentiated as a specific specialty different from that of the creative architect.

In this article are given examples of restorative interventions in some of the middle age architectural works where the restorative work is valuated as patriotic aspiration and inspiration with artistic passion.

Sulejman DASHI

DO NOT COPY

Edlira ÇAUSHI

Kisha e Shën Thanasit, VOSKOPOJE

Teknikat, Alterimet dhe Ndërhyrjet

Kantier, 2005

13 qershor 1724. Kjo është data që mund të deshifrohet në kishën e Shën Thanasit, në Voskopojë, testimoniance kjo që na lënë autorët, piktorët e mirënjohur të afreskut, vëllezërit Zografi, si dhe pesë mjeshtrit në drejtimin e një kryemjeshtri.

Ndër kishat e shumta bazilikale dhe madhështore të Voskopojës, për fat të keq në ditët e sotme kanë mbetur vetëm pak. Ndër më të spikaturat evidentohet madhërishëm edhe kjo kishë bazilkale që e pikturuar me mjeshtëri të rrallë nga mjeshtrit korçarë, Kostandin dhe Athanas Zografi, afreskët e saj iu kanë rezistuar gati treqind viteve, duke u prezantuar edhe në ditet tona po aq vitale duke shërbyer si një shkollë e denjë për brezat pasardhës.[1)]

Vëllezërit Zografi kanë punuar me një mjeshteri te lartë artistike. Përveç skenave biblike, padyshim të pranishme në objektin e kultit, ata paraqesin me realizëm edhe skena nga jeta e përditshme, si ajo me motive baritore, skena e muzikantëve në faqen jugore të kishës etj. [2)]

Puna, prania e vazhdueshme dhe konservimet intensive mbi to, na kanë ndihmuar të kuptojmë një sërë metodologjishë, teknikash, dhe mënyrash pikturimi që mjeshtrit kanë përdorur në pikturimin e pareteve të kishës së Shen Thanasit.

Teknika

Incizimi (gërvishtja) i intonakut[3)] ka shërbyer edhe këtu për të vizatuar e delimituar zonat që më pas pikturoheshin sipas ngjyrave të përzgjedhura prej tyre (fig. 1.)

Vërejmë po ashtu, të jetë përdorur me mjeshtëri të lartë jo vetëm teknika e afreskut, por edhe ajo e "mezzo frescos". Kjo teknikë, konsiston në pikturimin e intonakut të tharë me ngjyrat të përziera në qumësht gëlqereje (hidroksid kalciumi + ujë). Në këtë mënyrë ngjyrat mbeten të përfshira në shtresën e hollë të karbonatit, që hidroksidi i kalciumit formon duke u tharë në kontakt me anidridin karbonik të ajrit[4)].



Fig.1.

Për këtë gjermanët quajnë *Kalkseccomalerei,* [5)] pikturën e ndjekur me këtë teknikë, mbi një tjetër të ekzekutuar, a buon fresco (afresk) ku intonaku është pothuajse i tharë. Përkundrejt afreskut, kjo teknikë është më pak rezistente dhe duke parë fraxhilitetin e saj, e shohim të përdorur vetëm në paretet e brendshme të kishës. (fig. 2.) Si e tillë ajo arrin pjesërisht e dëmtuar, në ditët e sotme



Fig.2.

DO NOT COPY



Fig.3.



Fig.4.

dhe konsolidimi i saj paraqet një domosdoshmëri imediate.

Një veçori e pa ndeshur më parë në objekte të kultit dhe një teknikë e re është dhe ajo e aplikimit, me ngjitje mbi sipërfaqen e afreskut, në kupolën e parë të hajatit. Letra e prerë në formën e yllit, e trajtuar më pas me kolla i është aplikuar fleta e arit e cila më pas në tërësinë e saj i është ngjitur qiellit blu të realizuar me teknikën e afreskut. (fig. 3.)

Mbi suportin e murit, pas ariccios, gjejmë të aplikuar shtresën e intonakut sigurisht me fin dhe të përpunuar.

Përsa i takon përbërësve inorganikë, kemi të bëjmë me RERE, ndërsa si përbërës organik vegjetal, gjejmë prezencën e kashtës. Natyrisht, duke iu qëndruar besnik teknikave antike të intonakëve, ku dy komponentët kryesore janë rëra dhe gëlqerja e stazhionuar, ajo është përdorur nga mjeshtrit Zografi në kishën e Shën Thanasit, por në të njëjtën kohë e gjejmë të përdorur edhe në kisha të tjera të Voskopojes dhe të fshatrave të tjerë të zonës.

Ky element (kashta), është përdorur me shumicë edhe për të ruajtur një lloj elasticiteti të intonakut, pasi kjo zonë shquhet jo vetëm për lëkundje të mëdha sizmike, por edhe për temperatura mjaft të ulta që këtë zonë e përshkojnë.

Edhe në pikturën murale të Egjyptit, gjejmë intonakun të ishte i përbërë nga gëlqere dhe argjilë, përbërje së cilës i shtohej kashtë e copëtuar, derisa intonaku të kishte elasticitet më të madh. Por vlen të theksohet se këto piktura kanë arritur deri në ditet e sotme fal një klime ekstremisht të thatë.

Ndërsa me lagështirën që ka përshkuar paretet murore, të ardhur nëpërmjet infiltrimit ose kapilaritetit, në kishën e Shën Thanasit, ka bërë që ndjeshmëria e kashtës së intonakut të bymejë dhe të shpërbëjë afreskun. (fig. 4.) Këtë fenomen e vërejmë në vendet ku lagështira ka qenë më tepër presente, por duke qenë se kisha e Shën Thanasit, të paktën deri tani i ka zgjidhur problemet e lagështirës, ky lloj degradimi ka mbaruar së vepruari.

Pas mbarimit të të pikturuarit të kishës, në të gjitha detajet e saj, përfshi këtu edhe emrat e shkruar të shenjtorëve, që janë detajet e fundit të një vepre



Fig.5.

të pikturuar, kemi të bëjmë me një ripikturim të sfondit me ngjyre blu të thellë. Këtë veçori e ndeshim jo vetem në kishën e Shën Thanansit, Shën Mëhillit, por edhe në kisha të tjera të zonës, siç është ajo e Shën Pjetrit dhe Pavlit Vithkuq të pikturuar nga të njëjtët autorë. (fig. 5.) Kjo ngjyrë e vendosur "a secco" është ndryshe nga ngjyrat e tjera, si nga përbërja ashtu edhe nga potenca koloristike. Analizat kimike do të na sqarojne për të gjitha detajet e tjera mbi të. Megjithatë, kjo na bën të mendojmë që me sa duket kemi të bëjmë me një "mode", ndoshta vetem pak më të vonshme, përsa i takon rinfreskimit dhe rinovimit që shpesh e ndeshim nëpër objektet e kultit. (fig. 6.)



Fig.6.

Alteracionet (shkaqet e degradimit)

Ndërmjet shkaqeve të degradimit, në një vepër arti kemi të bëjmë me:

1- degradim të shkaktuar nga njeriu

2- degradim natyror

Përsai takon pikës së parë, kemi parë në raste të ndryshme nga historia e restaurimit, se motive të ndryshme mud ta kenë çuar njeriun të veprojë mbi një vepër arti (motive politike, fetare, shkaqe të tjera), pra edhe ne pikturën në fjalë kemi të bëjmë me fenomenin e vandalizmit.

Dëmtime të mëdha, përsa i takon integritetit të pikturës së kësaj kishe, paraqesin edhe shkrimet e ndryshme të periudhave, që variojnë që prej 1887, deri në ditët tona. Kjo bën (veçanërisht në pikturën e hajatit), të jetë vanitur lexueshmëria e figurave, e skenave dhe një dëm të konsiderueshëm kanë pësuar figurat e shenjtorëve, portretet e tyre si dhe shenja e kryqit.

Në shumë vepra arti, vërejmë që portreteve ju mungon irisi i syve. Shumë herë ato dëmtoheshin dhe më pas përvetësoheshin nga besimtarët, që sipas tyre shërbenin për t'u asimiluar nga ata që ju duhej të kuronin ndonjë sëmundje të syrit.

Po për fat të keq, këtu kemi të bëjmë, përveç shkrimeve për motive të ndryshme, edhe me akte vandalizmi të mirëfillta me qëllim shkatërrimin e kësaj pikture. (fig. 7.)



Fig.7.

Për sa i takon degradimit natyror, ato ndahen në shkaqe fizike:

1- Të karakterit mekanik, siç janë, lagështira që mund të kenë paretet, era që i ka rrahur dhe vibrimeve. Natyrisht, lagështira ka qenë e pranishme në afreskët e kësaj kishe në periudha të ndryshme.

Tjetër problem, që vjen si pasojë e lëkundjeve sizmike dhe lagështirës, janë krisjet dhe shkëputjet e intonakut nga muri. Kjo ka bërë që të ketë humbur per fat të keq, një pjesë jo e vogël e tij e si pasojë humbjen e pikturës bashkë me të. (fig. 8.)

Lëkundjet sizmike, po ashtu luajnë një rol negativ në degradimin e afreskut, pasi e dimë mirë se

DO NOT COPY



Fig. 14.

tulle dhe pigment për ta tonuar dhe tonofikuar atë në raport me kontekstin dhe suportin. (fig. 13.)

Për sa takon më tej, si pastramit, integrimit, fiksimit etj, do të procedohet me një projekt të detajuar, në bazë të rezultateve që do të kemi nga analizat e fragmenteve të prelevuara, analiza të cilat do të na ndihmojnë të kuptojmë materialet lidhësat, ngjyrat e përdorura.

Në bazë të tyre do mund të përcaktojmë me efikasitet edhe solventet dhe materialet e tjera për pastrimin e afreskut.

Megjithatë në disa sondazhe pastrami të kryera me WISHAB, afresku i kupoles 1 të faqes jugore të kishës çlirohet më së miri nga nxirjet. (fig. 14.)

Për të lexuar më mirë afreskun në ndërhyrjet e metejshme një rol të konsiderueshëm, do të luajë integrimi piktorik. I njohur si i tillë "restaurimi piktorik", ka si objektiv rikostruksionin e leximit të unitetit homogjen të një vepre, integritet ky që i ka humbur në kohë.

Si shembull për të parë rezultatin e një pjese të afreskut u propozua një integrim i nje siperfaqeje të



Fig. 15.



Fig. 16.

DO NOT COPY

parapërcaktuar të hajatit të kishës. Seleksioni kromatik me akuarel dha rezultatet e tij duke mbuluar mbishkrimet dhe gërvishtjet e panumërta dhe duke ruajtur ato më të hershme që u përkasin një ose dy shekujve më parë. (fig. 15-16).

Viti 2006 do të sjellë një punë më intensive dhe së paku të dyfishuar për sa i takon ndërhyrjeve në afreskun e kësaj kishe. Siç e theksova dhe më sipër, emergjenca është një faktor që mbetet i pranishëm dhe i domosdoshëm për afreskun e Shën Thanasit; dhe jo vetëm si vlerë piktorike.

Puna e specializuar e punonjësve të Institutit në bashkëpunim me specialistë të INP Francë dhe ICR Romë, shoqatën Trashëgimi pa Kufi, Universitetin e Hollandës dhe atë të Marburgut, dhe partnerë të tjerë, duke përfshirë këtu ndihmën e madhe financiare që ka bërë të mundur ndërhyrjen ndër vite, do të ndihmojnë që kësaj kishe kaq të rëndësishme per sitin e Voskopojës dhe për trashëgiminë kulturore shqiptare, ti kthehet integriteti i cënuar.

DO NOT COPY

Shënimet:

1 S. Adhami Voskopoja dhe monumentet e saj 1998 f.173
2 Po aty f.174
3 Giuseppina Perusini "Il restauro dei dipinti e delle sculture lignee" Storia, teorie e techniche f. 129
4 Guido Botticelli; Metodologia di restauro delle pitture Murali; f 29
5 G.Perusini po aty f. 179
6 F.Bandini e G.Botticelli; Le pitture murali Techniche, problemi, conservazione; Centro Di Fr. 25
7 Popa 1962; Adhami 1978-1
8 Foto Z.Marika e E.Çaushi.

The church of Saint Athanas, in Voskopoja

Techniques, Alterations and Interventions at the Construction - school 2005

June 13, 1724. This is the date deciphered at the church of 'Saint Athanas' in Voskopoja.

Zografi Brothers have worked with a great masterwork, concerning not only the technical side but also the innovative one. Except the Bible scenes, which are present in the church, they represent in a realistic way scenes of everyday life like the ones with pastoral elements, the musicians' scene in the south face of the church etc. We find in the documents even the names of the 5 masters who have worked in this church under the supervision of a chief master.

The work, the continuous and intensive conservations on them, helped us to understand the certain techniques, methods and ways of painting, which are used by masters for the painting of the church frescos.

The techniques, used are of a high artistic level. They are a lot and conservation work on them has done that: before and during the work to understand perfectly well these techniques and according to them to proceed with further restorations operations.

Alterations (Degrading causes)

The degrading causes will be divided in:
1. Degradation caused by humans
2. Natural degradation

Each of them is important to be analyzed and then to undertake restoration operations.

Conservation Interventions

These interventions are undertaken for the prevention for the further degradation of the picture.

For further steps like cleaning, integration, fixing etc will proceed with a detailed project, which has to use the results of the analyses of the samples.

The year 2006 will bring more intensive work and at least double work as far as the intervention in the frescos are concerned, to give to this church the lost integrity during the years.

Edlira ÇAUSHI

DO NOT COPY

Kristaq BALLI
Lorenc GLIOZHENI

Hartografia, Pîrî Reis dhe brigjet shqiptare në vitin 1520

DO NOT COPY



Zanafilla e përfytyrimit grafik sintetik të universit përreth, ndonëse me mjete e teknika primitive, evokon mijëvjeçarin e tretë, para Krishtit për të na përshëndetur me "*hartat*" e para babilonase e, më pas, ato egjiptiane, kineze dhe qytetërimeve të tjera orientale.

Teksa harta përfaqëson, në mënyrë grafike një areal të caktuar gjeografikisht, të përpunuar në një sipërfaqe të sheshtë, me anën e një numëri elementësh e simbolesh të përgjithshme të pranuara, të cilat zbulojnë tiparet natyrale, artificiale apo kulturore të atij mjedisi që ajo mbulon, evolucioni hartografik shënon eveniment të rëndësishëm me zbulimet e filozofit, matamaticienit e astronomit grek Anaksimandër (611-547 para Krishtit), harta e të cilit besohet se është e para që përfaqëson botën e njohur. Ajo ishte rrethore, në formë dhe tregonte territoret e njohura të botës, të grupuara rreth detit Egje në qendër dhe të rrethuara nga oqeani. Ndërkohë, Pitagora (582?-500? para Krishtit) dhe Aristoteli(L më 380 para Krishtit) krijuan "globet" e parë gjeografikë (sistemin gjeocentrik, sipas të cilit toka ishte e rrumbullakët, por nuk lëvizte në hapësirë), derisa, vonë në mesjetë, astronomi polak, Nikola Kopernik (1473-1543) dhe filozofi e poeti italian Xhordano Bruno (1548?-1600) provuan se qendra e gjithësisë është Dielli e jo Toka.

Midis hartave më të famshme të kohëve të vjetra është ajo e përpiluar nga gjeografi, matematicieni, astronomi e poeti grek Eratosthenes(276?-196 para Krishtit), e cila përfaqësonte rajonet e njohura nga Anglia në veriperëndim në derdhjen e lumit Gang-në lindje dhe në Libi- në Jug. Ajo pruri, gjithashtu, nocionet e para elementare e simpliste të latitudës (gjerësisë gjeografike), dhe longitudës (gjatësisë gjeografike), edhe pse me pasaktësi e shmangie të konsiderueshme. Ai është i pari që ka llogaritur "*perimetrin*" e Tokës.

Kronologjia e Erës pas Krishtit na kujton së pari, hartat regjionale romake të përpiluara për qëllime ushtarake e tregtare (shek. të 2-3-të), ku supozohet se për herë të parë, shënohen edhe toponime e territore shqiptare. Në mesin e shek. II rrezaton gjithashtu filozofi, astronomi, gjeografi, opticieni grek, që punonte në Aleksandri të Egjiptit, Klaudius Ptolemi (100?-170?) që, me botimin e "Gjeografisë" së tij, një guidë 8 vëllimëshe për mënyrën e përpilimit të hartave, e cila përmbante edhe hartat që përdornin në atë kohë formën më të saktë matematike të projektimit konik, e kapërxeu vështrimin e tij deri në hapësirat Euroaziatike e Afrikane.

Chang Heng, një astronom kinez i njëkohshëm me Ptolemin, hartoi një prej sistemeve të para të "*rrjetave*" gjeografike për hartat..

Mesjeta e hershme, bashkë me ndarjen e Perandorisë Romake, ka pak të dhëna burimore për zhvillimin e teknikave të reja shkencore në lëmin hartografik europian. Më pas, detarët arabë,

DO NOT COPY



Fig.1. Harta e Botës sipas Ptolemit (shek. 2-te)

megjithatë, pasi kishin përkthyer edhe veprën e Ptolemit, bënë dhe përdorën harta me saktësi të madhe e, ndërmjet tyre, hartat e Horezmit (V.820) dhe al-Idrizit (V.1154) do të zinin vendin e vet në historinë e hartografisë botërore.

Arti i bërjes së hartave u avancua nga të dy qytetërimet *Inkas* dhe *Maya* në shek. XII. Ata i përpilonin ato për vendet që pushtonin.

Një hartograf anonim kinez, gdhendi një hartë origjinale në gur, ku përfshiheshin tokat, lumenjtë, brigjet dhe vendbanimet kineze. Rreth vitit 1155, shfaqet në një enciklopedi kineze, harta e parë **e printuar**, pra 300 vite më parë se në Europë.

"Revanshin" do ta merrnin në shek. XIII lundërtarët mesdhetarë, të cilët, hartat e tyre të sakta, kryesisht për detin Mesdhe i pajisën me vija të reja për të treguar lidhjet midis porteve, skelave e qendrave të banimit pranë bregdetit dhe, për këto, ato u quajtën "*portolano*".

Pas vitit 1400 shfaqen tri dukuri progresive: u rizbuluan hartat e Ptolemit dhe u përkthyen në gjuhën shkencore zyrtare latine, të cilat influencuan në përsosjen e metodave hartografike; u shpik printimi apo riprodhimi tipografik, ç'ka lejonte shumëfishimin dhe përdorimin më të gjerë të hartave dhe, së treti, filloi era e zbulimeve dhe esplorimeve të mëdha botërore, që stimulonin krijimin e hartave.

Më 1492 eksploratori italian, Kristofor Kolombi (1451-1506) arriti në Amerikë, ndërkohë që një detar e tregtar gjerman, Martin Behaim prodhonte një „*Glob*" ashtu si europianët e njihnin planetin para zbulimit të Kolombit.

Më pas, në vitin 1507 hartografi gjerman Martin Waldseemûller përmendi për të parën herë në një hartë të tij emrin e Amerikës në zbulimet më të reja të tokave transatlantike. Harta e tij, e shtypur në 12 faqe të veçantë, ishte, gjithashtu, e para që veçonte qartësisht Amerikën e Veriut nga Azia.

I vjen radha hartografit të shquar turk, Pîrî Reis, i cili, më 1520, eksperiencën jetësore ia kushtoi veprës madhore hartografike të titullar "*Kitab-i Bahriye*", ku renditen të dhëna të rëndësishme edhe për bregdetin shqiptar, të cilat do të jenë edhe objekti ynë i mëtejshëm.

Ndërkaq, të dhëna të shumta për Shqipërinë jep edhe harta e gjeografit Gestald(1560).

Shekulli XVI identifikohet si më prodhimtari në fushën hartografike, kryesisht me harta që përfshinin informacion të konsiderueshëm nga lundërtarët dhe eksploruesit. Më 1570, gjeografi dhe hartografi flamand Abraham Ortelius (1527-1598), botoi atlasin e parë "modern"- "*Orbitus Terranum*", me 70 harta. Megjithatë, emri dhe vepra e gjeografit, hartografit e matematicienit flamand Gerardus Mercator (1512-1594), qëndron si më i famshmi midis hartografëve të periudhës së zbulimeve. Ai botoi atlasin botëror me tre volume, rreth viteve 1585-95. Ideja që ai sajoi për hartën e tij të botës, ishte më e vyera për gjithë lu-ndërtarët e tjerë.



Fig.2. Harta e Europës sipas Atlasit Orbitus Terranum

Do not copy

Rrjedha e kohës rrit perfeksionin dhe saktësinë gjeo-topografike. Hartat e para, që merrnin parasysh varaiacionet e busullës u hartuan në gjysmën e parë të shek. XVII dhe rreth vitit 1665, ato që tregonin rrymat detare.

Më 1686 anglezi Edmon Halley kompozoi "*hartën e parë të motit*", e cila tregonte sistemin e pafund të erërave, si dhe hartën e magnetike të tokës.

Në fund të shek. XVII astronomi francez nga Observatori i Parisit, Zhan Domenik Kasini, ndërmori inisiativën për përpilimin e hartës topografike të të gjithë Francës, detyrim të cilin e përfundoi 100 vite më vonë, nipi i tij, me të njëjtin emër.

Gjatë viteve 1600-1700, kolonizimi i Amerikës nga Europianët, krijoi nevojën për shumë harta të reja. Aventurieri anglez, Xhon Smith, përpiloi disa harta të rëndësishme të "Anglisë së Re", ashtu si dhe francezi Samuel De Champlain bëri hartën e viseve të Marylandit të sotëm, përgjatë lumit St. Laurence.



Fig. 3. Harte Europiane e Botes e vitit 1649

Në shek. e XVIII ishin konsoliduar mirë principet shkencore të kompozimit hartografik dhe, pasaktësitë kryesore të hartave lidheshin me pjesët e paeksploruara të planetit. Në kapërxyell të këtij shekulli filluan në Europë studimet topografike nacionale. Kështu, së pari Franca më 1793 dhe më pas Britania, Spanja, Austria, Zvicra përpiluan harta topografike e tematike të detajuara, kurse në Sh.B.A., një shekull më vonë, Kongresi Ndërkombëtar Gjeografik, promovoi për të parën herë Hartën e Botës në shkallën 1:1.000.000.

Progresi dhe novacionet e mëdha të shek. XX, në hartografi lidhen me aplikimin e teknologjive të reja shkencore, veçanërisht atë të fotografive ajrore me rezolucion të lartë, nga satelitët Pageos (1966) dhe Landsat(1970) ku Sh.B.A. është anga-zhuar në një studim të plotë "gjeodetik" të sipër-faqes së Tokës. Përparësitë e mëdha, megjithatë, nuk kanë mundur të depërtojnë, ende plotësisht e analitikisht në kontinentin Antarktik, ku vazhdojnë studimet.

Për të përmbyllur imazhin e historisë së shkurtër botërore hartografike, duhet të tregojmë se, sot, qëllimet e përdorimit të hartave janë të shumta, ndaj edhe llojet e tyre janë po kaq të larmishme. Midis tyre, tipet më të përdorshme e më shumë referuese janë ato topografike, që tregojnë veçoritë natyrale të mjedisit si dhe ato artificiale, të njohura si tipare kulturore dhe përfshijnë kufijtë e qyteteve, vendeve e shteteve. Në grupin e dytë përfshihen, hartat e quajtura "tematike", ku radhiten ato hidrografike, aeronautike, gjeopolitike, gjeologjike, klimaterike, të reliefit e dhjetra lloje të tjera, me përdorim special e shkencor, format e projektimit të të cilave janë kryesisht si globe, cilindrike, azimutale e konike.

Por, le t'i referohemi tani detarit, gjeeografit dhe hartografit të shquar turk **Pîrî Reis**, vepra "**Kitab-i Bahriye**" e të cilit zë një vend të posaçëm shkencor në historinë e hartografisë dhe navigacionit botëror, por edhe sepse midis faksimileve të tij origjinale, të ruajtura mirë, të transkriptuara e të përkthyera nga osmanishtja e vjetër, në gjuhën e sotme turke e angleze, të radhitura sipas itinerarit të udhëtimeve të tij të gjata, deteve e oqeaneve të botës, në dy dekadat e para të shek. XVI, takojmë edhe ato pjesë grafike (me ngjyra), dhe deskriptive të disa fragmenteve të vijës bregdetare shqiptare, ku ndodheshin edhe disa nga qendrat më të rëndësishme portuale e të banimit të popullsisë autoktone shqiptare. Këto shkrime e vizatime zënë vend në vëllimin e dytë (nga 4 vëllimet), e versionit të sotëm (1989), në të cilin përmblidhen vizatimet e siluetit bregdetar, që fillon me brigjet e Sirevilos (Gjiri Gulluk) të Provincës Mugla dhe ishullin Rodos, për të vijuar në ishujt e tjerë Ciklade, më pas në perëndim me Gadishullin e Peloponezit dhe Athinës, me brigjet e Epirit, të Shqipërisë, të Dalmacisë e për të përfunduar në Gjirin e Venedikut. Siç shihet, është një lundrim eksplorues i gjatë nëpër Mesdhe në detet Egje, Jon

DO NOT COPY



Fig 4.Mbulesa e Kitab-I Bahriye.



Fig.5 Fragment i një harte të Pîrî Reis të përpiluar në vitin 1513

e Adriatik dhe një vijë bregdetare, tepër e përthyer e komplekse dhe e mbushur me ngjarje të shumta historike midis dy shekujve, kështu që edhe puna e tij për vëzhgimin, gjurmimin, orientimin, studimin, vizatimin dhe narracionin deskriptiv hartografik ka qënë tepër intensive, e perceptueshme dhe, shpesh, e besue-shme kundrejt realitetit të atëhershëm gjeofizik e gjeosocial, po t'i krahasojmë ato me vlerat e sotme shkencore hartografike.

Konfiguracionin bregdetar shqiptar e paraprin përshkrimi i brigjeve të rrethinave **Ajamari** e **Prevezë**:

*"...Prej kështjellës **Ardine** në vilajetin me kopshte e vreshta të Yanya (Janina - u pushtua nga otomanët më 1430 dhe shërbeu si kryeqytet administrativ i tyre në këtë zonë - konstatim i përkthyesve në turqisht) është e lehtë të arrish Pargën, e cila duket si një kështjellë natyrore në breg të detit. Ajo është subjekt i Venedikut. Pas kështjellës ngrihet një mal i lartë i quajtur **Mazarak**, i cili **banohet krejtësisht nga shqiptarët**. Rretheqark Pargës nuk të zë syri tokë të punuar dhe shumica e popullsisë së saj e sigurojnë jetesën me karpenteri. Në veriperëndim të kështjellës rrjedh një përrua. Brenda gjirit e, përgjatë tij, funksionojnë disa punishte me ujë.* (fig 6, 7).

Duke udhëtuar në veriperëndim drejt ishullit të Korfuzit dhe duke e përshkruar e vizatuar atë imtësisht, në fund të kapitullit, që i përket këtij ishulli, harto-grafi gjen një hapësirë për të kundruar një kështjellë *"në brigjet e Rumelisë përballë Korfuzit"* me emrin **Vitor Andu** *"që i përket Venedikut. Përpara kështjellës është një lagunë e madhe e njohur me emrin **Vitirande**"*.



Fig. 6 Ajamaria dhe Parga



Fig.7 Gjiri i Pargës dhe Mali Mazarak

DO NOT COPY



Fig.8. Korfuzi, Laguna e Butrintit dhe Saranda



Fig.9. Hartë e sotme e Korfuzit, Butrintit e Sarandës



Fig.10. Laguna e Butrintit (fragm)

Sigurisht bëhet fjalë për qytetin e Butrintit dhe lagunën e tij e cila "*është plot me peshq dhe kanali i tij bashkohet me detin... Përgjatë tij punojnë një sërë pendash*".(fig. 8, 9, 10) Nga fundi i kepit të këtij vendi dhe pikës më të afërt të Korfuzit autori caktonte një milje e gjysëm. Ndërkohë, "*nga kështjella e Korfuzit, 82 milje sipër saj, ndodhet* ***Avlona***", së cilës ai i kushton një kapitull të veçantë (Avlona, Vlona, Vlora – kjo kështjellë e fortifikuar mirë ndodhet midis maleve të shkallëzuar dhe detit. I është bashkëngjitur territoreve otomane më 1417, gjatë sundimit të Sulltan Mehmetit të I-rë dhe është shkëputur prej tyre më 1913 – interpretim i përkthyesve në gjuhën turke).

Sipas vrojtimeve të tij "*Avlona është një fshat i madh. Deti pranë bregut përpara tij është i cekët dhe anijet që vijnë këtu duhet të përpiqen shumë për të gjetur ngushtica të thella, kështu që ato detyrohen të qëndrojnë ku të munden, duke hedhur spirancën në të dy anët. Anijet më të mëdha mund të qëndrojnë pranë një kepi më në veriperëndim të Avlonës. Para saj shtrihet një lagunë e madhe* (Me sa duket, Laguna e Nartës) *dhe në brendësi janë një sërë ishujsh të vegjël, secili me fshatin e tij. Sandallët mund të hyjnë në lagunë nëpërmjet deltës së saj.* (fig 11, 12, 13).

Gjashtë milje në jug të Avlonës rrjedh një lumë i madh i quajtur ***Irinç****. Sandallët venedikas shpesh i ngjiten këtij lumi për të marrë aty ujë të pijshëm. Përgjatë lumit është një liman i vogël i quajtur* ***Vasiliko*** *dhe anijet, që arrijnë këtu, i hedhin spirancat në drejtim të jugut në gjashtë pashë thellësi të ujit. Gjashtë milje e ca në jug të Valonës gjendet një tjetër liman, i quajtur* ***Porto Raguza*** (ndofta Orikumi), *i mbrojtur nga* ***Kepi Glosa*** (Kepi i Gjuhëzës), *i cili shtrihet midis dy masiveve. Prej së largu këto masive duken të djegur. Deti është i hapur dhe në anën e brendshme të tij të zë syri një rrafshinë rërë, i cili është një liman i mirë për qëndrimin e sandallëve, pasi vendi është i mbyllur dhe thellësia njëzetepesë pashë.*



Fig.11. Gjiri i Vlorës, Karaburuni, Sazani



Fig.12. Vlora (Fragment)

DO NOT COPY



Fig.13 Faksimile e tekstit origjinal të përshkrimit të brigjeve të Vlorës

Në anën veriperëndimore të këtij limani ngrihet një shkëmb i quajtur ***Kavu Lanku****, të cilin banorët vendas e quajnë* ***Kara Burun****. Katër milje në veriperëndim të këtij gadishulli dhe12 milje nga Avlona ndodhet një ishull i shkretë me emrin* ***Sazana****. Në pjesën veriore të tij shfaqet një kishë e rrënuar dhe deti para kësaj kishe është gjithashtu liman. Në lindje ndodhet një kishë tjetër gërmadhë. Një shqopishtë para kësaj kishe dhe një vend për ankorim karshi lindjes në 12 pashë thellësi të ujit. Nëqoftëse një anije ankorohet në thellësi më të vogël, atëhere spiranca godet në një shkëmb të madh 7 pashë të thellë.*

Përballë Kishës mund të gjendet ujë i pijshëm. Në anën jugore të Kara Burunit hapet një gji i vogël, i quajtur ***Tig Kirmata*** *(një hyrje e vogël në pjesën jugore të ishullit Sazana), që shërben si liman për sandallët në kohë të mirë. Kufiri i tij është një përrua që thahet në verë dhe prandaj shtrati i tij duket nga larg si një rrugë e bardh,që thekson më tepër pamjen e malit. Njëzet milje në juglindje të kësaj pike gjendet një skelë e quajtur* ***Pinazumu*** (ndofta Qeparo)(Liman i vogël në jug të Valonës. Emri në turqisht sipas kuptimit letrar përkthehet **„Limani i Lepurit"**- interpretim i përkthyesve në turqisht) *Gjiri ku ndodhet limani quhet nga detarët turq* ***Tavsan Limanu****. Anijet e vogla në liman qëndrojnë në 15 pashë thellësi uji. Erërat e detit janë shqetësuese sepse vendi është i ekspozuar por, gjithsesi,ai mbetet një gji i mbrojtur nga erërat perëndimore e veriperëndimore.*

Rreth dy milje larg në drejtimin perëndimor të këtij limani, shquhet një kështjellë e quajtur ***Hamira*** (Chimara, Himara - një kështjellë e fortifikuar diku në thellësi, në jugperëndim të Avlonës - interpretim i përkthyesve)*, e cila i takon sanxhakut të Yanya* (Janinës) *dhe vendoset në një kodër rrumbullake.*

Pasqyra historike e ngjarjeve, që reflekton përpilimin e hartave të Pîrî Reis, ka qënë ajo e ekspansionit të papërballueshëm të Perandorisë Otomane dhe zgjerimit të kufijve të saj në hapësira gjeografike trikontinentale, prej detit Kaspik në Lindje, Algjerisë në Perëndim, Jemenit (Deti i Kuq) në Jug e Vienës së Habsburgëve në Veri. Kështu, më 1520 e deri më 1566, gjatë sundimit të Sulltanit Sulejman I-rë, kur ai shpalli edhe Luftën e Shenjtë, Perandoria Osmane shënoi kulmin e shtrirjes hapësinore e kjo, natyrisht, ishte rezultat i fuqisë e potencialit të madh ekonomik, ushtarak, disiplinës ligjore ushtarake, i revizionimit ligjor që ky sulltan i bëri konstitucionit perandorak, si dhe indoktrinimit të fortë religjioz islam të popullsisë muslimane.



Perandoria Otomane në vitin 1683

Në fillim të shek. XVI Shqipëria jetonte periudhën historike passkënderbejane, pra thuajse kishin marrë fund edhe përpjekjet e mbrame të pasuesve të Gjergj Kastriotit për rezistencë territoriale e nacionale dhe kishin ndodhur eksodet e mëdha transadriatike. Përveç disa qendrave bregdetare, që u vunë nën protektoratin apo zotërimin e Venedikut, kryesisht si barriera ndaj rrezikut otoman, apo disa

DOKTORATURA

rajone veriore malore të papenetrueshme, territoret fushore e bregdetare ishin vënë nën kontrollin e diktatit ushtarak e administrativ otoman. Në këto rajone, veçanërisht në ato që ju nënështruan forcës ushtarake përkundër qëndresës, pati rrënime e përndjekje urbane e etnike, të cilat shënuan edhe fillimin e fenomenit të konvertimit të detyruar fetar, të shkatërrimit të institucioneve të kultit kristian, apo të shndërrimit e rikompozimit të tyre në objekte të fesë muslimane.

Midis këtij diktati force e barbarizmi ushtarak anadollak, të gjysmës së parë të shek. XVI në trojet shqiptare, ne duam të vemë në dukje një element që, ndofta, nuk është përdorur deri sot si fakt ilustrues historik e social, por që na duket jo pa interes ta evidentojmë kalimthi si një nocion të fermentit ekzistencial e të kundërvënies apo rezistencës së qytetëruar shqiptare, pra faktin që, pikërisht në këtë ekstrem raprezaljesh nacionale e fetare, jo rastësisht rrezaton krijimtaria spirituale e piktorëve fenomenalë pasbizantinë shqiptarë, Onufri e djalit të tij Nikolla, apo e të tjerëve pasuesë të shquar të shek. XVII-XVIII, brenda apo jashtë territoreve shqiptare.

...Por le të ndjekim itinerarin e udhëtimit të Pîrî Reis përbri brigjeve shqiptarë.

"*Tetëmbëdhjetë milje në veriperëndim të Avlonës rrjedh një lumë i madh i quajtur* ***Vuyus*** (Vjosa), *ku mund të hyjnë edhe anijet. Në veri të këtij lumi është një lumë tjetër që quhet* ***Apolonya*** (Semani) *dhe në veri të tij edhe një tjetër me emrin* ***Eski*** (Shkumbini). *Bregu përgjatë derdhjeve të këtyre lumenjve, sidoqoftë, është i butë, i ulët e i mbushur plot me përrenj deri përtej, shumë larg, aq sa edhe kështjella e Turaç-it, e cila gjendet nëntëdhjet milje në veri të Avlonës.*

Turaçi (i cili sipas përkthyesve modernë të Kitab-i Bahryie përfaqëson portin kryesor në Adriatikun Lindor, me emrin autentik të origjinës Epidamnus, i krijuar rreth vitit 625 para Krishtit si një koloni e Corcyra dhe Korinth, në kohët romake u quajt Dyrachium dhe ishte porta e rrugës tokësore midis Romës e Greqisë. Qyteti ndërroi shpesh dorë derisa erdhi nën urdhërin Venedikas më 1392, ndërsa otomanët ia bashkëngjitën Perandorisë më 1501) *është një kështjellë në breg, deti përpara së cilës duket i cekët. Nqs anije të mëdha duhet të ankorohen*



Fig.14
Faksimile e tekstit origjinal ku përshkruhet Durrësi

përpara kalasë, ato mund të gjejnë ngushticën e të hedhin spirancën nga të dy anët për të qëndruar. Deti përreth kepit në drejtimin veriperëndimor është gjithashtu i cekët dhe anijet duhet të lundrojnë me kujdes. Nëse dikush kërkon të qëndrojë në limanin ***Porto Palu*** (është fjala për për limanin e vogël në veri të Durrësit, Bishti i Pallës), *të cilin, së bashku me kështjellën, detarët turq e quajnë* ***Kazik Liman****, do të gjejnë aty një mbrojtje të sigurt për anijet e vogla".*

Siç ndodh zakonisht në libër, çdo përshkrim me fjalë shoqërohet me një hartë të veçantë, por nuk ndodh kështu me rastin e brigjeve të Durrësit edhe pse kështjella dhe porti i tij konsiderohen mjaft të rëndësishëm. Ndofta, kjo hartë mund të ketë humbur gjatë rrjedhës së shekujve...(fig.14)

"*Duke përparuar në aksin verior katër milje apo më tepër larg këtij moli rrjedh një lumë i madh i quajtur* ***Mata*** **(Mati)**, *më tej akoma në veri shihet një lumë tjetër me emrin* ***Adrin*** **(Drin)** *dhe gjithmonë më thellë, ndoshta 25 milje ose më shumë në veriperëndim të lumit Adrin gjarpëron një lumë tjetër i quajtur* ***Les*** *(Lesh, Alessio-ndofta dega jugore e Drinit, pranë të cilit ndodhet edhe qyteti i Lezhës). Kalaja e quajtur edhe ajo* ***Les*** *është rënuar kohë më parë, por është porositur rikonstruksioni i saj.*

24 milje në veri të këtij vendi është lumi ***Boyana***

DO NOT COPY



Fig.15. Shkodra dhe Ulqini



Fig.16. Shkodra (Fragment)



Fig.17. Ulqini (Fragment)

(Buna). *Ky është, gjithashtu, një lumë i madh dhe anijet mund të lundrojnë në të.*

Midis gjithë lumenjve të përmendur më lart nuk ka ndonjë më të madh se Boyana. Lumi që ne e quajmë Boyana buron nga para ***Arnavud Iskendeiyesi*** *dhe derdhet në det. Anije të mëdha mund të hyjnë në deltën dhe rrjedhën e tij.*(fig 15,16,17). (Sipas interpretuesve të veprës, Skutari-Shkodra antike supozohet të jetë themeluar nga Aleksandri i Madh. Në burimet otomane ajo quhet Arnavut Iskenderiyesi, dmth **Aleksandria e Shqipërisë**, për ta dalluar atë nga Aleksandria e Egjyptit. Ajo ishte fortesë e Skënderbeut në shek. e XV dhe u pushtua nga otomanët më 1479).

Prej Boyanës, 12 milje në veriperëndim gjendet një kështjellë e quajtur ***Dulçini*** (Ulqini-Antibari port në Malin e Zi i banuar nga shumë shqiptarë. Kështjellë pirate në mesjetë, qyteti kaloi nga venedikasit tek Osmanët më 1571 dhe mbeti në zotërimin e tyre deri më 1880 – shpjegim i interpretëve). *Kjo kështjellë është subjekt i Venedikut..."*

...Dhe kështu mbyllen kapitujt dedikuar bregdetit shqiptar për të vijuar më në veri drejt brigjeve Dalmate e, në fund në Gjirin e Venecias e qytetërimin venedikas.

Hartat fragmentare dhe përshkrimet origjinale të mësipërme i prezantohen për herë të parë publikut shqiptar dhe opinionit profesional e shkencor të interesuar për to. Rëndësia themelore e tyre qëndron në faktin se ato: 1)Na përforcojnë bindjen se brigjet lindore të deteve Jon e Adriatik kanë qenë të njohur për historinë navale, që lidhej kryesisht me lashtësinë e ngjarjeve historike dhe thellësinë kohore të popullimit autokton, përgjatë këtyre brigjeve; 2)Dendësia e porteve, limaneve, skelave, moleve dhe vendqëndrimeve më të vogla të mjeteve lundruese të krijon imazhin se këto brigje kanë qenë mjaft të rrahura e të preferuara sidomos për ata, që ju shërbenin këto brigje si porta hyrjeje për në Lindje e kthim; 3) Ato



Fig. 18. Detal simbolik nga hartat e Pîrî Reis

janë dëshmi të shtrirjes Jug-Veriperëndim të etnisë shqiptare prej Preveze në Ulqin; 4) Prej tyre njihemi, gjithashtu, me të dhëna interesante toponimike, disa prej të cilave në pendën e Pîrî Reis tingëllojnë si të ngjashme e sinonimike, përkundër, disa të tjerë si emra të rinj të përdorur pas pushtimit osman, që vijojnë të përdoren edhe sot, ose jo; 5)Duke u bazuar në pamjet grafike dhe përshkrimin verbal të qendrave shqiptare të banimit, do të konstatojmë se të gjitha ato janë të fortifikuara me kështjella mesjetare

DO NOT COPY



Fig. 19. Detaje nga Hartat e Pirî Reis

(Preveza, Butrinti, Himara, Vlora, Durrësi, Lezha, Shkodra, Ulqini), ç'ka tregon për veçorinë e kombit shqiptar për rezistencë dhe mbrojtje ndaj rrezikut, që vinte nga deti, por edhe ndaj superfuqisë otomane gjysmëshekulli më parë; 6)Një vështrim krahasues i vendbanimeve shqiptare me ato dalmate e veneciane në harta, si dhe në ilustrimin narrativ të krijon idenë se, përgjithësisht, qendrat urbane tregtare shqiptare, pas invadimit osman, kanë mbetur më të vogla e më pak rezonuese e të zhvilluara në krahasim me domenet e zotërimet Venedikase; 8)Imazhi hartografik i Pîrî Reis integrohej me dinjitet në sistemin hartografik të shek. XVI dhe ishte i përdorshëm për udhëtimet detare. Edhe pse, shpesh, të studiuara nga lartësia e përsosjes të shek. XX paraqesin inkosekuenca e shmangje në formën e brigjeve dhe ishujve, ato kanë në të shumtën e rasteve saktësinë e besueshme të orientimit apo vendndodhjes hapësinore. Disa harta komplekse të tij shfaqin talent e aftësi të shumanshme shkencore në fushat e historisë, gjeografisë, biologjisë, botanikës, hidrologjisë, astrologjisë, njohurive sociologjike, kulturore, etnike, të simbolizmit naval e letërsisë narrative dhe, më në fund, ai shfaqet edhe si një piktor i përkryer miniaturist, që i bën të flasin, veç të tjerash, edhe me gjuhën artistike të pikturës. (fig 15, 16, 17)

Kitab-i Bahriye është një prej kryeveprave botërore të historisë hartografike, navale e gjeografike. Ajo zbulon një shumicë faktesh, që sot mund të jenë akoma të panjohura, ose të dyshimta, është një pasqyrë që ndriçon vendet dhe detet e Tokës dhe i mëson secilit metodat e observimit e mendimit. Informacioni dhe hartat e saj kanë vitalitetin origjinal, unikalitetin dhe autenticitetin midis veprave klasike gjeografike, historike, ekonomike e sociale.

Pa bërë interpretime e përgjithësime të tjera, ndihemi të kënaqur që, nga vepra hartografike voluminoze e mjeshtrit të shquar botëror të fillimit të shek. XVI, Pîrî Reis, mundëm të gjurmojmë e të shkëputim këto pak kontribute interesante për vendin tonë, si një dritare e re që mund të nxitë edhe të tjerët për gjetje e zbulime të reja.



Literatura:

1. Pîrî Reis: ***Kitab-i Bahriye***, Vol 2, 1988
2. Van H. English: ***Map***, Encyclopedia Deluxe, 2003
3. Judy M. Olson: ***Map***, World Book 2003
4. Norman Itzkowitz: ***Ottoman Empire***, Encyclopedia Deluxe 2003
5. Virginia H. Aksan: ***Ottoman Empire***, World Book 2003
6. Tajar Zavalani: ***Historia e Shqipërisë***
7. ***Western Philosophy***, Encyclopedia Deluxe, 2003
8. Markus G. Singer: ***Philosophy***, World Book 2003
9. A. Shehu, S. Baçi: Njohuri mbi Hartografinë dhe Topografinë, 1975

DO NOT COPY

Piri Reis Cartography and the Albanian Coast

The first part of this article is a short mirror about the history of cartography. The art of cartography appears during the 3rd millennium B.C. in some countries of the Middle East such as Babylonia, Egypt, China and other oriental civilizations. The beginning of the first millennium before Christ marks the starting of a new period in the creation of simple maps that showed in a realistic way the discovered world up to that time.

Some well-known Greek philosophers, mathematicians, astronomers, such as Anaksimander (611-547) Pythagoras (582-500) Aristotle (L 380 B.C.), Eratosthenos (276-196) created images of geographic maps and globs. (The geometric system according to which the earth was round but it didn't move in space).

During the New After Christ (A. C.) period the chronology of cartography reminds us of the Roman maps of the II –III century, where it is supposed that, for the first time are distinguished Albanian territories and toponyms. The most famous author of cartography during the first millennium A.C. is the Greek philosopher, astronomer, geographer, and optician Claudius Ptolemy (100-170). He published his geography made of 8 books where he explained the way to compile maps.

Meanwhile, after a long time vacuum the Arabian seamen such as Horezmi (820) and Al Idriz (1154) made maps, which were more precise.

The Incas and Maya civilization during the XII century advanced their maps. In 1155 in the Chinese encyclopedia appeared the first printed map, which is about 300 years earlier than in Europe.

The XVI and XVII centuries are distinguished for the big development, exploration, discovering and occupations done at that time.

Martin Behaim a German cartographer produced a globe. In 1507 another German cartographer Martin Waldseemuller mentioned the name of America.

Piri Reis, the author of our study, compiled in 1520 the big cartographic work "Kitab Bahrie". In the second part of his study are arranged important data for the Albanian seacoast. Many data about Albania are found even in the map of the geographer Gestald (1560).

In 1570 Abraham Orteliuis (1527-1598) published the first modern atlas " Orbitus Terranum".

The name of another Flemish cartographer stands as the most famous one during the period of big discovering, with the publishing of the important world atlas in 1585-1595.

Later it will be the time of modern and more precise maps and also the compiling of topographic maps of weather, sea streams etc. At the end of the XIX century the World Geographic Congress promoted in USA, for the first time, the world map in the degree 1: 1000000.

With reference to the cartographic work made of 4 books " Kitab-I Bahriye" of the author Piri Reis, who has an important scientific role in the history of cartography and world navigation, illustrated firstly in the Ottoman language, and than translated in the Turkish and English language, we stopped in the interesting fragments that belong to the Albanian coast at the beginning of the 16 century.

The fragmentary colored maps of the Albanian sea coast illustrated with short describing texts are done during his exploring navigation that starts from Guluk Bay of Mugra and the island of Rodos and continues to the other Cycloid islands in the Peloponnesian peninsula, in the coasts of Epirus, Albania, Dalmatian and coming to the Benedict bay, in the Aegean, Indian and Adriatic sea.

The description of the Albanian coast starts with the surroundings of Ajamaria and Parga, where according to the author lived only Albanians. After this, there are painted and described with specific and symbolic cartographic language the Bay of Butrint, Saranda, the bay of Vlora, Caraburun and Sazan, Narta and Durres, Bishti i Palles, Shkodra and Ulqin and almost all the rivers that passed through the Albanian land, which closed the segments of Albanian sea coast. Inside this space we also found many important topographic data, historical, economical, social demographic ones for Albania and Albanians, which are given in detailed way and with antic and modern interpreting.

The interpreting and tracing aim of this article compiled on the bases of the work of Kitab-I Bahriye, has among the others even these scientific priorities:

1 — Shows for the first time to the Albanian public and to the professional and scientific opinion rare authentic data on the Albanian coastline at the beginning of the XVI century.
2 — Strengthens our belief that the eastern coasts of the Ionian and Adriatic seas have been known for their naval history that has precisely been linked with the antiquity of historical events and the time of autochthon settled people along this coast.
3 — The density of harbors, seaports, docks, moles and smaller stations of naval equipments that create the image that those coasts were as entering ports towards the East and turning back.
4 — They are a testimony of the extension of the Albanian ethnicity from Preveza to Ulqin.
5 — Also makes us known important data, some of which sound similar and identical according to Piri Reis. Some of them sound as new names used after the Turkish enviroment that continue to be used even today.
6 — Based on the graphic views and verbal description of the Albanian inhabited centers, we will notice that all of them are fortified with middle age castles (Preveza, Butrint, Himara, Vlora; Durres, Lezha, Shkodra and Ulqin).
7 — The cartographic image of Piri Reis is integrated with dignity in the cartographic system of the XVI century. Some of his complex maps show talent and scientific ability in the fields of history, geography, biology, botanic, hydrology, astrology, social, cultural and ethnographic knowledge in naval symbolism and narrative literature. At last he appears as an excellent miniaturist painter that makes them (maps) speak even with the artistic language of painting.

Kristaq BALLI
Lorenc GLOZHENI

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Shpresa PRIFTI

Banesa shkodrane me çardak deri rreth mesit te shek.XIX[*1]

Banesa popullore shkodrane e shek. XVIII - XIX, karakterizuar për tipizimin si në skemën kompozicionale ashtu dhe në formulimin funksionalo-arkitektonik të shumë mjediseve dhe elementeve përbërës, është trajtuar shpesh nga autorë të ndryshëm, por njëherazi është bërë dhe objekt studimi i veçantë*[2], në përpjekje për të bërë klasifikimin e saj gjatë rrugës së zhvillimit, si dhe për të përcaktuar vendin që ajo zë në kuadrin e banesës qytetare shqiptare.

Zhvillimi në tërësi i qytetit të Shkodrës gjatë kësaj periudhe është i lidhur ngushtësisht me krijimin e qendrës së re të banuar e cila erdhi si rezultat i rritjes së natyrshme të qytetit e pa shkëputur nga procesi i zhvendosjes së qytetit nga qendra e vjetër e ndodhur kjo në anën lindore të kalasë, deri te lumi i Kirit, në lagjet Qafë, Ajasem, Tabak e Tepe drejt asaj të re, në fushën në v-l të saj. Kjo zhvendosje e shtyrë nga mjaft faktorë të ndryshëm natyrorë dhe historikë, mori shtytjen vendimtare pas vitit 1860 për shkakun madhor të rikthimit të Drinit në shtratin e tij të parë, ku bashkimi me Kirin sollën përmbytjen e lagjes së vjetër Tophane. Ndërtimi i kësaj qendre të re, i përfshirë në periudhën kohore nga fundi i shek.XVIII dhe gjatë gjysmës së parë të shek.XIX, solli bashkekzistencën për një periudhë të konsiderueshme kohe të këtyre dy qendrave ku e reja tashmë formohej e forcohej dita ditës, ndërkohë që e vjetra dobësohej e dëgradohej. Tre gravura, ajo E.Lear 1837(fg. 1) A.Bonamore 1880 (fg. 2) dhe I. Kirshen 1885 (fg. 3)*[3], hedhin dritë mbi vazhdimësinë e jetës në lagjen e vjetër Bahçallek dhe Qafë ku të bie në sy tipi i banesës së hapur me çardak i zhvilluar në atë periudhë, ndërkohë, që dhe studimi i bërë një banese të ndodhur në lagjen Qafe*[4], e mbeshtet këtë fakt.



Fig. 1



Fig. 2



Fig. 3

Zhvillimi i banesës së hapur me çardak klasifikuar në tre variante*, "me çardak në gjithë ballin", "me çardak në njerin krah" dhe "me çardak në qendër", janë shkallë zhvillimi, që krahas ndryshimeve sasiore sjellin dhe ndryshime cilësore duke bërë kalimin nga banesë e hapur drejt asaj të mbyllur.

Kalimi brenda tipit të banesës nga varianti më i thjeshtë drejt atij më të zhvilluarit ka dy mundësi: ajo e zhvillimit llogjik të variantit të dytë, pra e lindjes së tij që në krye dhe mundësia e dytë, që është njëherazi dhe më e mundëshmja ka të bëjë me rikonstruksionin që pëson varianti i parë drejt atij të dytit apo dy variantet e parë drejt atij të tretit. Të dy këto procese si ai i lindjes së tipit të ri apo i rikonstruksionit të tipit të vjetër i përkasin realizimeve në fushën e ndërtimit të banesës tradicionale, si një krijimtari thjesht popullore shfaqje kjo në mbarë banesën qytetare shqiptare të kësaj periudhe.

Objekt i këtij artikulli do të jetë trajtimi i dy varianteve të dyta, të banesës së hapur me çardak ai "me çardak në njerin krah" dhe ai "me çardak në qendër", ndërkohë që varianti i parë, ai "me çardak në ballë" ka qenë objekt i një artikulli të mëparshëm*[5]. Studimi pëfshin një numër të konsiderueshëm banesash të vlerësuara si më me interes në numrin e përgjithshëm të vrojtuar, një pjesë e të cilave janë rikonstruktuar në bazë të vrojtimeve në vend si dhe të dhënave gojore, duke mos përjashtuar dhe ato të ardhura si rrjedhojë e një studimi të veçantë.

Varianti i dytë i banesës shkodrane ai "me çardak në njerin krah", krijohet me ndërtimin në një anë të çardakut të një mjedisi i cili shoqërohet me mjedisin në hajat, që zakonisht është ahur, por në disa raste e sidomos kur kemi të bejmë me rikonstruksionin e variantit të parë, ai ndërtohet për banim. Në këtë variant oda e miqve, zakonisht është ajo e dalë në çardak.

1. Banesa e Ismet Halilit

Banesë mjaft me vlerë, e variantit "me çardak në njerin krah"(tab.1) Ruan pothuaj plotësisht kompozimin origjinal. Banesa përbëhet nga katër mjedise në kat, nga të cilat tre janë të vendosura radhazi gjatë çardakut ku në mes qëndron shtëpia e zjarrit dhe në të dy krahët e saj oda e miqve si dhe një odë tjetër banimi e cila lidhet me mjedisin e katërt që del në çardak. Në katin përdhe, nën këtë mjedis, ndodhet një mjedis ndejtjeje, i cili siç duket kryente funksionet e shtëpisë përdhese ndërsa pjesa tjetër është një ahur i vetëm, i barabartë me sipërfaqen e mjediseve në kat. Çardaku, me përmasa të konsiderueshme të barasvlefshme me ato të hajatit, në të dy krahët e shkallëve dyfishe prej guri, ka patur dy qoshqe ku ai bri mjedisit të krahut trajtohet i mbyllur dhe tjetri i hapur (sot i prishur).

Bindemi, se mjedisi i dalë në çardak është ndërtim i njëkohshëm me gjithë banesën për shumë arësye, të para këto në këndvështrimin kompozicio-

DO NOT COPY

nalo – strukturor si dhe arkitektoniko - dekorativ si të banesës, ashtu dhe të elementëve përbërës arkitektonik të saj. Për këtë, merret në konsideratë mos ekzistenca e fugave në vendtakimet e muraturës së bërthamës qëndrore, me atë të mjedisit të dalë, teknika e njejtë e muraturës së tyre, trajtimi i njejtë tekniko - arkitektonik i dyerve komunikuese nga çardaku për tek mjediset e bërthamës, si dhe ajo e dalë, ndriçimi i të tre mjediseve në kat (përjashtuar atë të shtëpisë së zjarrit), me dritare dyfishe ku veçohet ajo e krahut të majtë për trajtimin e veçantë dekorativ duke qenë mjedisi i odës së miqve.

Banesa, në kohë ka pësuar ndryshime të cilat nuk lidhen me skemën e saj planimetriko – funksionale, me përjashtim të mjediseve të pasme, si dhe ato sanitare të cilat kanë pësuar zgjerim, por me trajtimin e ri arkitektoniko – dekorativ të elementëve kompozicionalë, ku do të dallojmë mjedisin e dalë i cili është rikonstruktuar duke rindërtuar plotësisht kompleksin trapazan – musandër, tavanin si dhe faqen ballore më mbylljen e oxhakut dhe ritrajtimin e dritareve të poshtëme pa prekur ato të sipërmet, ndërkohë që, mjediset e vendosura përgjatë çardakut kanë ruajtur gjendjen e tyre fillestare. I kësaj faze ndërtimi, është dhe mbyllja e qoshkut të krahut të djathtë me trajtimin e njejtë arkitertonik të mjedisit në krah, prishja e qoshkut të krahut të majtë si dhe ndërtimi i perdes mbyllëse të çardakut.

2. Banesa e Drishtit

Është një nga banesat më të mëdha të Shkodrës, e variantit "me çardak në njerin krah"(tab.2) ndoshta me çardakun më të madh, po të përmendim se ai ka një sipërfaqe rreth 150 m², e njëjtë kjo dhe për hajatin ku ndodhen shkallët, dy rrampëshe guri mbështetur mbi një sistem qemerësh. Banesa ka në katin përdhe tre ahure me përmasa të konsiderueshme. Në gjendjen e sotme ajo vjen mjaft e transformuar përsa i përket mjediseve të shumtë, të vendosur përgjatë çardakut, duke mos përcaktuar saktë numrin e tyre si dhe funksionet që ato kanë patur fillimisht duke veçuar në qendër, mjedisin e shtëpisë së zjarrit, vatra e së cilës është e ndërtuar në murin qëndror të banesës. Oda e miqve, sipas gjurmëve dhe të thënave gojore, ka qenë ajo në krah të majtë të çardakut ndërsa në krahun e djathtë ku sot ndodhet një mjedis i shtuar vonë, padyshim ka qenë kompleksi shlodhës e soditës, qoshk - sofa, element i pashkëputur i hapësirës së madhe të çardakut, karakteristikë kjo, veçanërisht për qytetin e Shkodrës.

Megjithëse banesa vjen mjaft e transformuar si në planin strukturor, ashtu dhe atë dekorativ hedhim idenë se, ndërtimi në krah të çardakut është i njëkohshëm me pjesën tjetër të banesës nga: mungesa e fugave në vend takimet e muraturës së bllokut të dalë me atë të bërthamës qëndrore, teknika e njëjtë e muraturave, si dhe ajo e dyerve të ahureve dhe faktori më bindës është vendosja e shkallëve në qendër të hapësirës së hajatit si një zgjidhje funksionale dhe njëherazi racionale për komunikimin me mjediset në kat.

3. Banesa e Ymer Ramadanit

Kemi të bëjmë me rastin e rikonstruksionit të variantit te parë, ku banesa nga varianti "me çardak në ballë" kalon te varianti "me çardak në njërin krah"(tab. 3). Banesa në gjendjen e sotme vjen mjaft e transformuar pasojë kjo e shtesave dhe përshtatjeve të bëra asaj në kohë. Rezultat i vrojtimit të kujdesshëm, gjurmëve të mbetura dhe studimit të veçantë*[6] bëhet i mundur konstatimi i fazës fillestare ndërtuar në gjysmën e dytë të shek. XVIII, i cili korrespondon me tre mjedise të vendosura radhazi çardakut ku ai qëndrori është shtëpia e zjarrit, ndërsa ai i krahut të djathtë oda e miqve. Në katin përdhe, në qendër të hajatit i cili zë të njejtën sipërfaqe me çardakun, janë të vendosura shkallët dy rampëshe prej guri mbështetur mbi një sistem qemerësh si dhe trë ahure. Në një fazë të dytë, banesa pëson transformime me vendosjen në krah të majtë të çardakut të një blloku ndërtimi dy katësh ku mjedisi i katit të sipërm zë vendin e odës së miqve dhe ai i poshtmi një odë ndejtjeje. Mbyllja e qoshkut lidhet me shtimin e mjedisit të ri në çardak. Më vonë kemi ndërtimin e bllokut dy katësh të vendosur në çardak.

Vërejmë se, plan vendosja e re e përfituar nga ndërtimi i fazës së dytë në tërësinë e saj ndërtimore, teknike dhe konstruktive na paraqet një ndërtim unik, mjaft të organizuar nga ana funksionale dhe njëherazi të arritur në aspektin e jashtëm arkitek-

Do not Copy

tonik, duke u dalluar në trajtimin e brendshëm arkitektoniko – dekorativ të odës së miqve, ndërtim i fazës së dytë, që mbart karakteristikat e zbukurimores të periudhës së gjysmës së parë të shek.XIX.

4. Banesa e Angjelin Shirokës

Një banesë mjaft interesante e variantit "me çardak në njerin krah" (tab. 4), ndërtim i njëkohshëm, i ardhur në ditët tona, i transformuar me mbylljen e çardakut dhe hajatit. Ruan në gjendje origjinale dy mjedise anësore nga të cilët ai në krah të çardakut, është oda e miqve. E veçanta për këto dy mjedise është realizimi materialo - teknik dhe estetik i tavaneve të tyre me punime në stuko reliev, ku ruhet skema kompozicionale e tavaneve prej druri, karakteristike kjo e mjediseve të shek. XVIII – XIX me realizime të arrira në drejtim të zbukurimores, të kornizës së tavanit, rozetës e trekëndeshave dhe të oxhakut dekorativ. Nga vrojtimi i realizimit të kësaj teknike, për këto dy mjedise, do të veçonim më të hershme atë të odës së miqve, realizuar me modelim në vend të allçisë, te oxhaku dhe pjesët e tavanit (fig. 4), në krahasim me atë të odës tjetër ku ajo është realizuar me kallëpe, konsideruar kjo si ndërhyrje e një faze të mëvonshme.

Vlen të përmendet konstruksioni i veçantë mbajtës i strehëve të gjëra të çatisë (fig. 5), të këtyre dy mjediseve, me pajanta druri, teknikë kjo jo e zakontë për banesën shkodrane në dallim nga ajo e Beratit me realizime mjaft të arrira.

Megjithëse banesa ka pësuar ndryshime me mbylljen e hajatit dhe të çardakut si dhe përshtatjen e tyre dhe të mjediseve në kat, elementët e ruajtur dhe gjurmët e vrojtuara hedhin idenë se, në krah të odës së miqve ka qenë një qoshk fillimisht i hapur, sot është një mjedis i vogël i mbyllur, ndërsa shtëpia e zjarrit ka qenë në qendër. Kati përdhe nën odën e miqve ka patur shtëpinë përdhese si dhe dy ahure, ndërkohë që ruhen dhe shërbejnë ende shkallët një rampëshe prej guri.

5. Banesa e Mati Jubanit

Banesa në kompozimin planimetrik, paraqet një shkëputje nga kompozimi i zakontë me vendosjen



Fig. 4



Fig. 5

DO NOT COPY

DO NOT COPY

e shtëpisë së zjarrit në pjesën e pasme të mjediseve të banimit duke qëndruar si një nën variant i variantit të dytë (tab. 5). Në ditët tona banesa vjen e transformuar me mbylljen e çardakut dhe ndërtimin në krah të djathtë të tij të një mjedisi si dhe ritrajtimin e shtëpisë së zjarrit, ndërkohë që hajati ruhet i hapur ndërsa shkallët janë transformuar. Vendosja e shtëpisë së zjarrit në pjesën e pasme ka bërë të domosdoshme nevojën e një korridori të brendshëm të ashtuquajtur rruginë, i cili mundëson lidhjen direkte të saj me çardakun dhe ndërkohë bën ndërlidhjen e dy mjediseve të dyta të vendosura bri tij. Kjo plan vendosje, ka sjellë spostimin majtas të bllokut të ndërtimit i përbërë nga dy mjedise duke sjellë një shkëputje nga konfiguracioni klasik, katërkëndësh kënddrejtë i banesës shkodrane. Të dy këto mjedise, ku ai në krah të çardakut është oda e miqve, ruajnë skemën e zakontë kompozicionale të periudhës së shek. XVIII– XIX, ku vleresohet shkalla e lartë e realizimeve të zbukurimores së odës së miqve në drejtim të daltimit në dru të tavanit, trapazanit dhe rafteve si dhe të plazmimit të oxhakut dekorativ. Do të dallojmë për odën e miqve, vendosjen e saj me ballë jo nga pamja kryesore, si një nga rastet e pakta të vrojtuara, e ardhur kjo për shkak të pozicionit të veçantë që ka faqja e hyrjes ndaj çardakut me vendosje përbri ti, në dallim nga skema tradicionale e vendosjes paralel. Shtëpia e zjarrit me përmasa të konsiderueshme me oxhakun e ndodhur në faqen përballë, ka patur një trapazan i cili komunikonte me dy trapazanet e mjediseve ndërlidhës si dhe një shkallë druri në lidhje me ahurin, mundësi këto për një komunikim të brendshëm dhe sa më intim për gratë dhe vajzat e shtëpisë. Banesa në katin përdhe ka katër ahure ku dy të mesit janë lidhur më vonë. Me interes janë portat e mëdha një flegërshe prej druri, që sigurohen me brava kovaçi. Banesa ka patur kullën e sanës, një ndërtim dy katësh, si dhe gjurmë të shtëpisë përdhese.

Varianti "me çardak në qendër"

Varianti i tretë i banesës së hapur shkodrane "me çardak në qendër", është ai, kur në të dy anët e çardakut vendosen respektivisht dy mjedise në të dy katet. Ky variant, i ardhur si rezultat i transformimeve që u janë bërë dy varianteve të parë, konsideruar këto shkallë zhvillimi të banesës së hapur drejt asaj të mbyllur, ka mbrritur deri në ditët tona në shumicën e rasteve në gjendjen e çardakut të mbyllur. Rastet me çardak të hapur janë shumë te pakta per vete faktin se çardaku si elementi me iracional e me primitiv i banesës dhe, njëherazi me sipërfaqen më të madhe të lirë që ka, është mjedisi më i favorshëm për tu modifikuar dhe ndërtuar mjedise të reja në të.

6. Banesa e Hysajve

Një banesë mjaft e madhe dhe e vjetër, e variantit "me çardak në qendër" (tab. 6) e cila në krahun e majtë vjen mjaft e transformuar. Krahu i djathtë i përbërë nga oda e miqve që del në çardak, oda e madhe mbas saj dhe shtëpia e zjarrit e ruajtur pjesërisht, ruajnë mjaft elementë origjinalë. Me interes është teknika e njejtë e treshes së dyerve të hyrjes së tyre nga çardaku si dhe ruajtja e komunikimit të brendshëm, realizuar kjo nëpërmjet hapësirave të trapazaneve. Të bën përshtypje, për të dy odat, trajtimi mjaft i varfër i zbukurimores së tyre me punime të pakta në dru, ku ato të tavanit për odën e miqve nga pikturat ekzistuese tregojnë se fillimisht kanë qenë të pikturuara, teknikë kjo më e herëshme se ajo e drurit. Banesa në vetvehte paraqet një ndërtim mjaft të rregullt dhe simetrik katërkëndëshi kënddrejtë, me dy mjediset e dalë në krah, me një shkallë një rampëshe guri, mbajtur me qemer cilindrik në pjesën e sheshpushimit, e veçanta e së cilës është, ndërtimi i rampave të kalimit, me gurë të plotë ku përgjithësisht ato vishen me rrasa guri. Po ashtu do të dallonim për këtë banesë, mungesën e rreshtit të dytë të shtyllave të drurit brenda së cilës vendoset shkalla, si një përjashtim disi i pa logjikshëm për hapësirën e madhe që ka çardaku e lidhur kjo me aftësinë mbajtëse të konstruksionit të çatisë. Duke u nisur nga formulimi i njëjtë arkitektoniko – teknik i mjediseve të krahut të djathtë, amortizimi i atyre të krahut të majtë dhe uniteti ndërtimor në tërësinë e skemës planimetriko – funksionale themi se, banesa në tërësinë e saj ndërtimore, përjashtuar këtu ritrajtimet e brendshme të mjediseve, vjen si rezultat i

DO NOT COPY

rikonstruksionit që pëson varianti i dytë me ndërtimin e njëkohëshëm të krahut të djathtë. Por, nuk përjashtohet dhe ideja se, i gjithë ndërtimi mund të ketë qenë i njëkohshëm, si një mundësi kjo për familjen e madhe dhe të pasur shkodrane ku nga pohimet e një të moshuare thuhet se "të parët tanë kanë qenë të pasur me toka".

7. Banesa e Hodo Sokolit

Y%shtë një nga banesat e vjetra të qytetit të Shkodrës e variantit me "çardak në qendër" (tab. 7) e ardhur në ditët tona me çardak e hajat të mbyllur ndërkohë që krahu i djathtë është i shkatërruara plotësisht. Transformimet e mjediseve të tjera e bëjnë të vështirë përcaktimin e saktë planimetriko – funksional të banesës. Ajo ruan në gjendje origjinale krahun e majtë që i përket mjedisit të odës së miqve që del në çardak si, një nga më përfaqësuesit në gjininë e vet, i periudhës së fundit të shek. XVIII. Oda e miqve respekton skemën kompozicionale të këtyre mjediseve, por dallon në trajtimin mjaft të varfër në aspektin dekorativ të zbukurimores, ku kompleksi musandër – trapazan (fig. 6) në gjithë lartësinë e tij trajtohet me një perde të thjeshtë dërrase, ndërsa tavanit prej druri i mungojnë plotësisht elementët zbukurues si rozeta dhe trekëndëshat. E veçanta në këtë mjedis, është shkëputja e oxhakut nga pozicioni tradicional në murin përballë hyrjes duke u zhvendosur në atë anësor. Oxhaku i



Fig. 6



Fig. 7

modeluar në vend në stuko reliev (fig. 7) një nga më të arriturit e periudhës përkatëse, vazhdon në çati me një tymtar me pretendime estetike rast ky i pakët në Shkodër ku përgjithësisht oxhaqet duke qenë thjesht dekorativ, me prush (mangall), nuk kanë dalje në çati, por në pjesën ballore hapet një dritare e vogël për ajrosje. Interesante, për këtë banesë është trajtimi në dy kate të ulët i hapësirës së volumit musandër – trapazan të odës së miqve në pjesën e pasme, me komunikim nëpërmjet një shkalle druri, ku në katin e poshtëm ndodhet kompleksi i njyjes sanitare pjesë kjo e pandarë e odës së miqve, si dhe një mjedis i vogël shërbimi me lidhje direkte me qilarin e shtëpisë ndërsa në katin e sipërm ndodhet një mjedis ndejtjeje. Të gjitha këto hapsira, janë padyshim në shërbim të grave dhe vajzave të shtëpisë për një komunikim sa më intim të tyre, shprehje kjo e fanatizmit të theksuar të asaj periudhe. Mjedisi i katit përdhe nën atë të odës së miqve ka luajtur funksionet e shtëpisë përdhese, ndërkohë që shkallët origjinale janë transformuar.

8. Banesa e Gjylve

Banesa i përket zgjidhjeve më të zhvilluara të variantit "me çardak në qendër"(tab. 8), i cili paraqet arritjen më të lartë në zhvillimin morfologjik të banesës shkodrane duke shprehur qartë shkallët e

DO NOT COPY

zhvillimit nga banesa e hapur drejt asaj të mbyllur. Në gjëndjen e sotme ajo vjen e transformuar me mbylljen e çardakut dhe hajatit si dhe mjaft transformime dhe shtesa të reja bërë në kohë të ndryshme. Është nga banesat e pakta të datuara.

Banesa ka qenë objekt i një studimi të veçantë*[7] rezultat i të cilit, janë përcaktuar katër faza ndërtimi. Së pari, banesa ka qenë e variantit "me çardak në gjithë ballin", e tre mjedise përgjatë tij, ku në qendër ka qenë shtëpia e zjarrit dhe në krahun e majtë oda e miqve. Më vonë, janë shtuar në të dy krahët e çardakut dy mjedise, të cilat kanë shërbyer si oda miqsh e nën ta, dy në hajat, oda ndejtjeje. Në një fazë të re, kemi mbylljen e çardakut dhe hajatit, kohë që korrespondon me vitin e rindërtimit 1887 të gdhendur në gur mbi portën e hyrjes të krahut të majtë në hajat (fig. 8). Kësaj faze i përket dhe ndarja e banesës në dy pjesë për arësye të ndarjes së dy djemve pasojë e së cilës është prishja e shkallës origjinale një rampëshe masive guri e ndodhur në qendër të hajatit dhe ndërtimini i dy shkallëve ekzistuese si dhe disa përshtatje të mjediseve origjinale. Faza e fundit që korrespondon me gjendjen ekzistuese, lidhet me ndërtimin e bllokut të ndërtimit në krahun v – l si dhe me krijimin e mjediseve të vogla, ne çardak e hajat.

Megjithese shkalla e realizimit të daltimeve në dru të zbukurimores së dy mjediseve që dalin në çardak dalluar ajo e krahut të djathtë, janë mjaft



Fig. 8

të arrira artistikisht dhe estetikisht duke përfshirë dhe oxhakun dekorativ të plazmuar në allçi vërejmë se, kemi një largim nga skemat tradicionale të ngrohta e shpesh naive në konceptim e realizim, me tendence drejt industrializimit në përshtatje të kushteve të reja të jetesës me kërkesa e tipare qytetare. Vlerësohet, teknika e veçantë e muraturës së këtij blloku, ndërtimi ndërtuar me gurë kave vendosur në rreshta paralel, ku ashpërsia dhe ftohtësia e saj ndërpritet nga kornizimi në suva i dritareve të mjedisit të katit përdhe.

Banesa shkodrane me çardak, në të tre shkallët e zhvillimit të saj, dallon për tipizimin e theksuar, si në skemën konstruktive, ashtu dhe atë të formulimit funksionalo – arkitektonik të mjediseve dhe të elementeve përbërës të saj. Kjo është një karakteristike e përgjithshme e ndërtimeve popullore*[8], e cila shpjegohet me një qëndrueshmëri relative të kushteve ekonomiko – shoqërore, me një fare konservatorizmi në ruajtjen e formave dhe teknikave nga mjeshtrit ku, për Shkodrën vjen në konsideratë dhe koha relativisht e shkurtër e kalimit nga qendra e vjetër, ku kjo banese pati zanafillë, drejt qendrës së re, ku ajo u zhvillua. Ndryshimet që fillon e pëson banesa shkodrane me çardak aty nga fillimi i shek. XIX, janë ato procese të borgjezimit të klasës feudale shkodrane e cila, megjithëse kishte një specifikë të veçantë që ishte njëherazi dhe pronare tokash, faktor që solli bashkëveprimin për një kohë të gjatë të ekonomisë qytetare me atë fshatare, e ndjen të nevojshme shkëputjen nga mënyra e vjetër patriarkale e jetesës, për t'ju përshtatur kushteve dhe koncepteve të reja. Në këto kushte ishte mjaft e arsyeshme dhe njëherazi e zbatueshme prekja e tipit tradicional me qëllimin e rikonstruksionit të tij. Vetë mundësitë që afronte ky tip me hapësira të lira dhe të bollshme për përshtatje, kushtueshmëria e mjaft banesave ekzistuese që nuk i lejonin familjes "luksin" e ndërtimit të një banese të re si dhe shpesh herë, shkalla e lartë e realizimit të brendësisë së mjediseve dhe komoditeti i tyre, sollën ruajtjen dhe ndërtimin për një kohë të gjatë të këtij tipi me ndryshime që prekin kryesisht skemën planimetrike dhe formulimin arkitektonik – dekorativ të pamjes së jashtme, me synimin për të kaluar nga banesa e hapur drejt asaj të mbyllur.

Rikonstruksioni, që pëson varianti i parë drejt atij

DO NOT COPY



Fig. 9

të dytit, apo dy variantet e dyta drejt atij të tretit, nuk duhet parë thjesht si një evolucion në fushën e ndërtimit, por, si shprehje e koncepteve të reja, lidhur me kushtet shoqërore – ekonomike të fillimit të shek. XIX. Këto koncepte shfaqen në raporte të ndryshme në tërësinë e banesës, në përshtatje kjo me kohën e ndërtimit, fuqinë ekonomike të pronarit si dhe shkallën e realizimit të saj. Mjediset e para, që preken pjesërisht apo plotësisht, janë hapësirat e lira dhe të bollshme të çardakut e hajatit, të cilat me rënien gjithmonë e më shumë të ekonomisë feudale, i humbasin funksionet e tyre fillestare. Në katin përdhe mjediset nën mjedisin e shtuar në çardak fillimisht me funksione të shtëpisë përdhese, përshtaten në mjedise ndjetjeje. Shtimi i mjediseve të rinj në çardak, zakonisht shoqërohet me mbylljen e qoshqeve dhe trajtimin e pamjes së tyre me elementët e rinj arkitektonik. Mjedisi i shtuar në çardak, shpesh zë vendin e odës së miqve për vetë trajtimin e ri arkitertoniko – dekorativ të zbukurimores së tij me teknika të reja, ndërkohë që dhe mjediset origjinale, ato të banimit, pësojnë ritrajtim ku zakonisht preket faqja e oxhakut me mbylljen e tij, zmadhimin e dritareve të poshtme duke ruajtur shpesh ato të sipërmet (fig. 9), si dhe ritrajtimin e tavanit dhe kompleksit karakteristik musander – trapazan. Ndryshime rrënjësore shfaqen veçanërisht te shtëpia e zjarrit si mjedisi me anakronik e njëherazi më primitiv i banesës*[9] jashtë normave të reja të jetesës duke pësuar një rikonstruksion të plotë, me paisjen e vatrës me tymtar, zmadhimin e dritareve, vendosjen e tavanit dhe shpesh prishjen e kompleksit trapazan – musandër.

Në mjaft raste, shtëpia e zjarrit bashkëjeton për një kohë të gjatë me rikonstruksionin e banesës në gjendjen e saj fillestare, kjo ndofta me shpjegimin e nënvleftësimit që i bëhet funksionit që ajo mbart, thjesht gatimi, i pashkëputur nga shtresa inferiore, si dhe diskriminuese e grave.

Fusha ku konceptet e reja gjetën pasqyrim relativisht më të gjërë, qe ajo e elementëve të ndryshëm arkitektonik të brendësisë dhe veçanërisht të pamjes së jashtme, me synimin e barastrajtimit të pamjes së jashtme me atë të brendshme. Keshtu, perdorimi i teknikave të hershme të ndërtimit të periudhës kohore të gjysmës së dytë të shek. XVIII si ajo e suvatimit me fije leshi e stampave dekorative, e mbërthimit të dyshemesë me gozhda kovaçi, e pikturimit në sipërfaqe druri, si dhe ajo në suva (fig. 10), e daltimit të drurit në relief të cekët, e modelimit të allçisë në vend, e aplikimit të dritareve në lartësi, e daljes së strehëve të hapura, zëvendësohen me teknika të reja përfaqësuese të periudhës kohore të gjysmës së parë të shek. XIX, si punimi i ornamentikës së aplikuar në gdhendjet e



Fig. 10



Fig. 11



Fig. 12

drurit në relief te thelle (fig. 11), plazmimi i allçisë me kallëpe, trajtimi i ri i pamjeve të jashtme të banesës, me shkurtimin dhe mbylljen e strehëve, zmadhimi i dritareve e kornizimi i tyre me fashatura të gdhendura druri dhe në suva (fig. 12), përpunimi i zgarave të hekurit të dritareve me motive hekuri të rrahur etj.

Kalimi nga varianti i parë, drejt dy varianteve të dyta, shoqërohet me ndryshimin në kompozimin planimetriko – volumor të baneses ku, nga forma e katërkëndëshit kënddrejtë kalohet në thyerjen e këtij konfiguracioni me daljet e mjediseve më tej ose anash çardakut në njërin apo të dy krahët e tij.

Kalimi nga njëri konfiguracion tek tjetri, nga varianti në variant, shprehje kjo e fazave të ndërtimit që pëson banesa në kohe, realizohet mjaft mirë nga ana teknike si dhe ajo strukturore duke përftuar një ndërtim mjaft solid, të lidhur organikisht në tërësinë e tij ndërtimore dhe arkitektonike. Raportet e krijuara mes volumit fillestar dhe atyre shtesë, zgjidhja shpesh herë unike e çatisë dhe rakordimi i plotë i strehëve, përpunimi i pamjeve të jashtme me ritrajtimin e elementeve arkitektonik, kanë sjellë një kontribut të vyer, në lëmin e arkitekturës tradicionale, vepër e mjeshtrave popullorë. (fig. 13).



Fig. 13

Neqoftese do t'i referohemi konkluzionit se, dy variantet e dyta si forma më të vona zhvillimi të banesës së hapur me çardak, si dhe rritja e numrit të mjediseve, të çojnë në zvogëlimin e çardakut dhe natyrshëm në mbylljen e tij, pra në zhdukjen e tipit të banesës së hapur, ku çardaku është mjedisi cilësues i këtij tipi, rastet e studiuara tregojnë se, jo gjithmonë ky zhvillim dhe kjo rritje sasiore mbart në vetvehte premisën e zvogëlimit të hapësirës së çardakut e lidhur kjo ngushtësisht me humbjen e funksioneve fillestare të tij.

Ky fakt i dukshëm tregon, se këto variante kanë bashkëjetuar në një hapësirë kohore, e cila nuk shkon më gjatë se një shekull. Përcaktues në evolucionin e kësaj banese është padyshim roli i faktorit shoqëror – ekonomik, ku elementi feudal ishte ende i fortë, karakteristike kjo e përgjithshme e qyteteve shqiptare të kësaj periudhe.

Ndryshimet që filloi të pësonte banesa shkodrane aty nga mesi i shek.XIX me mbylljen e plotë të çardakut e hajatit, rikonstruksionin e mjediseve dhe ritrajtimin e pamjeve të jashtme, janë shprehje të procesit të borgjezimit të klasës feudale në përpjekjen për një koncept të ri jetese, e lidhur kjo ngushtësisht me lindjen e marrëdhënieve kapitaliste.

Shënim:

1. Rilevimet janë kryer nga autori, E. Riza, F. Zarshati, B. Penxha. vizatimet janë të B. Penxhes, fotot të autorit, H. Çollakut, R. Veselit.

Bibliografia

2. E. Riza. "Banesa popullore në Shkodër gjatë shek. XVIII XIX." Monumentet 4 / 1972
3. F. Hudhri "Albania and Albanians in World Art "
4. Sh. Prifti "Restaurimi i një banese me çardak në Shkodrën e vjetër" Monumentet 17 / 1979
5. Sh. Prifti "Banesa shkodrane me çardak në gjithë ballin "Monumentet 12 / 1976
6. V. Shtylla "Studim mbi restaurimin e një banese në Shkodër" Monumentet 2 / 1971
7. Sh. Prifti "Një shembull i zhvilluar i banesës shkodrane dhe problemet e restaurimit të saj" Monumentet 1992/1999
8. E. Riza "Banesa qytetare shqiptare gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX deri rreth çerekut të parë të shek.XX" Monumentet 20 / 1980
9. Sh. Prifti "Shtëpia e zjarrit në banesën shkodrane të shek. XVIII-XIX dhe elementët arkitektonike të saj". Monumentet 1990.

DO NOT COPY

TAB. 1

BANESA NR. 1 (HALILI)

DO NOT COPY



PAMJA BALLORE



PLANIMETRIA E KATIT PERDHE



PLANIMETRIA E KATIT TE PARE

SHTESA TE MEVONESHME

0 2 4 6M

TAB. 2

BANESA NR. 2 (DRISHTI)

DO NOT COPY



PAMJA BALLORE



PLANIMETRIA E KATIT TE PARE



PLANIMETRIA E KATIT PERDHE

TAB. 3

BANESA NR. 3 (RAMADANI)



PAMJA BALLORE

FAZA FILLESTARE



PLANIMETRIA E KATIT TE PARE





SHTESA TE MEVONESHME

DO NOT COPY

TAB. 4

BANESA NR. 4 (SHIROKA)



PAMJA BALLORE



SHTESA TE MEVONESHME

PLANIMETRIA E KATIT TE PARE

DO NOT COPY

TAB. 5

BANESA NR. 5 (JUBANI)



PAMJA BALLORE



PLANIMETRIA E KATIT TE PARE



PLANIMETRIA E KATIT PERDHE

DO NOT COPY

DO NOT COPY

TAB. 6

BANESA NR. 6 (HYSAJVE)



PAMJA BALLORE



PLANIMETRIA E KATIT PERDHE



PLANIMETRIA E KATIT TE PARE

0 2 4 6 M

SHTESA TE MEVONESHME

TAB. 7

BANESA NR. 7 (SOKOLI)



PAMJA BALLORE



PLANIMETRIA E KATIT TE PARE

SHTESA TE MEVONESHME



PAMJA ANESORE

DO NOT COPY

DO NOT COPY

TAB. 8

BANESA NR. 8 (GJYLVE)



PAMJA BALLORE

FAZA FILLESTARE





PLANIMETRIA E KATIT TE PARE



PLANIMETRIA E KATIT PERDHE

SHTESA TE MEVONESHME

Residences os Shkodra during the middle of 19TH Century

The traditional Shkodra house of the 18-19th century was characterized for its typology in the compositional scheme as well as in architectonic-functional formulation of different rooms (ambiences) and component elements. It is treated often by scholars as a specific topic. This is an attempt to make its classification during the development process and also to determine the position that it deserves in the framework of Albanian civil house.

The development of the open house with balcony is classified in three variations:

1 – with balcony along the entire façade, 2 – with balcony in one side, 3 – with balcony in the center. These are development stages that bring quantity and quality changes making possible the transformation from an open to a closed house.

Transformation within the house type from a simple variation to a developed one has two possible ways: that of logical development of the second variation, which is rising of the house from the beginning and the second and most possible one is that of reconstruction of the first or creating a new third variation.

The subject of this article is the treatment of two variations of open house with a balcony: a) with a balcony in one side, b) with balcony in the center, because the variation with balcony in the façade has been treated in previous articles.

This research includes a considerable number of observed and valuated houses.

A part of them are reconstructed based on the observation and oral information.

Shkodra house with balcony, in the three development stages is distinguished for a specific typology in its constructive and architectonic form of the component parts.

In this conditions it was necessary the treatment of the traditional type and its reconstruction.

The changes that were done to Shkodra house, somewhere in the middle of the 19-century with the entire closing of the balcony and porch, reconstruction of ambiences and external view are part of the social-economic changes in the threshold of bourgeois system in west Europe.

Shpresa PRIFTI

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Mustafa ARAPI

Nikolla, biri i Onufrit dhe jo i Onufër Qipriotit

Artikulli në fjalë merr shkas nga shkrimi i z. Hasan Nallbani, "Pikturat Mesjetare dhe piktorët në kishat e kalasë së qyetit të Beratit" e kumtuar në simpo-siumin "2000 vjet art dhe kulturë shqiptare në Shqipëri" organizuar në Tiranë nga kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë" në vitin 2000 dhe ka për qëllim që:

Nëpërmjet të dhënave të reja të kundërshtoj argumentat dhe mendimin e tij të gabuar se, NIKOLLA ONUFRI është bir i Onufër Qipriotit dhe jo i Onufrit, Mjeshtrit të madh. Krahas argumenteve që do paraqes, sigurisht që do të sjell të dhëna të reja për ikonografin Onufër Qiprioti, të cilat njëkohësisht do të vlejnë dhe si argumente në kundërshtimin e kësaj teze të ngritur nga ky autor.

Siç dihet kur flasim për shekullin XVI, kemi para-sysh elitën e piktorëve të asaj kohe, e përbërë prej Onufrit, Nikolla Onufri dhe Onufër Qiprioti. Që të tre kontribuan në themelimin e shkollës së Beratit. Autori në fjalë bën pyetjen: "Nga vjen Qiprioti dhe çfarë tradite përfaqëson? Dhe në vazhdim nuk jep asnjë të dhënë për prejardhjen e tij, si dhe vendin ku u formua si ikonograf, duke arritur në konkluzionin se Nikolla është bir i Onufër Qipriotit.

"...Jam bir i Onufrit" Nikolla e shkruan nëdy mbi-shkrime të lëna në afreskat e kishës "Shën Mëri Vllaherna" në Berat dhe tjetrën mbrapa një ikone. Për këtë studiuesi Theofan Popa shkruan:

"Në verën e vitit 1956, ekspedita e Insitutit të shkencave zbuloi në Berat (në Kishën e moçme të Shën Mëri Vllaherna), (fig. nr.1) një mbishkrim që na bën të njohim Nikollën, si bir të Onufrit me këto fjalë, "...dhe piktori Nikolla, bir i Onufrit, viti 1578". Me këtë rast, piktori Nikolla, për herë të parë identifikohet si



Fig.1



Fig.2

bir i Onufrit. (Th. Popa, "Piktorët mesjetar shqiptarë"). (fig. nr. 2).

Për mbishkrimin e dytë: "Në verën e vitit 1960 na u dha rasti të deshifrojmë në Berat, në kishën e

DO NOT COPY



Skica 1.

Vllahernës, prapa një ikone të Shën Mërisë, një mbishkrim autograf të Nikollës me nënshkrimin e tij: "...Nikolla i Onufrit". Pranë nënshkrimit Nikolla kishte vizatuar edhe një skicë shenjtori". Th. Popa, Onufri ikonograf i shquar shqiptar. Skica I.

Në lidhje me këtë çështje, në artikullin tim të botuar më parë në revistën "Monumentet" e vitit 2004, kam deklaruar se sipas një shkrimi të botuar në guidën "Byzantine Museum Holy See of Paphos) 1987 Kocilias Publications Nikosia, se:

"Më 1571, Qipro pushtohet nga Turqit, shumë prej ikonografëve vendas si, Joan Qiprioti ose Onufër Qiprioti, largohen nga vendi dhe vendosen në Venedik apo në vende të tjera, ku shtypja ishte më e pakët". Në këtë vit, mundet të ketë qenë një piktor i ri, rreth të njëzetave, i paformuar dhe i panjohur në Qipro. Sipas një korrespondence me shkrim që kam patur me Departamentin e Antikitetit të Nikosias, si dhe me studiues të kësaj fushe, thuhet se veprat e këtij autori nuk gjenden në Qipro. Pas largimit, Qiprioti mundet të jetë vendosur në Venecia apo në ndonjë qytet si Firence ose Siena. Pas njëzet vjetësh qëndrimi në Itali, e pikërisht në vitin 1591, ai shfaqet në kalanë e Beratit me mbishkrimin e lënë në afreskun e mureve të kishës (Shën Kolli, të kalasë së Beratit (fig. nr. 3) dhe ky mundet të ketë qenë



Fig. 3



Fig. 4

DO NOT COPY



Fig. 5

viti kur Qiprioti të jetë takuar dhe me Nikolla Onufrin dhe ky i fundit kishte pikturuar më 1578 afreskët e kishës "Shën Mëri Vllahernë", në kalanë e Beratit e pikërisht 13 vjet më parë se Qiprioti të pikturonte kishën që përmendëm më sipër. Duke përfituar nga këto datime, si dhe ajo e viti 1554 (mbishkrim i fundit lënë prej mjeshtrit të madh Onufri, në kishën e "Shën Premte" të fshatit Valsh të rrethit të Elbasanit), del qartë se Nikolla ka studiuar, punuar pranë Onufrit, të Jatit, ndërsa Qiprioti i ardhur në vitin 1591, në Berat, mundet të mos ta ketë arritur mjeshtrin e madh Onufri. Kështu Qiprioti, nuk ka punuar nën drejtimin e tij, por është influencuar prej veprave të tij.

Në artikullin e tij, z. Hasan Nallbani, ka gabuar në leximin e dy datimeve, në atë të "Dyerve të bukura" (fig. nr. 4 dhe 5), të ikonostasit të kishës "Shën Meri Vllahernë", në kalanë e Beratit e shkruajtur (A Φ ζ A), d.m.th. vitin 1591 e lexon 1569, si dhe



Fig. 6

mbishkrimin e kishës "Shën Kolli" (fig. nr. 3) pranë Vllahernës, të shkruajtur po prej Qipriotit (A Φ ζ A)(fig. nr. 6), d.m.th.1591 e lexon po gabim 1609. Që të dy datimet 1569 dhe 1609 të pretenduara prej tij, sipas referimit të alfabetit të greqishtes së vjetër, duhet të ishin shkruar, e para (A Φ ξ A), ndërsa e dyta (A X Θ).

Datimin e parë e ka çuar 22 vjet përpara dhe të dytën 18 vjet më vonë, kur ato janë realizuar që të dyja në vitin 1591. Nga ky mbishkrim i tij, e kanë çuar atë në konsiderata dhe mendime të gabuara mbi ngjashmërinë stilistike ndërmjet tre ikonografëve.

Në kapitullin e parafundit autori shkruan: "Në pikturën murale të kishave të Shelcanit, të Valshit dhe në atë të "Shen Todhrit", në kalanë e Beratit, nuk gjejmë elementë ikonografikë dhe dekorativë, që të na kujtojnë pikturën e Nikollës te "Kostandini dhe Helena" të pikturuar nga Qiprioti.

Meqë jemi pranë këtyre konkluzioneve, do të mundohem të paraqes argumenta që i kundërshtojnë ato. Në figurën nr. 7 kemi shkëputur një fragment nga apsida e kishës "Shën Kolli", në fshatin Kurjan të rrethit të Fierit dhe po të njëjtën figurë të marrë nga apsida e kishës së "Shën Kollit" në Shelcan të pikturuar prej Onufrit (fig. nr. 8). Është e njëjta figure e arkangjelit, që ndodhet në krahun e majtë të Shën Mërisë Platitera. Po të vëmë re me kujdes, kemi të njëjtën paraqitje të figurës. Konstatojmë të njëjtën lëvizje apo plastike të përkuljes së trupit. Koka e arkangjelit, e siluetuar brenda aureolës, është e njëjta, po kështu lëvizjet e krahëve të

DO NOT COPY



Fig. 7



Fig. 8

tyre si dhe vendosjeve të flatrave njëra poshtë dhe tjetra e ngritur lart, duke krijuar pranë aureolës një hapësirë të njëjtë, gjithashtu dhe dekori me pika që gjenden në veshjet e tyre.

Tani le të marrim rastin e dytë të Baldakinit e realizuar nga Qiprioti për kishën "Kostandini dhe Helena" (fig. nr. 9) dhe atë të Nikollës që realizoi për kishën "Shën Mëri Vllaherna" (fig. nr.10). Që në pamje të parë kemi të bëjmë me një ndryshim në një paraqitje të një numri të madh shenjtorësh te ai i Qipriotit, dhjetë në një krah dhe dhjetë në krahun tjetër, dhe secili krah që fillon nga skena "Deissis" ndodhet figura e arkangjelit, ndërsa tek Nikolla janë dhjetë gjithsej, pesë e nga pesë për çdo krah, gjë të cilën e shohim tek Baldakini i Onufrit të realizuar për kishën e Evangjelizmos në kalanë e Beratit (fig. nr.11). Tek Onufri dhe tek Nikolla, shenjtorët janë radhitur njësoj, tipat afrohen më shumë me njëritjetrin, madje mbajtja e librave të shenjtë dhe të përgamenëve është pothuaj e njëjtë, ndërsa tek Qiprioti është tjetër tipologji.

Ndyshim të madh me Qipriotin dhe ngjashmëri me Onufrin, Nikollën e shohim në trajtimin apo zbukurimin e aureolave të shenjtorëve. Në skicën (II, III, IV) janë të skicuara direkt nga fotot e ikonave. Ato të Nikollës dhe të Onufrit, kanë ngjashmëri të theksuar, ku loja e zbukurimit bëhet nëpërmjet pikave të realizuara me majën e një bulinoje metalike mbi shtresën e arit, ndërsa tek Qiprioti, aureolat janë të trajtuara me pika shumë të imta e të cekta, ndërsa tek figurat kryesore, si Krishti dhe te Shën Mëria, Joan Pagëzori, Shën Teologu, etj., Qiprioti aplikon teknikën e stukorelievit duke realizuar motive bimësh e degësh. Përsa i takon kaligrafisë së shkrimit, të tre

DO NOT COPY



Fig. 9



Fig. 10

DO NOT COPY



Fig. 11

ikonografët, shohim përsëri elementë të ngjashëm që afrojnë Nikollën me Onufrin (skica V). Këtu kemi marrë në analizë gërmat E, O, Φ, Y, B. Duke filluar nga gërma E, shohim që Qiprioti ndryshon nga ajo e Onufrit dhe e Nikollës. Fundi i gërmave "E" është e harkuar, ndërsa tek Onufri dhe Nikolla përfundon me majë.

Kjo ndodh gjithashtu te rasti i gërmave O, P, Φ, Y, dhe B tek shkrimet e librave të shenjtë, që mban në dorë Krishti, si dhe tek gërma e parë e fillimit të tekstit në këtë libër. (skica VI). Nikolla së bashku me Onufrin vendosin rreth e qark siluetit të gërmës "E" gjethe të vogla, ndërsa Qiprioti siluetin e lë të lirë. Po kështu raste të ngjashëm midis Nikollës dhe Onufrit, shohim edhe te mënyra e mbajtjes së librit të shenjtë nga Krishti, ku Qiprioti, gishtërinjtë i ka vendosur në drejtim të kundërt me atë të Nikollës dhe të Onufrit (fig. nr. 12).

Një nga shembujt e fundit, që do paraqes, është modelimi dhe plastika në realizimin e portreteve të Krishtit Pantokrator (fig. nr. 13). Ato të Nikollës e aq më tepër ato të Onufrit, i përkasin modeleve dramatike ku, nëpërmjet vizatimit të theksuar të tipareve dhe aksentimeve me dritën e fortë pranë bebezave të syve që provokojnë tension. Ndërsa tek Qiprioti karakterizohen nga tonet e ngrohta të okrave. Vizatimi linear i tipareve dhe i formave është më plastik te portretet e pikturuara prej tij. Ai fillon nga pikturimi mbi ngjyrën kafe të ngrohtë ndryshe nga Nikolla dhe Onufri, të cilët procedojnë në mënyrë të rregullt sipas kanoneve të stilit bizantin, ku vendet e dritave maksimale që burojnë nga poshtë syve në drejtim të mollëzave duke e bërë në mënyrë tepër kaligrafike me anë të përdorimit të vijave të bardha dhe tepër të holla, dy e nga dy të baraslarguara nga njëra-tjetra.

Qiprioti nuk e bën një gjë të tillë. Vendosja e dritave si dhe modelimi me anë të toneve të së bardhës, është shumë i lirshëm në dhënien e volumeve dhe të formave, e cila afron apo ngjason me portretet të realizuara nga piktorët e Rilindjes Italiane.

Këto argumente që paraqitëm deri këtu, nëpërmjet shembujve tregojnë se Nikolla ka qenë pranë Onufrit, babait të tij dhe jo me kot ai shkruan në mbishkrimin e kishës së Vllahernës: "...unë Nikolla bir i Onufrit...", jo i Onufër Qipriotit por i mjeshtrit të madh Onufrit, i cili pikturoi kishën e Valshit, Shelcanit, Kosturit etj.

DO NOT COPY



NIKOLLA

Skica 2.



ONUFRI

Skica 3.



QIPRIOTI

Skica 4.



Skica 5.



Skica 6.

DO NOT COPY



Fig. 12

DO NOT COPY



ONUFRI



NIKOLLA



QIPRIOTI

Fig. 13

Nikolas son of Onupher and not son of Onupher Cypriot

This article opposes the idea that Nicolas is the son of Cypriot and not son of Onupher who realized the frescos in the church of Valsh.

Hasan Nallbani expresses this idea in his article because he hasn't read correctly the dating left by Onupher Cypriot on the inscriptions in the "Dyert e Bukura" (Beautiful Doors) of the iconostasis in the church of "Saint Maria Vllaherna"-Berat and on that of the church of Saint Nicolas, also in the castle of Berat. On both of the inscriptions is written the year 1591.

The author has read the first as the year 1569 and the second as 1609 sending it 22 years ago and the second 18 years later.

This observation brought wrong arguments, which lead to wrong conclusions that the works of Nicolas are not the same with those of great Onupher, but are closer with the works of Onupher Cypriot who painted the walls of the church of Saint Maria in the village of Vrahogoranxi in Gjirokastra.

The article gives evidence on the origin of Cypriot who left Cyprus in 1571 and was settled for a long period in Venice and after 20 years, that is in 1591, appears in Berat with the inscription in the church of Saint Nicolas.

Meanwhile Nicolas in 1578 painted the walls of "Saint Maria Vllaherna" Church living and working close to his father, Great Onupher.

Mustafa ARAPI

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Dr.Ark. Latif LAZIMI

Trashëgimia Kulturore në funksion të turizmit kulturor në bregdetin Jonian

Për trashëgiminë kulturore shqiptare është ndjekur një strategji e veçantë përgjatë disa dekadave në vendin tonë, e cila ka synuar mbrojtjen, ruajtjen, restaurimin inventarizimin e saj, ndërsa integrimi i kësaj trashëgimie kulturore në funksion të turizmit kulturor nuk është parë me përparësi.

Në vitet e fundit shihet një rritje e turizmit të përgjithshëm në të gjithë Shqipërinë dhe në një masë të vogël atij kulturor dhe në mënyrë të veçantë në zonën bregdetare Jonike.

Në gjendjen e tanishme aktiviteti turistik nuk plotëson kushtet e një turizmi të vërtetë kulturor, i cili parakupton: shfrytëzimin e trashëgimisë kulturore për këtë qëllim, të resurseve natyrore, peizazhin urban malor e bregdetar, burimet ujore, faunëen, florën, pasuritë historiko-etnografike dhe produktet tradicionale të gastronomisë etj. Për këtë qëllim synohet që në të ardhmen turizmi kulturor të zërë një vend të rëndësishëm në turizmin kombëtar, rajonal dhe në mënyrë të veçantë në bregdetin Jonian.

Në aspektin ekonomik infrastrukura në qendrat e banimit tradicionale në bregdetin Jonian është në gjendje nën zhvillim. Konstatohet, që në këto qendra popullsia vendore është e pakët, për shkak të migrimit ekonomik, kështu që zhvillimi i turizmit kulturor në këto zona do të sjellë ripopullimin e tyre, rritjen e nivelit ekonomik, krijimin e vendeve të reja të punës. Turisti ose vizitori kulturdashës duke qëndruar një apo disa ditë në një qendër historike, apo duke vizituar objekte të trashëgimisë kulturore, shpenzon duke i sjellë të ardhura poseduesve të këtyre objekteve, bashkësisë apo shtetit, i cili interesohet për vlerat e Trashëgimise Kulturore. Kështu përfshirja e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit urban në zonën e bregdetit Jonian, në turizmin kulturor nuk shfaqet vetëm në funksionin e tyre praktik por përherë e më tepër kjo përfshirje është në rrafshin kulturor, i cili parakupton pjesëmarrjen e gjerë të popullsisë së kësaj zone si vlerësuese dhe ndikuese në ruajtjen dhe vlerësimin e kësaj pasurie të paripërtëeritshme dhe të pazëvendsueshme.

Objektet e Trashëgimisë kultorore që ndodhen në zonën e bregdetit Jonian, nga Vlora deri ne Sarandë, rrokin të gjitha gjinitë e objekteve monumentale nga prehistoria, antikiteti, mesjeta dhe në vazhdim deri në ditët e sotme.[1)]

Shteti Shqiptar nëpërmjet I.M.K dhe Institutit të Arkeologjisë, si institucione të specializuara për mbrojtjen, ruajtjen dhe restaurimin e trashëgimisë kulturore në Shqipëri ka realizuar një politikë adekuate për administrimin, ruajtjen, vlerësimin, restaurimin dhe inventarizimin e gjithë kësaj trashëgimie.

Tani gjendja e objekteve të Trashëgimisë Kulturore paraqitet jo e mirë, për faktin sepse për gjatë 15-viteve të fundit në këto objekte kulturore peër mungesë fondesh nuk janë realizuar ndërhyrje konservuese dhe restauruese, si në infrastrukturën, arkitekturën dhe veprat artistike të tyre.

Për këtë qëllim një pjesë e këtyre objekteve kulturore kërkojnë ndërhyrje konservuese dhe restauruese të menjëhershme jo vetëm për vazhdimësinë e qëndrueshmërisë së tyre, por dhe me qëllimin e për-

---

[1)] Harta e pasurive të Trashëgimisë Kulturore të bregdetit jugor shqiptar.

HARTA E PASURIVE TE TRASHIGIMISE KULTURORE TE BREGDETIT JUGOR SHQIPETARE
CULTURAL HERITAGE ASSETS MAPP OF ALBANIAN SOUTHERN COAST


Legend
Légende
SCALE 0 5 10 15 20 25 KM
DETI JON
IONIO PELAGOS
ΙΟΝΙΟ ΠΕΛΑΓΟΣ
GJIROKASTËR
Kérkira
(Korfu)
Κέρκυρα
KËRKIRA
(KORFUZ)
ΚΕΡΚΥΡΑ
Selenicë
Memaliaj
Përmet
Libohovë
Çukë
Xarrë
Himarë
Dhërmi
Lukovë
Kuvelesh
Mali i Gjerë
Mali i Çikës
Mali i Lungarës
Mali i Nemërckës
Mali i Trebëshinës
Mali i Dhëmbelit
Mali i Tomorrit
Mali i Shpiragut
Mali i Çikës
Mali i Kurveleshit
Mali i Gjerë

fshirjes së tyre në turizmin kulturor të kësaj zone.

Pronësia e objekteve kulturore të zonës në studim paraqitet e tillë; qendrat prehistorike, shpellat (grote), qendrat arkeologjike (antiko-mesjetare), dhe objektet inxhinierike janë në pronësi shtetërore dhe mbrohen nga shteti shqiptar me ligj të veçantë. Qendrat historike të shpallura dhe ato që po punohet për t'u shpallur; në komponentin e tyre kryesore (banesa) janë pronë private, ndërsa peisazhi urban është pronësi shtetërore-private. Objektet kulturore të kulteve (të shpallura me ligj monument kulture) janë në pronësi të komuniteteve fetare përkatëse si psh. xhamitë, teqetë, kishat dhe manastiret.

Përfitueshmëria (fruibilita) e objekte të trashëgimisë kulturore sipas gjinisë së tyre na ofron këto mundesi përdorimi dhe përshtatje:

Qendrat arkeologjike antiko-mesjetare, përveç funksionit të vizitueshmërisë na ofrojnë dhe mundësi për t'u përdorur dhe përshtatur për organizimin e spektakleve, shfaqjeve teatrale (psh. qyteti antik i Butrintit).

Qëndrat historike na ofrojnë mundësinë e vizitueshmërisë dhe nëpërmjet përshtatjes së objekteve përbërëse të tyre (ndërtimeve) për qëllime bashkëkohore, si banesa akomodimi për turista, lokale, barrestorante, diskoteka, hotele, objekte të shërbimit social-kulturor, krijojnë më së miri kushtet e zhvillimit të një aktiviteti social dhe ekonomik për turizmin kulturor.

Objektet monumentale të kulteve, na ofrojnë mundësinë e vizitueshmërisë dhe njëherazi realizimin e riteve fetare përkatse, por ekziston mundësia edhe e shfrytëzimit të tyre për akomodimin e turistëve.

Peizazhi urban i kësaj trashëgimie kulturore na ofron mundësi përdorimi jo vetëm në aspektin vizual, por edhe të organizimit të eskursioneve për zbavitje, për njohjen e faunës dhe florës dhe alpinizëm etj.

Aktualisht në rolin e materialit promovues kanë qenë vetëm botimet lidhur me objektet e Trashëgimise Kulturore të zonës së bregut Jonian, në revistat shkencore "Monumentet" të I.M.K, "Iliria" të Institutit të Arkeologjisë dhe "Etnografia" të Institutit të Kulturës Popullore.

Në të ardhmen me zhvillimin e turizmit kulturor në këtë zonë lind nevoja e përgatitjes dhe botimit të guidave turistike për objektet monumentale të veçanta dhe komplekse që përfshijnë gjithë zonën në studim. Për këtë qëllim do të shërbejnë ekspozitat, panairet e ndryshme, spotet publicitare në radio-televizion dhe ngritja e agjensive turistike në këtë zonë, etj. Qendrat arkeologjike më të spikatura, që ndodhen në zonën e bregdetit Jonian janë:

Qyteti Iliri Amantia, në fshatin Pllloçe, kalaja në fshatin Mavro, kalaja në fshatin Kaninë, kalaja e Himarës në qytetin e Himarës. Kalaja e Gjon Boçarit në fshatin Tragjas, kalaja e Porto Palermos, kalaja e Ilias në fshatin Vuno, kasteli në fshatin Qeparo, Tuma në fshatin Tragjas, Qyteti antik Buthrot në Butrint, Qyteti antik Foenike në fshatin Finiq, Kalaja e Cukës së Atojt në fshatin Ciflik, Kalaja në malin Ilias në fshatin Malcan, Kalaja në fshatin Borsh, Kalaja në fshatin Kalivo, Kalaja në qytetin e Delvinës, Kalaja e quajtur Bardha në veri të fshatit Borsh.

Pjesa më e madhe e këtyre qendrave në gjendjen e sotme rrethohen me një peizazh urban, me parqe natyrale që kanë një vegjetacion shumë të pasur. Përgjate dekadave janë realizuar gërmime arkeologjike dhe punime restaurimi, por që nga 1990 në to nuk është ndërhyrë më dhe si rrjedhoje, nga mos mirëmbajtja gjendja e tyre është përkeqësuar.

Në to kërkohet që në të ardhmen të realizohen, si gërmimet arkeologjike dhe ndërhyrjet restauruese me qëllim që jo vetëm të përmirësohet gjendja tekniko-estetike, por dhe ajo e vizitueshmërisë duke ju përshtatur më së miri zhvillimit të turizmit kulturor.

Në këto site duhet të ndiqet një politike promocionale e komunikimi më e specializuar, për të nxjerrë më në pah rëndësinë dhe vlerat e këtyre siteve.

Në zonën bregdetare Joniane një vend të rëndësishëm në zhvillimin e turizmit kulturor, zënë dhe qendrat historike ekzistuese, por dhe ato që po studjohen për t'u shpallur si të tilla. Në gjendjen e sotme si qendra historike të shpallura janë: qendra historike e Vlorës dhe e fshatit Tragjas. Në zonën që kemi në studim, ndodhen shumë qendra të banuara, të cilat plotësojnë kushtet për t'u shpallur në të ardhmen, si qendra historike siç janë:

Qendrat e banuara në: Lagjja e banuar në kalanë e Kaninës, Palas, Dhërmi, Vuno, lagja e banuar brenda kalasë së Himarës, Qeparoi, Borshi, Lukova, Livica, Kamenica, Dhrovjani dhe Saranda.

DOKTORATURË

Këto qendra të banuara paraqesin një interes të veçantë sepse karakterizohen nga një tipologji ndërtimore dhe infrastrukturë me specifika të veçanta për zonën në studim.

Peizazhi urban që rrethon këto qendra është shumë piktoresk dhe karakterizohet nga një terren i thyer malor dhe pozicioni i tyre në pikën më të lartë të terrenit na jep një siluetë shumë interesante. Në gje-ndjen e sotme janë të prekura nga emigracioni dhe lëvizjet demografike drejt qyteteve të mëdha. Në aspektin e infrastrukturës paraqiten me mangësi të dukshme, ndërsa në aspektin social-ekonomik karakterizohen nga një zhvillim i ulët.

Në të ardhmen, pasi këto qendra të shpallen qendra historike duhet të investohet për rregullimin e infrastrukturës dhe hartimin e projekteve për rivitalizimin e ndërtimeve për të krijuar kushtet për zhvillimin e turizmit kulturor në to dhe njëkohësisht në zhvillimin social-ekonomike të komunitetit të këtyre qëndrave.

Edhe muzeumet janë institucione shumë të rëndësishme në shërbim të shoqërisë dhe në veçanti të turizmit kulturor dhe të zhvillimit të tij. Në zonën në studim, në gjendjen e sotme ndodhen një numër i vogël muzeumesh, të cilët janë të përqendruar vetëm në dy qytetet kryesore të zonës, në Vlorë dhe Sarandë. Në qendrat e tjera të populluara të zonës ka patur disa muze, që tani nuk ekzistojnë më.

Në Vlorë janë muzeumi historiko-etnografik dhe i pavarësisë, ndërsa në Sarandë është muzeu historiko-etnografik dhe në Butrint është muzeu arkeologjik i Butrintit.

Vizitueshmëria në këto muzeume vitet e fundit ka rënë dukshëm, me përjashtim të muzeut të Butrintit, i cili ka vizitueshmëri të lartë. Çdo grup vizitorësh që shkon në Sarandë, pasi viziton Butrintin e mbyll vizitën me muzeun arkeologjik të tij. Në muzetë e tjerë gjendja e eksponatëve (koleksioneve) nuk është e një cilësie të duhur, si nga pikëpamja e ekspozimit estetik ashtu dhe përmbajtjes, prandaj në të ardhmen duhet të parashikohet ngritja e muzeumeve të rinj në disa qendra banimi tradicionale dhe rinovimi i atyre ekzistus për të pasqyruar më së miri historinë, kulturën, etnografinë dhe gjendjen ekonomiko-shoqërore të këtyre qendrave të zonës në studim.

Tipologjia arkitektonike e muzeumeve ekzistues përputhet dhe me funksionin e muzeumeve dhe në të ardhmen ky kriter duhet të dominojë edhe në muzeumet e rinj, që do të realizohen p.sh. muzeumi historiko-etnografik në Vlorë është përshtatur në një banesë karakteristike dhe muzeu arkeologjik në Butrint është vendosur në mjediset e kalasë mesjetare.

Në gjendjen aktuale ka munguar një politike promocinale dhe komunikimi për muzet ekzistuse, gjë e cila në të ardhmen duhet të shoqërohet me promovimin e vlerave dhe funksionin që ata luajnë në zhvillimin endogjen të komunitetit social, si dëshmi që ruhen, si dhe mesazhin kulturor që ato japin.

Deri në vitin 1990 disa objekte të Trashëgimisë Kulturore të një rëndësie të veçantë në zonën që kemi në studim, kanë qenë brenda zonave ushtarake dhe si rrjedhojë ka qenë i pamundur jo vetëm shfrytëzimi i tyre, por dhe mirëmbajtja e specializuar e këtyre objekteve.

Nga këto mund të veçojmë këto objekte kulturore të shpallura monument kulture:

Manastiri i Zvërnecit, Kalaja e Ali Pashës në Porto-Palermo, Kalaja e Likursit, Kisha e 40-shenjtorve, Manastiri i Demës, të cilet në gjendjen aktuale janë në gjendje të lira. Nëdisa prej tyre gjatë viteve '90, janë bërë ndërhyrje restauruse të pjesëshme.

Këto objekte kulturale na ofrojnë jo vetëm vlera historike, arkitetktonike, natyralistike, por dhe mundësi për një rivitalizim për zhvillimin kulturor në këto zona.

Trashëgimia kulturore e materializuar më tepër në monumentet kulturore që ndodhen në zonën e bregdetit Jonian, përmban vlera të spikatura jo vetëm historike, arkitektonike, urbanistike dhe artistike, por dhe mundësi të mëdha për përfshirjen e tyre në zhvillimin e turizmit kulturor në këtë zonë.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

The Cultural Heritage helps the Cultural turism in Ionian Seacoast

In our country during these last decades has been prepared a special strategy, which attempts the protection, conservation and restoration of cultural heritage, but it is left apart the integration of this heritage, which helps the cultural tourism.

In the last years in our country is noticed a growth of tourism in general and particularly in the Ionian seacoast. In the conditions it is now the touristic activity does not grant the conditions of a true cultural tourism, which means: to take advantage of cultural heritage, natural resources, mountainous and coastal landscape, water resources, the flora and fauna, and the historic-ethnographic resources.

The cultural tourism in the future aims to take an important part of the national and regional tourism and to be developed especially in the Ionian coast.

In the economic aspect the infrastructure in the inhabited centers of the Ionian coast is in very bad conditions. The inhabitants here are few, as a result of the economic emigration, so the development of the cultural tourism aims to bring them back, to increase the economic level and create new possibilities to get employed.

The tourists or the visitors, staying one or more days in a historical center, visiting places of cultural heritage, spend money that goes in the pockets of their owners, municipalities or state that show interest for the values of Cultural Heritage. Including the objects of cultural heritage and the urban landscape that surrounds them in the Ionian Sea in the Cultural tourism will grow the participation and interest of the population in the protection of this unrepeatable heritage.

Dr. Ark. Latif LAZIMI

DO NOT COPY

i Lisit, Akrolisi, Ardaksani dhe zona përreth.

Në survejimin e realizuar nga Filipi, në prag të luftës, dhe më pas në vëndosjen e trupave ushtarake, vërejmë se ai nuk është larg qytetit. Kjo situatë pasqyrohet mjaft qartë në kohen e përgatitjes së sulmit ndaj Lisit dhe në shpërndarjen e forcave ushtarake, ku: peltastët i vendosi në fushë, ndërsa ushtarët e armatosur lehtë i nisi drejt kodrave. Më pas përmendet një grup ushtarësh të fshehur nga ana e tokes, të cilët realizuan pushtimin e Akrolisit i cili ishte lëshuar me parë nga ushtarët ilirë. Kur forcat ilire e ndjenë dredhinë maqedonase, ato u rikthyen menjëherë për të mbrojtur Akrolisin, i cili tashmë ishte pushtuar nga maqedonasit. Nga ky pasazh, kuptohet se distanca e fushës së betejes me Akrolisin, ku ishin dislokuar peltastët me atë ku ndodheshin trupat nga ana e tokës është shumë e madhe. Kjo flet, njëherëzi se vendndodhja e Filipit gjatë përgatitjes se luftimeve ishte shumë afër qytetit të Lisit, nga ku nuk është e mundur të vërehen lumenjt si Erzeni apo Mati. Kjo situatë mendojmë se përjashton paraprakisht identifikimin e lumit Ardaksan, për të cilin flet Polibi, i cili ndodhej pranë qytetit të Lisit, me lumejt e mësipërm.

Sipas burimeve historike të kohës[19], të dhënat e grumbulluara për lumin Drin na japin një tablo të tillë: - Plini sqaron se "*... mbas Epidaurit janë qytetet që gëzojnë të drejtën romake, Rizini, Akrui, Butua, Olcini, më parë i quajtur Kolkin, sepse u themelua prej kolkasve; lumi Drin, dhe mbi brigjet e tij një qytet që gëzon të drejtën romake, Scodra, tetëmbëdhjetëmijë hapa larg detit... Në bregdet është kepi i Nymfeut, qyteti i fortifikuar Lis, me të drejtë romake, që është larg njëqindmijë hapa nga Epidauri*". Ndërsa Straboni shkruan se "*...pas bregdetit të adrianëve dhe plerejve vjen gjiri i Rizonit edhe qyteti Rizon, si dhe qytete të tjera të vogla. Vjen edhe lumi Dril, i cili thellë nga lindja arrin gjer në Dardani*"[20]. Nga Livi mund të veçojmë këtë pasazh "*... Shkodra, e cila ishte pika më me rëndësi e luftës, sepse Genti e kish zgjedhur këtë si fortesë të gjithë mbretërisë, duke qenë vendi më i fortë i labeatëve dhe i vështirë për t'u afruar. Ky qytet rrethohet prej dy lumejsh; prej Klausalit (Kiri), që rrjedh nga ana lindore, pranë qytetit dhe në perëndim prej Barbanës (Buna), lum që buron nga liqeni Labeat. Të dy këta lumenj derdhen në ujrat e lumit Oriund (Drini?), i cili buron nga mali Skord dhe, pasi përmbledh edhe ujrat e lumenjve të tjerë derdhet në detin Adriatik*".

Siç vihet re, nga të dhënat e mësipërme, lumi Drin, për periudhën në fjalë nuk kalonte në qytetin e Lisit, por në Shkodër e më pas në Adriatik. Sipas Livit, Drini në kohën e sundimit të Gentit njihej me emrin Oriund, ndërsa lumi që kalonte pranë qytetit të Lisit, përshkruar nga Polibi, ishte Ardaksan. Mirëpo dihet se lumi i Lezhës (flumen Lissii)[21] përmendet shumë vonë në dokumentacionin historik, që lidhet me datën 7 janar 1338. Ndërrimi i shtratit të Drinit

DO NOT COPY

Shënime

1 Polib. II, 12, 3.
2 Polib. III, 16, 3
3 F.Prendi, K.Zhegu, *Lisi në dritën e të dhënave të reja arkeologjike*, " Monumentet " 2, 1971. f. 16-17, po ata, *La ville illyrienne de Lissus, son origine et son systeme de fortifications*, Iliria II, 1972, f. 219- 238.
4 Polib, VIII, 13, 3
5 Polib, VIII, 13, 6
6 Caes. *Belli Civilis*, III, 26, 4.
7 F.Prendi, K. Zhegu, vep. cit... f. 17.
8 Po aty.., III, 29,1, 2, 3; III, 40, 5.
9 Polyb...VIII, 13, 6, 7, 8.
10 Po aty, VIII, 6
11 A.Baçe, *Skelat grykëlumore të Adriatikut gjatë mesjetës, shek. XI-XV*, "Monumentet" 1986, 1, f. 25
12 Po aty, VIII, 8.
13 Anna Comn. na njeh me variantin e emrit χαρζανης, të cilin e lokalizon me lumin e Erzenit, afër Tiranës. Shih: Tabula Imperii Romani (Naissus-Dyrrahachion-Scupi-Serdica-Thessalonike), Ljubljana, 1976, f.17. Mendim të njejtë me Ana Komnenën për identifikimin e këtij lumi me Erzenin ka dhe Tomaschek, Realencyclopadie der classichen Altertumswissenschaft (Stuttgart), II, 611.

në mesjetë si pasojë e ndryshimeve gjeomorfologjike në këtë kohë krijoj një degë të re të tij të njohur, si *Drini i Lezhës*[22], i cili me sa duket shrytëzoi shtratin e vjetër të lumit Ardaksan (Gjadrin e sotëm) që përmend Polibi, sepse sipas mendimit tonë lumi i sotëm i Drinit të Lezhës, i cili përfundimisht ndahet në dy degë, në Drinin e Lezhës dhe Bunës, në shekullin XIX, përshtatet mjaft mirë me kompleksin gjeografik të përshkuar nga Polibi si në qytetin e Lisit ashtu dhe për lumin *Ardaksan*. Njëkohësisht, në afërsi të qytetit të Lezhës, nuk eksizton një lum tjetër që derdhet në detin Adriatik.

DO NOT COPY

14 H.Kiepert, Formae orbis antiqui (Berlin 1893-1914), XVII, 3.
15 Th. Ippen, *Skutari und die nordalbanische Küstenebene*, Zur Kunde der Balkanhalbinsel 1, Reisen und Beobachtungen, Helf 5 f. 62
16 Th. Ippen, po aty, f. 62
17 C. Praschniker und A. Schober, *Archäologische Forschungen in Albanien und Montenegro*, Akademie der Wissenschaften in Wien, Schriften der Balkankommission, Antiquariche Abteilung, Helf VIII, Wien 1919, f. 25
18 Ilirët dhe Iliria te autorët antikë, Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë, vol. I, Tiranë, 1965.
19 Anonimi i Ravenës, COSMOGRAPHIA, IV,16. Nëpër këto Dalmaci rrjedhin shumë lumenj, në mes të cilëve ato që quhen: **Salon, Margus, Drinus** etj,. Njëkohësisht më tutje ky autor përmend me këtë emër një stacion rrugor *Drinum*, lokalizuar në Zvornik pranë lumit Drin. Stefan Byzantini, DE URBIBUS ET POPULIS, Pas Rizonit është qyteti Lis, Akrolisi dhe Epidamni, themelim i kërkyrasve, i cili tani quhet Dyrrah.... Pastaj lumenjt Dril dhe Lao. Plini, NATURALIS HISTORIAE, III, 22 e 26; Straboni, GEOGRAPHICA VII, 7,8; Livi, AD URBE CONDITA, XLIV, 31,4.
20 Straboni, VII,8
21 K. Jireçek, *Scutari und sein Gebiet im Mittelaltes*, "Illyrisch- albanische Forchungen" Munchen- Leipzig, 1936, f. 117.
22 Gjeografia Fizike e Shqipërisë, pjesa e parë f. 232.

DO NOT COPY

The identification of Ardaksan River

About the Illyrian-Roman war and the other events that took place in the Illyrian hider land, a very important resource for the acquaintance of the general situation of this period is even the written work of Poliby « *Historiae* ». Here is mentioned directly or indirectly, the town of Lisus, for the important role that it has during the Macedonian-Illyrian war.

Polibis, in its description of the position of the town of Lisus separates clearly the tow main parts of the town, that are restricted by the sea and earth where one part of the town is washed by Adriatic sea, near which is *the Ardaksan* river, while behind it there were some reforested valleys.

Jul Caesars, in his work « *Belly Civilis* » mentions a harbour named *Nymphet,* situated 3000 steps far from Lisus, in which found shelter the fleet of M. Anthony during the civil war, identified with the present name of Shengjin. In this passage, is also mentioned the welcoming reception that the council of roman citizens that were in Lisus, made to Anthony. He was accompanied with three legions of veterans, one legion of recruits and 800 knights. He deployed in Durres a ship named *« pantone " which* was burned later from Pompous' son, in his efforts to occupy Lisus and Oricum. Anthony settled his ships not only in Nymphet harbour but also even in Lisus, fact that opened a broad discution for the existence of another harbour in this town. It is still not clear if it was a river harbour or a sea harbour.

Even though the studies that will be undertaken will be not only in the field of archaeology but even in other fields, so as to have more important information for this important and very interesting data.

While about the identification of the river Ardaksan, which according to Polib is near Lisus exist many opinions. Ana Komnena and Tomaschek identify this river with the today Erzen, while Kiepert thinks that it is the river Mat .Th Ipen during its travelling from Lezha to Kruja, Tirana and Ishem, thinks that in the central part of this lowland, during the year 213 B.C Philip the Vth of Macedonia raised his camp during his marching to Lisus. Having in consideration the position of Philip's army, Kieper and Tomaschek thought that the river Ardaksan is the today Erzen based on the similarity Ardazanus-Arsen, but Ippen doesn't agree with that, he thought that today Mat is the river Ardaksan in Antiquity.

Later on Prashniker and Shober taking in consideration Ipen's data for this problem thought that the river of Mat may be identified with the river of Ardaksan. They came to that conclusion based to the movement of Fillip's army, which was coming from southeast to Lisus. In the book « Illyrians and Iliry of antic authors » the river Ardaksan was identified with the today Mat. Having in consideration this data, mainly based in the itinerary of the Macedonian army and the tactics used by Philip to occupy the town of Lisus we can say that the position of the river Ardaksan mentioned by these authors create a contradiction with the data and the historical sources, because near the town of Lisus do not pass the rivers of Erzen and Mat.

According to Liv, the river of Drin, during the time of Gent reign was known with the name Oriund, while the river that passed near the town of Lisus described by Polibs, was Ardaksan. It is also wellknown that the river of Lezha (flumen Lissii), is

mentioned very late in the historic documentation, that is on the 7th of January 1338. The river of Drin during the middle ages, because of the geomorphologic changes, in that time created a new branch, known as Drin of Lezha, which made use of the old bed of the river Ardaksan (today Gjader).

We think that the river Drini i Lezhes suit very well to the geographical complex described by Polibs, either for the town of Lissus or for the river Ardaksan. For more, near the town of Lezha is not passing any other river that flows in the Adriatic Sea.

Luan PERZHITA

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Skënder MIHALÇKA

Afreskat në kishën e Shën Thanasit në Pecë viti 1525

Veprimtaria ndërtimore dhe artistike në vendin tonë, përfshin lëndën e artit në teknikat dhe stilet e ndryshme si dhe shquhet për zhvillimin kohor të saj. Ky aktivitet artistik do të lidhet me dispozitat psiqike dhe fizike të vitalitetit, që karakterizon popullin tonë mbështetur në traditat e vjetra.

Në artin e kultivuar dhe të zyrtarizuar, siç ishte arti fetar, në epokën pas bizantine, do të zhvillohet një aktivitet artistik jo dhe aq modest[1].

Studiuesit e çdo vendi në Ballkan kanë evidentuar veprat artistike në monumentet dhe piktorët[2]. Nga periudha pasbizantine në vendin tonë gjatë shek. XV-XVI do të ruhen disa kisha dhe fragmente afreskash të cilat dëshmojnë për ekzistencën e zhvillimit të pandërprerë të artit[3].

Me gjithë këto, kohët e fundit janë zbuluar gjatë restaurimeve në kishën e Shën e Premtes, në rrethin e Lezhës, afreska të epokës bizantine të shek. XIII dhe afreska pas bizantine të shek. XV[4].

Nga kjo periudhë ruhet kisha e Shën Thanasit



Fig.1



Fig.2. Shën Thanasi, Pecë. Planimetria, prerje gjatësore.

në fshatin Pecë të Delvinës themeluar në vitin 1525[5] në të cilën do të mundohemi të evidentojmë disa nga vlerat artistike të afreskave, vepër e piktorit të talentuar Ilia Llongovitit. Kisha është në funksion të qimitrit të fshatit dhe i atribohet Shën Thanasit të Aleksandrisë, këtij filologu të ndritur të kishës greke dhe ballkanike. Ndërtesa e kishës është e tipit njënefëshe[6] dhe e mbuluar me çati dy nivelëshe (foto 1- foto 2 plan). Ajo është ndërtuar me gurë dhe lidhur me llaç gëlqere. Interieri i errët ndriçohet vetëm nga dera kur hapet dhe flaka e qirinjve duke

DOKUMENT



Fig. 3

krijuar një atmosferë mjaft intime (foto 3 grafike).

Piktura e Pecës nis me traditat më të vjetra të artit në monumentet e shek. XIII-XIV të vendit tonë[7], prej nga do të marrë udhë ky art deri në këtë periudhë që po studiojmë[8].

Stili i pikturës është popullor në traditën artistike sepse ambjemti i ashpër, kërkesat e klientelës dhe niveli intelektual pasqyrohen në këtë kishë fshatareske, që ndodhet larg qendrave artistike dhe qyteteve. Vihet re ndryshimi i shpejtë i shijes artistike duke filluar nga fraktura dhe ritmi. Vizatimi, forma, kompozimi, ngjyra realizohen nga frymëzimi i vetë piktorit në mjedisin dhe në kushtet specifike. Pa dyshim pikturimi i kishës bëhet në konditat e veçanta politike dhe shoqërore. Nga mbishkrimi, mbi portën kryesore të kishës, mësojmë se në realizimin e saj kanë marrë pjesë një rreth i ngushtë njerëzish nga elita e fshatit Pecë, si prifti Dhimitri me të bijtë, klitorë dhe ideatorë që kanë dhënë mendimet e tyre teologjike për paraqitjen e pikturës, në zgjedhjen e tematikës dhe pikturimin e shenjtorëve, që adhurohen më shumë në këtë kohë[9]. Por nismën e realizimit të veprës së artit do ta ketë artisti me imagjinatën dhe mjetet shprehëse personale, që do ta bëjnë të pëlqyeshme në syrin e besimtarëve.

Kjo tregon se kemi një mjedis të rregulluar dhe një organizim kishtar të mirë të famullisë. Fshati Pecë, në këtë kohë, është i permendur për zhvillimin ekonomik dhe kulturor në këtë krahinë.

Në të përgjithshmen e dekoracionit, vihet re thjeshtësia dhe qartësia që karakterizojnë afreskat me lidhjet ikonografike, në harmonizimin e kompozimeve dhe personazheve nëpërmjet stilit të lirë të veprës. Ciklet paleologe vendosen në zonën e sipërme, kurse në regjistrin e poshtëm pikturohen shenjtorët në këmbë. Figurat dhe skenat ndahen me bordura të kuqe dhe vija të bardha, sipas "sistemit maqedonas". Këto bordura nganjëherë rrethojnë në formë harku figurat si ajo e Shën

DO NOT COPY

Mëhillit dhe Shën Gjergjit, por duke i zbukuruar edhe me kapitele (foto 4). Skenat zhvillohen në formë katërkëndëshe, në drejtim horizontal si një frizë duke u ngushtuar në lartësi çka tregon se këto pano imitojnë stilin e ikonave portative në të cilat mungojnë planet dhe elementët morfologjikë, që përbëjnë kompozimin e një afresku. Por nga njëra anë dhe, çka është më e rëndësishme është parapëlqim i artistit për të evidentuar figurat e shenjtorëve strategë të cilët dominojnë interierin e kishës.

Pikturimi i shenjtorëve kalorës, me lëvizjet e gjalla dhe të natyrshme, me uniformat e mbërthyera pas trupit dhe armët që mbajnë në duar krijojnë një gjendje të tensionuar sa dhe epike.

Në ndërtesën drejtkëndëshe të kishës, ciklet ikonografike dhe shenjtorët unifikohen në vazhdimësi dhe kronologjikisht nga fillimi dhe përfundimi i dekoracionit në pozitat dalluese që kanë. Ato paraqiten sipas tregimeve evangjeliste të Dhjatës së Re. Në zonën e sipërme duke filluar nga hapësira e altarit, në krahun jugor me gjithë degradimin e afreskave dallohet pikturimi i një profeti deri në tors,



Fig.4

që mban në duar shkrimin e hapur me drejtim nga cikli i Shën Mërisë, kurse poshtë është vendosur figura madhore e një hierarku me qëndrim të përkulur dhe adhurimi sipas shërbesës liturgjike.

Deisisi me Krishtin dhe Joanin janë pikturuar në pozitë dalluese në murin jugor afër ikonostasit, gjithashtu sipas shkallës hierarkike deri në bashkimet e mureve paraqiten shenjtorët në madhësi natyrale që shkelin në tokë. Në radhën e tyre dallohen strategët si Stratillatët, Minai si dëshmues, Shën Mitri dhe Shën Gjergji si luftetarë, kryeëngjëlli Mihal si hakmarrës dhe Shën Thanasi i Aleksandrisë si padron i kishës.

Kompozimet liturgjike, Shestia dhe Metamorfoza, janë vendosur përkundrejt njëri-tjetrit në timpanin lindor dhe perëndimor të mureve duke ruajtur raportet hapësinore të dekoracionit. Në fasadën lindore në ambjentin e altarit, platitera dominon absidën e përgjysmuar dhe në të njëjtin plan janë pikturuar Etërit e kishës. Për mungesë të hapësirës nuk është pikturuar Kungimi Apostujve. Në anën e protezisit është vendosur deri në tors figura e Krishtit me kokën e përkulur nga vdekja dhe duart e kryqëzuara.

Dy nga skenat që i kushtohen jetës së Shën Mërisë, si Lindja e Krishtit dhe si e dyshimtë skena e dytë, Mospranimi i Dhuratave, e pa identifikuar nga prishja e suvasë ndodhen në zonën e sipërme të murit jugor.

Cikli I vuajtjeve të Krishtit, reduktohet në tre skena në fasadën e murit verior, me temat Rruga për në kalvar, Kryqëzimi dhe Ngritja nga varri.

Me këtë ndërthurje ikonografike, piktura e Pecës na jep modelin e një ansambli të thjeshtë të realizuar në fillim të shek.XVI me idetë, kërkesat dhe shijen që i përshtatet kësaj periudhe të pandarë nga influencat e paraqitjes së figurave të shenjtorëve në vendet fqinje si në Maqedoni[10]. Stili pasbizantin i pikturës do të jetë i përbashkët, por edhe i ndryshueshëm si në rastin e Pecës, i krahasuar me monumentet e pasura të kësaj zone ku dallohet vepra e piktor Ilia si parësor, por edhe i njohur jashtë kufijve të vendit si në Greqi[11].

Afreskat e Pecës karakterizohen edhe nga thjeshtësia e teknikës dhe të procedimit të pikturës. Në paletën e artistit përdoret e verdha okër, e

DO NOT COPY

kuqja e ndezur, vishnja, bluja azurit dhe më pak e zeza, tonalitetet e të cilave përzihen me të bardhën e gëlqeres duke krijuar nuanca piktorike, si tonet e errëta, gjysëmtonet dhe ndriçimet në procesin përfundimtar të ekzekutimit të pikturës.

Vizatimi linear dhe forma janë të lidhura me njëra-tjetrën të cilat modelojnë trupat, portretet, palëzimet, objektet mjedisore dhe skenografinë. Tonalitetet e ngjyrave përgjithësisht i përshtaten fizionomisë së fytyrave, veshjeve, tipave dhe qëndrimeve duke zbërthyer kuptimin e subjekteve në atmosferën e dhënë. Përgjithësisht, kështu operon piktori në të gjitha afreskat, ku theksohet grafizmi i drapërive, kërkesa për detajet ose kalimet ritmike të vijave që modelojnë flokët e errëta ose të bardha si tek portreti i Shën Minait ose kafeja e gështenjtë te Shën Mitri. Duke ruajtur këtë linjë të teknikës, karnacioni përsëritet në të gjithë pikturën dhe elementët e veçantë duke filluar me bashkimin e ngjyrës kafe të errët, pak tek e blerta ne gjysëm tonet dhe e verdha okër e ndriçuar me të bardhën.

Më qartë, teknika dallohet te portreti i ngjeshur i Krishtit, tonalitetet e ngrohta të Shën Mërisë ose tek ndriçimet me penelatat e buta tek Shën Varvara ose më të theksuara te drita që ndriçon shkëmbijtë tek Metamorfoza.

Bluja e azurit integrohet në sfondin e kompozimeve dhe të shenjtorëve duke dalluar siluetat dhe aurolat me përmbajtje të qeta ose dinamike si tek Deisisi, Stratillatët, Shën Minai, Shën Dhimitri, Shën Gjergji etj. Në tonalitetin e bardhë të kalit të Shën Gjergjit dhe së kuqes të pelerinës organizohen duke u shpërndarë në variacionet e ngjyrave në figura të tjera, si tek e bardha e iskitios së Krishtit të vogël në absidë, e kuqja vishnje në mantonë e Shën Mërisë tek Lindja. Variacione të larmishme i gjejmë tek veshjet, ornamentika zbukuruese e tyre nëpërmjet goditjes së penelit tek materializimi i armëve, tek peizazhi dhe malet ku e kuqja e errët modelon thellësite dhe çarjet e shkëmbinjve. Ngjyra gri e maleve ose okra e ndriçuar krijon siluetat në sfondin e qiellit ku mbizotëron e kaltra. Në afreskat e Pecës bota ireale pikturohet, nga ekzistenca e figurave biblike dhe hapësirës abstrakte, ku gjithësia mishërohet brenda mureve të kishës që buron në fantazinë popullore dhe mësimeve të Ungjillit. Sipas traditës dhe zakonit piktori i jep frymën veprës, e afron atë më afër besimit të njerëzve duke luajtur me imagjinatën krijuese dhe mjeshtërinë e ekzekutimit. Kjo vihet re edhe më mirë në kompozimin Lindja e Krishtit sepse skena përmban elemente popullore të komunikueshëm në një mjedis, pothuajse natyror dhe familjar të ngrohtë.

Përmbajtja, megjithëse fetare e jetës së shenjtorëve si Shën Mitrit,Shën Gjergjit dhe Shën Thanasit të pikturuara sipas modelit të ikonave portative, por në teknikën e afreskave i bëjnë shenjtorët mjaft popullorë dhe të adhurueshëm të cilët evokuojnë ngjarje që përputhen me bëmat e luftëtarëve dhe të ideve që qarkullonin në atë periudhë.

AFRESKAT NË FASADËN LINDORE DHE NË ALTAR

Rilevimi I

Në përshkrimin që do të bëjmë sipas programit ikonografik, çka përcaktohet në vrojtimin e kishës, janë shfaqjet dhe figurat që pikturohen në absidë dhë në muret e poshtme të altarit. Pastaj episodet

Ril. I *Afreskat në fasadën lindore*



DO NOT COPY



Fig.5

nga jeta e Shën Mërisë, jeta e Krishtit dhe së fundi figurat e shenjtorëve në naosin e kishës.

Platitera (foto 5) përfshin të gjithë absidën e përgjysmuar e cila pikturohet sipas tipit të Vllahernës. Në gjoksin e saj mban Krishtin e vogël të veshur me iskitio të bardhë që përshkohet nga ajri. Paraqitja e Shën Mërisë pikturohet si gjithëpushtuese, me duart e ngritura lart dhe të hapura prej nga varen palat e rënda të mantelit. Në fizionominë e fytyrës theksohen vetullat e errëta, të harkuara lart dhe sytë e afruara të cilat shprehin habinë. Në trajtimin e portretit vihen re karakteristikat arkaike të tipit të saj.

Ndryshe paraqitet Krishti i vogël me duart e ngritura dhe që i mban të mbyllura lehtas tek gishtërinjtë si për bekim. Krishti është i pikturuar në sfondin e bardhë të një pëlhure dycepëshe. Fizionomia e fytyrës ka frymëmarrje ngazëlluese dhe shprehëse që buron nga misioni liturgjik.

Etërit e kishës zënë pozita hierarkike në zonën e absidës të kompozuar dy e nga dy me vështrimin në qendër të Platiterës. Si zakonisht, ata mbajnë në të dy duart shkrimet e shenjta me fjalët e Ungjillit. Pikturohen sipas prototipeve ikonografike, të vjetër dhe të rinj, me shprehje devotshmërie dhe solemniteti. Janë të veshur me kostume peshkopale të zbukuruar me kryqe dhe shirita që kryqëzohen me njëri-tjetrin duke krijuar një ornamentikë të pasur. Ndër këto evidentohet figura e Shën Kirilit(foto 6).

Në zonën e protezisit qëndron Krishti para kryqit dhe sipas ritit, që zë një pozitë të rëndësishme në bekimin që bëhet për parapërgatitjen e ceremonive fetare (foto 7).

Piktori me sa duket njeh historinë e vjetër të shenjtorëve si atë të Shën Terinit, i cili u martirizua në teatrin e Butrintit në kohën e Perandorit Dioklecian (283-305) në fushatën që bëri ky i fundit kundër përhapjes së krishtërimit në Epir[12].



Fig.6

DO NOT COPY



Fig.7

Perandori urdhëroi që Terinin ta shqyenin bishat e egra por ato u shtrinë te këmbët e tij duke e lepirë dhe pastaj u larguan. Populli brohoriti për këtë mbrekulli duke e shpallur si njeri të shenjtë. Kështu ka ndodhur edhe me profet Danielin, i cili i shpëtoj martirizimit.

Shën Terini adhurohet nga popullsia e Korfuzit si shenjtor.

Ka të ngjarë, që Shën Terini të ketë vdekur në moshë të re, se kështu është pikturuar për herë të parë në kishën e Pecës dhe si e vetmja figurë që nuk është paraqitur në kishat e Shqipërisë.

Figura e tij është pikturuar në kollonën e ikonostasit, në ambjentin e altarit me shikim nga absida. Ai mban një qëndrim statik me këmbë pak të hapura të mbështetura në tokë, njërën këmbë e mban të përkulur gjithë elegancë. Është i veshur me rroba të kushtueshme me atributet e xhiakonikonit. Pelerina i mbulon krahët dhe i mbërthehet në gjoks me një gur të çmuar. Palat i përshkruajne bukurinë fizike të trupit. Me njërën dorë mban kryqin e ngritur lart, kurse pëllëmbën e dorës tjetër e mban të hapur në pozicion dëshmimi. Fytyra e bukur ovale rrethohet nga aurola dhe në kokë mban një kurorë princërore trecepëshe të zbukuruar me gurë. Flokët e mbledhura prapa pikturohen me ngjyrë të kaltër që ndahen nga viza të bardha duke formuar romboide që stilizojnë format e flokëve. Fisnikëria dhe hijeshia janë mishëruar në afreskun e Shën Terinit (foto 8).

Sipas liturgjisë në hapësirën e timpanit lindor



Fig.8

zhvillohet Shestia që përfshihet në kufirin e dy mureve verior e jugor të zonës së altarit, deri në kulmin e çatisë. Motivi ikonografik dhe specifik njihet në ikonografinë bizantine dhe përsëritet sipas një varianti në pikturën e Pecës. Skena zhvillohet në planin e parë në një moment dramatik dhe përfshihet nga grupimet e apostujve të ndarë në dy grupe anash saj. Në njërin prej grupeve rrethuar prej apostujve qëndron Shën Mëria dhe afër saj Shën Pavli me këmishën e grisur nga dhembja. Gjestet e Shën Mërisë, me duart e ngritura lart në qiell dhe mantelin e purpurt të shpalosur nga drapëritë, flokët e shpupuritur dhe të lëshuara, shprehin shqetësimin e pamasë të largimit përfundimisht të birit të saj në qiell.

Ritmi linear vizaton personazhet të cilat kanë zgjatur trupat dhe duart në drejtim të qiellit. Ndjenjat patetike pushtojnë qënien e figurave të shenjtorëve nga vetë përmbajtja e ngjarjes. Në njërin prej grupimeve të kompozimit shquhet figura e apostullit të ri, i cili tregon me gisht Krishtin në qiell. Kjo figurë është një prej afreskave më të mrekullueshëm të realizuar në këtë skenë dhe në të gjithë ansamblin

DO NOT COPY

e kishës. Ndjeshmëria shprehet në fytyrën e të riut që harmonizohet me lëvizjet elegante të trupit. Peizazhi i thatë pa pemë, terreni i errët dhe silueta e malit në plan të dytë përcaktojnë karakteristikat e këtij kompozimi. Krishti brenda diskut ngrihet lart në sfondin e qiellit i shoqëruar nga dy ëngjëjt që e mbajnë. Në fundin e murit dallohet, megjithëse mjaft e prishur, skena e Johanit që del nga goja e peshkut kurse dekoracioni me rizat shumëpalëshe përshkojnë horizontalisht poshtë fasadën e murit.



Fig.9

AFRESKAT NË FASADËN JUGORE

Rilevimi II

Në zonën e sipërme të murit jugor është pikturuar Lindja e Krishtit (foto 9). Kompozimi i afreskut mbështetet në shkrimet evangjeliste të liturgjisë bizantine. Ashtu siç përshkruhet, Shën Mëria e lindi Krishtin në shpellë, i cili ngrohet nga fryma e një kali dhe një kau të ndodhur aty. E shtrirë si lehonë, në pozicion diagonal ajo zotëron pothuajse të gjithë skenën. Manteli vishnje i mbulon trupin dhe kokën e mban



Ril. II. Afreskat në fasadën Jugore



Fig.10

DO NOT COPY

të përkulur nga Krishti i sapolindur. Në krahun e djathtë të skenës qëndron i ulur Josifi me një bari duke biseduar. Dadilat sipas zakonit përgatisin në një kënd të veçantë larjen e foshnjës. Skena, Lindja e Krishtit, është trajtuar thjesht përsa i përket elementëve përbërës. Pamjet e gjalla spikasin tek fizionomia e Shën Mërisë, si dhe tek pozicioni i natyrshëm. Më realiste është e trajtuar figura e bariut me gunën karakteristike që komunikon thjesht me Josifin. Masivi i shkëmbinjve ashpërson peizazhin dhe përcakton përmbajtjen popullore të skenës (foto10).

Mospranimi i dhuratave (foto11) mendohet të jetë kompozimi që dallohet nga trapezeria e mbuluar me stof të zbukuruar ku qëndrojnë të ulur dy hierarkë si për gosti. Kurse në nivele të shkallëzuara paraqitet skenografia e ndërtesave të qytetit dhe e një tempulli.

Në qendër të episodit paraqitet Shën Mëria, me duart e zgjatura përpara si për shërbesë drejt nga trapeza. Bashkuar me Shën Mërinë dhe në të njëjtin plan ajo shoqërohet nga dy shenjtore, njëra prej të cilave është Elisabeta. Në lëvizje e sipër, në fundin e skenës një personazh i ndjek nga pas. Kompozimi i skenës në përgjithësi është i mbyllur në hapësirën e afreskut dhe mungon thellësia e planeve. Vetëm figurat parësore, me qëndrimin vertikal të mbështetur deri në vijën e bardhë të bordurës, zotërojnë të gjithë zhvillimin e ikonografisë.

Deisisi vendoset në një pozitë dalluese (foto12) afër ikonostasit që përfshin hapësirën e murit në zonën e poshtme të naosit. Në të paraqitet figura madhështore e Krishtit në këmbë, në madhësi natyrale, i veshur me himation ngjyrë të gjelbër dhe drapëritë, që modelojnë qëndrimin e thjeshtë të figurës. Në dorën gjysëm të ngritur mban Ungjillin. Portreti dhe shprehja serioze, vështrimi me sytë e ngritur lart, format e fytyrës që rrethohen nga flokët e dendur e trajtojnë Krishtin si në tipin e Pantokratorit



Fig.11

DO NOT COPY



Fig.12

sipas modeleve të ikonave të shek.XIV. Afër tij qëndron Johani në pozicion gjysëm profil duke treguar me dorën e hapur figurën e Zotit. Ndryshe nga paraqitjet e mëparshme të veshjeve me lëkurë, Johani është i veshur me rroba luksoze dhe liturgjike që ndriçohen nga e verdha. Të dy figurat karakterizohen nga monumentaliteti, alternohen nga vizatimi linear në harmonizim me pikturimin, ndërsa lëvizjet e pavarura kanë prirjen e pavarësisë individuale.

Stratillatët (foto13) përbëjnë një krijim origjinal të piktorit, të cilën nuk e kemi parë në këtë formë në veprat e mëparshme. Atë e gjejmë të pikturuar vetëm në ikona portative(Muzeu Onufri, Berat).

Të dy strategët paraqiten të hipur në kuaj, të veshur me uniforma ushtarake dhe të armatosur.



Fig.13

Nga këta i pari, Theodor Stratillati, është paraqitur në profil i veshur me një hiton që i shtrëngon mesin. Në dorën e djathtë, të kthyer përpara, mbështet vertikalisht shtizën. Mbi qafë, kaluar në të djathtë të shpatullave, i varet mburoja. Fytyra trajtohet nga format anatomike që vihen re tek nofullat, zigomatikët, mjekra dhe sytë e errët. Kurse, Teodor Tironi me një lëvizje të shpejtë, i është kthyer Teodorit me kokën e ngjitur pas tij, sa që të krijohet përshtypja e një figure të vetme me dy koka. Edhe portreti i Tironit trajtohet me shprehje të ashpër, me flokët që i rrumbullakosin kokën dhe mjekrën e gjatë. Pelerina që i valëvitet në ajër përfundon deri në vijën e bordurës. Kompozimi i ngjeshur, me figurat dhe kuajt, këmbët e të cilëve prekin fundin e skenës krijojnë pak hapësirë në sfond duke e bërë kompozimin mjaft plastik dhe të veçantë.

Shenjtorët kalorës janë pikturuar, mjaft rrallë në artin bizantin, kurse në kishat e vendit tonë nuk ekzistojnë në këtë periudhë. Vetëm në kishën e Ipapandisë, shek.XIII në Dhërmi u zbuluan gjatë restaurimit[13], në shtresën e parë të pikturimit figurat

e strategëve të skicuara me sinopio të kuqe, por të ndryshëm nga kompozimi i Pecës.

Në shek. XVI, piktor Onufri[14] do të pikturojë strategët me kuajt në Kishën e Shën e Premtes në Shpat të Elbasanit por në një etapë më të vonë se piktor Ilia dhe në një formë tjetër.

AFRESKAT NË FASADËN PERËNDIMORE

Rilevimi III

Në timpanin perëndimor të ndërtesës së kishës dhe në të njëjtën shtrirje si tek Shestia zhvillohet episodi, që bazohet në tregimet e ndodhisë së

Ril. III *Afreskat në fasadën Perëndimore*



Krishtit tek Metamorfoza (foto14). Në siluetën e majës së malit qëndron Krishti, me madhështinë fizike dhe morale, i ndriçuar nga rrezet e dritës qiellore. Në të majtë dhe të djathtë të tij qëndrojnë, profet Ilia dhe Davidi me librat në duar. Figura njerëzish me ritme të gjalla ngjiten drejt malit. Poshtë, në plan të parë, në zbritje duken shkëmbinjtë e thepisur, që krijojnë hapësirën e ikonografisë dhe përcaktojnë dramacitetin që jepet me figurat e tre nxënësve të kërrusur nga ndriçimi.

Ikonografia vazhdon ne regjistrin e poshtëm të



Fig.14

murit me strategët, Shën Minain dhe Shën Mitrin. Shën Minai paraqitet si dëshmonjës i Krishtit (foto15) ashtu si Stratellatet është i hipur në kalë të bardhë.



Fig.15

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Trupi i tij ka një lëvizje të veçantë të kundërt me qëndrim frontal nga drejtimi horizontal i kompozimit të kalit. Karakteristike janë veshjet si hitoni i shkurtër, i cili mbështetet tek shala e kalit, mburoja metalike dhe pelerina e kuqe që i mbështetet në gjoks. Në dorën e majtë mban të shtrënguar shtizën të dalë përpara trupit. Kurse në krahqafë, ka varur mburojën. Pelerina e kuqe në të djathtë valëvitet duke krijuar palë. Shën Minai pikturohet në afresk në moshë të vjetër siç e tregojnë mjekra dhe flokët e bardhë. Fytyrën e ka të kthyer nga spektatori dhe shikim të drejtë me shprehje krenarie. Portreti është trajtuar me mjeshtri nga ana piktorike si me dhënien e gjallërisë tek sytë, format e fytyrës dhe trajtimin e bukur të flokëve nëpërmjet modelimit të formave me ngjyrë të bardhë dhe hijeve me okër të kuqe. Shën Mitri (foto16) është një nga afreskat më të bukura të kesaj kishe. Paraqitet si strateg në moshë të re mbi një kalë të kuq. Trupin e mban të shtrënguar pas kalit, shtizën e mban në dorë dhe me vështrim të përqendruar në tokë. Uniforma ushtarake i zbukuron trupin, si parzmorja matalike në formën e luspave të peshkut me shpatën e varur në mes. Koka e bukur me sytë, vetullat ngjyrë gështenjë dhe buzët e vogla rrethohen nga flokët e valëzuara. Figura e Shën Mitrit të kujton hijeshinë e prototipëve të stilit paleolog.



Fig.16

AFRESKAT NE FASADEN VERIORE

Rilevimi IV

Si në frizë zhvillohet cikli i vuajtjeve të Krishtit në zonën e sipërme të fasadës së murit. Megjithëse mjaft të dëmtuara dhe të mungesës së elementeve tipologjike dallohet kompozimi Rruga për në kalvar. Në këtë skenë mungon qendra kompozicionale, siç është figura e Krishtit me kryqin në kurriz. Figura e tij është pikturuar në anë të skenës që dallohet nga pelerina që i ka mbështjellë trupin dhe këmbët e zhveshura. Krishti ndiqet nga disa personazhe të shkëputur si pa kuptim. Tej për tej skenës dhe po në plan të parë dallohet fasada e një muri të ndërtesës kurse terreni është i zbrazët.

Skena Kryqezimi i Krishtit zhvillohet horizontalisht por që i mungojnë mjaft nga tiparet dhe elementët e kompozimit. Figura e Krishtit pikturohet në qendër



Fig. 17



Ril. IV. Afreskat në fasadën Veriore

nga gjysma e trupit dhe këmbët e gozhduara të vendosura në piedestal. Skena ka një shpërndarje personazhesh që dallohen, dy më kryesorët, siç janë Shën Meria dhe Shën Madalen duke vajtuar. Kurse, në anën tjetër paraqiten figura apostujsh dhe të rinjsh. Në përgjithësi panoja na duket e paorganizuar në kuptimin tipollogjik të saj.

Ngritja nga varri. Kjo skenë (foto17) që do të pikturohet më vonë në ikonografinë e shek.XVII-XVIII, do ta gjejmë për herë të parë në kishën e Pecës. Është një temë e re, pasbizantine, ku vihen re elementët e artit italian tek veshjet dhe armët e ushtarëve romake. Në mungesë të plasticitetit dhe ritmit ajo zotërohet prej sarkofagut të hapur, rreth të cilit janë pikturuar figurat e ushtarëve të ngjeshur afër njëri-tjetrit. Në këtë mund të vlerësojmë momentin emocional në fizionominë e fytyrave, tronditjen dhe frikën që i ka ngjallur ngritja nga varri e Zotit.

Shën Gjergji (foto18) është paraqitur si Shën Mitri, por i kthyer me kalin në drejtim të figurës së kryeengjëllit Mihal. Lëvizja e tij është dinamike me dorën e ngritur lart që mban heshtën në pozicion luftimi.



Fig. 18

PHOTOCOPY

Pelerina e kuqe i valëvitet si një krah mbi shpatullat. Në portret vihet re modelimi pothuajse realist i tipareve. Edhe figura e Shën Gjergjit është një realizim i bukur i këtij strategun të ri.

Kryeëngjelli Mihal (foto19) trajtohet si një figure drejt barokut nga format e fryra të trupit. Qëndrimi i tij është krejtësisht frontal, krahët dhe flatrat e hapura pushtojnë gjithë sfondin e ikonës. Në dorën e djathtë të ngritur mban shpatën. Shën Mëhilli është pikturuar si në ikonë me elemente të shumtë koloristike, ngjyrë të kuqe e të bardhe te krahët, ngjyrë të kaltër te hitoni, që i varet sipër gjunjëve. Kurse me ngjyrë gri pikturohet mburoja dhe brezi. Figura e tij të jep përshtypjen e rinovuar nga prototipi i vjetër.

I ndarë me dy bordura vertikale dhe ornamentike të gërshetuar është vendosur figura e Shën Thanasit të Aleksandrisë (fig.20). Kjo figurë zë pozitëe të rëndësishme në naosin e kishës sepse përfaqëson emrin e padronit të saj. Shën Athanasi është i nderuar në kishën greke dhe ballkanike jo vetëm si shenjt, por edhe si intelektual i formuar, për kontributin që ka dhënë në kishën lindore (295-373). I formuar në shkollën neo-platonike, helenistike, ai do të hartojë diskurset, tezat kryesore të të cilit do të luftonin herezinë arianiane në këshillin e I-rë të Nikesë (325). I konsakruar prej 30 vjetësh, ai do të vazhdojë luftën kundër partizanëve të tezave arianiste. Por arianët e akuzojnë atë rëndë te perandori Kostandin. Për këtë perandori e dërgoi për azil, në Trèvë. Në 339 ai arrin në Romë prej nga ku përgatit Këshillin e Sardikës. Aktualisht perandoresha Sofia konfirmon tezat e këshillit të I-rë të Nikesë. Në 346, Athanasi rivendoset në fronin episkopal të Aleksandrisë, në mjedisin e lidhur me popullin. Duke punuar pa pushim Shën Thanasi publikon Dekretet e Nikesë dhe mbi të gjitha, katër diskurset kundër arianëve. Shën Thanasi mbetet një luftëtar kundër herezisë ariane dhe mund të konsiderohet si mjeshtër i Shën Bazilit të Çezaresë (L.Reau, Tome III). Në ikonografi ai pikturohet midis tre figurave të hierarkëve. Kurse duke mbajtur titullin si Pere i kishës së Lindjes, ai pikturohet në afresk në radhe të absidës me hierarkët. Afresku i Pecës ngjason me prototipin e saj të vjetër të një ikone të Boboshticës (foto 21).



Fig. 19



Fig. 20

PO NOT COPY



Fig. 21

* * *

RENDESIA E PIKTORIT ILIA LLONGOVITI

Nga përshkrimi dhe vrojtimi që i bëmë afreskave të Pecës vumë re mjeshtërinë artistike dhe individualitetin e këtij piktori[15]. Por edhe modelin e një ansambli dekorativ të kësaj periudhe që është karakteristike për zonën e Delvinës dhe të Sarandës.

Veprat artistike të kësaj periudhe pasbizantine (1503-1525) janë në fazën e gjurmimeve dhe hulumtimeve[16]. Në këto rrethana kjo gjë e vështirë-son punën tonë, por megjithatë ne jemi munduar me njohuritë e deritanishme, të evidentojmë sado-pak edhe vlerat e këtij autori.

Punët e piktorit Ilia Llongoviti duken për herë të parë në të dy kishat, në Pecë dhe në Leshnicë të Sipërme, në Theollogo gjatë vitit 1525. Pa dyshim nga dora e tij duhet të ketë edhe vepra të tjera sepse piktori në këtë kohë ishte i formuar dhe me sa duket i njohur në rrethet e vendit si piktor parësor dhe që kërkohej në vende të tjera duke qarkulluar si në Greqi (Janinë), Maqedoni dhe rreth Ohrit, i cili rrezatonte me idetë politike dhe artistike gjer në vendin tonë. Piktor Onufri do të pikturonte pikërisht për herë të parë në Kostur[17].

Afreskat e Pecës karakterizohen nga frymëzimi dhe ndjeshmëria. Një atmosferë e re e përshkon pikturën ndryshe nga veprat e mëparshme sepse në Pecë piktori ka ditur të konceptojë kohën dhe t'i përshtatet preferencave të rrethit të tij. Kjo gjë lidhet me llojin e pikturës, që do aplikojë dhe linjën që do të ndjekë. Ai nuk është krejtësisht i pavarur dhe i izoluar, por është edhe në dijeni të zhvillimeve të artit në monumentet e kësaj kohe si në Janine dhe Kostur, ku janë dhe ateliete me të vjetra të shek. XV në të cilat mësohej arti ikonografik[18].

Në artin e piktorit vëerejme dy elementë, stilin dhe teknikën individuale që i trashëgon nga traditat bizantine dhe kombëtare të monumentëve të shek. XIII-XIV, por edhe më gjërë nga përfshirja në rrymën maqedonase të pikturës[19]. Prandaj vërehen edhe influencat e shkollës maqedonase.

Në Pecë vijojnë programet paleologe, me ciklet

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 22



Fig. 23

e Jetës së Shën Mërisë dhe të Vuajtjeve të Krishtit, por futet edhe tematikë e re, si skena Ngritja nga Varri dhe versione origjinale si Stratillatet. Afreskat dallohen nga thjeshtësia e paletës dhe trajtimit të figurave, por edhe e cilësisë së ngjyrës, trajtimit të fytyrave, të hollësive në detajet dhe në ornamentikën.

Përgjithësimi i formave të figurave i bëjnë ato më monumentale dhe të dallueshme, sipas karaktereve. Kompozimi i disa skenave, siç i përshkruan në mungesën e elementëve përbërës si skenografia ose vetëm ekzistenca e planit të parë dhe të figurave të zmadhuara nuk duhen konsideruar si të meta ose dobësi të piktorit sesa influenca që vijnë nga imitimi i ikonave portative. Shenjat e pikturës tregojnë se ky artist është më afër traditave artistike të vendit dhe nuk besojmë se mund të grupohet në shkollën kretase[20]. Veprat kretase akoma nuk kishin depërtuar në këtë zonë përveç se influencave, ne kemi vrojtuar se ato do të duken më mirë në shek.XVII; një vepër e mirë e shkollës kretase është në manastirin e Shën Mërisë në Dhivervun (1604) të Sarandës. Përfundimisht, mund të konkludojmë se në pikturën e Pecës mund të veçohen realizime të mrekullueshme, ashtu siç i kanë vënë re edhe studiuesit[21], si tek figura dhe portreti Shën Minait (foto 22), tek portreti i Krishtit me ngjeshjen koloristike (foto 23), tek portreti Shën Mitrit me freskinë e teknikës dhe bukurinë klasike (foto24),



Fig. 24



Fig. 25

tek portretet e Stratillatëve, me dinamizmin dhe trajtimin e formave anatomike (foto 25). Por edhe në figurat tërësore si ajo e apostullit të ri tek Shestia ose portreti Shën Mërisë me ndjenja sentimentale tek Lindja. Prirjet realiste vihen re tek figurat laike, si e bariut me Josifin, tek kafshët ose tek gjymtyrët e Krishtit për të evidentuar gjendjen fizike. Punët e autorit Ilia Llongoviti meritojnë të studiohen sepse ato përbëjnë sistemin e pikturës të kësaj periudhe në zonën e Delvinës dhe të Sarandës e që mund të lidhen edhe me monumentet e vendeve fqinje si në rrethet e Janinës. Studimi i këtyre monumenteve ka rëndësi për historinë e artit mesjetar të vendit tonë dhe edukimin estetik të njerëzve. Duke parë gjendjen e rëndë të konservimit të këtyre afreskave është hartuar një projekt restaurimi për ruajtjen dhe vendosjen në vlerë të tyre (S.Mihalçka, Z.Marika) Tiranë 2003.

DO NOT COPY

Shënimet:

1 A. Grabar, L'art du moyen age en Europe orientale, Paris 1968, pag.86.
2 M.Chatzidakis, Considerations sur, la peinture post-bizantine en Greece, Congres Internacional des etudes ballkaniques, Sofia 1966, pag. 176.
Th. Popa, Disa konsiderata të përgjithshme të pikturës pas bizantine në Shqipëri, "Studime historike", Tiranë 1967,faq.94-97.
3 J.Jakumis, 2000 vjet art dhe kulturë kishtare në Shqipëri, Tiranë 2003,faq.90.
4 Ekspedita e Institutit të Monumenteve të Kulturës (S.Mihalçka, Z.Marika), Lezhë 2004
5 Th. Popa, Piktorët mesjetar shqipëtarë, Tiranë 1967, faq.34.
6 A.Meksi, P.Thomo, Arkitektura pas bizantine në Shqipëri, "Monumentet" 1981/2, faq.98.
7 V.Puzanova, Dh.Dhamo. Njekatorije pamjatniki monumentalnoi zhivopisi, 13-14 vjekov I Albanij, "Studia albanica", Tirane 1962/2, faq.150.
8 A. Maria, Autor des notions de tradition, d'innovation et de renesainsse dans la peinture du sud-est europieen aux XV-XIX sec. dans Revue sud-est europieen , Bucurest 1976 faq.67.
9 Th.Popa. Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1988, faq.294.
10 G.Subotic. L'ecole de peinture d'Ohrit au XV siecle. Beograd, 1980, fig.17,34,50
11 Bizantinon Muze, në Janinë, specialistët njohin emrin e këtij autori Ilia Llongoviti në pikturimin e një kishe në krahinën e Pogonit në rrethin e Janinës. Janinë, 1977.
12 L.Ugolini. Butrinto, Instituto Grafiko Tiberiano, (ribotim) Roma 2000,faq.92.
13 Ekspedita e restaurimit të Institutit të Monumenteve të Kulturës, (E.Sopi dhe ekipi I tij). Dhërmi,1983.
14 Th.Popa, Onufri, piktor I madh shqiptar i shek.XVI."Buletin I Universitetit Shtetëror të Tiranës" Tiranë 1957,faq.208
15 Ekspedita e Institutit te Monumenteve te Kultures (Dokumentimi i gjendjes se konservimit dhe vlerave artistike te monumentit: Pr.H.Nallbani, S.Mihalçka (kërkues), Z.Marika,A.Bengu, S.Laçka, Rilevimet S.Mihalçka, fotot Z.Marika) Pece,1983.
16 J.Jakumis, 2000 vjet art dhe kulture... , vep. e cit.
17 Dh.Dhamo, La peinture murale du Moyen age en Albania(Album),Tirane 1974.
18 M.Chadzidakis, Consideration..., vep. e cit.
19 A.Xyngopoylos, Thessalonique et la peinture macedonienne, Athene 1973, faq.203.
20 Th.Popa. Disa konsiderata..., vep. e cit.
21 J.Jakumis. 2000 vjet art dhe kulturë..., vep. e cit.

DO NOT COPY

The Frescos of "Saint Thanas" church in Peca

The church of "Saint Thanas" belongs to the post Byzantine period. This church is located in the village of Peca in the district of Delvina. A very talented painter Ilia Llongoviti builds it in 1525. The origin of the author is from the village of Llongo in Upper Dropulli that belongs to the district of Gjirokastra.

The function of this church is that of cemetery of the community and it is attributed to Saint Athanas of Alexandria. He is a famous philologer, who is adored not only from the Greek and Balkan church but also from the Albanian one.

The picture of Peca starts with the oldest traditions of the monumental art of the XII-XIV, which includes even the period, we are studying. The style of this picture is popular in the artistic tradition because the rough environment, the order of the clients and the intellectual level are reflected in this village church that is located far from the artistic centers and towns.

In the whole decoration is noticed the simplicity and transparence that characterizes the frescos in iconographic relations, in the harmony of compositions and personages through the free style of the work. The paleologist cycles are placed in the upper register while below are painted the saints on foot. The scenes and the saint' photos are divided with red bordures and white lines.

In the frescos the fictional world is inspired and painted from the biblical pictures in abstract space where the universe is expressed inside the church walls, the inspiration of which comes from the people fantasy and the lessons of the bible.

This fact is noticed better in the scene "Birth of Christ" because the composition has popular elements of a warm, natural and familiar environment.

The works of the painter Ilia Llongoviti appear for the first time in two churches; that of Peca and Upper Leshnica in Theologo in 1525.Undoubtely the author must have had even other works done by him, because at that time he has been a well-known painter in all the districts of the country as a favorite one who has been asked to go even in other countries such as Greece, Macedonia, and the surrounding of Ohrid where he illuminated with his artistic and political ideas.

The frescos of Peca are characterized by the inspiration and sensibility. A new atmosphere describes the picture differently from the previous ones because in Peca the painter was able to determine the time and fit with the preferences of the people around him.

The specific features of his pictures show that painter is more familiar with the artistic traditions of the country and we thing that he has nothing to do with the school of Crete.

In the frescos of Peca are distinguished wonderful pictures that are valuated even by other scholars such as in the photo and portrait of Saint Mina, in the portrait of Christ with the knight clothes, in the portrait of Saint Mitri with the freshness of the technique and the classical beauty, in the portraits of Stratillars painted with dynamism and treatment of anatomic forms.

Skënder MIHALCKA

DO NOT COPY



Fig.4

dhomës si tavanët, dyshemenë, dhipatonë, dritaret etj.

Për të realizuar këtë detyrë grupi ynë hartoi projektin e resaturimit të pikturës murale me të gjithë elementet e duhur, si anën historike, gjendjen e pikturës, mënyrën e ndërhyrjes, dokumentacionin grafik, dokumentacionin fotografik etj.

Ky projekt mori aprovimin edhe në KKRSH. Pas një procesi të gjatë vëzhgues duke parë në vend objektin dhe pas ecejakëve Tiranë-Gjirokastër, por dhe me konsultimet ndërmjet nesh, u vendosën piketat kryesore të ndërhyrjes në objekt.

Në fillim puna nisi me konsolidimin e boshllëqeve dhe mbushjen e xhepave. Kjo ndërhyrje u krye në të gjithë sipërfaqen e pikturës pasi në një pjesë të madhe të saj kishte gufmime dhe shkëputje të pikturës nga arriço. Për të kryer këtë proces, ne përdorëm disa mënyra konsolidimi. Xhepat që kishin edhe shkëputjen më të madhe u konsoliduan duke i mbushur me fije kaktusi dhe më pas duke përdorur injektimin me "aluminato di calcio" dhe akril 33. Kjo mënyrë kryhet duke përzier fijet e kaktusit me akrilin 33 dhe duke e futur nëpër boshllëqe me spatulat e posaçme dhe të holla për këtë proces. Për këtë proces tepër delikat u veprua me shumë kujdes dhe profesionalizëm.

Rezultatet ishin shumë impresionuese pasi në fund, u pa që konsolidimi u krye në mënyrë të plotë. Nëpër pjesë të tjera u injektua dhe "aluminato di calcio" me anë të shiringave, pasi më përpara kishim përdorur letrën japoneze të ngjitur me metil celuloze, ngaqë piktura ishte mjaft e dëmtuar dhe rrezikohej të binte. Për këtë problem ne vendosëm të ndërhynim me teknikën e strapos (heqjen dhe rivendosjen e afreskut). Kjo ndërhyrje ishte nga ndërhyrjet më të vështira sepse piktura ishte shkëputur në një distancë të konsiderueshme nga suporti mbajtës (muri). Në fillim u bë pastrimi i sipërfaqes së pikturës, nga pluhurat me një përzierje të ujit të distiluar me amoniak në masën 10:1. Pas pastrimit në sipërfaqen e rrezikuar u vendos letër japoneze duke e ngjitur me kujdes me mentil celulozë. Në kohën kur letra japoneze fiksohej përgatitëm përzierjen e paraloidit me açeton në masën 1:10. Procesi i punës vazhdoi me ngjitjen e merlës me anë të këtij solucioni. Pasi u tha mirë u bë prerja e afreskut, u vendos në një planshet ku u bë dhe hollimi i intonakos. Ky proces u krye duke përdorur dalta të vogla të cilat u goditën lehtë me çekiç gome. Për të kryer rivendosjen e afreskut u përgatit llaç i ri i cili u vendos në pjesën e prapme të afreskut duke bërë të mundur ngjitjen e tij në mur. Pas vendosjes u bë heqja e merlës dhe letrave japoneze me açeton.

Një problem tjetër specifik, përsa i përket konsolidimeve, ishte tek pjesa e oxhakut ku shkëputja e intonakos ishte evidente. Kjo intonakino ishte mjaft e hollë dhe në distancë jo të vogël nga suporti e cila e bënte të vështirë ndërhyrjen konsoliduese. Piktura u fiksua në fillim me letër japoneze për të shmangur fryrjen e afreskut. Ky fiksim u bë, me anë të metil celulozës, duke e lyer me shumë kujdes me anë të një peneli nga qendra në anët e letrës. Injektimi me akril 33 u krye me kujdes dhe, pak nga pak, deri sa në fund të këtij procesi faqet e oxhakut u konsoliduan tërësish (Fig.5).



Fig.5

Më pas ndërhyrja konsistoi në pastrimin

DO NOT COPY

e krostas, një shtresë kjo e krijuar nga lagështia e ardhur nga çatia, e cila në këtë pjesë ka qënë shumë e dëmtuar. Ky pastrim u krye me anë të kompresave, me AB 57, por gjithmonë nën vëzhgimin e vazhdueshëm nga ana jonë sepse nuk duhej të takonte shtresën e pikturës. Pas zbutjes dhe pastrimit të sipërfaqes përdorëm në pjesët e vështira mënyrën mekanike të pastrimit me bisturi.

Pas pastrimit vumë re prezencën e një patine që nuk duhet hequr pasi ajo mund të shërbejë si mbrojtës për pelikulin piktorik.

Problematikë tjetër ishte dhe prania e mbivënieve në frizën e pjesës ballore në një ngjyrë blu. Kjo pjesë u pastrua me shumë kujdes duke ruajtur të paprekura motivet piktorike, për arsye se piktura është (mezzo secco) dhe na lejonte të ndërhynim me kompresa arboçeli, ujë të distiluar + alkol. Këto kompresa krijonin zbutjen e shtresës së mbivënies dhe bënin më të lehtë pastrimin me anë të bisturive.

Në fund të këtyre proceseve u përdor për pastrimin e gjithë pikturës (Wish AB) dhe shpërlarje me ujë amoniakal. Më pas u kryen të gjitha stikimet dhe u bë integrimi piktorik me një koncept bashkëkohor.

E rëndësishme për t'u përmendur është qëndrimi estetik, që u mbajt në marrëdhënie me pjesët e tjera të dhomës si gjetja e një tonaliteti neutral, i përdorur



Fig.6

në pjesët ku mungonte piktura duke harmonizuar të gjithë elementët. Ky tonalitet bëri që piktura të evodentohet në mënyrë të natyrshme me ambientin. E gjithë kjo ndërhyrje restauruese, në pikturën murale shkoi paralel dhe me ndërhyrjet në objektet e drurit e arkitekturë, duke kompletuar restaurimin e banesës së Zekateve (fig.6).

Të gjitha këto vlera artistike që mbart banesa e Zekatëve, e bëjnë një objekt shumë prezantues më tepër se asnjëherë, edhe me rastin e hyrjes së Gjirokastrës si qytet i mbrojtur nga UNESCO.

DO NOT COPY

The house of Zekat in Gjirokastra

Gjirokastra is a town with rare architectonic and urbanologistic values. During its classic period (1800-1830) the most specific achievement is the house of Zekat.

The wall picture covers all the walls of "oda e mire" (the welcome room)

In the Zekat house, where are seen pictures with flourish motives, which show pots, bunches of sickle-fruited fenugreek, bunches of flowers with wavy arches, typical for the Barok art.

Having in consideration the painter's style we think that the wall decorations are painted not only from one painter. We base this opinion to the difference of the picture treatment at the front part, compared with the central part. The central part where is placed even the fireplace, has picture sensitivity and delicacy in the treatment of lines and using of colors, while in the front part the picture style has not the finesse and delicacy of the central part, the colors are pale but there is noticed an expressivity in the way of painting.

The picture presented signs of decline, where were seen pockets and blank spaces.

In some zones it is noticed a serious fading of color and with the passing of the time we might have the lost of the picture image. The surface of the picture was covered with dust, but also cracks and many splits. The most damaged part was the decorative fireplace.

All this artistic values were restored and now the house of Zekat becomes a very representative object and more valuable one for Gjirokastra, awarded lately with a special status, such as World Cultural Heritage, under UNESCO protection.

Adrian CENE
Andi SPAHIA
Gentian VOKOPOLA

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Frederik STAMATI

Një mbulesë ikone prej argjendi e vitit 1802. Konservimi dhe studimi i saj

Kjo mbulesë ikone, e marrë në Kishën e Kryeëngjëjve të fshatit Qestorat të Lunxhërisë ruhet në Muzeun Kombëtar të Artit Mesjetar në Korçë, ku ka pas qenë e ekspozuar për një kohë të gjatë.

Ajo u soll, për restaurim në Laboratorin e Konservimit dhe Arkeometrisë të Institutit të Kulturës Popullore, në vitin 1980. Ishte nga ato mbulesa që u vihen përsipër ikonave, kur ato vjetërohen e fillojnë të prishen ose kur punohen si ikona të argjendëta e të çmuara për dedikime të rëndësishme, veçse me fytyrën e Shën Mërisë dhe të Krishtit të pikturuara me teknikën e temperas. Ajo ishte katandisur në një rrangullinë të vërtetë, me dy zgavra në vend të fytyrave, e shtrëmbëruar, e nxirë, gjithë pluhur, e pëlhura merimangash dhe e spërkatur me gëlqere.

Restaurimi u krye me shumë kujdes dhe zgjati tetë ditë. Fillimisht ajo u trajtua me detergjentë jo jonikë, me acid formik 15%, për largimin e depozitimeve karbonatore,e pastaj me një përzierje të tartratit të natriumit dhe të kaliumit me hidroksid natriumi në raportin 3:1, për hidrolizimin e depozitimeve yndyrore. Pas largimit të papastërtive, që e kishin mbuluar prej kohësh, doli sipërfaqja e argjendit, e errësuar deri në të zezë të shkëlqyer nga veprimi i gazit sulfhidrik, që kishte formuar sulfurin e argjendit: ishte patina fisnike e argjendit, aq shumë e parapëlqyer në muzeume, që i jep objektit fisnikërinë e vjetërsisë.

Nuk u ndërmor asgjë për të penguar errësimin e mëtejshëm. Ajo vazhdon të jetë akoma laramane, e grunjtë, blu dhe e zezë, derisa të errësohet plotësisht, procedurë natyrore që do vite të tëra reaksionesh kimike. Gjatë këtij procesi do të krijohet një shtresë uniforme dhe e rregullt mikrokristaline prej sulfuri argjendi, që luan njëkohësisht edhe rol mbrojtës.

Padyshim, që kjo mbulesë ikone, përbën një nga realizimet më të shkëlqyera të argjendarisë shqiptare, Foto Nr.1 Ajo është shumë e madhe: 89 cm e gjatë dhe 52,5 cm e gjerë. Është realizuar në një fletë të trashë prej argjendi të pastër. Puna e bërë me rrahje i ka dhënë formën e parë. Disa plasaritje të shkaktuara nga goditjet janë arnuar nga mbra-



Fig. 1

DO NOT COPY



Fig. 2



Fig. 3

pa me fletë të holla prej argjendi. Pastaj mbi të është punuar për të realizuar plastikën përfundimtare. Trashësia e konsiderueshme e fletës së argjendit, që vende-vende arrin në afërsisht 3 mm, e ka bërë që të qëndrojë e fortë dhe t'i rezistojë kohës.

Kjo mbulesë e argjendtë ka qenë realizuar për ikonën e më të lartës qiellore, të Shën Mërisë udhërrëfyese, ose Hodigidria, që i atribohet si tip ungjillorit Lluka dhe që adhurohet aq shumë në kishat mariane.

Organizimi i ornamentikës është origjinal dhe nuk ndeshet në realizimet e ngjashme të kësaj gjinie.

Në dy medalione të pozicionuar në pjesën e sipërme, Foto Nr. 2 dhe Foto Nr. 3, e të konceptuara në një trajtë interesante plot ornamente floreale, të modeluar nën influencën e stileve barok dhe rokoko, që në shek XVII-XIX kishin filluar të depërtonin edhe në Shqipëri, është shkruar në greqisht me shkronja të mëdha: NËNA E PERËNDISË.

E gjitha jep imazhin e Shën Mërisë, që mban në duar birin e saj, Emmanuel, term ky i marrë nga hebraishtja (Immanuil), e që do të thotë: "Zoti me ne". Dora e saj e djathtë tregon duke ofruar butësisht Krishtin, Birin e Zotit Monotonia që do të shkaktohej nga mungesa e ngjyrave dhe mban në dorën e majtë një pergamen të mbledhur rrulo, që simbolizon Ungjillin, ndërsa me dorën e djathtë bekon me një gjest të madhërishëm. zgjedhur mjeshtërisht, duke e ngarkuar të gjithë plastikën me zbukurime të shumta. Maforioni i bukur, pasi mbështjell kokën e Shën Mërisë derdhet i rëndë pala-pala mbi supet e saj (foto Nr. 4), e pastaj zbret poshtë, duke lënë paksa të zbuluar veshjen e brendshme, të zbukuruar me shirita të dekoruar me lule. I gjithë maforioni është mbushur me lule të gdhendura në plan të drejtë, (arti bizantin nuk para e njeh volumin), ku spikatin trëndafilat e bukur, që nuk fishken kurrë, sepse Shën Mëria është konceptuar si një trëndafil

DO NOT COPY

i përjetshëm. E në këtë rast, mund të mendojmë për një ndikim të piktures së Onufër Qipriotit, që ka realizuar vepra të tëra pikture në atë zone. Është interesant dekoracioni me dy rombe të brendashkruar tek njëri-tjetri i anës së pasme të maforionit, ndoshta i hastarit, krejtësisht i ngjashëm me pëlhurën ku është qëndisur epitafi i Gllavenicës, duke përbërë të vetmin rast ngjashmërie, që kemi ndeshur deri sot në objektet e kultit kishtar ortodoks.

Në krahasim me ikonën e hershme bizantine kjo mbulesë është më e pasur me ornamentikë floreale edhe në bordurat e velomantelit, ku ndjehet ndikimi i shkollës kreto-veneciane. Në plastikën e butë të rrudhave të veshjeve, realizuara sipas ligjeve të Bizantit, shprehet ndikimi i artit perëndimor.

Në mëngët e mantelit dallohen qartë thekët e arta, ashtu siç i përshkruan profeti Isa. Tri yje shumëcepëshe të vendosur rreth fytyrës së Shën Mërisë, simbolizojnë virgjërinë e saj, Foto Nr. 5.

Krishti Emmanuel, Foto Nr. 6, i veshur me kiton të



Fig. 4



Fig. 5

brendshëm, e me një kimation të zbukuruar me lule të inçizuara të vendosura kryq sipër.

Në ditët e sotme vepra nuk vjen e plotë; asaj i mungojnë dy brezoret e Shën Mërisë dhe e Krishtit, e megjithatë vlera e saj mbetet maksimale. Ne nuk e dimë se kush e realizoi këtë vepër. Ndoshta, murgjërit argjendarë që ushtronin mjeshtërinë e tyre nëpër manastire.

Në fund të mbulesës së ikonës është kapur me thumba argjendi një shirit, po prej argjendi në të cilin është shkruar në greqisht: "Zonjës Sime, Hyjëlindëses Eleusë, lutje e të gjithë të krishterëve ortodoksë të devotshëm, që banojnë në këtë katund. Sinkriati bashkë me gratë dhe fëmijët e tyre që janë kujdesur, Qirkut Kalo dhe fëmijët dhe Aleks Çipi dhe fëmijët dhe Sevo Qëndro dhe fëmijët dhe Nikollë Çuçu dhe fëmijët dhe me shpenzimet e tyre Malo i Dedes dhe fëmijët dhe Papa Stathit. Janaq Qëndro dhe fëmijët për ndihmë dhe mbrojtje për të gjithë ne Amin" : 1802 : Gusht 1.

I pari që e ka botuar këtë shkrim ka qënë P.I.Pulica,

pastaj Theofan Popa1. Data 1 gusht mungon në botim. Vetëm në këtë punim jepet varianti i plotë i mbishkrimit, i cili siç u theksua edhe më lart është i montuaar në fund të mbulesës së ikonës

Duke e shqyrtuar me kujdes, mund të na lindë mendimi se mbulesa e ikonës dhe mbishkrimi nuk janë të njëkohshëm. Egziston mundësia, që mbulesa e ikonës të ketë qenë përgatitur më parë, ajo ka qenë e gatshme dhe është përdorur kur është paraqitur rasti. Po sa më e mëparshme nga shkrimi? Në këtë punim nuk është e mundur që të bëjmë as edhe një përcaktim të përafërt.

Ka edhe një argument tjetër që e përforcon këtë mendim. Mbishkrimi montuar ka fjalën "Eleusë", të përdorur për Shën Mërinë, e që do të thotë përkëdhelëse, tipike për ikonat e tipit Brefokratusa, kur në këtë rast kemi të bëjmë me një ikonë të tipit Hodigidria. Nuk është gabim. Një mjeshtër që ka realizuar një vepër të tillë nuk mund të ngatërronte tipet e ikonave. Ai që ka shkruar mbishkrimin ka qenë tjetër argjendar, i mëvonshëm, i vitit 1802 dhe ka shfrytëzuar për dedikim një ikonë më të vjetër.

Në botimin e Theofan Popës, kjo mbulesë ikone cilësohet si e fshatit Qesarat të Lunxhërisë. Në të vërtetë, ka një ngatërresë emrash. Fshati Qesarat i takon Tepelenës, kurse në Lunxhëri është fshati Qestorat, ku edhe sot e kësaj dite ndeshen mbiemrat e familjeve të përmendura në mbishkrime.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

The Restoration os Hoxhara Treasure

The treasure of Hoxhara, which consists in 560 silver coins and tow suppurates, was brought to the laboratory in an advanced stage of decline.

The product of reaction was the bromine of silver and the components of tow valence cooper in the case of suppurate coins.

Some methods of conservation were applied. The best and the most effective one was that of reduction with diction in alkaline environment. The treatment took 5 months. In the end was generated a clear surface of the coins, easy to read, in which was deposited a thin silver stratum. Their conservation consists even in the undertaking of some other measures such as the removal of melted anions; conduct-metric measurements and isolating them from the atmospheric agents.

The suppurate coins were clinically treated with Rochelle alkaline. The methods that were used were very successful because the coins are in good condition, without any sign of recordation.

A SILVER ICON COVERAGE OF THE YEAR 1802

The coverage of this icon, conserved in the Middle Age Albanian Museum in Korca, was brought for restoration in the laboratory. There it was treated with formic acid and Rochelle. After the treatment appeared completely its silver surface, covered with the products that create the noble coated surface of silver. No measurements were taken to stop the further darkness of the surface so as to continue the forming process of a uniform surface of silver sulphur. This icon is of the type Hodigidria, done with craftiness (mastery). In this icon is felt the indifference of the west art.

At the end of the silver coverage is placed a stripe where is written in the Greek language the dedication and the year.

The author determines that this object belongs to the "Archangel Church" of the village Qesarat of Lunxheria district of Gjirokastra.

Frederik STAMATI

DO NOT COPY

Ajet NALLBANI

Drejtoria Rajonale e Monumenteve të kulturës Berat në 40-vjetorin e krijimit

U mbushën 40 vjet që kur pionierët e parë të fushës së restaurimit nisën nën kujdesin e krijusit të këtij institucioni Gani Strazimiri, punën gjurmuese, konsoliduese, restauruese dhe propaganduese për trashëgimine tonë kulturore.

Objektet e para ishin ato të trashëguara nga studjues të huaj dhe diçka ishte nisur për këto vlera. Berati një nga qendrat historike më të dëgjuara për trashëgimine kulturore, u futur nën kujdesin shkencor të Institutit të Monumenteve, vetëm me krijimin e tij si institucion që mbulon këto vlera.

Para krijimit të Institutit, vlerat e trashëgimise në Berat trajtoheshin nga një skuadër nën drejtimin e Ismet Hundes një teknik ndërtimi që me punën e tij për kohën dhe njohjen që kishte atëherë në vendin tonë për monumenetet, ishte një përkujdesje ndaj asaj që deri atëherë nuk ishte kujdesur askush. Kështu kjo skuadër nën drejtimin e Arsim-kulturës në rrethin e Beratit, filloi në vitin 1961 të merrej fillimisht me kalanë.

Për mungesë njohjeje, u rindertuan dhe ca mure të kalasë dhe një pjesë e bedenave, të cilat ndonëse u konsoliduan duke mos lejuar shkatërrimin e tyre patën dhe efekte negative që sot kritikohen per vetë faktin e ndërhyrjes pa kriter, kjo për shkak të mos njohjes së kritereve në këtë fushë.

Me krijimin e institutit të monumenteve filloi trajtimi shkencor I punës mbi trashgiminë.

Një nga qytetet ku u drejtuan sytë e specialistëve ishte dhe Berati, me një pasuri të madhe me vlera kombëtare por dhe me probleme të shumta. Kjo për shkak të një kohe mjaft të gjatë pa ndërhyrje në ndërtimet popullore si dhe në kala apo monumente të tjera.

Me specialistët e institutit dhe të Ateljesë filloi puna e dokumentimit të këtyre vlerave, fotografimit skicimieve dhe përgatitjeve e projekteve të para.

Ateljeja e Beratit, më vonë drejtohet nga Millan Buca një mjeshtër ndërtimi, deri në vitin 1969.

Vitet e para të krijimit të këtij instituti me ateljetë ne Rrethe, ishte përsëri me kuadër të marrë nga sfera e ndërtimit por që dalngadalë u bënë specialistë të restaurimit nën kujdesin e specialistëve që vinin nga instituti që dhe ata dikur pa eksperiencë, tashmë kishin marrë njohuri nga literaturat e huaja apo nga ish drejtori Gani Strazimiri i cili kishte kontaktuar me specialistë europianë dhe kishte marrë pjesë në Konferenca Nderkombetare.

Me këtë pjesëmarrje ai solli elementë të nevojshëm për organizimin e Institutit dhe Ateljeve në rrethe.

Ai hartoi rregulloren e parë të qytetit-muze të Beratit, e cila shërbeu si bazë për kryerjen e punimeve të restaurimit dhe në qytetet e tjera deri sa më vonë u hartuan dhe te tjera.

Qyteti i Beratit, për vlerat historike, urbanistike, arkitektonike dhe ambjentale është shpallur qytet-muze në bazë të vendimit të keshillit të Ministrave 172 datë 2.6.1961.

Gjatë këtyre viteve është bërë një punë e mirë për evidentimin e monumenteve në Berat dhe për restaurimin e fasadave të lagjes Mangalem që ishte në gjendje të mjeruar.

Plotësimi me kuadër inxhinier në këtë kohë ndryshoi drejtimin e punës kërkuese dhe shkencore. Duke zbatuar kartat ndërkombëtare per restaurim te cilat u bënë busull për punën e kuadrove të reja dhe kishin marrë kulturen në ndërtim dhe tashmë balla-

DO NOT COPY

faqoheshin me kërkesat e restaurimit, pati nje ndryshim te theksuar për dokumentimin e vlerave dhe restaurimin e tyre.

Tashme dhe mjeshtrat që punonin në Atelje filluan të disiplinoheshin me kërkesat e reja duke lënë nocionin ndërtim dhe duke iu përkushtuar me kujdes zëvendësimit të elementeve të dëmtuar me elementë të njëjtë apo të ngjashëm me origjinalin, si dhe duke respektuar gjurmët e vjetra, duke u futur kështu në rrugën e restaurimit.

Kështu mbas ca vitesh Ateljeja e Beratit plotësohet me kuoder te lartë dhe të mesëm në restaurim dhe me mjaft mjeshtra të aftë për të përballuar gjendjen e monumenteve që solli koha. Ne vitin 1973 kthehet me statusin e Deges se Institutit duke u forcuar dhe me teper.

Nga vitet 1970– 1980 u reterstauruan shumë monumente që ishin në gjendje shkatërrimi. Kështu shumeë mure të kalasë filluan të konsolidoheshin. U restaurua xhamia e Beqarëve, kisha e Shën Triadhës, Kisha e Shën Todrit, një numër i madh banesash të kategorisë së parë si Hazendari, Xhokaxhiu, Mishaxhiu, Angjeliu, Zaharija dhe Xhimitiku në Goricë, banesa e Novës dhe dhjetra monumente të kategorisë së dytë. Gjatë kësaj periudhe u restauruan dhe u mirëmbajtën gjithë muret dhe portat në zonën–muze duke e çliruar lagjen nga bastardimet dhe iu kthyen vlerat autoktone.

Vitet 1980-90 ishin vite që punohej me nivel shkencor në restaurim por fluksi i tyre filloi të ulej si rezultat i rënies ekonomike në përgjithësi dhe shënon fillimin e tranzicionit të rëndë për monumentet e kultures. Ndryshimet politike sollën një stanjacion të kësaj gjendjeje dhe rezultoi me probleme që u shfaqën në dhjetra monumente.

Ne vitin 2003 Dega e Beratit merr statusin e Drejtorise Rajonale me vartësi te dyfisht.

Kohët e fundit, si rezultat i hapjes me botën, Drejtoria Rajonale e Momumenteve të Kulturës Berat ka krijuar lidhje shkencore dhe financuese me Lombardinë, si rezultat i së cilës janë bërë të mundura restaurimi i Katedrales në Kala, të kishës së Shën Kollit, po në Kala dhe të 30 ikonave të muzeut Onufri. Ky bashkëpunim ka sjell një shans për shkëmbime eksperience dhe asistence teknike nga vendet e avancuara në restaurim.

Së shpejti do të hapet shkolla verore e restaurimit në bashkëpunim me Universitetin politeknik të Milanos, Universitetin e Firences dhe Universiteti i Tiranës.

Shoqata italiane ARCI Milano është prezente me projektet e veta në zonën e Beratit që prej vitit 1998. Fillimisht puna nisi me diagostikimin e situates, përcaktimin e sektorëve për ndërhyrje dhe më pas u kalua në hartimin e projekteve fillimisht emergjente e më pas në ato te zhvillimit. Kjo shoqatë ka në qendër të punës së vet artin kulturën e zhvillimin gjë që shprehet në vetë emrin e saj.

Për këtë qellim ARCI Milano shfrytëzoi prezencën e Qendrës së Gruas në Berat si partner për projektin e vet për katalogimin e veprave të artit në muzeun "Onufri", projekt i cili u realizua me sukses. Ne vazhdim ARCI Milano financoi punimet për restaurimin e ndërteses së këtij muzeu për ato pjesë që partneri shqiptar IMK vendosi të preventivojë dhe që gjithashtu edhe ky projekt u realizua definitivisht. Nga ky investim u perftua nje restaurim i cili rivlerësoi Muzeun Onufri duke krijuar kushte të mira të ekspozimit dhe mënjanimin e problemeve që shqetësonin muzeun ne fjale.

Së bashku me financimin e punimeve ndërtimore u realizua në dy faza edhe financimi i restaurimit të 52 ikonave në nivelin e bllokimit të degradimit.

Të gjitha këto operacione janë kryer në sintoni me projekte e preventiva të hartuara në përputhje me legjislacionin shqiptar e atë italian mbi trashëgiminë kulturore.

Për vitin 2005 është në vazhdim puna për restaurimin e kishës së Shën Kollit në kala si edhe do të restaurohen disa ikona te fondit te IMK-së dega Berat, sipas miratimit të bërë nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve Tiranë. Puna ka filluar dhe vazhdohet me ritme të kënaqshme duke u fokusuar fort në cilësinë e tyre dhe profesionalizmin që kërkojnë standartet e këtyre punimeve. Do të ndërhyhet për forcimin e mureve, injektime, heqjen e mbeshtetjeve te vendosura në një periudhe kur mendohej se këto siguronin strukturën por që tani janë kthyer në faktor që ndikon negativisht dhe ndërhyrje te tjera të cilat sigurojnë ndërtesën e kishës në përputhje me kriteret e sotme të restaurimeve.

Së bashku me këto punime është parashikuar

DO NOT COPY

edhe organizimi i një kursi veror me restauratorë beratas të cilët në bashkëpunim me institucionet e specializuara do të trajtojnë tema dhe praktikë të cilat kanë të bëjnë me qellimet në fjalë.

Për vitin 2006 ARCI Milano ka prezantuar donatorëve një projekt që do të ndihmojë në restaurimin e Akropolit dhe Çisternës së ujit në kala me qëllimin e vetëm ta kthejë këtë ambient në polifunksional, duke shtuar edhe se Universiteti Politeknik i Milanos do të organizojë në verën e ardhëshme një shkollë verore në lidhje me restaurimet duke realizuar edhe shkëmbime profesionale me MKRS e IMK.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

The 40th Anniversary of the Institute of Cultural Monuments. (I.C.M.) the branch of Berat

There are 40 years now from the time when the first pioneers of the conservation field started, with the care of the creator of this institute Gani Strazimiri, the tracing, conservative, consolidate, for our cultural heritage.

Berat, one of the most important historic centers for our cultural heritage was under the care of the ICM only after this institute was founded, as an institute that protects these values. A construction team preserved the values of cultural heritage in Berat at the time when ICM was not founded yet.

When ICM was founded started even the scientific treatment of the cultural heritage.

The town of Berat was declared a museum town for its historical, urbanologistic, architectonic, and environmental values, based on the decision of the Council of Ministers No. 172 date 2.6.1961. During these years it has been done a very good job for the identification of the monuments in Berat and the conservation of the façade of the Mangalem neighborhood, which was in very bad conditions. At this moment even the masters started to become conscious that was not important only to build but to replace carefully the damaged elements with new ones, similar with the original, and also respecting the old traces and so entering a new stage of conservation.

In 1970-1980 were conserved and protected a lot of monuments that were in ruined conditions. In this aspect the walls of the castle were consolidated. It was also conserved and reconstructed the mosque of " Beqareve", the church of "Saint Triad", the church of "Saint Todri", a great number of first category residences like: Hazendary, Xhokaxhiu, Mishaxhiu, Angjeliu, Zaharia and Xhimitiku in Gorica, the residence of Nova and so many others monuments of the second category. During this period were conserved and protected all the walls and doors in the museum zone and it has now its autochthon values.

Nowadays, the Regional Directory of Cultural Monuments of Berat has established scientific and financial relations with Lombardy, as a result of which have been possible the reconstruction of the Cathedral in the Castle, the church of "Saint Nicolas", and also in the Castle 30 icons of the "Onufër" museum. This cooperation was a chance to exchange experience and technical assistance with progressed countries in the field of conservation and protection of cultural values.

Ajet NALLBANI

DO NOT COPY

Dr. Kristofor NASLAZI

Mbi veprimtarinë artistike ikonografike të piktorit të fundit të shek. XVII Murgut Simon I Ardenicës

Në historinë e artit mesjetar shqiptar janë bërë të njohur pjesa më e madhe e piktorëve, që e përfaqësojnë atë së bashku me konsolidimin e krijimtarive bazë të tyre, në fushën e pikturës së kavaletit, skulpturës dhe pikturës murale. Veç tyre, ka ende piktorë të panjohur apo pak të njohur, veprimtara e të cilëve reflektohet në një numër shumë të kufizuar veprash, por që në tërësinë e artit mesjetar shqiptar ato plotësojnë një vakum kohor dhe historik, duke bërë njëkohësisht edhe ndërlidhjen e stileve, rrymave e preferencave shpirtërore e artistike në tërësi.

Niveli i lartë i artit ikonografik, i periudhës paleologe, e sidomos i shek. të XVI i perfaqësuar në Shqipëri me shkollën e Beratit, shërbeu si një model i pazëvendësueshëm për piktorët pasardhës të njohur dhe anonimë, të cilët u mbështetën fuqimisht në këtë traditë të pasur.

Janë të njohura dhe të admirueshme ikonat, që vijnë nga manastiri i "Shën Marisë të Postenanit', të vitit 1635, ikona e Krishtit Pantokrator nga Kisha e Shën Pjetrit, Bezhan, Kolonjë e vitit 1651, ikona e Gjithë Shenjtorëve e vitit 1690, ikonat e Mësues Konstandinit, të vitit 1685, ikonat e Konsanti Jeromonajut të viteve 1693-1694 ikonat e murgut Simon i Ardenicës dhe shumë ikona të tjera që, i përkasin shek. te XVII. Këto ikona përfaqësojnë vazhdimësinë e vlerave të atelieve të njohura shqiptare të shekujve të mëparshëm, të parë nën një këndvështrim të ri artistik dhe emocional. Simoni i Ardenicës, për të cilin po flasim më poshtë, është një piktor shumë pak i njohur. Fillimisht ai është identifikuar nëpërmjet mbishkrimit të ikonës së Shën Gjergjit mbi kalë (fig.1) ku gjendet edhe emri i tij.



Fig. 1. Shën Gjergji

Pra, ishte pikërisht kjo ikonë nga e cila mësuam ekzistencën e një piktori tjetër mesjetar, i panjohur më parë, i fundit të shek. XVII.Më vonë u identifikuan edhe disa ikona të tjera të panjohura më parë, që vijnë nga kisha të ndryshme të Shqipërisë jug-lindore si: Berati, Lushnja, Elbasani, Vithkuqi (Korçë) etj.

Ikonat hyrja e 'Shën Marisë në tempull'(fig. 2), 'Hyrja e Krishtit në Jeruzalem'(fig 3),dhe 'Fjetja e Shën Marisë' (fig. 4), vijnë nga kisha e Shën Mari Vllahernës Berat, Shën Mëhilli(fig.5), së bashku me ikonën e Shën Gjergjit mbi kalë, të cilën e përmendëm më sipër, vijnë nga manastiri i Ardenicës.

Një ikonë e vogël 'Deisis me Shenjtorë' ndodhej

DO NOT COPY



Fig. 2
Hyrja e
Shën Mërisë
në tempull



Fig. 4
Fjetja e
Shën Mërisë



Fig. 3
Hyrja e
Krishtit
në Jerusalem



Fig. 5
Shën Mëhilli

DO NOT COPY



Fig. 7
Shën Gjergji me kalë



Fig. 8
Dyert e bukura

në sektorin e restaurimit pranë Institutit të Monumenteve në Tiranë, e ardhur nga kisha e Shën Gjon Vladimirit në Elbasan, ndërsa 'Shën Gjergji mbi kalë, (fig.7) dhe 'Dyert e Bukura' (fig.8) vijnë nga kisha e Shën Marisë Vithkuq dhe ikona 'Mbledhja e Apostujve' (fig.9) nuk i dihet prejardhja.

Siç e shohim këto ikona vijnë nga disa vende të dëgjuara për kohën, për pikturën e kavaletit, dhe atë murale si Berati, ku kanë punuar piktorët e njohur si Onufri, Nikolla dhe Qiproti. Në kishat e Vithkuqit kanë punuar Qirko Panajoti, (3) Mësues Konstandini, (2) dhe piktorë të tjerë anonimë nga shek.XII-XVII, e më vonë në këtë qytet kanë punuar piktorët e njohur të shkollës së Korçës, vëllezërit Konstandini dhe Athanas Zografi,(4) Konstandin Shpataraku, (5), Konstandin Jeromonaku (6) etj.

Në Valsh dhe Shelcan të Shpatit të Elbasanit ka punuar Onufri, ndërsa kisha i përket një shenjti të adhuruar shumë nga shqiptarët. Edhe manastiri i Ardenicës, jo vetem që ndodhet në pellgun e Beratit, por ka qenë nën juridiksionin e kësaj peshkopate, dhe nën influencën e artit kishtar.Në këtë manastir, ku bënin jetën monastike murgjër, të cilët kishin krijuar ndonjë atelie pikture për pikturimin e ikonave dhe objekteve të tjera të kultit, në gjini të tjera të kësaj fushe.

Pikërisht, njëri prej tyre ka qenë igumeni i shenjtë apo Jeromonaku, siç e nënëshkruan ai, Simoni i Ardenicës. Ekzistenca e shumë qendrave, që ushtronin veprimtarinë e tyre në fushën e ikonografisë, shpjegohet me faktin se, duke filluar nga shek. XVII me intesifikimin e procesit të islamizimit të popullsisë ortodokse, kryesisht në Shqipërinë e mesme, e më pas në të gjithë Shqipërinë, u duk një rritje sasiore e cilësore e ndërtimit të kishave, si refleks i një rezistence shpirtërore.

Në këtë periudhë shohim të zbatohen tipe dhe konceptime arkitektonike, e konstruktive më të zhvilluara. Kjo arrin pikën më të lartë në shek. e XVII (7).

Kjo rritje sasiore dhe cilësore e kishave zhvilloi në një aspekt më të gjerë konceptimin e afreskut, dhe lindi nevojën për shtimin e numrit të ikonave.E gjitha kjo shpjegohet edhe me faktin se përkundrejt numurit të ikonave të shek. XVI, në shek. e XVII, numuri i tyre shtohet. Gjithashtu, kjo lidhet edhe me faktin e periudhave shumë të vështira historike, e fushatave luftarake, që ka kaluar vendi ynë e për rrjedhojë veprimtaria artistike ka qenë mjaft e kufizuar.

Pra, Murgu Simon i Ardenicës, shfaqet si piktor i zakonshëm në pikturën e kavaletit, por është paksa i vecantë në stilin e tij, në kuadrin e pikturës pasbizantine, në fund të shek. të XVII. Në pergjithësi, ikonat e Simonit të Ardenicës janë punuar në dru halorë dhe dru arre. Në disa prej tyre, ai ka vendosur mbi panelen e drurit kanavacë lini ose copëza kanavaceje, kur panelja e drurit ka patur plasaritje. Ato janë punuar në teknikën e temperasë, mbi një shtresë përgatitore gipsi, me lidhësa organikë (tutkallorë). Shtatë prej ikonave të tij, të cilat do t'i trajtojmë në këtë shkrim, janë thelluar në pjesën e brendshme të panelit duke lënë anash një kornizë të gjerë, diku të pikturuar, diku me motive floreale e diku me motive të gdhendura.

Vetëm ikona e Shën Gjergjit të Vithkuqit është e thjeshtë dhe pa korniza. Janë të mrekullueshme 'Dyert e Bukura' të ikonostasit të cilat janë gdhendur kryesisht me motivin e dredhëzës dhe të lyera më vonë me ar. Mbi shtresën e pikturës është vendosur një shtresë e trashë llaku. Disa prej ikonave janë shumë të dëmtuara.

Ikona e Shën Gjergjit, me të cilën autori është bërë i njohur, është mjaft e pasur në ornamente floreale. Ai është pikturuar sipas skenës tradicionale mbi kalin e bardhë, me veshje luftarake, parzmoren, pelerinën dhe heshtën duke vrarë dragoin. Në sfond dallohet arkitektura e një qyteti me ndërtesa të larta, kulla dhe bedena mbi të cilat ndodhen disa figura princësh, me çelësat e qytetit ndër duar. Pranë shenjtit qëndron princesha, e cila tërheq litarin e lidhur në qafën e dragoit. Në pjesën e sipërme të ikonës ndodhen segmentet qiellorë, nga ku del dora e zotit që bekon shenjtin dhe një engjëll duke vendosur kurorë mbi kokën e tij. Midis këmbëve të kalit ndodhen dy mbishkrime në gjuhën greke. Te njëri përmendet dhuruesi apo përkushtuesi i ikonës, ndërsa tek shkrimi tjetër personi që ka kontribuar në pikturimin e ikonës me talentin e tij, d.m.th. autori.

MBISHKRIMI NR:1



Që do të thotë; 'Lutje e shërbëtorit të Perëndisë' Gjergji Dhoço dhe fëmijët e tij'.

MBISHKRIMI NR: 2



Që do të thotë; 'Me kontributin e murgut ose igumenit të shenjtë, zotit Simon i Ardenicës 1690'.

Ikona e dytë ku autori ka vënë mbishkrimin e tij apo porositësin e ikonës, me përkushtimin ndaj zotit është ajo e 'Kryeengjullit' Mikail. Kryeengjulli paraqitet me këmbë, përballë, me shpatë në dorë, me pelerinë dhe parzmore metalike, si dhe me flatra mbi supe, si të gjithë engjujt. Edhe te kjo ikonë, djathtas pelerinës, ndodhet mbishkrimi.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

MBISHKRIMI NR: 3



'Lutje e shërbëtorit të Perëndisë, Gjergji Dhoço e fëmijët e tij 1690'. Ndërsa në anën e majtë të saj ndodhet një mbishkrim tjetër.

MBISHKRIMI NR: 4



Që do të thotë –' Me kontributin e igumenit të shenjtë, zotit Simon Jeromonakut nga Ardenica'.

Te ikona e dytë përveç titullit igumen ai shton edhe atë jeromonak, d.m.th. prift, murg. Pra, këto dy ikona janë porositur dhe janë paguar nga i njëjti person, me përkushtimin ndaj zotit Gjergji Dhoço e fëmijët e tij, e janë pikturuar nga Simoni i Ardenicës në vitin 1690.

Gjashtë ikonat e tjera kanë disa fragmente mbishkrimesh, ende të pa identifikuara mirë, porse stili i punimit të tyre të çon te stili i ingumenit të shenjtë, Simoni i Ardenicës.

Te ikona e ' Shën Gjergjit', i gjithë kompozimi mbyllet mirë me kornizën e zbukuruar, me motivin e zambakut të stilizuar, mbi një fushë ngjyrëqielli.Kjo ikonë në përgjithësi është trajtuar në mënyrë dekorative dhe është mjaft e ngarkuar. Me sa duket, piktori është udhëhequr nga koncepti për ta bërë ikonën sa më të pasur dhe me efekte, prandaj kjo ikonë në përgjithësi të lë përshtypjen e një gobelini me karakter të theksuar popullor.

Ikona e 'Shën Mëhillit' ka një kornizë të gdhendur në reliev ashtu si dhe te ikona e "Shën Gjergjit", dekori i së cilës ka motivin e dy rrathëve të brendashkruar, që ndjekin njëri- tjetrin dhe anash tyre motivi i majës së gjethes, i përsëritur gjatë gjithë kornizës.

Ikona e tretë 'Hyrja e Shën Mërisë në tempuj' paraqitet sipas kompozimit tradicional të kishës lindore, bizantine, ku tregohet Shën Maria 3 vjeçare e shoqëruar nga Joakini dhe Ana, prindërit e saj e virgjëreshat. Në krye të shkallëve të tempullit i pret Zaharia. E veçantë te kjo ikonë është se veç grupit të Joakinit, Anës dhe virgjëreshave, që janë me madhësi normale, ndodhet edhe një grup tjetër, figurat e të cilit janë konceptuar dhe trajtuar me përmasa më të vogla se të parat, ndonëse janë në një plan.

Kjo dukuri është normale për artin bizantin pasi aty nuk respektohen raportet e përmasave të figurave. Sipër, në sfondin arkitektonik, shfaqet skena e 'Ungjillëzimit'. Edhe te kjo ikonë korniza është konceptuar si te dy ikonat e përmendura më sipër, e zbukuruar me motivin e zambakut, të silizuar, paksa i ndryshëm në trajtim dhe ngjyrë. Edhe pikturimi i kësaj ikone është trajtuar në mënyrë dekorative dhe të lë përshtypjen e një vitrazhi.

Te kjo ikonë ndodhen disa fragmente shkrimesh të vendosura në të katër anët e kornizës.

MBISHKRIMI NR: 5

Sipër ka dy shkrime:



që do të thotë – 'Të shenjtat e të shenjtëve poshtë ka katër fjalë të paidentifikuara.

DO NOT COPY



Djathtas, sipër dhe poshtë ka dy fragmente shkrimesh,



që përkthehen - 'Në vitin e zotit' dhe 'Me kontributin e zotit'.

Majtas, sipër ka vitin 1689 dhe pak më poshtë është shkrimi,që do të thotë – " Të bashkënderuarit, Joan Jeromonakut."



Edhe ikona 'Fjetja e Shën Marisë", megjithëse shumë e dëmtuar, në gjysmën e poshtme, është mjaft e arritur artistikisht. Edhe në kornizën e saj përsëritet i njëjti motiv, zambaku i stilizuar, e midis tyre ka një motiv të dredhëzës. Në mënyrë shumë dekorative është vendosur grupi i Krishtit në qendër i rrethuar nga dy harqe me engjuj në ngjyrën e qiellit, meqenëse ata i përkasin botës qiellore, që mbyllen sipër me figura kerubinësh si te ikona e Onufrit. Sfondi arkitekturor, anash tyre e sipër, ndodhen segmentet qiellorë e portat e qiellit në pritje të Shën Marisë, që ngjitet nga engjujt. Edhe te kjo ikonë përsëritet e njëjta formulë shkrimi dhe i njëjti stil.

MBISHKRIMI NR: 6



Që do të thotë - Me kontributin e Joan Manakut, prift Zotit Saker .....

Duke u nisur nga stili i gërmave, motivet mbi kornizë, arkitekturës dhe figurave, pavarësisht se kjo ikonë nuk është e plotë, na çon te e njëjta dorë që ka pikturuar ikonën e Shën Gjergjit. Pra, kjo ikonë i përket dorës së Simonit të Ardenicës.

Ikona 'Hyrja e Krishtit në Jerusalem' është konceptuar me kornizë ashtu si ikonat që kemi përmendur më sipër, veçse motivi në formë gjysmë gjetheje është i gdhendur në dru. Edhe kjo ikonë, megjithëse është shumë e dëmtuar sidomos në pjesën e poshtme, të lë përshtypjen e një gobelini të qëndisur. Përsa i përket nivelit artistik kjo ikonë mund të konsiderohet ndër më të mirat e këtij autori.

Ikona tjetër ' Shën Gjergji mbi kalë', e ardhur nga kisha e Shën Marisë, Vithkuq, Korçë, është më e thjeshtë se të tjerat sepse i mungon korniza. Kjo ikonë është konceptuar tepër dekorative. Duke gjykuar në përgjithësi nga stili dhe tipat e portreteve, figurave, karakteret, arkitektura, ngjyrat etj, mendojmë se kjo ikonë është vepër e murgut Simon i Ardenicës, por pak më e vonë.

Po nga kisha e Shën Marisë Vithkuq janë 'Dyert e Bukura të ikonostasit', vepër kjo e përbërë nga dy kanata të gdhendura në dru, e konceptuar nga ana plastike me ndërthurje motivesh floreale, të organizuara këto në mënyre simetrike në të dy kanatat. Skenat e pikturës janë kompozuar në katër rrjeshta, ku të bie në sy skena e madhe e ungjillëzimit, me Shën Marinë dhe Kryeengjullin Gabriel, dhe dy profetët djathtas e majtas tyre, dukuri e kësaj skene te dyert e bukura.

Poshtë kësaj skene janë dy shenjëtorë të tjerë, midis ndërthurjeve të motiveve floreale, Joakimi dhe

DO NOT COPY

Ana, prindërit e Shën Marisë dhe përfundi ndodhen katër figura në këmbë me ungjij ndër duar, që përfaqësojnë katër jerarkët kryesorë të kishës. Më e veçanta e këtyre dyerve është përsëritja e skenës së Ungjillëzimit, por në përmasa më të vogla. Kjo dukuri nuk vërehet tek dyert e tjera të kësaj natyre. Pra kjo derë e bukur ka dy veçanti, - e para – vendosja në të e Joakimit dhe Anës dhe dublimi i skenës së Ungjillëzimit, si shprehje e një dukurie të rrallë.

Motivi kryesor i kësaj ndërthurjeje është kryesisht zambaku i stilizuar si dhe një motiv dredhëze me gjethe tripetalshe, ku gjithashtu dallohen boçet e pishës dhe gjethe të bimës së duhanit, vertikalisht në të dy anët e jerarkëve. Edhe për dyert e bukura, jam i mendimit se i përkasin dorës së Simonit të Ardenicës, duke gjykuar nga stili i punimit dhe elementët e tjera arkitektonike.

Një ikonë tjetër, më e vogla e koleksionit të Simonit të Ardenicës, që ne kemi mundur të identifikojmë nga fondi i I.M.K., është "Deisis me Shenjtorë." Edhe te kjo ikonë përsëritet i njëjti, tip kornize, me zambakun e stilizuar. Piktura e kësaj ikone ndahet në dy skena. Sipër ndodhet skena Deisis, e përbërë nga tre figura. Në qëndër Krishti i ulur mbi fron duke bekuar, ndërsa djathtas e majtas tij, figura më këmbë e Shën Marisë dhe Joan Pagëzorit, me duar të kryqëzuara mbi gjoks e të përkulura paksa drejt tij. Poshtë ndodhen katër figura shenjtorësh, katër prej të cilave në plan të parë me ungjij ndër duar, të veshur me hiton, himation dhe petrahilë, me kryqe të mëdhenj ku predominon ngjyra e kuqe. Të dy skenat ndahen nga një mbishkrim

MBISHKRIMI NR: 7

✱ Η ΔΕΗCIC ΔΒϞΘV:ΔΙΟΓΟΗΕΡΟC CΗΝΗΚΝΟ : Α

ΡΟCΔΕ ϞΕ ΚΕ ΤΗΝ

ΧΟΡΟC
ΤΟΝ

ΚΕ
ΡΔΡ
ΧΟ
Ν

ΩΝ ΗΕΡΑΡΧΟΝ

ΔΕΗCΙΝ ΤΟΝ ΔCΛΩΝ ⟨⟩ ΔΙΟΓΤΔΜ ΡΡSΟΟ

Që do të thotë – rreshti sipër – " Lutje e shërbëtorit të Perëndisë Apostol, prift, bashkë me fëmijët e tij".

Në të dy anët e shenjtorëve -djathtas – Vallja e engjëjve.

Rreshti poshtë, do të thotë – " Lutje e shërbëtorit të Perëndisë Apostol Dhimitri" etj.

Kjo ikonë nuk ka asnjë mbishkrim, por duke gjykuar nga stili, tipat, karakteret, lloji i shkrimeve, dhe motivin e zambakut të stilizuar, pranojmë me bindje të plotë se kjo ikonë është pikturuar nga dora e Simonit të Ardenicës.



Fig. 6 Deisis me shenjtore

Veç ikonave që kemi përmendur më sipër, kemi identifikuar edhe dy ikona të tjera si "Deisis me Shenjtorë" (fig.6), e ngjashme me ikonën e të njëjtit titull, që e kemi përmendur më sipër dhe ikonën "Mbledhja e Kryeëngjujve" (fig.9) e cila është ekspozuar në ekspozitën "Mesazhe Biblike" në muzeun Mark Shagall, Nicë, Francë në vitin 1993. Edhe kjo ikonë nuk ka ndonjë lloj mbishkrimi që të tregojë autorin e saj. Pavarësisht nga kjo, këtë ikonë ia atribojmë piktorit Simon i Ardenicës, pasi stili i punimit, tipat, karakteret, shenjtorëve të çojnë te stili apo atelijeja e tij.

Për të vërtetuar se të gjitha ikonat e përmendura,



Fig. 9

pa mbishkrimin e autorit, i përkasin dorës së Simonit të Ardenicës, studiuam me vëmendje të gjitha elementët e përbashkët të tyre si: panelet e drurit, lloji i tyre, shtresën përgatitore, konceptimin kompozicional, stilin, tipat e shenjtorëve, veshjeve, karakteret e portreteve, elementet arkitektonikë e dekorativë, motivet, ngjyrat e deri tek teknika e pikturimit.

Ikonat janë pikturuar në dru arre dhe dru halor. Mbi dru është vendosur e njëjta kanavacë lini, dhe e njëjta shtresë përgatitore prej gipsi me lidhës tutkalli. Për të gjitha ikonat ai përdor të njëjtat ngjyra si: të kuqen, kafenë, blunë, jeshilen, okrën, të bardhën etj. Këto ngjyra ai i vendos te veshjet, pajimet e kuajve, arkitekturën, motivet dekorative, peizazhi duke i harmonizuar me njëra – tjetrën, sipas rastit.

Tipat e portreteve të shenjtorëve si ato të Shën Gjergjit, Shën Mëhillit, tipat e shenjtorëve të dyerve të bukura, të qytetarëve, të princërve, tipat e Shën Marive, Kryeengjujve etj, janë të ngjashme e të lënë përshtypjen sikur përsërisin njëri - tjetrin.

Një tipar dallues është mënyra e konceptimit dhe pikturimit të veshjeve të shenjtorëve në përgjithësi. Ato kanë elementë të përbashkëta të vizatimit, deri në modelimin plastik të tyre në mënyrë dekorative dhe grafike të konturuara me një linjë të hollë e të errët. Të dy figurat e Shën Gjergjit dhe figura e Shën Mëhillit kanë të njëjtën veshje luftarake, të njëjtat pelerina të lidhura nyje në gjoks, të njëjtat këmisha, kallçe dhe zbukurime me shirita ari. Të njëjtën veshje kanë princeshat, te ikonat e Shën Gjergjit, me të njëjtën ngjyrë të kuqe e të njëjtat kurora mbretërore si ato të mbretërve e princërve mbi muret e qytetit.

Kuajt paraqiten në të njëjtin pozicion luftarak, me të njëjtën ngjyrë të bardhë në të kaltër, të njëjtën krifë, të njëjtin bisht, të njëjtin trajtim plastik. Ky lloj konceptimi i kuajve vihet re më vonë edhe te ikonat e Jeromonakut, Joan Çetiri, dhe piktorët e tjerë anonimë. Të një lloj konceptimi janë llojet e kapistrave, frerëve dhe zbukurimeve të tyre.

Afërsisht të njejtë janë dragojt e të dy ikonave të Shën Gjergjit, në të njëjtin pozicion, me bisht të spërdredhur e kokën lart me gojën hapur, dhëmbë të mëdhenj e me dy brirë mbi të, me kthetra e flatra të mprehta.

Sipas fesë kristiane, bisha apo dragoi duhej të paraqitej sa më i tmerrshëm, për të dalë në pah fuqia dhe forca e shenjtit si përfaqësues i fuqisë hyjnore, i cili e ka vrarë atë. Kjo vërehet sidomos te ikona e Shën Gjergjit të Vithkuqit ku autori, pranë dragoit ka vendosur një shkrim "Ofovero Dhrako" që do të thotë – " Bisha e tmerrshme".

Te pesë nga ikonat e Simonit, në sfondet e tyre shfaqet arkitektura e një qyteti mesjetar, me kulla, çardakë me parmakë, taraca, dritare çardakësh dhe dhomash të ndara, kollona etj,godina me çati dy ujshe e formë kubeje, konike, dritare e dyer me kangjella. Të gjitha këto ansamble arkitektonike, me parmakët dhe thyerjet plastike, të kujtojnë shpesh qytetin mesjetar të Beratit, të përzierë me elemente të kështjellave mesjetare evropiane. Motivi i parmakut përsëritet, pothuajse në të gjitha ikonat. Pra piktori ka vendosur te ikonat e tij shumë elementë bashkëkohorë arkitektonikë, si shprehje e zonës ku ai jetonte.

Motivin e kangjellës autori e përdor te dyert, dritaret e sfondit arkitekturor të ikonës së Shën Gjergjit Vithkuq apo te ikona "Hyrja e Shën Marisë në tempull". Po ky motiv i pastër përdoret si element zbukurimi edhe në veshjet e katër shenjtorëve te dyert e bukura të kishës së Shën Marisë në Vithkuq. Ky motiv është përdorur një shekull më parë nga mjeshtër Onufri te dyert e bukura të kishës Evangjeliste në Berat.

Element i përbashkët te ikonat me sfond arkitekturor janë plepat e vendosur midis ndërtesave. Këto kanë një konceptim e trajtim të njëjtë. Gjithashtu, sfondet dyngjyrëshe janë të përbashkët te ikonat e Simonit të Ardenicës, pjesa e poshtme jeshile,

DO NOT COPY

ndërsa e sipërmja ngjyrë okër. Sfondi dyngjyrësh është një dukuri e përdorur edhe nga piktorë të tjerë bashkëkohës të njohur dhe anonimë si: Mësues Kostandini në Vithkuq, Konstandin Jeromonaku e më vonë Shpataraku etj.

Një motiv i përdorur, nga shumë piktorë ikonografë mesjetarë, është ai i zambakut të stilizuar. Edhe në katër nga ikonat e tij ndodhet ky motiv, diku në ngjyrë të kuqe e blu, e diku shtohet edhe varak, i bardhë apo argjend etj. Këtë motiv të stilizuar e shohim të gëdhendur te kanatat e dyerve të bukura të kishës së Shën Marisë në Vithkuq. Motivi i zambakut është ndër më kryesorët që do të trajtojë më pas piktori Konstandin Jeromonaku në të gjitha ikonat e tij me variacione të ndryshme.

Një element tjetër që na ndihmon në përcaktimin e autorësisë së disa ikonave është padyshim stili kaligrafik i mbishkrimeve të tyre, si formulat e përkushtimit, të autorësisë. Partisipet, emrat e skenave apo shenjtorëve, ku çdo autor ka llojin dhe stilin e tij të gërmave. Duke bërë krahasimet e shkrimeve, që kemi përmendur më sipër, e përforcon mendimin tonë se ato kanë tipare të përbashkëta si në konceptimin e formulave të përkushtimit, përkushtuesit apo donatorëve, deri te stili dhe lloji i gërmave të veçanta me mënyrën e shkurtimit të fjalëve etj. Kjo vihet re te shkrimet e ikonave që kemi trajtuar më sipër.

Pra, duke gjykuar mbi të gjitha, sa thamë më sipër mendojmë se ikonat që përmendëm, me mbishkrime e pa mbishkrime, janë punuar nga një autor i vetëm, që është Murgu, Simon i Ardenicës.

Mendojmë se e veçanta e artit të këtij autori është trajtimi i figurave të shenjtorëve apo dragojve, i peizazhit arkitektonik e në përgjithësi i motiveve floreale dhe gjeometrike, të cilat e bëjnë shumë dekorativ në krahasim me shumë piktorë të tjerë, paraardhës, bashkëkohës dhe pasardhës. Ai ka një stil të veçantë që i afrohet në konceptim Vitratit apo Gobelinit, me plane të sheshta të konturuara me një linjë të errët.

Duke e krahasuar me piktorët e tjerë bashkëkohës, si mësues Kostandinin apo Jeromonakun e të tjerë anonimë, ky piktor nuk është në lartësinë e tyre si artist, por është një piktor i zakonshëm ikonograf. Por, për artin ikonografik mesjetar shqiptar ka rëndësi: së pari ai është shqiptar, ka qenë murg në një nga manastiret e dëgjuara për gjithë zonën e Beratit e Shqipërinë, siç është manastiri i Ardenicës. Ka patur një atelie të pikturimit të ikonave si shprehje e rolit mjaft të rëndësishëm, që kanë luajtur manastiret e atelietë e tyre, në zhvillimin dhe çuarjen më tej tek brezat pasardhës të traditës e jetës monastike dhe artistike.

Ai vendos një gur sado të vogël në historinë e artit mesjetar shqiptar duke lënë një dëshmi modeste në përcjelljen e mesazheve shpirtërore – artistike, e historike të kohës e vendit ku ai ka jetuar, si shprehje e një periudhe kalimtare nga shkolla e Beratit, me përfaqësuesit e mëdhenj Onufrin, Nikollën, Qipriotin e Joanin, te pasardhësit e shekullit të XVII, të njohur e anonimë deri te e ashtuquajtura shkolla e dëgjuar e Korçës, me përfaqësuesit më të mëdhenj si Jeromonakun Shpatarakun, vëllezërit Zografi, Selenicasin e Çetirët, të cilët u bënë zëdhënësit e kësaj shkolle të dëgjuar në Shqipëri e jashtë saj, të pasuesve të tjerë si Mihal e Dhimitër Anagnosti.

PO NOT COPY

BIBLIOGRAFIA

1. Dh. Dhamo, K. Naslazi – U identifikua për herë të parë gjatë sistemimit shkencor të fondeve.
2. Dh. Dhamo – "Piktura mesjetare e Vithkuqit" – Material në arkivin e Institutit të Historisë.
3. K. Naslazi – "Piktori mesjetar Kostandin Jeromonaku"- monografi e përgatitur për botim.
4. K. Naslazi – "Piktorët mesjetarë Kostandin e Athanas Zografi dhe bijtë e tyre Terpo, Evthim dhe Naum" Monografi e përgatitur për botim.
5. K.Naslazi – "Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar Shqiptar" Katalog i përgatitur për botim.
6. K. Naslazi – "Piktori mesjetar Kostandin Jeromonaku" Monografi e përgatitur për botim.
7. P. Thamo, A. Meksi – Arkitektura pasbizantine në Shqipëri- Monumentet Nr.11 Tiranë 1976

DO NOT COPY

The Iconographic work of the painter Simon of Ardenica

This article is about some of the most famous icons of the XVII century. The school of Berat and being based on the tradition of the Paleolog art of that period had a great effect on the work of painters at that time. We can mention the icons of Postenan in 1635, "Pantocrator Christ in 1651 in Bezhan Ersekë; the icons of teacher Constantine in 1685; the icons of Constantine Jermonak in 1693-1694 and the icons of the monk

Simon of Ardenica created progressively during the VIIth century seen in a new artistic and emotional way.

Simon of Ardenica is not a very well known painter. He was identified for the first time with the inscription of the icon of Saint George (photo. 1). Later were identified even some other icons from the churches of south-east Albania such as Berat, Lushnje, Elbasan, Vithkuq of Korça etc. Some of them are "The entrance of Saint Maria in the temple" (photo.2); "The appearance of Christ in Jerusalem" (photo. 3), "Saint Maria asleep" (photo. 4) which belong to the church of "Saint Maria" in Vllahern Berat. "Saint Michel" (photo. 5) which belong to the Monastery of Ardenica, "Daises with Saints", the church of "Saint John Vladimir" in Elbasan, "Saint George" (photo. 7) and "Beautiful doors" (photo.8) and the church of "Saint Maria" in Vithkuq.

Simon appears as a usual iconographer painter, but what is specific about him and makes him different from the others is the style he uses in the post Byzantine picture in the end of the XVII century. Seven of his pictures are framed with carved or painted motives.

The icons are painted with watercolor technique mixed with yellow liquid of the egg and a gypsum layer. There is also added an organic establisher compound by livestock origin material.

Some of them have inscriptions in the ancient Greek language. In the icons of "Saint George" and "Saint Michele" (photo. 1,5) are tow inscriptions one of which belongs to the dedicators or donators, while the other has to do with the contributor or the author of the icon painting (Inscription 1, 2, 3, 4) where is written the year 1690.

In the icon "The entrance of Saint Maria in the temple" exist some written fragments placed on the four sides of the frame (inscription 5), where among the others there is even the year 1689.

Except the icons we mentioned above there were identified even tow other icons such as: "Daises with the Saints" (photo 6) and "Archangel meeting" (photo9).

Both of these Icons are attributed to Simon of Ardenica because the style, the type, and the character of the saints are the one he used.

What makes this author different from the others is the decorative treatment of the saints' photos, the landscape, and the floral and geometric motives etc., contoured with a dark line in flat plans that give the impression of a gallery.

Kristofor NASLAZI

DO NOT COPY

Emin RIZA

Propozim për përfshirje në listën e pasurive botërore, dorëzuar nga Shqipëria

QENDRA HISTORIKE E BERATIT 2005









DO NOT COPY



Foto [1]



Foto [2]



Foto [3]

FOTO[1] Pamje e Lagjes MANGALEM
FOTO[2] Pamje e Lagjes GORICE
FOTO[3] Pamje e Lagjes KALA

DO NOT COPY

PËRCAKTIMI I PASURISË

HARTA DHE PLANE QË TREGOJNË KUFIJT E PASURISË SË PROPOZUAR



- HARTA NR.1 - QENDRA HISTORIKE E BERATIT
MONUMENTE TE KATEGORISE SE PARE DHE TE DYTE



LEGJENDA

- MONUMENTE TE KATEGORISE SE PARE
- MONUMENTE TE KATEGORISE SE DYTE
- RRUGE PEDONALE
- RRUGE AUTOMOBILISTIKE
- KUFIRI I QENDRES HISTORIKE
- KUFIRI I ZONES TAMPON
- LUMI

- LISTA E MONUMENTEVE TE KATEGORISE SE PARE QE NDODHEN BRENDA KUFIRIT TE QENDRES HISTORIKE

- LISTA E MONUMENTEVE TE KATEGORISE SE PARE QE NDODHEN BRENDA KUFIRIT TE ZONES TAMPON

- LISTA E MONUMENTEVE TE KATEGORISE SE PARE QE NDODHEN JASHTE KUFIRIT TE QENDRES HISTORIKE DHE ZONES TAMPON

DO NOT COPY

DO NOT COPY

- HARTA NR.2 - QENDRA HISTORIKE E BERATIT
MONUMENTET SIPAS GJINIVE

LEGJENDA

SHKALLA : 1 / 2000

- HARTA NR.3 - QENDRA HISTORIKE E BERATIT
GJENDJA E KONSERVIMIT TE MONUMENTEVE - 2005



LEGJENDA

- MONUMENTE QE KANE NEVOJE EMERGJENTE PER RESTAURIM
- MONUMENTE QE KANE NEVOJE PER NE RRYFUE KONSERVUESE
- MONUMENTE NE GJENDJE TE MIRE
- MONUMENTE NE GJENDJE SHUME TE MIRE
- RRUGE PEDONALE
- RRUGE AUTOMOBILISTIKE
- KUFIRI I QENDRES HISTORIKE
- KUFIRI I ZONES TAMPON
- LUMI

SHKALLA : 1 / 2000

V

DO NOT COPY

DO NOT COPY

PËRSHKRIMI I PASURISË

a. Përshkrimi i Pasurisë

Qyteti i Beratit shtrihet në Shqipërinë qendrore duke pasur në lindje masivin madhështor të malit të Tomorrit, ndërsa në perëndim fushën pjellore të Myzeqesë. Lumi i Osumit e përshkon qytetin, duke i dhënë gjallëri. Ai e kalon atë nëpërmjet një ngushtice natyrore, e cila ka nga veriu Kalanë e Beratit dhe nga jugu atë të Goricës. Të ngritura të dyja mbi dy kodra ato kontrollonin rreptë kalimet në luginën e Osumit. Ndërsa Kalaja e Goricës mbeti thjesht qendër e fortifikuar, ajo e Beratit qe zanafilla, vetë qyteti dhe më pas pjesë e rëndësishme e tij. Falë bashkëmarrëdhënieve të qytetit të përmendur, me ata përreth që në periudhën antike si me Apolloninë, Nikaen, Bylisin, Dimalin etj, Berati në sajë të pozicionit gjeografik, kushteve të përshtatshme ekonomike dhe vitalitetit të banorëve, si rrallë qytetet ballkanike, gjalloi pa ndërprerje në shekuj.

Një prej treguesve konkret të vitalitetit të banorëve shekullor, të të njëjtit etnos të qytetit, emërtuar ilirë, dhe shqiptarë është veprimtaria e tyre ndërtuese. E periudhave dhe gjinive të ndryshme, me arritje të rëndësishme për kohën, kjo veprimtari ndërtimore shekullore, ka ardhur në ditët tona si dëshmi konkrete historiko - kulturore. Në sajë të jetëgjatësisë së funksionit të këtyre ndërtimeve, strukturave të qëndrueshme teknike, kujdesit të banorëve për mirëmbajtjen e tyre dhe sensibilizimit krahasimisht të hershëm të shtetit shqiptar për vlerësimin e kësaj pasurie, sot Berati shfaqet si një bashkësi vlerash madhore urbanistiko - arkitekturore dhe artistike.

Në gjendjen e sotme, qendra historike e Beratit vjen me tre kategori kryesore ndërtimore, fortifikimit, ndërtimeve të kultit dhe arkitekturës folklorike, të cilat janë pjesë njësish urbanistike të përcaktuara qartë. Zgjedhja e truallit, mbi të cilin u ngrit kjo qendër e banuar, plotëson kërkesat për mbijetesë si në planin ekonomik ashtu edhe atë të sigurisë, duke qënë faktori i dytë me rëndësi të posaçme. Si qendër e banuar Berati, sipas dëshmive arkeologjike i ka fillimet që në agimet e shoqërisë njerëzore, më saktë që në periudhën Neolitike (2600 – 1800 p.e.s). Gërmimet arkeologjike të kryera gjatë viteve 1976 – 1980 kanë pohuar faktin se vendbanimi i parë njerëzor është vendosur në hapësirën e Kalasë së Beratit, rreth 26 Shekuj p.e.s. Rrjedhimisht provohet se kjo zonë ka qenë vazhdimisht e banuar.

Qyteti i mirëfilltë lindi në shekullin IV p.e s si qendër e fortifikuar. Ai parapëlqen kodrën në të djathtë të lumit Osum, me hapësirë të gjerë dhe lehtësisht të fortifikueshme. Në të njëjtin shekull, ndërtohet me



RIPRODHIM I GRAVURES "BERATI", EDWARD LEAR, 1848

kodrën përkundrejt, kalaja e Goricës për të sunduar kalimin e rëndësishëm nëpërmjet luginës së Osumit. Në binomin Kala e Beratit, Kala e Goricës, e para qe në krye njëherazi qendër e banuar, për të ardhur, pa ndërprerje e tillë deri më sot, ndërsa Kalaja e Goricës u ndërtua dhe mbeti fortifikim ushtarako – strategjik.

Kalaja e Beratit ngrihet mbi një kodër me faqe të pjerrëta, madje pjerësisht të thepisura, duke

lehtësuar mbrojtjen. Ashtu si përgjithësisht, konturi i mureve rrethues të fortifikimit ndjek konfiguracionin e truallit, duke iu afruar formës së një trekëndëshi. Jetëgjatësia 2400 vjeçare e kalasë, e cila ndoqi pa ndërprerje rrjedhat e historisë, duke qenë pjesë e saj, natyrshëm shfaqet me një varg zgjerimesh, shkatërrimesh dhe rindërtimesh. Këto të fundit u realizuan sipas teknikave të kohës, të cilat për këtë kategori ndërtimore ndikoheshin dukshëm prej evolucionit të teknikës luftarake. Kështu sot kalaja madhështore e Beratit, shfaqet si një bashkësi periudhash të ndryshme ndërtimi, të cilat mund të cilësohen si periudhat ilire, bizantine, të principatave feudale shqiptare, ajo e pushtimit otoman dhe e pashallëqeve të mëdha shqiptare.

Periudha ilire me këtë fortifikim ka lënë gjurmë të qartë në fragmente muresh dhe në disa kulla. Teknika e ndërtimit është me blloqe gurësh me gjatësi 60 – 250 cm, lartësi 40 – 50 cm, ndërsa me trashësi 50 – 60 cm. Bashkimi i gurëve bëhet pa lidhës. Studiues të fushës kanë hedhur mendimin se Berati i sotëm është ANTIPATREA antike e përmendur prej Polibit dhe Tit Livit. Pas pushtimit romak të qytetit i cili rezistoi fuqishëm, Berati pësoi shumë shkatërrime. Fragmente të qeramikës ***"terrasigillata"*** tregojnë se qyteti e mori veten shpejt.

Gjatë periudhës Bizantine, emrin e Beratit e ndeshëm në listën e fortifikimeve të perandorit Justinian. Në shekullin e VI Berati ndeshet me emërtimin PULCHERIOPOLIS. Ndërsa gjurmët e rindërtimeve të periudhës së hershme Bizantine është vështirë t'i identifikosh, ato të mëvonshme dallohen prej teknikës së ndryshme prej asaj të periudhës Ilire. Eshtë fjala për teknikën e muraturës, elementit thelbësor të fortifikimit, e cila tani realizohet me muraturë të çrregullt gurësh të papunuar lidhur me breza tullash përforcuese. Gjurmë të këtyre ndërtimeve ruhen me fragmente muresh dhe kullash të Kalasë. Në fillim të shekullit XIII, fortifikimi rimëkëmbet prej Mihail Komnenit, Despot i Epirit, duke përfshirë në këtë veprimtari shumë kulla dhe pjesë murature. Monogrami me tulla në murin verior të barbakanit dëshmon për sa më sipër. Në shekujt XIII është ndërtuar dhe oborri i fortifikuar me kryekullën për të penguar afrimin e pushtuesve drejt hyrjes kryesore. Shekullit XIII i përkasin edhe ndërtime të tjera. Vlen të përmendet kështjella e brendshme e ndarë më vonë në dy pjesë. Ajo shërbente për veçimin e garnizonit dhe parisë. Në hapësirën JL të kështjellës ndodhet një sterë e madhe, mbi të cilën ngrihej pallati i parisë së qytetit. Të kësaj periudhe janë edhe dy ledhe anësore, që nisnin prej pjesës jugore të Kalasë dhe përfundonin me dy kulla në lumin e Osumit.

Gjatë periudhës së principatave feudale shqiptare prej fundit të shek. XIII dhe gjatë shek. XIV, pati një veprimtari të gjerë rindërtuese në Kalanë e Beratit si në muret rrethues dhe shumë kulla. Krahas, në këtë periudhë u bë ndarja e hapësirës së kështjellës së brendshme, si dhe ledhet anësore që nisnin prej pjesës jugore të kalasë dhe përfundonin në lumë, ndërtohen me muraturë guri. Teknika e muraturës është e llojit të derdhur, duke ndërtuar dy parete me gurë të papunuar dhe copa tjegullash lidhur me llaç gëlqereje, ndërmjet tyre është hedhur një përzjerje gurësh dhe çakulli lidhur me një rrjetë trarësh druri për të komplekësuar atë.

Periudha e hershme e sundimit Osman, në shekujt XV – XVII, nuk paraqet risi të rëndësishme në kalanë e Beratit sepse ajo u mor në befasi prej turqve dhe kështu rindërtimet e feudalit shqiptar Muzakaj nuk pësuan dëmtime. Megjithkëtë, kryesisht pas tentativës së Gjergj Kastriotit – Skënderbeut për të çliruar Beratin më 1455, muret rrethues të Kalasë së Beratit u dëmtuan nga bombardimet. Rindërtimet e kësaj periudhe në meremetimin e disa mureve dhe kullave, u shoqëruan dhe me ndërtimin e dy kullave. Me rëndësi, si rast i rrallë, duhet konsideruar ndërtimi i një galerie e cila fillonte nga njëra prej kullave të reja dhe përfundonte në një kullë të ngritur në bregun e djathtë të Osumit. Kjo galeri siguronte furnizimimin e kalasë me ujë prej lumit.

Veprimtaria e fundit rindërtuese në Kalanë e Beratit i përket asaj të Pashallëqeve të mëdha shqiptare të shekullit XVIII. Feudali shqiptar Ahmet Kurt Pasha, kryen punime në Kalanë e Beratit më 1768. Edhe Ali Pashë Tepelena kreu punime në këtë fortifikim. Rindërtimet në muraturë janë me të njëjtën teknikë të periudhës paraardhëse. E reja e kësaj veprimtarie janë dy kulla të reja. Ndërtimi i tyre në faqen jugore, si dhe rindërtimi i atyre ekzistuese është i kushëzuar prej synimit për të mbuluar me zjarr

PROTOTYPE COPY

artilerie mbarë zonën përreth Kalasë. Kullat kanë formë poligonale dhe muret kanë pjerrësi në faqen e jashtme. Frëngjitë për topa kanë formë gjysëm trungu koni.

Pas një kryengritjeje kundër pushtimit osman më 1834, Kalaja e Beratit dëmtohet rëndë prej tyre, duke humbur praktikisht funksionin mbrojtës, gjithnjë duke ruajtur vlera autentike të periudhave të ndryshme të ndërtimit. Ajo sot vjen si një prej fortifikimeve më të ruajtura në mbarë hapësirën shqiptare dhe më gjerë, me larmi fazash dhe teknikash ndërtimi dëshmi e jetëgjatësisë rreth 2400 vjeçare.

Një kategori tjetër ndërtimore e pranishme në qytetin e Beratit është ajo e kultit, e cila lidhet me besimin kristian dhe atë musliman. Ndërtimet e kultit kristian janë më të hershme dhe shtrihen kryesisht në lagjen e banuar brenda fortifikimit, por edhe në qytetin e hapur. Ndjekja e historisë kishtare të Beratit mund të kryhet kryesisht prej ndërtimit të kishave, shumë prej të cilave ruhen ende, ndërsa burimet e shkruara janë të pakta. Arkitektura paleokristiane thuajse nuk ka gjurmë ndërtimesh në Berat me përjashtim të tre elementeve, dikur pjesë e kishave paleokristiane. Periudha bizantine e shekujve VII – XVpërkundrazi është e pasur me ndërtime të kultit kristian, veçanërisht gjatë fundit të kësaj periudhe. Në përgjithësi ato janë me përmasa të vogla dhe lidhen kryesisht me qendrën e banuar brenda mureve të fortifikimit. Ndër kishat e periudhës bizantine në Berat veçohen kisha e Shën Mëri Vllahernës ndërtuar në brendësi të kalasë në fillim të shekullit XIII kur Berati qe qendër e rëndësishme e Despotatit të Epirit. Kisha është e tipit kryq të brendashkruar me kupol mbi tamburë. Ajo ruan vlera të rëndësishme të pikturës murale, realizuar në vitin 1578, të cilat mbajnë autorësinë e Nikollës, birit të piktorit të shquar Onufri. Kisha e Shën Triadhës, ndërtuar gjithashtu në hapësirën brenda rrethimit të kalasë, i përket hapësirës kohore të gjysmës së dytë të shekullit XIII deri në fillimin e shekullit XIV. Ajo është e tipit kryq i brendashkruar. Kisha e Shën Mëhillit gjithashtu e tipit kryq i brendashkruar, me kupol, ngrihet mbi një truall të thepisur shkëmbor jashtë mureve të kalasë, në hapësirën ndërmjet dy pritave që lidhin kalanë me lumin, në perëndim të lagjes "Mangalem". Ngushtësia e truallit ka kushtëzuar përmasat relativisht të vogla të ndërtimit, i cili mund të klasifikohet si kapelë. Ndërtimi i saj, bazuar kryesisht në strukturën, i përket gjysmës së dytë të shekullit XIV.

Pas pushtimit osman të Shqipërisë, Berati mbeti deri në 1767 në vartësi të Patrikanës së Ohrit. Gjatë shekujve të pushtimit Osman në Berat u ngritën kisha të reja si në Kala, ashtu edhe në lagje të tjera të qytetit. Ndër to përmendim kishën e Shën Todrit, me një hapësirë të vetme, rindërtuar në shekullin XVI, atë të Kostandinit, një kapelë e thjeshtë, me piktura murale të vitit 1639, kishën e Shën Mitrit rindërtuar në kapërcyellin e shekujve XVI – XVII, dhe pikturuar në vitin 1607. Për t'u përmendur është kisha e Ungjelizmoit, ndërtuar rreth shekujve XVII – XVIII dhe me përmasa më të mëdha se kishat e tjera të lagjes brenda Kalasë. Në lagjen "Goricë" në vitin 1864 ndërtohet një kishë e tipit bazilikë trenefëshe. Në lagjen "Vakëf" në gjysmën e dytë të shekullit XIX është ndërtuar një bazilikë trenefëshe. Vend të rëndësishëm në arkitekturën kishtare pasbizantine në Berat, zë Katedralja e Shën Mërisë në lagjen Kala, rindërtuar në vitin 1797, e cila mund të konsiderohet monumenti më përfaqësues i arkitekturës pasbizantine në Berat. Kisha është bazilikë trenefëshe, ku janë përdorur gjerësisht qemeret dhe kupolat. Ajo rrethohet në tre anë prej një portiku që del në oborr dhe disa ndërtimeve ndihmëse në anën veriore dhe perëndimore. Për tu theksuar janë përmasat e mëdha të veprës dhe ikonostasi me vlera i saj.

Kishat e Beratit, krahas vlerave arkitekturore, ruajnë edhe vlera të rëndësishme arti në fushën e pikturave murale dhe ikonave krahas rekuizitës së pasur ku shquhen ikonostaset. Në pikturat murale të kishave të Beratit, kryesisht të atyre në lagjen Kala kanë punuar piktorë të afirmuar të Kohës së Onufrit, i biri i tij Nikolla, Onufër Qiprioti, gjatë shekullit XVI, Gjergj dhe Joan Çetiri, gjatë shekullit XVIII, etj. Këta piktorë kanë realizuar vepra me vlerë me teknikën e afreskut si dhe ikona në Kishat e Shën Todrit, Shën Triadhës, Shën Vllahernës, Shën Kollit, Shën Kostandinit dhe Elenës, si dhe Katedrales e Shën Mërisë në lagjen Kala. Në Katedralen e Beratit, kthyer në muze të ikonografisë ruhet një fond me

DOKUMENT

vlera të mëdha ikonash të Beratit dhe objektesh kishtare, dëshmi të nivelit të lartë artistik për kohën, të veprimtarisë në këtë fushë.

Nuk mund të mos përmenden edhe kodikët e Beratit, emërtuar Beratinus, dy prej të cilëve, përkatësisht të shekujve VI dhe X janë përfshirë programin e UNESCO's "Kujtesa e Botës".

Me pushtimin osman të Beratit më 1417, repertorit të ndërtimeve të kultit iu shtua edhe një gjini tjetër ajo muslimane. Kthimi i një pjese të mirë të popullsisë në fenë e re krijoi kushtet që këto ndërtime të kultit të ri të përhapen në mbarë qytetin e Beratit, tashmë me shtrirje të gjerë jashtë mureve të fortifikimit. Në nomeklaturën e ndërtimeve të kultit musliman në Berat, vendin kryesor e zënë xhamitë, krahas janë ndërtuar teqe, tyrbe dhe medrese. Ndër xhamitë e para të Beratit është ajë që emërtohet – Xhamia e Kuqe, ndërtuar në shekullin XV, prej sulltan Bajazitit. Ajo sot ruhet në gjendje rrënojë. Në të është zbatuar teknika e muraturës së klauzonazhit. Me gjasë kjo xhami i shërbente garnizonit turk të kalasë. Xhamia Mbret, me emrin e sulltan Bajazitit II, është ndërtuar në lagjen e poshtme, pranë Pazarit në fund të shek. XV. Ajo është e tipit me sallë me çati dhe hajat. Me kapërcyellin e shekujve XVII – XIX xhamia ka pasur një rindërtim. Kjo xhami e ndërtuar në qendër të qytetit të vjetër, përbën elementin kryesor të një kompleksi kulti të mesjetës së vonë në Berat.

Xhamia e Plumbit është ndërtuar në vitet 1553 – 1554 nga feudalët vendas Skuraj. Ajo është e tipit me sallë mbuluar me kupol, dhe paraprihet prej portikut, duke pasur edhe minaren. Ajo në planin e teknikës së ndërtimit dallohet për muraturën e tipit klauzonazh dhe është një prej shembujve më të arritur të kësaj gjinie në Berat dhe më gjerë.

Xhamia e Beqarëve është ndërtuar në vitin 1827, në pjesën e poshtme të lagjes 'Mangalem', prej esnafit të beqarëve. E ndërtuar në një zonë të pjerrët shkëmbore, si mbarë ndërtimet e lagjes, xhamia është kompozuar me shkallëzim, duke qenë pjesërisht me kat. Niveli i sipërm, në të cilin zhvillohet ndërtimi, formohet prej sallës së lutjeve dhe portikut të gjerë pas. Mbulesa është me çati druri. Ndërtimi bashkëpërfshihet natyrshëm me karakterin specifik të lagjes Mangalem.

Ndër teqetë e Beratit vlera të rëndësisë së veçantë paraqet Teqeja Helvetije, ndërtuar në fundin e shekullit XVIII. Eshtë njëri prej objekteve më të arritura të gjinisë së monumenteve të kultit musliman në Berat dhe më gjerë. Ajo së bashku me xhaminë Mbret janë objektet kryesore të kompleksit islamik të Beratit. Ndërtimi formohet prej sallës së lutjeve dhe mjedisit të varreve, që paraprihen prej një portiku. Kjo vepër dallohet për teknikën e ndërtimit me gurë të latuar dhe dekorin e pasur të brendësisë, ku shquan tavani i sallës së lutjes.

Në qytetin e lashtë të Beratit, krahas fortifikimit dhe ndërtimeve të kultit ruhet një pasuri e rëndësishme kulturore në fushën e banesës popullore, e cila shfaqet me vlera të rëndësishme historiko – kulturore si në planin arkitekturës ashtu edhe atë urbanistik. Banesa Beratase për nga tipologjia dhe trajtimi zë një vend të posaçëm në kuadrin e banesës tradicionale shqiptare. Ajo i përket kryesisht shekujve XVIII – XIX dhe përgjithësisht shtrihet në lagjet Kala, Mangalem dhe Goricë, duke qënë e pranishme edhe në lagjet e tjera fushore të qytetit të vjetër. Natyrisht, banesat vijnë sot me ndryshime në rrjedhë të kohës, por si rrallë në historinë e arkitekturës shqiptare një ngjarje katastrofike si tërmeti i 17 tetorit 1851, ka pasur pasoja në karakterin arkitekturor të qytetit. Veçanërisht banesat pësuan dëmtime të rënda, kryesisht në katin e sipërm, gjatë këtij tërmeti. Sipas dëshmive të kohës, para këtij tërmeti banesat e mbyllura të llojeve të ndryshme kanë qenë ndërtuar me mur guri në të dy katet. Pas tërmetit, duke ruajtur, përgjithësisht katin përdhe të ndërtuar me muraturë guri, kati i parë pësoi ndryshime, duke përvetësuar gjerësisht teknikën në skelet druri, daljet në formë erkeri, dritaret e shumta, etj. Berati i sotëm e ruan mirë këtë gjendje, e cila shfaqet me njësi të theksuar trajtimi arkitekturor.

Tipologjikisht banesat Beratase janë ndikuar ndjeshëm prej truallit të aksidentuar shkëmbor mbi të cilin ngrihen tre lagjet e vjetra, më të rëndësishmet e qytetit. Klasifikimi i kompozimit të banesës Beratase do të dallonte tre kategori banesash; ato me çardak, banesat e mbyllura me vendosje normale dhe paralel vijave të niveleve dhe zgjidhjet e veçanta. Banesat me çardak të Beratit, të njohura në shumë qytete Shqiptare në të kaluarën, janë

DO NOT COPY

një arritje madhore në këtë tipologji. Kjo banesë njihej në trojet shqiptare që para shekullit XV, por gjatë shekujve XVII – XIX, arriti zgjidhje të zhvilluara. Banesat e muzeut etnografik, Simsisë dhe Haxhistasës janë shembujt më të arritur të këtij tipi. Këto banesa i përkasin periudhës prej gjysmës së dytë të shek. XVII dhe deri rreth fillimit të shekullit XIX.

Banesat me vendosje normale dhe paralel vijave të niveleve, të ndikuara prej truallit të aksidentuar shkëmbor të lagjeve të vjetra të Beratit, kanë përhapje të gjerë veçanërisht në lagjet Mangalem dhe Goricë. Ato karakterizohen prej thyerjeve në volum për t'iu përshtatur truallit. Rindërtimet e shumta në katin e sipërm të këtyre banesave nuk cënuan ndjeshëm kompozimet origjinale, por futën koncepte të reja në teknikën e ndërtimit dhe elementët arkitekturorë. Krahas, banesa me qoshk të mbyllur gjeti zbatime, megjithëse disi të sforcuara gjatë këtyre rindërtimeve masive të banesave beratase të shekujve XVII – XIX. Zgjidhjet e lira, ndeshen gjithashtu dendur në tipologjinë e banesës beratase. Ato, gjithë duke ruajtur repertorin e ambienteve të banesës tradicionale beratase dhe shqiptare, më gjerë, shquhen për kompozime të improvizuara, duke synuar përshtatjen me truallin e larmë mbi të cilin ngrihen.

Tërësia e këtyre ndërtimeve gjithmonë ka jetuar në një hapësirë urbanistike të përcaktuar, e cila gjithë duke qenë e paparaprirë prej planifikimit, ka qenë e udhëhequr prej kriteresh të kristalizuar prej përvojës. Në Beratin e ndërtuar mbi një reliev sa të larmë aq edhe dinamik, nga pikëpamja urbanistike ndeshim tre koncepte të ndryshme.

Së pari, vjen në konsideratë lagjja e banuar brenda mureve rrethues të Kalasë, e banuar që prej antikitetit dhe vijueshëm deri më sot. Eshtë vështirë të ndiqet evolucioni shumëshekullor i skemës urbanistike të lagjes Kala. Megjithëkëtë mund të pohohet se tre arterie kryesore të cilat kanë përshkuar Kalanë prej lagjes veriore në jug të saj, njëra në pjesën qendrore dhe dy të tjerat përbri mureve rrethues janë të gjithëkohshme. Rrugë të ndërmjetme tërthore, apo pjesërisht paralele me arterierit kryesore e kanë bërë këtë qendër të banuar, lehtësisht të kalueshme. Kuptohet se fortifikimi, me saktë hyrja e vetme e rëndësishme e tij dhe qarkullimi sa më e lirë, përbri mureve të rrethimit kanë kushtëzuar zgjidhjen e arterieve kryesore ndërlidhës të kësaj qendre.

Së dyti, vend të rëndësishëm për zgjidhjet urbanistike zënë lagjet Mangalem dhe Goricë, thuajse me tipare të njëjta të konfiguracionit të truallit. Lagja Mangalem duket se ka filluar të ngrihet nga fundi i shekullit XV, apo fillimi i atij XVI, ndërsa lagjja Goricë rreth mesit të shekullit XVII. Në të dy këto lagje arteriet kryesore ndërlidhëse ndjekin vijat e niveleve, dhe ndërlidhen ndërmjet tyre me kalime tërthore shpesh tejet të pjerrta, madje në disa raste me shkallë. Vargëzimi i ndërtimeve, me dalje të drejtpërdrejta në rrugë, shfaq qartë zgjidhjet urbanistike të këtyre lagjeve, të arritura, me treguesit thelbësorë, rreth mesit të shekullit XVII.

Kategorinë e tretë, të zgjidhjeve në planin urbanistik të Beratit antiko – mesjetar, e paraqesin ultësirat në lindje dhe perëndim të Kalasë. Në këto lagje me fillesa në shekullin e XVI – XVII, ndeshim kriteret e njohura urbanistike të qytetit të mesjetës së vonë në Shqipëri dhe Ballkan, që karakterizohet prej rrjetit rrugor të improvizuar, banesa me oborr të gjerë rrethuar me mure. Vetëm ndërtimet e kultit me përmasat dhe trajtimin e tyre thyenin monotoninë e këtyre lagjeve.

Në gjendjen e sotme, veçanërisht njësitë urbanistike të Kalasë dhe lagjeve Mangalem dhe Goricë ruhen mirë. Berati i vjetër fushor ndiqet me vështirësi për shkak të ndryshimeve, ndërsa zona e pazarit ka humbur krejtësisht.

b. Historiku dhe zhvillimi

Qyteti i Beratit ka një histori të shtrirë gjerë në kohë. Kategoritë e ndryshme ndërtimore të Beratit si fortifikimi, ndërtimet e kultit dhe arkitektura popullore, në gjendjen e sotme, i përkasin hapësirave të ndryshme kohore. Sa më gjatë në kohë shtrihet kategoria ndërtimore, aq më të shumta janë ndryshimet, rindërtimet apo zgjerimet e saj. Kështu Kalaja e shekullit IV p.e.s. shfaqet me shumë faza ndërtimi, për t'u pasuar nga kishat e periudhës bizantine të shekujve XIII – XIV, asaj pasbizantine të shekujve XV – XIX, dhe së fundi kategoria e banesës, kryesisht e shekujve XVIII – XIX Ndryshimet në këtë të fundit

DO NOT COPY

kryesisht lidhen me tërmetin katastrofik të vitit 1851, pa përjashtuar ato për shkaqet, të themi, të natyrshme të zgjerimit të familjeve dhe ndryshimeve të mënyrës së jetesës.

Dëshmitë më të hershme për ekzistencën e një vendbanimi në hapësirën e Kalasë së Beratit vijnë që prej periudhës së bakrit dhe fillimit të bronzit, duke provuar se në vitet 2600 – 1800 p. e. s. në këtë hapësirë kishte një qendër të banuar. Fragmente qeramike dëshmojnë se gjatë, periudhës së parë të hekurit, shekujt VII – VI p.e.s, këtu ishte zhvilluar një vendbanim paraqytetar me lidhje tregtare me qendra të tjera të vendit. Rreth mesit të shekullit IV p.e.s, kodra në të djathtë të lumit Osum, rrethohet me mure prej gurësh të latuara, me një sipërfaqe prej 9,60 ha. Pak më vonë ndërtohet edhe kështjella e Goricës, në kodrën përkundrejt, për të kontrolluar luginën e rëndësishme të Osumit.

Berati është identifikuar në antikitet me ANTIPATREAN. Kjo qendër e fortifikuar i qëndroi pushtimit romak, duke pësuar pas pushtimit hakmarrje ndaj popullsisë dhe rrënime në fortifikim. Por jeta në qytet rifilloi shpejt, siç dëshmojnë zbulimet arkeologjike. Në periudhën e vonë antike, në shekujt IV – VI dyndjet e shpeshta në Epirin e ri, detyruan forcimin e fortifikimeve ku përfshihet edhe Berati. Në udhërrëfyesin e Hieroklitit, në vitin 533, Berati përmendet me emrin PULCHERIOPOLIS, sipas emrit të bashkë-Perandores në fronin e Bizantit në vitet 450 – 453. Berati hyn në mesjetë si qendër e rëndësishme me rënien e qyteteve të fuqishëm përreth tij. Gjatë mesjetës emri PULCHERIOPOLIS zëvendësohet me atë BERAT duke u përmendur së pari më 1018. Berati bie nën pushtimin Bullgar në vitet 860 deri më 1018 me një ndërprerje.

Me rënien e Perandorisë Bizantine prej Kryqtarëve më 1204, dhe me krijimin e Despotatit të Epirit, Berati kthehet në avanpostin verior të tij. Në vitin 1277 Anzhuinët u përgatitën për pushtimin e trojeve ndërmjet Durrësit, Beratit dhe Vlorës. Berati rrethohet në vitin 1280. Pas shumë përpjekjesh ata arritën të marrin lagjet e jashtme të qytetit. Këto lagje duhen kërkuar në shpatin perëndimor të Kalasë. Krahas, në këtë kohë ekzistonte edhe qyteti i poshtëm, në jug të Kalasë mbrojtur prej dy ledhesh paralele që fillonin prej mureve të kalasë e përfundonin në lumë. Por Bizanti reagoi dhe i theu Anzhuinët në Berat, duke shënuar fundin e përpjekjeve të tyre për aneksimin e tokave shqiptare. Në shekullin e XIV, pas pushtimit Serb në vitet 1345 – '46 , i cili zgjati pak, Berati bie nën sundimin e familjes feudale të Muzakajve një nga më të fuqishmet e kohës. Berati gjatë periudhës së viteve 1356 – 1417 qe kryeqendër e principatës së Muzakajve.

Gjatë shekujve XIII – XIV, në Kalanë e Beratit dhe në lagjen e poshtme të fortifikuar ndërtohen tre kisha me vlera të rëndësishme akitekturore dhe artistike. Eshtë fjala për kishën e Shën Mëri Vllahernës, Shën Triadhës dhe Shën Mëhillit.

Në vitin 1417, kur Berati krahas qendrës së fortifikuar të banimit në Kala, kishte qytetin e hapur, ai pushtohet prej turqve, duke mbetur nën të për pesë shekuj. Kjo periudhë e shekujve XV – XIX, e cila mund të emërtohet si Mesjetë e vonë, është periudha e zgjerimit të vazhdueshëm të qytetit të hapur jashtë mureve rrethues të Kalasë, gjithë duke mbetur kjo lagje pjesë e rëndësishme e jetës së qytetit.

Sipas rregjistrit fiskal të vitit 1431 gjatë kësaj kohe Berati kishte 216 banesa, të cilat i përkisnin pjesës jashtë lagjes Kala. Xhamia Mbret e shekullit XV, poshtë në zonën fushore në lindje të Kalasë, tregon se qyteti i hapur kishte filluar të zgjerohej përtej truallit të thepisur shkëmbor të lagjes Mangalem. Pas pushtimit, Berati u përfshi në sistemin administrativ Osman, duke u kthyer në kryeqendër të Vilajetit të Beratit, njërit prej dhjetë vilajeteve të sanxhakut të Shqipërisë. Berati vazhdon kështu të jetë qendër administrativo - ushtarake e krahinës si dhe qendër e rëndësishme e prodhimit zejtar. Tentativa e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut më 1455 për të rimarrë qytetin prej turqve dështoi. Pas kësaj, ashtu si mbarë qytetet ballkanike edhe Berati vazhdon të zgjerohet dhe të forcojë rolin e qendrës zejtaro – tregtare. Në 1506, ai numëronte 406 banesa, që të arritur ato në 582 më 1520 dhe 1094 më 1583. Të dhënat e udhëtarit të njohur turk Evlija Çelebiu i cili vizitoi qytetin më 1670 janë me rëndësi. Nga këto të dhëna mësohet se Berati, tashmë kishte arritur në elementet thelbësore, mbarështrimin urbanistik, ndërkohë që në binomin Kala – Qytet i hapur, i dyti kishte marrë dukshëm përparësinë. Me rëndësi të veçantë për zhvillimin dhe karakterin e

DO NOT COPY

DO NOT COPY

qytetit janë të dhënat e këtij autori për tregun. Ai përmend gjithashtu mjeshtëritë e shumta që ushtroheshin në këtë pazar. Me rëndësi është përmendja e emërtimeve të lagjeve të Beratit prej Çelebiut. Në vitin 1688, në një dokument të kohës gjithashtu jepen emërtimet e lagjeve të qytetit, gjithësej 22 të tilla. Çelebiu përmend edhe urën e Goricës, mbi Osum, e cila ishte me këmbë guri mbi të cilat ngriheshin harqe druri. Feudali shqiptar Ahmet Kurt Pasha e rindërtoi atë prej guri më 1771. Gjatë shekujve XVIII- XIX, Berati vazhdon të zhvillohet, kryesisht duke dëndësuar ndërtimet në lagjet e vjetra dhe duke ngritur lagje të reja në pjesët lindore dhe perëndimore të Kalasë, në zonën fushore të saj.

Në vitin 1846 Berati kishte 830 familje muslimane dhe 460 të krishtera. Tërmeti katastrofik i vitit 1851, pati pasoja të dukshme, veçanërisht në kategorinë e banesës, asaj më të dëmtuarës krahas Kalasë dhe ndërtimeve të kultit. Dëmtimet në katet e sipërme të banesës Beratase përgjithësisht dykatëshe, krijuan rrethanat që rindërtimi i tyre të krijohej në ballet e tyre me teknikën e skeletit të drurit, e cila lejonte ndërtimin e hapësirave të mëdha të ndriçimit, kornizimet me dru, daljet në formë erkeri etj. Veprimtaria e dendur rindërtuese pas tërmetit njësoi ndijshëm, veçanërisht, ansamblet me vlera madhore të Mangalemit dhe Goricës.

Në fushën e fortifikimit edhe gjatë shekullit XVIII, Ahmet Kurt Pasha kreu punime në Kalanë e Beratit më 1788. Pas kryengritjes antiturke të vitit 1834, ajo dëmtohet rëndë dhe praktikisht kthehet në një relike historike. Lidhur me ndërtimet e kultit, si ato të kultit të krishterë dhe musliman vazhdojnë të ndërtohen gjatë shekujve XVIII – XIX. Përmendin katedralen e Shën Mërisë në Kala më 1797, xhaminë e Beqarëve, më 1827 në lagjen Mangalem etj. Me interes janë ndërtimi i çezmave të shumta në qytet, si dhe i ujësjellësit, i cili binte në qytet ujin prej burimeve në fshatin Duhanas. Ky ujësjellës, siç duket furnizonte hamamin dhe çezmat në qendër të qytetit. Për t'u përmdendur është edhe Kulla e Sahatit në qendër të qytetit, të cilën e përmend Çelebiu, por sot nuk ruhen gjurmë prej saj.

Për rrethana, do të thoshim, të favorshme, të përkujdesjeve me synime utilitare të trashëgimisë arkitektoniko – urbanistike dhe artistike të Beratit të lashtë, në rrethanat e zhvillimit të ngadalshëm të shoqërisë, e cila nuk kërkonte ndryshime të shpeshta të mënyrës së jetës, dhe më tej për shkak të kodifikimit të ndërtimeve të kultit, përgjithësisht gjendja e Beratit të vjetër ka ardhur me dëmtime të pakta deri në vitin 1961. Në këtë vit ai u vu në mbrojtje shtetërore, në mbarë vlerat e tij, duke iu nënshtruar ndërhyrjeve sistematike konservuese dhe restauruese në mbarë gjinitë, sipas kritereve bashkëkohore të fushës. Këto ndërhyrje synonin së pari ruajtjen e autenticitetit të këtyre veprave si dëshmi të papërsëritshme historiko – kulturore, pra me vlerën e dokumentit. Për këto arsye sot Berati është një dëshmi konkrete e vazhdimësisë së jetës në një qendër të banuar që prej antikitetit deri në ditët tona.



PAMJE E NJE BANESE TRADICIONALE NE LAGJEN MANGALEM - BERAT

JUSTIFIKIMI PËR PËRFSHIRJE NË LISTËN E PASURIVE BOTËRORE TË UNESCO's

a. Kriteret sipas të cilave bëhet propozimi

Qendra historike e qytetit të Beratit është nje site, sipas definicionit të Konventës për pasuritë botërore.

PROTECTED COPY

Qendra historike e Beratit në gjendjen e sotme vjen si një pasuri kulturore e cila përfshin një numër të madh dëshmish urbanistiko – arkitektonike qe prej antikitetit, mesjetës dhe deri në ditët tona. Këto dëshmi, të shtrira në një hark kohor, relativisht të gjerë prej 24 shekujsh janë kategori të ndryshme gjinore. Brenda së njëjtës gjini si fortifikimeve, ndërtimeve të kultit dhe banesave, ndeshim qartë evoluimin e koncepteve urbanistiko – arkitektonike në përputhje me kushtet ekonomiko – sociale të epokave të ndryshme, si dhe teknikave përkatëse të ndërtimit. Kështu që Kalaja e Beratit shfaqet si një bashkësi teknikash të ndryshme ndërtimi që karakterizojnë atë të periudhës Ilire (shek IV – V), bizantine (shek V – XV) dhe turke (shek XV – XX), gjithë duke pasur brenda tyre evolucion, në treguesit kryesorë përbërës dhe teknikë. Ndërtimi i kultit të dy besimeve kristian dhe mysliman, dallohen për larminë tipologjike e cila ndjek evolucionin kësaj gjinie në kohë. Kështu kishat e Beratit ndeshen të tipit të kryqit të brendashkruar, kapela, bazilika një dhe trenefëshe etj. Xhamitë gjithashtu shfaqen me larmi tipologjike dhe me ndikim të faktorit lokal, siç e shohim në xhaminë e Beqarëve.

KRITERI II

Tesuti urbanistik i Beratit është i larmë, duke u ndikuar kryesisht prej mureve rrethuese të vendbanimit si në lagjen Kala, truallit të pjerrët shkëmbor si në lagjet Mangalem dhe Goricë dhe prej truallit të sheshtë si në lagjen Murat Çelepias. Banesat e Qendrës Historike të Beratit i përkasin kryesisht shekujve XVIII – XIX. Konsideratat e mësipërme tregojnë se Berati në gjendjen e sotme i plotëson kërkesat e Kriterit II të kritereve për vlerësimin e vlerave të jashtëzakonshme universale, duke dëshmuar një ndryshim ndikimesh të konsiderue-shme gjatë një periudhe 24 shekullore në hapësirën kulturore Shqiptare të përfshirë në ato Antike, Romake, Bizantine dhe Osmane, gjithë duke ruajtur identitetin etnik.

KRITERI III

Në gjendjen e sotme Qendra Historike e Beratit, në mbarë arealin Ballkanik, paraqitet si shembull i vetëm i një qendre të banuar me jetë të pandërprerë 24 shekullore, duke u dëshmuar kjo ecuri, ku më shumë e ku më pak me mbeturina ndërtimesh dhe ndërtime, krahas veprave të arteve të fushës së besimit. Shtojmë se nëntoka e Beratit, ruan vlera të rëndësishme të cilat presin gërmime arkeologjike. Lagja Kala, brenda mureve rrethues të fortifikimit shumëfazësh, shfaqet si një dëshmi e jashtëzakonshme. Kjo lagje rrethohet në pjesët perëndimore, jugore dhe lindore me qytetin e hapur, i cili zë fill që në shekullin XIII. Duke konsideruar faktet e mësipërme, mund të pohojmë se Qendra Historike e Beratit i plotëson gjithashtu kërkesat e Kriterit III të kritereve për vlerësimin e vlerave të jashtëzakonshme universale, duke sjellë një shembull të jashtëzakonshëm dhe unik mbi një traditë kulturore që tashmë i përket së kaluarës.

KRITERI VI

Berati është i lidhur edhe me rryma artistike të një rëndësie universale, siç është shkolla ikonografike e Beratit e piktorit të njohur të shek XVI, Onufri, e cila pati për një kohë të gjatë ndikim të gjerë jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Greqi, Maqedoni dhe Itali e Jugut. Dëshmi të shumta si, ikona dhe afreskë ruhen në kisha muzeume dhe koleksione private. Gjithashtu, këto vlera janë paraqitur nëpër ekspozita të organizuara në mënyrë periodike që prej vitit 1992 kryesisht në Itali po edhe në Gjermani.

Vlera të tjera artistike universale provojnë se Berati përmbush edhe Kriterin VI të kritereve për vlerësimin e vlerave të jashtëzakonshme universale.

a) Codex Purpureus i shek VI është Kodik unik në Botë
b) Codex Aureus i shek X është një ndër 5 kodikët e vetëm, e botës së artit Hrysografik Bizantin.

Bukuria e këtij qyteti ka qenë frymëzimi i shumë veprave letrare dhe atyre të arteve vizive.

b. Deklarimi i vlerave të jashtëzakonshme universale

Qendra historike e Beratit, një bashkësi ndërtimesh, gjurmësh ndërtimore dhe veprash arti që prej antikitetit dhe deri në ditët tona, si qendër e fortifikuar banimi njihet që në shek. IV p.e.s. I ngritur

në një kodër, që së bashku me Kalanë binjake të Goricës, Berati kontrollonte rrugën e kalimit prej zonës malore lindore në hapësirën e fushës së Myzeqesë. Ai që në antikitet pati pranë qytete të fuqishme antike si Apollonin ë, Nikaen, Bylisin, Dimalin etj. Këto qytete herët a vonë nuk i qëndruan dot rrebesheve dhe kushteve të kohës, ndërsa Berati gjalloi vijueshëm për 24 shekuj. Kështu ai na vjen si dëshmi autentike e dukurive urbanistiko – arkitekturore të një hapësire të gjerë kohore, të cilat përbëjnë burime të vërteta historike.

Dukuritë urbanistiko – arkitekturore të qendrës historike të Beratit janë përfaqësuese të periudhave të ndryshme historike të bashkëlidhura organikisht duke qenë shembull tepër i rrallë, madje unikal, në të cilin ndeshim dukuri të periudhave të ndryshme, me lidhje organike funksionale ndërmjet tyre. Kështu me planin urbanistik, në Berat ruhen mirë periudhat e kalimit prej qytetit të mbyllur, sepse të fortifikuar, në qytetin e hapur që në shek. XIII, për tu konsoliduar kjo dukuri me fillimin e ndërtimeve në lagjen Mangalem në shek. XV. Kjo dhe lagja përballë Goricës janë shembuj të arritur të realizimeve të urbanistikës spontane mesjetare në mbarë hapësirën ballkanike. Ajo gjithë duke mos u paraprirë prej planifikimit, në rastin e Beratit, shfaqet me koncepte racionale si ndërlidhja e ndërtuesve me truallin, rrjetin rrugor funksional, diellëzimin e mjaftueshëm dhe njësinë stilistike. Edhe pjesët rreth zonës së Qendrës historike janë me interes në planin urbanistik, duke u shfaqur me zgjidhje të lira, ku spontaniteti gjen hapësire të gjerë.

Berati me Qendrën e tij historike, me gjendjen e sotme, dëshmon prekshëm një rrugë të gjatë evolutive konceptuale dhe teknike në binomin urbanistikë – arkitekturë. Përbërësi arkitekturë në ndërtimet e Beratit ndeshet me shkallë të lartë autenticiteti në tre përbërësit themelorë të Qendrës Historike, fortifikimit, ndërtimeve të kultit dhe banesave.

Fortifikimi shumëduarsh, sepse ka qenë objekt sulmi dhe përmirësimesh të vazhdueshme teknike, ruan natyrshëm vlerat e periudhave të ndryshme në një hark kohor disa-shekullor. Ndërtimet e kultit me programe të kanonizuara, dallohen për tipologji të kristianizuara, të cilat ndeshen me ndryshime të vogla përgjatë shekujsh. Të dy kategoritë e ndërtimit të kultit të krishterë dhe mysliman, janë dëshmi e prekshme e mirëkuptimit shumë shekullor përgjatë shekujve karakteristike kjo e një vlere të vërtetë kulturore e cila ka rritur imazhin Beratit shumë-shekullor. Qendra Historike e Beratit, me kategorinë e banesës qartazi më evolutive se dy kategoritë e mësipërme shfaqet me vlera të veçanta. Këto vlera të cilat nga ana arkitekturore i përkasin shekujve 18-të – 19-të, duke qenë dëshmitë e shekullit të 19-të me të shumtat, në dallim prej shumë qendrave të tjera të Shqipërisë dhe hapësirës ballkanike, dallojnë për larminë e kompozimeve, kryesisht për shkak të truallit të pjerrët shkëmbor mbi të cilin ngrihen të tre lagjet e Qendrës Historike. Ato shquajnë për modelimin e gjetur arkitekturor dhe ndërlidhjen organike ndërmjet tyre, duke krijuar ansamble që shquajnë për vlera të vërteta urbanistiko estetike, në mbarë arealin ballkanik, gjatë shekujve 18–19-të.

c. Analiza krahasuese

Qendra Historike e Beratit me dëshmitë urbanistiko – arkitekturore, të shtrira gjatë dhe vijueshëm në kohë që prej shekullit të IV p.e.s shfaqet si një shembull i jashtëzakonshëm dhe unik në mbarë arealin ballkanik. Qendra e banuar brenda Kalasë, fillesa, me vazhdimësi të pandërprerë të jetës, në bashkë-marrëdhënie konstante me qytetin e poshtëm, që në shek. XIII dhe qytetin e hapur që në shek. XV, paraqet një qendër sa dinamike aq dhe të përshtatur me evolucionin e mënyrën e jetesës.

A. Ne hapësirën shqiptare ndeshim shembuj lagjesh të banuara brenda kalash antike e mesjetare, por asnjëra prej tyre nuk ka bashkëjetuar organikisht me pjesën e hapur të qendrës së banuar si Berati. Kështu lagja e banuar në Kalanë e Himarës, mbeti e tillë pa zhvillimin e qytetit të hapur, ndërsa gjithashtu kalaja e Tepelenës e shekullit të XIX me një lagje të vogël nuk mund të krahasohet me Beratin. Edhe lagja Kala brenda kastrumit romak të Elbasanit mbi themelet e të cilit turqit në shek. e XV e ringritën atë, është një dukuri e veçantë që nuk mund të krahasohet me vijueshmërinë organike të qendrës së banuar të Beratit në shekuj.

B. Edhe qendra të tjera të fortifikuara në arealin

DO NOT COPY

ballkanik si Tivari, Budva, Kotorri, Dubrovniku apo Ohri, Janina etj, nuk shfaqin tiparet unikale të Beratit me karakteristikat thelbësore si qendër e fortifikuar e bashkëlidhur organikisht dhe vijueshëm me hapësira të reja banimi, pranë dhe përreth Kalasë. Edhe në hapësirën europiane nuk ndeshim qendra të banuara me vazhdimësi 24 shekullore.

Krahasuar me Qendrën Historike të Gjirokastrës, megjithë distancën e afërt, Berati dallohet ndjeshëm. Ndërsa Gjirokastra, megjithëse qendra e banuar e fortifikuar është dukuri e vonë e shek. XIII, e cila bashkëjeton me qytetin e hapur, me fillesa në shek. XIV. Në fillim të shek. XIX banesat e pakëta të qendrës së banuar brenda Kalasë, zhvendosen përfundimisht prej saj. Gjirokastra qe kryesisht qendër administrative dhe ushtarake, rezidencë e shtresave latifondiste dhe funksionarëve të lartë, ndërsa Berati qendër e mirëfilltë zejtaro-tregtare. Kjo shihet edhe në karakterin e banesës gjirokastrite, me tipare të fortifikuara dhe qartësisht të tipizuara, në dallim prej banesës Beratase me variacione të shumta kompozicionale dhe me përmasa dallueshëm më të vogla se ato Gjirokastrite. Ndërtimet e kultit në Gjirokastër janë sa të pakta në numër aq edhe me vlera modeste në krahasim me realizimet madhështore të Beratit. Monumentaliteti disi i ashpër i ndërtimeve të Gjirokastrës përballet me harmoninë dhe njësinë e ansambleve piktoreske të Beratit. Gjirokastra dhe Berati duke qenë të ndryshëm janë dhe njëherazi komplementare, duke përfaqësuar dy kulme të krijimtarisë popullore shqiptare në mbarë hapësirën ballkanike dhe evropiane.

d. Integriteti dhe autenticiteti

Qendra Historike e Beratit, vjen në ditët tona me një bashkësi përbërësish urbanistiko – arkitekturorë dhe artistikë, të cilët mbulojnë hapësirën 24 shekullore të historisë së qytetit. Këta përbërës të gjinive të ndryshme shfaqen në evolucion të qartë tipologjik, arkitekturor dhe teknik në përputhje me periudhën së cilës i përkasin, gjithë duke qenë përbërës të një njësie homogjene urbane. Dëshmitë e sotme të qytetit të Beratit paraqesin një përfaqësim të plotë të evolucionit të kësaj qendre në shekuj, të cilat shprehin vlerat e saj të jashtëzakonshme universale.

Fatmirësisht, që prej humbjes së vlerave funksionale të fortifikimit të qytetit të sipërm më 1834, ai nuk pësoi rrënime, por thjesht iu ekspozua degradimit të natyrshëm. Ky degradim nuk qe i përmasave të mëdha për shkak të qëndrueshmërisë së strukturave të fortifikimit. Ndërtimet e kultit për natyrën e tyre patën vijueshëm kujdesin e besimtarëve, ndërsa periudha e ndalimit të institucioneve fetare në vitet 1967 – 1990, nuk ndikoi në ndërtimet e kultit, të vëna në mbrojtje shtetërore si monumente, në qytetin e Beratit. Kategoria e banesave, më e prekshme ndaj ndryshimeve, për vetë natyrën e saj, gjithashtu nuk pësoi ndryshime të rëndësishme në kohë. Banesat e tipit me çardak, të ndërtuara kryesisht në pjesën fushore të Beratit dhe në brezin e poshtëm të lagjes Goricë, kanë pësuar ndryshime kryesisht me mbylljen e ambjenteve të hapura, duke mos cënuar strukturën kompozicionale dhe duke respektuar frymën arkitekturore origjinale. Shumica e banesave prej guri të qytetit, veçanërisht në Qendrën Historike kanë pasur rindërtime në katin e sipërm pas tërmetit të vitit 1851, duke respektuar hapësirat origjinale, por duke futur në banesë frymën e kohës në këtë kategori ndërtimore.

Gjatë gjysmës së parë të shekullit të XX, banesa qytetare Beratase për shkak të arritjeve të qëndrueshme në planin funksional dhe teknik dhe gjendjes së vështirë ekonomike të vendit, nuk iu nënshtrua ndryshimeve të rëndësishme duke ruajtur mjaft mirë vlerat origjinale. Relativisht herët, madje dhe në plan evropian, sensibilizimi i qeverise shqiptare për vlera të trashëgimisë popullore dhe trashëgimisë kulturore në përgjithësi, bënë që Qendra Historike e Beratit të shpallet "Qytet Muze" dhe si i tillë të vihej në mbrojtje shtetërore me 2 qershor 1961. Prej kësaj date vlerat e trashëgimisë kulturore të Beratit iu nënshtruan përkujdesjeve të specializuara në përputhje me kriteret e njohura të restaurimit, duke shpëtuar njëherë e përgjithmonë prej rrezikut të dëmtimeve për arsye nga më të ndryshmet.

Shqipëria bashkëfirmatare e Kartës se Venecias më 1964, qe zbatuesja rigoroze e kritereve të sanksionuara në të. Duhet pohuar se si për volumin e ndërhyrjeve në Qendrën Historike të Beratit ashtu

DO NOT COPY

dhe kritereve me të cilat kryheshin këto ndërhyrje Shqipëria zinte një vend të rëndësishëm në arealin ballkanik. Përmendim se Dr. Andrash Roman, i cili vizitoi Shqipërinë prej 18 – 22 nëntorit 1991, sipas kërkesës se ICOMOS për të parë Qendrat Historike të Beratit dhe Gjirokastrës, në vijim të kërkesës së qeverisë Shqiptare për përfshirjen e këtyre qyteteve në listën e Pasurisë Botërore, në raportin e tij, dërguar UNESCO-s më 2 dhjetor 1991, shkruante ndërmjet të tjerash "Si vërejtje të përgjithshme mund të shënoj se mbrojtja e monumenteve në Shqipëri është në standardet më të mira evropiane, si tregojnë punimet e restaurimit të kryera me një nivel të lartë autenticiteti".



URA E GORICES (1778)

Përfundimisht mund të pohohet se integriteti dhe autenticiteti në Qendrën Historike të Beratit i plotësojnë kushtet e njohura ndërkombëtare, kur është fjala për tu përfshirë kjo pasuri kulturore në Listën e Pasurive Botërore.

GJENDJA E KONSERVIMIT DHE FAKTORËT QË NDIKOJNË NË ZONËN E PROPOZUAR

a. Gjendja e sotme e konservimit

Në përgjithësi mund të provohet se gjendja e sotme e Qendrës Historike të Beratit është e mirë. Me këtë cilësim kuptojmë, ekzistencën e kuadrit të plotë ligjor për vlerësimin e kësaj pasurie kulturore, kryerjen sistematike të ndërhyrjeve restauruese, veçanërisht gjatë viteve 1965 – 1990 dhe kujdesin e pushtetit lokal dhe qytetarëve të Beratit për ruajtjen e vlerave të Qendrës Historike. Pas viteve 1990 kujdesi për Beratin, prej shtetit Shqiptar ka pësuar rënie, për arsye të periudhës së vështirë të tranzicionit politik dhe ekonomik Vitet e fundit interesi për Trashëgiminë Kulturore dhe posaçërisht për Beratin, veçanërisht prej pushtetit lokal është rritur ndjeshëm për të qenë në përputhje me detyrimet ligjore. Shmangiet ligjore të rregulloreve për mbrojtjen e Qendrës Historike të Beratit, tashmë nuk ndeshen më, ndërsa disa tjetërsime në lëmin e banesës tradicionale presin ndërhyrje për kthimin në gjendje fillestare apo adaptime, brenda kritereve të njohura të fushës.

Qendra Historike e Beratit është vënë në mbrojtje të shtetit në cilësinë "Qytet – Muze" me Vendim të Këshillit të Ministrave të Shqipërisë, nr. 172, të datës 02. 06. 1961. Ai me pas është trajtuar me frymën e dekretit nr. 568 të datës 17. 03. 1948, lidhur me "Konservimin e monumenteve kulturore dhe natyrore të rralla, të miratuara me ligjin nr 609, të 24.09.1948. Ky ligj është zëvendësuar me atë të datës 23.09.1971 dhe më pas me ligjin nr. 7867 të datës 23.10.1994. Së fundi ky ligj është zëvendësuar me ligjin nr. 9848 të datës 07.04.2003, mbi Pasurinë Kulturore, i cili është në fuqi. Rregullorja e parë mbi Mbrojtjen e "Qytetit Muze" të Beratit është ajo e datës 02.06.1961. Rregullorja në fuqi është ajo e miratuar.

Rregullorja e re e përgatitur nga Instituti i Monumenteve të Kulturës në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë e qytetit të Beratit me vendim

DO NOT COPY

të Këshillit të Ministrave nr. të datës 30.12.2005.

Momentet me të rëndësishme të rregullores për mbrojtjen e Qendrës Historike të Beratit kanë lidhje me zonat dhe monumentet që përfshihen në të, apo rrethojnë atë. Kështu Qendra Historike ruhet në tërësinë e përbërësve të saj urbanistiko – arkitekturorë dhe ambjentalë, ndërsa Zona Tampon, që e rrethon, synon të ruajë vlerat e Qendrës Historike, duke pasur kushtëzime për ndërtimet në këtë zonë. Monumentet e veçantë ndahen në dy kategori, në atë të kategorisë se parë dhe të kategorisë së dytë. Monumentet e kategorisë së parë, që shtrihen në mbarë qytetin e Beratit dhe kryesisht në Qendrën Historike, ruhen në mbarë përbërësit kompozicionalë dhe arkitekturorë. Monumentet e kategorisë së dytë janë të gjithë ndërtime brenda Qendrës Historike të pa cilësuar monumente të kategorisë së parë. Ato ruhen në volume dhe në pamjen e jashtme të tyre, ndërsa në brendësi mund të bëhen ndryshime në përputhje me kërkesat prej mënyrës së sotme të jetesës.

Në gjendjen e sotme, në Qendrën Historike të Beratit dhe jashtë saj, ruhen 64 monumente të kategorisë së parë të gjinive: fortifikime, ndërtime kulti, banesa etj. Monumentet e kategorisë së dytë, kryesisht banesa dhe disa ndërtime kulti janë 380.

Me vënien në mbrojtje të Qendrës Historike të Beratit filloi ndërhyrja sistematike konservuese dhe restauruese në ansamblet e saj. Çdo vit, sipas projektesh të hartuara nga Instituti i Monumenteve me qendër në Tiranë, filluan të kryhen punime sistematike për vlerësimin e monumenteve të Beratit. Specialistet e fushës u mbështetën fuqishëm mbi parimet e Kartës së Venecias në të cilën Shqipëria qe bashkënënshkruese. Specialistët patën hapësira të mjaftueshme për të zbatuar këto parime edhe në fushën e banesës popullore Beratase, kuptueshëm me probleme për shkak të mospërputhjes së formulimit tradicional të banesave në planin kompozicional dhe arkitekturor dhe kërkesave të sotme të jetesës. Ndërhyrjet përfshinë Kalanë me ndërhyrje konsoliduese, pastrime dhe largime hedhjesh ndërtimore, për të dalë në pah strukturat origjinale. Edhe në fushën e ndërtimeve të kultit janë kryer veprimtari të rëndësishme restauruese si në monumentet e kategorisë së parë, ashtu dhe ato të kategorisë së dytë, si në përbërësin arkitekturor dhe atë artistik. Këto ndërhyrje, të cilat kanë respektuar rigorozisht kriteret e restaurimit dhe kriterin themelor të ruajtjes së substancës origjinale kanë ndikuar në ruajtjen dhe nxjerrjen në pah të vlerave të këtyre monumenteve. Volumi më i madh i ndërhyrjeve restauruese i përket gjinisë së banesave, në të cilat gjithashtu janë zbatuar kriteret e restaurimit, duke u detyruar të kryhen në disa raste edhe zëvendësim strukturash tejet të degraduara, si e vetmja rrugë për të ruajtur formën e njohur të strukturës.

Deri më sot në qytetin e Beratit është kryer ndërhyrje me punime restauruese në 55 monumente të kategorisë së parë, pra në 86 % dhe në 227 monumente të kategorisë së dytë, pra në 60 %. Degradimi i monumenteve si një proces i natyrshëm, dhe i pashmangshëm, por i cili mund të ngadalësohet me përkujdesje të vazhdueshme, edhe në Berat, paraqet një konstante vazhdimësie të ndërhyrjeve mirëmbajtëse dhe atyre restauruese të herëpashershme. Në gjendjen e sotme 14 monumente të kategorisë së dytë, pra 4 % kanë nevojë për ndërhyrje emergjente. Në gjendjen e sotme 7 monumente të kategorisë së parë, pra 11 % dhe 30 monumente të kategorisë së dytë, pra 8 % kanë nevojë për ndërhyrje restauruese. Ndërsa 57 monumente të kategorisë së parë, pra 89 % dhe 350 pra 92 % monumente të kategorisë së dytë janë në gjendje të mirë. Gjendja e rrezikshme mund të mënjanohet brenda një periudhe 3 vjeçare. Problematike paraqitet gjendja e afreskëve në kisha dhe pikturave, me teknikën asecco, në xhami si dhe ikonave veprimtari e cila kërkon një përkujdesje të veçantë dhe përpjekje për rritjen e numrit dhe kualifikimit të restauratorëve.

b. Faktorët që prekin pasurinë

– (i). Presionet e ushtruar si pasojë e zhvillimit

Në të tre kategoritë ndërtimore të Qendrës Historike të Beratit ato të fortifikimit, ndërtimeve të kultit dhe banesave presionet që ushtrohen për dëmtimin e vlerave të monumenteve nuk ekzistojnë, apo janë të ndryshme. Në kategorinë e fortifikimit nuk ndeshen presione. Përkundrazi në gjininë e banesave, të cilat përbëjnë numrin më të madh të

DOKTORATURA

DO NOT COPY

monumenteve në Qendrën Historike të Beratit ndeshen presione të zgjerimeve, kërkesa për rindërtime mbi bazë të dhënash, për banesa që sot janë rrënoja etj. Legjislacioni për mbrojtjen e monumenteve ka qenë dhe është i qartë për të ndaluar këto veprime. Megjithëkëtë gjatë vitit 1997, ka pasur shmangie të këtyre kritereve. Organizmat shtetëror, mbi bazën e denoncimeve të Drejtorisë Rajonale për monumentet në Berat, i kanë evidentuar këto parregullsi dhe mbi bazën e ligjit pritet që të veprohet në dobi të ruajtjes së vlerave të monumenteve.

Vitet e fundit vërehet një sensibilizim i ndjeshëm i pushtetit lokal dhe masës së gjerë të qytetarëve për ruajtjen vlerave të Qendrës Historike të Beratit, faktorë këta tepër të rëndësishëm.

– (ii). Vështirësi lidhur me ambjentin

Qendra Historike e Beratit, nuk paraqet probleme te lidhura me ndotjen e agjentit. Faktorët klimaterike janë në parametra normalë. Megjithatë vrojtime të mëtejshme duhet të kryhen në këtë fushe.

– (iii). Katastrofa natyrore dhe përgatitja ndaj rrezikut të tyre

Lidhur me faktorët e fatkeqësive natyrore, për sa i përket tërmeteve, Berati përfshihet në zonën 7 – 8 të shkallës Richter. Kuptohet se vetëm kur nuk dëmtohen parimet e restaurimit në këto ndërhyrje, është pasur parasysh marrja e masave të mundshme teknike kundër tërmeteve.

Daljet e rralla të lumit Osum prej shtratit nuk paraqesin rrezik për Qendrën Historike të Beratit. Për sa i përket masave të sigurisë kundër zjarrit, ato janë në përputhje me ligjin, por duhen forcuar për Qendrën Historike edhe për faktin e vështirë për të ardhur, madje për t'u afruar me objektin e përfshirë prej zjarrit të automjeteve të zjarrëfiksave. Përsa më sipër ekziston edhe një rregullore e veçantë e cila trajton këto probleme.

–(iv). Trysnia e vizitorëve

Tani për tani numri i vizitorëve të turizmit kulturor është i vogël dhe nuk paraqet asnjë faktor dëmtues. Edhe në të ardhmen, sado që të shtohet ai Qendra Historike është e aftë të përthithë ata pa u dëmtuar. I vetmi problem i pritshëm është ai i vizitave nëpër objektet e kultit, i cili mund të disiplinohet lehtë nëpërmjet formave të ndryshme, për të mos lejuar dëmtim eventual të veprave të artit në këto objekte.

– (v). Numri i banorëve brenda perimetrit të Qendrës Historike dhe Zonës Tampon (viti 2005)

Numri i banorëve në Qendrën Historike :4070
Numri i banorëve në Zonën Tampon :9850
Shuma :13920



PAMJE E NJE RRUGICE KARAKTERISTIKE TE LAGJES KALA

MBROJTJA DHE MENAXHIMI I ZONËS SË PROPOZUAR

a. E drejta e pronësisë

Në Qendrën Historike të Beratit dhe zonën tampon ndeshemi në tre lloje pronësish: ato shtetërore (fortifikimi dhe disa banesa), pronësi të institucioneve fetare (ndërtimet e kultit) dhe pronësitë

private, të cilat përfshijnë kryesisht banesat në hapësirën e mbrojtur të Beratit.

b. Klasifikimi i mbrojtjes

Mbrojtja e Qendrës Historike të Beratit është bazuar mbi aktet e mëposhtme ligjore:

1. Dekreti i Këshillit të Ministrave nr. 172 datë 02.06.1961.
2. Ligji nr. 9048 i datës 07.04.2003 "Mbi mbrojtjen e Pasurisë Kulturore të luajtshme dhe të pa luajtshme".
3. Rregullorja për Qendrën Historike të Beratit miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 826, datë 30.12.2005 "Mbi shpalljen e Qendrës Historike të qytetit – muze të Beratit dhe aprovimin e rregullores për administrimin e kësaj qendre".

Lista e parë e monumenteve me mbrojtje të shtetit në Shqipëri i përket vendimit të Institutit të Shkencave nr. 93, datë 16.10.1948. Në këtë listë përfshihen edhe Kalaja e Beratit, ura mbi Osum, katër kisha dhe një xhami. Lista e monumenteve të kategorisë se parë në qytetin e Beratit i bashkangjitet vendimit nr. 172 datë 02.06.1961, të Këshillit të Ministrave. Kjo listë përfshin 50 monumente, shumica e të cilave të gjinisë së banesave popullore. Në vitin 1963 janë shpallur edhe dy monumente të kategorisë se parë, ndërsa në vitet 1973, 1977 dhe 1983 nga një monument.

c. Mjetet e zbatimit të masave mbrojtëse

Kuadri ligjor për mbrojtjen e Qendrës Historike të Beratit dhe monumenteve që formojnë atë është i plotë. Zbatimi i tij është në përgjithësi i drejtë dhe kjo garantohet falë financimeve të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe ndonjëherë të dhuruesve privatë. Bashkia e qytetit të Beratit është në bashkëpunim të vazhdueshëm me Drejtorinë Rajonale të Monumenteve të Kulturës. Gjithashtu ekziston partneritet i vazhdueshëm midis pronarëve dhe sektorit privat të interesuar në të gjitha segmentet që sigurojnë zbatimin e ligjeve dhe rregullave për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

d. Planet e sotme lidhur me bashkinë apo rajonin ku përfshihet zona e propozuar

f. Burimet dhe niveli i financimit

Që prej vënies në mbrojtje shtetërore të disa ndërtimeve në Berat në cilësinë e monumentit, në vitin 1948 dhe deri në vitin 1990, ku Shqipëria ndërroi sistemin politik duke përqafuar atë demokratik, mbarë shpenzimet për vlerësimin e monumenteve, pra edhe atyre të Beratit mbuloheshin prej shtetit në forma të ndryshme. Kështu ndërtimet – MONUMENT të të dy kategorive restauroheshin krejtësisht me shpenzimet e shtetit kur ishin pronë shtetërore, apo i përkisnin institucioneve fetare. Shpenzimet e restaurimit në monumentet në pronën private, kur ishin të kategorisë së parë mbuloheshin prej shtetit në masën 50%, ndërsa në monumentet e kategorisë së dytë prej shtetit 30% ndërsa prej pronarëve 70%. Kur pronarët nuk kishin mjete financiare atëherë përfitonin kredi me interes të ulët. E njëjta praktikë ndiqet ende edhe pas ndryshimeve politike të viteve 90 të shekullit të kaluar. Në gjendjen e sotme financimet vazhdojnë të jenë kryesisht prej shtetit. Krahas me hapjen e Shqipërisë ndaj botës, kanë filluar të gjenden edhe fonde alternative prej investimesh private vendase si dhe të huaja, gjithashtu dhe prej fondacionesh dhe organizmash ndërkombëtare.

Në gjendjen e sotme fondet për restaurimin e monumenteve të Beratit pritet të rriten.

g. Burimet për kualifikim në teknikat e reja të konservimit dhe menaxhimit

Në fushën e vlerësimit të monumenteve në Shqipëri, të kuptuar si bashkësia e veprimtarive për gjurmimin, dokumentimin, studimin, restaurimin dhe publikimin në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar është arritur që të krijohet rrjeti institucional dhe kuadrin e "restaurator i tre niveleve". Kështu mbi bazën e një institucioni paraardhës, më 1965, është krijuar Instituti i Monumenteve të Kulturës në Tiranë, me detyrë mbrojtjen dhe restaurimin e monumenteve

DO NOT COPY

DO NOT COPY

në Shqipëri.

Ai ka në përbërje të tij shtatë drejtori rajonale monumentesh me qendër në qytete të ndryshme të Shqipërisë. Drejtoritë Rajonale mbulojnë hapësira të përcaktuara të territorit të vendit, duke qenë përgjegjës për monumentet në këto territore. Projektet hartohen përgjithësisht prej specialistëve të Institutit të Monumenteve, apo atyre të liçencuara duke u miratuar përfundimisht në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve, i cili drejtohet prej Ministrit të Turizmit, Kultures, Rinisë dhe Sporteve.

Kuadri i lartë restaurator, kryesisht arkitektë, inxhinierë ndërtimi dhe arkeologë, janë specializuar deri më sot në punë e sipër, si dhe disa prej tyre duke ndjekur kurset e ICCROM, apo kurse jashtë vendit. Kuadri i mesëm teknik vjen prej shkollave teknike të degës së ndërtimit, ndërsa mjeshtrit e ndërtimit specializohen nëpërmjet punës dhe duke ndjekur kurse specializimi. Para viteve 1990, punimet e restaurimit kryheshin nëpërmjet organizmave zbatuese pranë degëve të Institutit të Monumenteve, ndërsa sot, krahas, ndërhyrjet restauruese kryhen edhe prej ndërmarrjeve të ndërtimit të liçencuara për fushën e restaurimit.

Për të përgatitur restauratorë në fushën e arkitekturës pranë Fakultetit të Arkitekturës të Universitetit të Tiranës këtë vit ka filluar kursi Higher Education Curricula Development Project Tempus Programme.

Në qershor të vitit 2005, u nënshkrua marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Kulturës së Shqipërisë dhe UNESCO-s në lidhje me qendrën kombëtare të restaurimit. Për herë të pare në Shqipëri do të hapet kjo qendër restaurimi, që do të trajnojë për dy vjet restauratorë që punojnë në IMK dhe në DRMK-të në rrethe, pra do të trajnohen punonjës të strukturave shtetërore për monumentet. Qendra do të trajnojë 20 restauratorë duke i ndarë në dy grupe: 10 restauratorë për arkitekturën dhe 10 për restaurimin e artit (përfshi këtu, afreskun, drurin, mozaikun dhe materiale të dala nga gërmimet arkeologjike). Ky është një fakt mjaft pozitiv pasi falë UNESCO-s dhe qeverisë Italiane, që mundëson financiarisht këtë projekt, bëhet e mundur për herë të parë në Shqipëri kjo qendër e rëndësishme për restaurimin që do të hapet në muajt e parë të vitit 2006.

h. Mbarështrimi për vizitorët dhe statistikat lidhur me to

Shqipëria deri në vitet 1990 duke qenë nën diktaturën komuniste ishte thellësisht e vetë-izoluar kështu që turizmi i jashtëm nuk ekzistonte, ndërsa turizmi i brendshëm gjithashtu qe i tillë për shkak të varfërisë ekonomike. Vetëm pas viteve '90, pengesat politike për turizmin u hoqën, por gjallërimi i tij për shumë arsye nuk mund të kryhet me shpejtësinë e synuar. Në gjendjen e sotme turizmi kulturor është në fillesat e tij në Berat. Natyrshëm cilësimi i Beratit, Pasuri Botërore do të krijonte premisa për gjallërimin e turizmit. Banesat e kategorisë së dytë dhe disa të kategorisë së parë, me lehtësi mund të kthehen në hotele madje edhe restorante të vegjël, tepër të rëndësishme për turizmin, pa cënuar vlerat për të cilat monumentet janë vënë në mbrojtje. Megjithëkëtë numri i hoteleve në qytet është rritur ndjeshëm vitet e fundit. Sot qyteti numëron 7 hotele, gjithsej me rreth 200 shtretër. Numri i restoranteve është i madh, ashtu dhe i vend-shitjeve të pijeve freskuese i mjaftueshëm. Rritja e pritshme e turizmit do të shoqërohet natyrshëm me rritjen e infrastrukturës për pritjen e këtij fluksi. Biznesmenët vendas dhe pushteti lokal, tashmë janë të gatshëm të kryejnë investime në këtë fushë, duke përfshirë dhe atë të tualeteve, vendqëndrimeve shlodhëse si dhe treguesve të nevojshëm, materialeve përshkrimore propaganduese etj. Sot në Berat një banesë e shpallur monument i kategorisë së parë është kthyer në muze etnografik, ndërsa Katedralja e Shën Mërisë në muze të artit mesjetar "Onufri". Qendra Historike e Beratit, me lagjet e saj ka mundësi të mëdha potenciale që të mirëpresë me të gjitha kushtet vizitorët, si ata ditorë, ashtu dhe ata që kërkojne të kalojnë një natë në këtë qytet me vlera të veçanta.

i. Politikat dhe programet lidhur me ndërtimin dhe promovimin e pasurisë

Në Qendrën Historike të Beratit është realizuar një politikë e suksesshme për vlerësimin e pasurisë kulturore që ruan ajo, e cila është në përputhje me artikujt 4 dhe 5 të Konventës së Pasurisë Botërore të vitit 1972. Kështu që në vitin 1961 është bërë zonifikimi



KISHA E SHEN TRIADHES
SHEK XIII – XIV – LAGJA KALA

i Qendrës Historike të Beratit, sipas së cilës Qendra Historike emërtohej, zonë-muze, ndërsa zona tampon – zonë e mbrojtur. Gjithashtu ky zonifikim u shoqërua me listën e monumenteve të kategorisë së parë, pas një punë studimore dhe seleksionuese. Sistemi ligjor që në vitin 1948, me ligjin përkatës pasuar me rregulloren e Qytetit-Muze të Beratit të vitit 1961, të cilat më vonë janë përmirësuar dhe përshtatur kushteve të reja, janë një bazë e vlefshme për mbrojtjen e kësaj pasurie kulturore. Studimet për monumentet e Beratit kanë ecur paralelisht me ndërhyrjet restauruese të filluara rreth viteve 1960. Këto ndërhyrje janë mbështetur plotësisht në Kartën e Venecias dhe dokumentet e mëvonshme ndërkombëtare mbi problemet e vlerësimit të monumenteve. Ndërkohë është strukturuar që në vitin 1965 sistemi tekniko-organizativ i mbrojtjes së monumenteve me Institutin e Monumenteve të Kulturës në kryeqytet dhe degët e tij në rrethe, njëra prej më të rëndësishmeve prej të cilave ka qenë dhe mbetet ajo e Beratit. Krahas ka ecur edhe formimi i personalitetit teknik dhe shkencor të ngarkuar me vlerësimin e Qendrës Historike të Beratit.

Në kushtet e sotme, duhen që të rritet kapaciteti profesional dhe menaxhues i Drejtorisë Rajonale të Monumenteve të Beratit për të përballuar detyrat në rritje për planifikimin e ndërhyrjeve dhe kryerjen e tyre brenda kërkesave të restaurimit, veçanërisht për monumentet e artit. Promovimi i vlerave të Beratit në planin ndërkombëtar mbetet një synim për t'u vënë në rrugën e zgjedhjes, si një konstante e përpjekjeve të këtyre vlerave si dëshmi historiko-kulturore me tregues të lartë autenticiteti.

j. Numri i punonjësve (sektori profesional, teknik dhe i mirëmbajtjes)

Në gjendjen e sotme Drejtoria Rajonale e Monumenteve të Beratit ka 54 punonjës, prej të cilëve, 9 profesionalë, 9 teknikë dhe 36 të sektorit të mirëmbajtjes. Në përbërjen e Muzeut "Onufri" dhe atij Etnografik dhe Historik përfshihen 13 punonjës prej të cilëve 4 profesionalë.

MONITORIMI

a. Treguesit kryesorë për matjen e gjendjes së konservimit

Qendra Historike e Beratit vënë në mbrojtje që në vitin 1961 ka qenë vazhdueshëm në vëmendjen e organeve kompetente për vlerësimin e kësaj pasurie duke kryer sistematikisht ndërhyrje restauruese. Pas vitit 1990 këto ndërhyrje janë pakësuar ndjshëm, ndërsa këto 2 – 3 vjetët e fundit është rritur kujdesi i shtetit për monumentet në përgjithësi dhe Qendrën Historike të Beratit në veçanti.

Për të përgatitur gjendjen e konservimit të Qendrës Historike të Beratit do të përdorim dy tregues:

- Treguesi i parë është ai i numrit të monumenteve të kategorisë së parë dhe të dytë të cilët janë në gjendje të rrezikuar.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

- Treguesi i dytë është ai i monumenteve të kategorisë së parë dhe të dytë të cilët kanë nevojë për ndërhyrje restauruese. Periodiciteti i nxjerrjes së këtyre treguesve është 5 vjeçar. Në vitin 2005 në Qendrën Historike të Beratit ka:

	Numri	*përqindja*
Monumente të kategorisë së parë në gjendje të rrezikuar	0	0 %
Monumente të kategorisë së dytë në gjendje të rrezikuar	14	4 %
Monumente të kategorisë së parë që kërkojnë restaurim	7	1 %
Monumente të kategorisë së dytë që kërkojnë restaurim	30	8 %

Këto të dhëna ruhen në arkivin teknik të Drejtorisë Rajonale të Monumenteve në Berat.

b. Masa administrative për monitorimin e zonës së propozuar

Mbrojtja e Qendrës Historike të Beratit i ngarkohet pushtetit lokal, përkatësisht Bashkisë së qytetit. Ndërsa në planin tekniko – shkencor institucioni i ngarkuar për mirëmbajtjen dhe restaurimin e Qendrës Historike të Beratit është Instituti i Monumenteve të Kulturës me qendër në kryeqytetin e Shqipërisë – Tiranë, dhe vartëses së saj Drejtorisë Rajonale të Monumenteve të Beratit.

c. Rezultate të raporteve të mëparshëm

Që prej vitit 1965, me krijimin e Institutit të Monumenteve të Kulturës në Tiranë, çdo vit Dega e Monumenteve të Beratit dërgonte raporte vjetore në Institutin qendror. Pas viteve 1990, në kushtet e tranzicionit prej diktaturës komuniste drejt sistemit demokratik kujdesi për vlerat kulturore pësoi rënie, kështuqë edhe sistemi i raportimeve vjetore dhe planeve pesëvjeçare pësoi shkëputje.

Këto vitet e fundit dhe veçanërisht gjatë vitit 2005 vërehet një rritje e ndjeshme e sensibilizimit për vlerat e Qendrës Historike të Beratit dhe në këtë kontekst, do të gjejë zgjidhje përfundimtare çështja e planeve prognoze dhe verifikimit të treguesve të gjendjes së monumenteve.

DOKUMENTACIONI

a. Fôto diapozitivë, inventare

b. Teksti i lidhur me klasifikimin për qëllime mbrojtje

c. Forma dhe data e dosjeve më të reja të invetarëve



HYRJA KRYESORE E KALASË – OBORRI I FORTIFIKUAR

Menjëherë pas vënies në mbrojtje të Qendrës Historike të Beratit ka filluar veprimtaria dokumentuese e monumenteve të kategorisë së parë në formë grafike, fotografike dhe përshkrimore. Të gjitha ndërhyrjet restauruese në monumentet e Qendrës Historike të kategorisë së parë dhe të kategorisë së dytë, janë shoqëruar sipas shkallës së ndërhyrjeve restauruese me projekte, relacione teknike dhe preventiva. I gjithë ky dokumentacion ruhet në arkivin qendror, pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës në Tiranë. Për vetë

natyrën e tij ky dokumentacion është në rritje dhe pasurim të vazhdueshëm.

d. Adresa ku ruhen invetarët, dosjet dhe arkivat

Materialet dokumentare të invetarëve, dhe dokumentacionit grafik, fotografik dhe përshkrimor të Qendrës historike të Beratit ruhen në Institutin e Monumenteve të Kulturës në Tiranë.

Adresa : Rruga "Sami Frasheri" Nr. 33 Tiranë - Albania
Tel : + 355 4 2275 11
Tel/Fax : + 355 4 2285 12
E-mail : isnkult@abcom-al.com

e. Bibliografia

Pjesa e parë – Botime në Shqip

1. **GJERGJI,** Andromaqi; ***Veshje Popullore Shqiptare/ Albanian Folk Costumes, et al, Vol. I,*** **Instituti i Kulturës Popullore, Tirana, 1999**
2. **PAPAJANI**, Lazër; ***Bibliografia e Monumenteve të Kulturës dhe të Arteve,*** Tiranë 2004, 114, 115, 117, 128, 140, 144, 150, 167, 170, 174, 248, 248/1, 404, 446, 480, 521, 522, 547, 550, 1039, 1042, 1045, 1050, 1052, 1082, 1083, 1084, 1121, 1145, 1180, 1189, 1323, 1324, 1326, 1341, 1474, 1545, 1569, 1576, 1596, 1602, 1633, 1656, 1655, 1666, 1668, 1669, 1670, 1671, 1672, 1673, 1674, 1675, 1676, 1677, 1678, 1711, 1713, 1716, 1718, 1740, 1743, 1744, 1745, 1803, 1932, 1935 (shiko librin).
3. **VARFI**, Gjin; ***Heraldika Shqiptare***, Dituria.

Pjesa e dytë – Botime në gjuhë të huaj

– HISTORI

1. **WINNIFRITH**, T.J.; ***Badlands-Borderlands: A History of Southern Albania / Northern Epirus,*** Duckworth (Pub), London, 2002.
2. **JACQUES**, Edwin; ***The Albanians: an ethnic history from prehistoric times to the present, Jefferson, N.C.;*** London: McFarland, 1995.
3. **WILKES**, John; ***The Illyrians, Blackwell Publishers,*** Oxford UK/Cambridge USA, 1992.
4. **HEGYI**, Klara – ZIMANYI; ***Vera, The Ottoman Empire in Europe,*** Corvina Kiado, Budapest, 1986.
5. **DUCELLIER**, Alain; ***La Façade Maritime de L'Albanie au Moyen Age,*** Institute for Balkan Studies, Thessaloniki, 1981.

– ARKITEKTURË

1. **KIEL**, Machiel; ***Studies on the Ottoman Architecture of the Balkans,*** Variorum, Aldershot (UK), 1990.
2. **KIEL**, Machiel; ***Ottoman Architecture in Albania (1385-1912),*** Research Centre for Islamic History, Art and Culture, Istanbul, 1990.

– ETNOGRAFI

1. **ROBERT**, DANKOFF – **ROBERT**, ELSIE; ***Evliya Celebi in Albania and Adjacent Regions (Translations from the Seyahatname),*** Brill (Pub), Leiden / Boston / Koln, 2000 (Modern Turkish / English plus facsimiles of original Ottoman Turkish).



XHAMIA E BARDHË, SHEK XV – LAGJA KALA

DO NOT COPY

2. **ROBERT**, Elsie; ***History of Albanian Literature (Vol. I), East European Monographs*** No. CCCLXXIX, Distributed by Columbia University Press, New York, 1995.
3. **KOCH**, Guntram; Albanien. ***Kunst und Kultur im Land der Skipetaren***, Cologne: DuMont, 1989.
4. **HYMAN** Susan; ***Edward Lear in the Levant. Travels in Albania, Greece and Turkey in Europe, 1848-1849***, compiled and edited by, John Murray (Pub), London,1988.

– BESIMI FETAR

1. **ROBERT**, Elsie; ***A Dictionary of Albanian Religion, Mythology and Folk, Culture,*** C. Hurst Publishers, London, 2001.
2. **NORRIS**, H.T.; ***Islam in the Balkans,*** C. Hurst Publishers, London, 1994.

INFORMACION PËR KONTAKT ME AUTORITETET PËRGJEGJËSE

a. Pjesëmarrësit në përgatitjen e dosjes

1. **Emri** : Emin RIZA
   Titulli : Profesor, Doktor Shkencash (Arkitekturë dhe Restaurim)
   Adresa : Instituti i Monumenteve të Kulturës
   Qyteti : Tiranë
   Shteti : Albania
   Tel : + 355 4 227 511
   Fax : + 355 4 228 512
   E-mail : isnkult@abcom-al.com
2. **Emri** : Apollon BAÇE
   Titulli : Profesor, Doktor Shkencash (Histori, Arkitekturë)
   Adresa : Drejtor i Institutit të Monumenteve të Kulturës
   Qyteti : Tiranë
   Shteti : Albania
   Tel : + 355 4 227 511
   Fax : + 355 4 228 512
   E-mail : isnkult@abcom-al.com
3. **Emri** : Ajet NALLBANI
   Titulli : Drejtor i Drejtorisë Rajonale, Berat
   Adresa : Drejtoria Rajonale e Monumenteve të Kulturës, Lagja "28 Nëntori"
   Qyteti : Berat
